CONTEMPORARY RESEARCH CENTER – Journal

International Journal of Social and Human sciences

Editor-in-Chief: Qashif Bakiu, PhD

Editors: Metodi Shamov, Orhan Çeku, Elitza Kumanova,

Publisher: Contemporary Research Center

International Editorial Board:

Francis Balle, prof. dr., 'Université Paris II Panthéon-Assas, R. France, Stanford University USA

Dimitar Bechev, Visiting Senior Fellow, European Institute (LSEE – Research of South Eastern Europe), London School of Economics; Oxford University, Great Britain,

Lachezar Dachev, prof. dr., Sofia University "St. Kliment Ohridski", R. Bulgaria, "Angel Kanchev" University of Ruse, R. Bulgaria

Michael Schulz, Ph.D. SCHOOL OF GLOBAL STUDIES, Associate Professor in Peace and Development Research, University of Gothenburg

Metodi Shamov, PhD, Sofia University "St. Kliment Ohridski", R. Bulgaria

Mehmet Can, prof. dr. International University of Saraevo, R. Bosnia and Hercegovina,

Ibish Mazreku, PhD, University Haxhi Zeka, R. Kosovo

Orhan Çeku, PhD, Universiteti "Pjeter Budi", R. Kosovo

Sibel Kibar, Phd, Kastamonu University, R. Turkey

Bekir Çınar, prof. dr. R. Tukey

Jorida Frakulli, PhD, Albanian University, R. Albania

Genta Skurra, PhD, Tirana University, R. Albania

Halit Shabani, PhD, University Haxhi Zeka, R. Kosovo

Dragana Ranđelović, International University of Novi Pazar, R. Serbia

Bajram Çupi, PhD, University of Tetova, R. Macedonia

Ylber Sela, PhD, University of Tetova, R. Macedonia

Qashif Bakiu, PhD, Editor-in-Chief

Editorial Council:

Salajdin Saliu (Macedonia)
Aqif Mulliqi, (Kosova)
Lemane Mustafa (Serbia)
Ismail Mehmeti (Kosova)
Arjan Gjini (Albani)
Fatmir Halili, (Kosovo)
Valmira Rada, (Albania)
Adrijana Velija (Macedonia)
Emira Limani (Kosovo)
Arsim Aziri (Macedonia)
Adelina Yankova (Bulgaria)
Svetla Marinova (Bulgaria)
Semija Saliju (Macedonia)
Fekri Iseni (Macedonia)
Liridona Vejseli (Macedonia)
Alberta Tahiri (Kosova)
Selam Isejni (Macedonia)
Enisa Murseli Gjokaj (Montenegro)

Reviewers Bord:

Lachezad Dachev
Orhan Çeku
Metodi Shamov
Alqi Naqellari
Dimitar Bechev
Hasim Deari
Elitsa Kumanova
Bajram Çupi
Ibish Mazreku
Qashif Bakiu
Musa Musai
Genta Skura
Ismail Mehmeti
Aqif Mulliqi
Afrim Halili
Rametulla Ferati

Proofreading:
(English, Albanian, German)
Visar Bakiu, Abdulla Mehmeti, Agron Kurtishi
Office assistant: S. Saliju

ISSN 1857- 9744 (Print)
Published twice a year
Qendra për Hulumtime Bashkëkohore
Account No. 210069974570114
Deponent: NLB TUTUNSKA BANKA
Account in EURO:
IBAN MK07210722000045560
SWIFT: TUTNMK22
A.D. NLB TUTUNSKA BANKA

Technical Editing/Layout:
Rexhep Rexhepi, Drilon Musai, Rilinda Hoda
Printing House:
IRIS
Editorial Office: Contemporary Research Center, Ohrid, Republic of Macedonia
A. Mustafa C/2-14, 6000, Ohrid
Phone: +389 76 404 662
e-mail: **crc-journal@crc-journal.com**
URL: www.crc-journal.com

Project coordinators:
Besian Istrefi – Europe and USA
Alban Nadzaku - Switzerland
Arjan Gjini – R. Albania
Fatmir Halili –R. Kosova
Semija Saliju – R. Macedonia
Zornitsa Yordanova – R. Bulgaria,
Enisa Murseli Gjokaj – R. Montenegro

All research articles are reviewed by at least two anonymous reviewers appointed by the Editor

ISSN1857-7474 online

www.crc-journal.com

PËRMBAJTJA:

Balkans Better Off without Tsar or Sultan 7

DIMITAR BECHEV

Zbatimi i Konventës së Vjenës të 11 Prill 1980 në Shqipëri 9

Dr. Ilda MUÇMATAJ

The principles of foster care in bulgarian legislation.....19

Elitsa Kumanova

RREGULLIMI LIGJOR DHE SITUATA AKTUALE E ORGANIZATAVE SINDIKALE NË SHQIPËRI 27

ARJAN GJIN, EJONA XHEMALAJ

E DREJTA E PERSONAVE HOMOSEKSUALË PËR TË KRIJUAR FAMILJE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 41

Dr. Xhensila KADI

MENAXHIMI DETEKTIV I SITUATAVE KRIMINALE.....49

Dashmir Nasufi

Apelimi i Vendimeve në Procedurën Administrative Doganore – Analizë Komparative.....60

Dr. Sc. Orhan M. Çeku

Dr. Sc. Ismail Mehmeti

Dr. Sc. Mentor Shaqiri

SEANCA E DËGJIMIT NË PROCEDURËN E ARBITRAZHIT.....73

Mr.Sc Kastriote VLAHNA

TË DREJTAT E PËRAFËRTA ME TË DREJTËN E AUTORIT.....87

mr.Sc Kastriote VLAHNA

IDEJA DHE RATIFIKIMI I TRAKTATIT REFORMUES TË LISBONËS 105

Ma. sc. Refik Latifi

SISTEMET ZGJEDHORE DHE NDIKIMET E TYRE NË SISTEMIN POLITIK 115

Mr. Muaz Agushi

Partitë politike shqiptare në Maqedoni dhe rroli i tyre 123

METALI ALILI , QASHIF BAKIU

POSSIBLITIES FOR EXTENSION OF TOURISM SEASON IN SOME OF THE REPUBLIC OF MACEDONIA'S PLANNING REGIONS 141

Andrea ZLATKOVSKA, Julijana SAZDOVA,

Vështrim krahasues të politikës monetare midis Republikës së Maqedonisë dhe Shqipërisë 151

Msc. Jeton Shaqiri

IDEAS, CHALLENGES AND THE FUTURE OF THE EUROPEAN UNION 159

FATMIR HALILI, SHEQIR KUTLLOVCI

THE ROLE OF SMEs ON THE ECONOMIC DEVELOPMENT: KOSOVA's CASE 167

MSc. Donjeta Morina, MSc. Prespë Gashi

BASHKËSIA JASHTËMARTESORE – ANALIZA JURIDIKO-KRAHASUESE E ZGJIDHJES LIGJORE DHE PROBLEMET NË PRAKTIKË NË REPUBLIKËN E SERBISË DHE TË MAQEDONISË 181

DOC. DR. DRAGANA RANĐELOVIĆ, MsC. LEMANE MUSTAFA

ASPEKTET GJINORE TË PRONËSISË SË PYJEVE DHE KULLOTAVE NË SHQIPËRI 197

LINDA GJERMANI

OPINION

Balkans Better Off without Tsar or Sultan

DIMITAR BECHEV[1]

The row between Moscow and Ankara may not lead to proxy contests in countries like Bosnia and Herzegovina, but Balkan states should be wary of potential consequences

Are the current tensions between Turkey and Russia likely to spill over to the Balkans? The international media coverage of the crisis following the downing of the Russian Su-24 is peppered with references to the old rivalry between the Tsarist and Ottoman Empire.

There is the notion that countries and regions squeezed in between their latterday successors, from Nagorno-Karabakh in the South Caucasus to Bosnia and Herzegovina, risk turning into areas of proxy conflict.

Not only would the Tsar and the Sultan be facing off against one another in northern Syria but also in pretty much any place where the two have friends or allies.

This scenario might look convincing at first sight but is not likely to come true in the Balkans.

Russia and Turkey may have seen their diplomatic and economic clout growing over the past decade or so, but to cast them as rivals is stretching it too far.

For starters, Turkey and Russia have both profited from the gaps and tensions in the EU and US policy in the region.

In the mid-2000s, Moscow teamed up with Serbia to fight back against Kosovo's independence and thwart Western moves on an issue which had repercussions in the post-Soviet space too.

Frustrated by the deadlock in its EU accession talks, Turkey developed an independent neighbourhood strategy and inserted itself as mediator in Bosnia, following the failure of the now forgotten Butmir talks in 2010.

The point is that Moscow and Ankara have never clashed, even when their views differed or were diametrically opposed (e.g. on Kosovo).

Economic relations between Russians and Turks have been thriving, with significant fallout for the Balkans.

Turkey allowed the South Stream gas pipeline to pass through its exclusive economic zone, and Vladimir Putin used his trip to Ankara back in December 2014 to unveil, to everyone's surprise, a new project – swiftly named Turkish Stream by President Tayyip Erdogan.

Both South Stream and Turkish Stream have commanded a lot of attention across the Balkans. From Skopje to Banja Luka politicians have been eagerly expecting a windfall from investment, transit fees, jobs and lower gas prices and taking up every opportunity to jump on the energy bandwagon set in motion by Moscow and Ankara.

The last few weeks are a belated yet sobering reminder that such expectations were inflated and misplaced from the very start.

---

[1] *Centre for European Studies at Harvard University*

After the shelving of South Stream it should serve as a lesson. The Russian decision to call off Turkish Stream only proves that the pipeline's prospects were unclear, to put it very mildly.

Few in the region bothered to read the small print, that is the fact that the two governments never signed a legal agreement, let alone a commercial deal between Gazprom and the Turkish state-owned company BOTAS.

The notion that the so-called Tesla Pipeline, a five-billion-euro extension of Turkish Stream going through Greece, Macedonia, Serbia and Hungary, will come onstream in the next five years is at best questionable.

The squabble with Russia has implications for Turkey's foreign and security policy that are sure to have repercussions across South East Europe.

Faced with instability and conflict on its southern border and with a Russian challenge in the north, Turkey has a strong incentive to deepen links its allies in NATO.

That happens at a time when the Balkans are steadily moving to the Alliance. Montenegro obtained an invitation to start membership talks during a NATO ministerial meeting earlier this month, while Serbia signed an Individual Partnership Action Plan back in January.

It is worth remembering that historically Turkey has been one of the greatest champions of NATO enlargements to the region. From the Balkans' perspective, a shift in the Turkish approach from vigorous unilateralism to multilateralism and partnership with the West is doubtless good news.

The Balkans have much to gain from a convergence between Turkey and the EU too.

The restart of membership talks with Ankara, the opening of a new negotiations chapter, and the prospect of visa-free travel for Turkish citizens (on the model already tried in the Western Balkans in the previous decade) open wide-ranging political and economic opportunities for everyone: the Union, Turkey, other membership candidates.

Cooperation between Turkey and the EU is an essential condition to deal with the refugee crisis that has swept the Western Balkans and the surrounding region over the past year.

Of course, much depends on whether the Turkish government is motivated to comply with the Brussels' conditions and whether the EU is playing a fair game.

The drift towards illiberal rule in Ankara poses severe constraints and limits as to how far the process could go.

That brings us back to Russia and its increasingly adversarial relationship with Turkey.

The recent tensions have much to do with the sort of leadership exercised by Vladimir Putin and Recep Tayyip Erdogan. The negative consequences should serve as a cautionary tale to those in Balkan societies who buy into populist politics, venerate power-hungry strongmen, at the expense of things like the rule of law, free media and civil society.

Both Putin and Erdogan surely have their fans in the fragile democracies populating the Balkans, but the governance model that they personify charts no way forward.

Zbatimi i Konventës së Vjenës të 11 Prill 1980 në Shqipëri

Dr. Ilda MUÇMATAJ[2]

UDC: 339.54(100-773:100-775) 339.54(496.5)

Abstract

The United Nations Convention on Contracts for the International Sales of Goods purpose is, to facilitate trade between the highly developed countries and those less developed. To create certainty in commercial exchanges between countries that have different legal systems, different economy and social development and to decrease transaction costs in the field of international sales of goods. The Convention, was prepared by the United Nations Commission on International Trade Law (UNCITRAL) and adopted by a diplomatic conference on 11 April 1980. Until 26 September 2014, the Convention has been ratified by 83 countries, resulting ¾ of all world trade. While countries such as Britain, India and South Africa have not yet ratified the Convention. This diversity gives a special character to the Vienna Convention, meeting its general purpose to provide a uniform text of law for international sales of goods. The Convention has in its content rules of substantive law governing the formation of the contract, obligations of the parties, remedies for breach of the contract by each of the parties, passing of risk, damages, interest, exemptions, effects of avoidance, preservation of the goods etc.

The Republic of Albania has acceded to the Convention in May 2009 with the law No. 10092 date 09.03. 2009 "For the accession of Republic of Albania in the United Nations Convention on Contracts for the International Sales of Goods" and it entered in force in 1 June 2010. Accession is performed for all parts of the Convention and the Republic of Albania has made no reservation or declaration.

***Key words**: international sale, goods, convention, uniform law, contract.*

Fusha e zbatimit të Konventës.

Dispozitat e Konventës që rregullojnë fushën e zbatimit të saj, të cilat përbëjnë edhe objektin e këtij punimi, përgjithësisht përfshihen në pjesën e Parë të Konventës dhe përcaktojnë se cilat çështje rregullohen nga Konventa dhe cilat përjashtohet nga zbatimi i saj.

Kjo Konventë do të zbatohet vetëm për kontratat tregtare të shitjes që janë lidhur pas hyrjes në fuqi të saj dhe objekti material i kontratës duhet të jenë mallrat. Vetë Konventa, në asnjë nga dispozitat e saj nuk jep përkufizimin e një termi të tillë, por si kriter kryesor për ti

[2] Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

dhënë një karakter më të gjerë termit "*mallra*"[3] mund të vijë si rrjedhojë e interpretimit të normave që rregullojnë mungesës të konformitetit (neni 35 i Konventës).

Nëse i referohemi kontratës së Shitjes, në të drejtën shqiptare, në nenin 705 të Kodit Civil, rregullohet kalimi i pronësisë mbi sendet dhe të drejtat ekzistuese por edhe kalimi i pronësisë mbi sendet dhe të drejtat e ardhshme, ku fitimi i pronësisë të tyre bëhet sapo sendi apo e drejta pranohet se ekzistojnë (Neni 706 i Kodit Civil). Sendet mund të jenë të luajtshme apo të paluajtshme, individualisht të përcaktuara apo të përcaktuara në gjini. Në termin "*sende*" përfshihen jo vetëm sendet që marrin pjesë lirisht në qarkullimin civil, por edhe ato me qarkullim të kufizuar civil,[4] të cilët mund të tjetërsohen sipas procedurave ligjore të caktuara duke u pajisur me parë me lejen apo autorizim të organeve kompetente.[5]

Ndërsa, Konventa e Vjenës në termin "*mallra*" ndryshe nga ligji i brendshëm i Republikës së Shqipërisë nuk përfshin në objektin e saj sendet e pa luajtshme. Sipas Honnold, Konventa ka për objekt të rregullimit të saj objektet e luajtshme dhe të trupëzuara, në momentin e dorëzimit të tyre.[6] Në këtë term përfshihen të gjitha objektet e reja apo të përdorura,[7] të cilat mund të jenë objekt i kontratës të shitjes ndërkombëtare të mallrave. Ndërsa jurisprudenca në termin "*mallra*", nënkupton objektet të cilat në kohën e dorëzimit janë të luajtshme dhe të prekshme të tilla si: qeniet e gjalla,[8] objektet parafarmaceotike,[9]gazi,[10] ushqimet,[11] makinat[12] etj.

Megjithatë, në përcaktimin e qëllimit të këtij termi, doktrina ka sugjeruar, që interpretimi i tij nuk duhet të bëhet në bazë të ligjit të brendshëm të shteteve, por duhet të jetë një interpretim i pavarur, autonom,[13] që do të rrjedh nga kuptimi i dispozitave të Konventës.

Sipas Konventës, shitja e dokumenteve, të tilla si: Certifikatat magazinimit të mallrave apo faturat e ngarkesës, të cilat përfaqësojnë mallrat, (në kuptimin e të drejtës së blerësit për tu pajisur me dokumentet e mallit që do të marri në dorëzim), do të konsiderohet si një shitje

---

[3] Schlechtriem & Schwenzer: "*Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)",* Third Edition, Oxford University Press (2010), fq. 34.

[4] Nuni A, "*E Drejta e Biznesit*", (2006), fq. 449-453.

[5] Si për shembull: armët e gjahut.

[6] Honnold J. O, "*Uniform Law for International Sales*", (1982), fq. 52, i cili përkrah qëndrimin se: ("*mallrat që hyjnë në fushën e rregullimit të Konventës duhet të jenë të prekshme, të trupëzuara dhe të mos jenë të drejta të patrupëzuara*").

[7] Vendim Gjyqësor Nr. 22 U 4/96, datë 21.05.1996 i Oberlandesgericht Köln, Gjermani. "*Për shitjen e një makinë të përdorur*".

[8] Vendim Gjyqësor, Nr. 5, Datë 14.01.1998 i Gjykatës së Apelit të Parisit: "*Objekti i kontratës të shitjes ishin elefantë cirku*"; po ashtu, Vendim Gjyqësor Nr. 4 O 369/99, datë 19 Janar 2001 i Landgericht Flensburg, Gjermani., "*objekti i kontratës të shitjes: dele*".

[9] Vendim Nr. 98 CIV 961 RWS, 99 CIV 3607 RWS, Datë: 21 Gusht 2002 i Gjykatës së Distriktit Federal, New York-SHBA,"*objekti kontratës të shitjes janë produkte farmaceutike klatrat-anti-koagulant*".

[10]Vendim Gjyqësor Nr. 10 Ob 518/95. datë: 6 Shkurt 1996 i Oberster Gerichtshof, , "*Objekti i kontratës të shitjes gazi*".

[11] Vendim Gjyqësor Nr. VIII ZR 159/94, datë: 8 Mars 1995 i Gjykatës se Lartë e Gjermanisë, "*Objekti i kontratës të shitjes midhjet*".

[12] Vendim Nr. 7 U 3771/97, date 28 Janar 1998, i Gjykatës së Apelit të Mynihut, "*Objekt i kontratës të shitjes automobilat*".

[13] Vendim Nr. -, date 25 Shkurt 2004 i Gjykatës së Padoves,. "*Gjykata në këtë rast argumenton se, termi i shitjes duhet të interpretohet në përputhje me dispozitat e CISG, pra në mënyre të pavarur nga ligji i një rendi të brendshëm të posaçme*".

mallrash dhe do të përfshihet në fushën e zbatimit të Konventës. Pavarësisht se mund të paraqitet vështirësi për të bërë dallimin e shitjes së mallrave, e cila realizohet nëpërmjet dorëzimit të dokumenteve nga njëra anë dhe shitjes së vetë këtyre dokumenteve nga ana tjetër, rezultati është i njëjte të dyja këto kategori hyjnë në fushën e zbatimit të saj.[14]

Konventa e Vjenës, në nenin 2 të saj përmban një listë të llojeve të shitjeve, që përjashtohen nga zbatimi i saj, ose për shkak të qëllimit të shitjes (mallra të blera për qëllime vetjake, familjare ose shtëpiake), të natyrës së shitjes (shitje përmes ankandit, përmbarimit ose përmes rasteve të tjera të zbatimit të ligjit) ose të natyrës së mallrave (pjesëmarrje në pronësi, aksione, investime në letra me vlerë, instrumente të negociueshme, mjete monetare, anije, mjete lundruese, mjete me jastëk ajri, mjete ajrore dhe energji elektrike). Në shumë Shtete, disa ose të gjitha këto shitje, rregullohen me norma të posaçme, të cilat pasqyrojnë natyrën e veçantë të tyre.

Konventa përfshin edhe përjashtime të cilat sipas disa autorëve nuk duket se "*gjen ndonjë argument të vlefshëm*". Kështu, pavarësisht se në të drejtën shqiptare sipas nenit 142 të Kodit Civil, "*Të gjitha sendet e tjera, duke përfshirë edhe çdo energji tjetër natyrore, janë sende të luajtshme*", në disa sisteme juridike energjia nuk konsiderohet si "*mall*".

Konventa sikurse e sipërlistuam nuk e konsideron si "*mall*" energjinë elektrike, por nga disa pikëpamje të doktrinës ky përjashtim mbetet i paargumentuar në masën kur burime të tjera energjie si gazi ose nafta hyjnë në kategorinë e mallrave dhe si të tillë rregullohen nga Konventa. Kjo do te na çonte në çështjen shumë të debatueshme, për të ditur nëse Konventa rregullon disa mallra që megjithëse të transportueshme nuk janë të prekshme.[15]

Nga ana tjetër, sipas neneve 4 dhe 5 të Konventës, rezulton e qartë se lënda e Konventës ka të bëjë vetëm me hartimin e kontratës dhe të drejtat dhe detyrimet e shitësit dhe blerësit, të cilat lindin nga një kontratë e tillë. Në veçanti, Konventa nuk ka të bëjë me vlefshmërinë e kontratës, pasojat që mund të ketë kontrata në lidhje me pronësinë e mallrave të shitura ose përgjegjësinë ligjore të shitësit në lidhje me vdekjen ose dëmtimin në njerëz të shkaktuar nga mallrat, kështu përjashtohet përgjegjësia e prodhuesit për dëmin jopasuror të cilin e shkaktojnë produktet e tij. Sipas disa kritikëve kjo përben një disavantazh, pasi mund të sjell probleme në interpretimin uniform të Konventës, pasi këtu përjashtohen çështje që lidhen me kalimin e pronësisë, pavlefshmërisë së kontratës etj.[16]

Zbatimi direkt.

Konventa zbatohet për kontratat e shitjes ndërkombëtare të mallrave, nëse të dy palët kontraktuese (shitësi dhe blerësi) i kanë vendet e biznesit të tyre në shtete të ndryshme të cilat e kanë ratifikuar Konventën atëherë, ato janë automatikisht subjekte të Konventës në përputhje me nenin 1(1)(a). Përjashtim nga ky rregull i përgjithshëm bën rasti kur palët me vullnetin e tyre kanë deklaruar mos zbatimin e kësaj Konvente.

[14] Schlechtriem P, Butler P "*UN Law on international sales*" Springer, (2009), fq. 28.
[15] Ferrari F, "*La Vendita Internazionale. Applicabilità e Applicazioni della Convenzione delle Nazioni Unite sui Contratti di Vendita Internazionali di Beni Mobili*", fq.112-113.
[16] Schlechtriem P, Butler P "*UN Law on international sales*", Springer, (2009), fq. 31

Për tu përgjigjur pyetjes se cili do të konsiderohet si vend biznesi përcaktues për zbatimin e Konventës, kur pala kontraktuese ka më shumë se një vend të tillë në shtete të ndryshme që mund ta kenë ratifikuar Konventën, doktrina nga njëra anë, mban qëndrimin se vendi i biznesit do të konsiderohet vendi ku ndodhet selia kryesore e personit juridik, ndërsa nga ana tjetër qëndrimi më i përkrahur është se do të konsiderohet "*vend biznesi*" vendi, që ka lidhje më të ngushta me kontratën dhe përmbushjen e saj.[17] Po ashtu, sipas doktrinës mund të jetë përcaktues, vendi i biznesit në të cilin ekzekutohet kontrata; vendi i biznesit ku zhvillohen veprimet parakontraktore; vendi i biznesit ku realizohet lidhja e kontratës; vendi i zakonshëm i biznesit apo vendi i biznesit ku ndodhet selia kryesore e një personi juridik.[18]

Ndërsa, Konventa në nenin 10(a) të saj, parashikon: "*në rast se një palë ka më shumë se një vend biznesi, vend i biznesit është ai i cili lidhet më ngushtë me kontratën dhe përmbushjen e saj, duke pasur parasysh rrethanat e njohura ose të parashikuara nga palët, në çdo kohë para ose gjatë lidhjes së kontratës*". Neni 1(2) i Konventës, shton një kusht në lidhje me përcaktimin e momentit, në të cilin vendet e biznesit te palëve kontraktuese janë në shtete të ndryshëm, kështu: "*nuk mbahet parasysh fakti se palët i kanë vendet e biznesit të tyre në shtete të ndryshme kur ky fakt nuk del as nga kontrata as nga veprimet e mëparshme ndërmjet palëve, as nga të dhënat e ofruara nga palët kontraktuese, në një moment çfarëdo para lidhjes apo gjatë lidhjes së kontratës*". Që kontrata e shitjes të jetë ndërkombëtare, presupozon jo vetëm që palët të kenë vende biznesi në shtete të ndryshme kontraktuese të Konventës, por gjithashtu që, çdonjëra prej palëve të dijë që vendi i biznesit te palës tjetër ndodhet në një shtet tjetër nga ai ku ndodhet i tij, jo më vonë se në momentin e lidhjes së kontratës.[19] Prandaj, ndryshimi i mëpasshëm në vendndodhjen e vendit te biznesit nga një shtet në një tjetër, nuk duhet të ketë asnjë ndikim mbi karakterin ndërkombëtar të kontratës.[20]

Dispozitat e fundit të Konventës, fusin dy kufizime të tjera shtesë, në lidhje me fushëveprimin territorial që ka të bëjë me disa shtete.

Njëri, vlen vetëm nëse një shtet është palë e një marrëveshjeje tjetër ndërkombëtare që përmban dispozita të cilat kanë lidhje me çështjet e rregulluara nga kjo Konventë. Ndërsa, kufizimi tjetër u lejon shteteve që kanë legjislacione të njëjta ose të ngjashme për shitjen, që të deklarojnë që Konventa nuk zbatohet mes tyre.

Zbatimi indirekt.

[17] Schlechtriem & Schwenzer: "*Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)*", Third Edition, Oxford University Press (2010), fq. 37-38.

[18] Eörsi G, "*International Sales: the U.N. Convention on Contracts for the International Sales of Goods*", New York (1984), fq. 2-29.

[19] Schlechtriem P, "*Uniform Sales Law - The Experience with Uniform Sales Laws in the Federal Republic of Germany*" (Juridisk Tidskrift, 1991/92), fq. 1-28

[20] Velicu D, "*La vendita internazionale di merci", Profilo Comparatistico*" Aracne (2007), fq. 27-30.

Konventa do të zbatohet edhe në rastin kur një ose te dyja palët kontraktuese kanë vendet e tyre të biznesit në shtete jo kontraktuese të Konventës, dhe normat e të Drejtës Ndërkombëtare Private të këtij shteti thërrasin për zbatim, ligjin e një shteti kontraktues të Konventës.[21]

Neni 1(1)(b) i Konventës, në vetveten e tij nuk është një norme konflikti, por ai përfshin të Drejtën Ndërkombëtare Private, për te përcaktuar ligjin e zbatueshëm për çështjen e dhënë, duke zgjeruar fushën e zbatimit te Konventës.

Kështu, sipas kësaj dispozite së pari, duhet të përcaktohet ligji i të Drejtës Ndërkombëtare Private që do të zbatohet, i cili mund të jetë një akt ndërkombëtar i ratifikuar nga shtetet kontraktuese të Konventës (për shembull: Konventa e Hagës e vitit 1955 "*Mbi ligjin e zbatueshëm për kontratat e shitjes ndërkombëtare te mallrave*", Konventa e Romës e vitit 1980 "*Mbi ligjin e zbatueshëm për detyrimet kontraktore*" ose Rregullorja Roma I, në lidhje me këtë çështje); ose një akt kombëtar: (për shembull: ligjet e brendshme të shtetit që rregullojnë të Drejtën Ndërkombëtare Private, për Shqipërinë: Ligji Nr. 10428 datë 02.06.2011 "*Për të Drejtën Ndërkombëtare Private*").

Së dyti, duhet verifikuar nëse shteti në të cilin ka referuar e Drejta Ndërkombëtare Private është një shtet kontraktues i Konventës të Vjenës. Nëse ky është një shtet kontraktues i Konventës atëherë, do të zbatohet ligji uniform dhe jo ligji i brendshëm i atij shteti".[22]

Përmes zbatimit të normave të së Drejtës Ndërkombëtare Private zgjerohet fusha e zbatimit të Konventës, për ketë arsye u përfshi në Konventë neni 95.[23]

Neni 95, u mundëson shteteve anëtare të Konventës të përjashtoje zbatimin e nenin 1(1)(b) të ligjit uniform dhe të lejojnë zbatimin e Konventës vetëm në rastet e parashikuara nga neni 1(1)(a), pra kur të dyja palët e kanë vendin e biznesit në shtete kontraktuese të Konventës.

Me përfshirjen e nenit 95 në Konventë, disa shtete bene rezerve pra nuk pranuan zbatimin e nenit 1(1)(b) këtu mund te përmendim: Republikën Popullore të Kinës, Republikën Çeke, Shën Vincenti dhe Grenadinet, Singaporin, Sllovakinë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kur aderoi në Konventë Kanadaja bëri rezervë për nenin 95, në lidhje me një krahinë në (British Columbia) por më vonë u tërhoq. Gjermania, ka deklaruar se nuk do të zbatojë nenin 1(1)(b) në lidhje me çdo shtet që ka bërë një deklaratë se nuk do të zbatoj nenin 1(1)(b).[24] Për këto vende Konventa do të zbatohej vetëm në mënyrë të drejtpërdrejte sipas nenit 1(1)(a).

Në këtë kuadër jemi të mendimit se deklarimi apo jo i rezervës ngelet në zgjedhjen e shteteve kontraktuese të Konventës. Kështu, konkretisht Republika e Shqipërisë e ka ratifikuar Konventën e Vjenës pa kufizime duke pranuar edhe zgjerimin e fushës së zbatimit, që ofron neni 1(1)(b) i saj.

[21] Schlechtriem P, Butler P "*UN Law on international sales*" Springer, (2009), fq. 14.
[22] Huber P, Mullis A "*The CISG A new textbook for students and practitioners*", Sellier European law publisher (2007), fq. 52, 53.
[23] Ferrari F, "*La Vendita Internazionale. Applicabilità e Applicazioni della Convenzione delle Nazioni Unite sui Contratti di Vendita Internazionali di Beni Mobili*", fq. 83.
[24] UNCITRAL Digest of Case Law on the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods, (Edicioni 2012), fq.14.

Kontratat që i nënshtrohen zbatimit të Konventës.

Konventa e Vjenës ka për objekt të saj shitjen ndërkombëtare të mallrave. Në përputhje me nenet 30 dhe 53 të Konventës së Vjenës, mund të nxjerrim karakteristikat kryesore të kontratës të shitjes. Kështu, në vija të përgjithshme mund të themi se, me kontrate shitje do të kuptojmë: "*marrëveshjen me anë të së cilës shitësi kalon pronësinë e një pasurie tek blerësi, dhe ky i fundit paguan për të çmimin për të cilin është rënë dakord*". Këtë qëndrim e gjejmë edhe në Kodin Civil, sipas nenit 705 të të cilit, kontrata e shitjes "*ka për objekt kalimin e pronësisë të një sendi apo një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi*". Karakteristikë e kontratës të shitjes sipas legjislacionit shqiptar paraqitet fakti se shitja është një kontrate e dyanshme[25] dhe konsensuale.[26]

Mirëpo, sipas Konventës së Vjenës rregullohen edhe kontrata të një lloji të veçantë. Kështu, neni 73 përfshin kontratat me dorëzim në pjesë/periodik të mallrave, neni 35(2)(c) përfshin kontrata të shitjes me mostër apo model dhe kontrata të shitjes me provë.[27] Po ashtu, neni 3 i Konventës, konsideron shitje dhe i nënshtrohen rregullimit të saj edhe "*kontratat për furnizimin e mallrave që fabrikohen ose prodhohen*", pra mallra të ardhshme që nuk janë prodhuar apo fabrikuar ende në momentin e lidhjes së kontratës. Si rrjedhojë, mund të themi se Konventa e Vjenës zbatohet për kontratat në të cilat një palë (shitësi) detyrohet që të prodhojë ose fabrikojë mallrat me kusht që ai të ketë siguruar pjesën e konsiderueshme të materialit të domosdoshëm për prodhimin apo fabrikimin e tij, ndërsa e kundërta nuk sjell zbatimin e Konventës. Me fjalë të tjera, kur pala që porosit mallrat merr përsipër të furnizojë një pjesë të konsiderueshme të materialeve të nevojshme për një fabrikim apo prodhim të tillë, kjo do të konsiderohej si një Kontratë Sipërmarrje dhe nuk do të sillte zbatimin e Konventës. Konventa nuk zbatohet gjithashtu, edhe për kontratat në të cilat pjesa mbizotëruese e detyrimeve të palës e cila furnizon mallrat konsiston në furnizimin e krahut të punës apo të shërbimeve të tjera.

Pavarësisht zgjerimit te fushës te zbatimit te Konventës ne lidhje me përfshirjen e këtyre kontratave të veçanta. Në interpretimin e saj janë mbajtur qëndrime të ndryshme për sa i përket përfshirjes të disa lloji kontratash në fushën e zbatimit të Konventës, kështu:

Në parim Konventa nuk i rregullon Kontratat e Distribucionit Ndërkombëtar, por ajo mund të zbatohet për kontratat e shitjes së vetme (jo periodike), që janë lidhur në bazë të një marrëveshjeje Distribucioni. Gjithashtu, edhe Kontratat e Franchising nuk përfshihen në fushën e zbatimit të Konventës. Jurisprudenca ka pranuar si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, përfshirjen në fushën e zbatimit të Konventës, kontratat e shitjes që janë lidhur ndërmjet shitësit dhe blerësit mbi bazën e një Kontrate Franchaisingu, të lidhur me parë.[28] Po ashtu, Kontrata

[25] Neni 662 i Kodit Civil të Republikës të Shqipërisë: "*Kontrata është me detyrime të dyanshme, kur palët detyrohen reciprokisht ndaj njëra-tjetrës*".

[26] Tutulani-Semini M, "*E drejta e detyrimeve dhe kontratave*" Pjesa e Posaçme, Skanderbeg books (2006), fq. 2, sipas së cilës: (Kontrata është e vlefshme që nga momenti i arritjes të marrëveshjes së palëve).

[27] Galgano F, "*E Drejta Private*" (Botimi i tretë) Luarasi University Press, (2006), fq. 615.

[28] Vendim Nr. 11 95 123/357, datë 8 Janar 1997 i Gjykatës së Apelit Luzern, Zvicër, "*Gjykata argumentoi se, Konventa nuk do të zbatohej nëse elementet e tjera të ndryshme nga shitja do të ishin mbizotëruese neni 3(2) i Konventës. Megjithatë Gjykata citoi se: një kontratë shitje (e vetme) individuale e cila është mbështetur në një kontratë ekskluzive Distribucioni apo Franchise do të përfshihet në fushën e zbatimit të CISG*".

Leasing, është përjashtuar nga fusha e zbatimit të Konventës, për shkak te funksionit ekonomik që ajo kryen, dallimit në objekt me kontratën e shitjes dhe mungesën e karakteristikave të saj, për tu rregulluar nga ligji uniform. Konventa nuk zbatohet edhe për Kontratat e Shkëmbimit Ndërkombëtar,pasi ato kanë për objekt kalimin e pronësisë të mallrave, por në këto kontrata çmimi nuk paguhet nëpërmjet monedhës por nëpërmjet një malli tjetër.[29]

Autonomia kontraktore e palëve nën vështrimin e Konventës.

Hartuesit e Konventës kanë konsideruar se njohja e lirisë kontraktore të palëve është një parim thelbësor i cili është rregulluar nga neni 6 i Konventës. Sipas kësaj dispozite parashikohet qartë se palët mund të zgjedhin rastet dhe mënyrën që Konventa do të rregullojë, kontratën e tyre të shitjes. Pra, në rastin e një mosmarrëveshjeje, gjykata përpara se të veproj për zbatimin apo përjashtimin e Konventës, duhet të verifikojë se cili është vullneti i palëve.

Palët mbështetur në vullnetin e tyre mund të vendosin që kontrata e tyre të mos rregullohet nga Konventa e Vjenës, duke përjashtuar gjithë zbatimin e saj, ose mund të vendosin të përjashtojnë zbatimin e vetëm disa dispozitave të saj. Ky mekanizëm është quajtur "*opting out"* dhe zbatimi i tij paraqet debate të shumta, që kanë të bëjnë kryesisht me përjashtimin e shprehur ose të nënkuptuar të Konventës.[30]

Përjashtim i shprehur i Konventës mund te shfaqet në dy mënyra. Së pari, përjashtimi i Konventës duke treguar ligjin e zbatueshëm që do të rregullojë kontratën. Kështu, palët kontraktuese mund të përfshinë në kontratën e tyre një klauzolë, e cila parashikon zbatimin e ligjit të brendshëm të një shteti të caktuar duke përjashtuar shprehimisht Konventën, ndërsa në rast se një klauzolë e tillë do të mungonte atëherë, do të zbatohej Konventa. Ndërsa, në rastin e dytë, palët mund të përjashtojnë shprehimisht zbatimin e Konventës nëpërmjet përfshirjes të një klauzole vullneti në kontratë, por nuk e përcaktojnë ligjin e zbatueshëm për kontratën e tyre, ky ligji do të identifikohet nga normat e të Drejtës Ndërkombëtare Private.

Përjashtimi i nënkuptuar i Konventës nuk parashikohet shprehimisht në asnjë dispozitë të saj pavarësisht se përfshirja e një dispozite të tillë u propozua nga përfaqësues Belg dhe Anglez, ajo nuk gjeti zbatim në tekstin e Konventës.[31] Megjithatë, mund të themi se një mënyrë e nënkuptuar për të përjashtuar zbatimit e Konventës mund të jetë, zgjedhja e një ligji të një shteti jo kontraktues të Konventës, si ligji i zbatueshëm për rregullimin e kontratës së lidhur midis palëve.

Debat është shfaqur ne rastin kur palët zgjedhin si ligj te zbatueshëm, për rregullimin e kontratës së tyre, ligjin e një shteti kontraktues të Konventës. Pyetja që është ngritur është në një rast të tillë duhet te zbatohet ligji substancial i Konventës apo ligji i brendshëm i këtij shteti?

[29] Ferrari F, "*The CISG's sphere of application*", fq. 63-64.
[30] Butler A. E, "*A Practical Guide to the CISG; Negotiations throught litigation*" Aspen Publishers, (2007), fq. 8-9.
[31] Herber R, "*Kommentar zum einheitlichen UN-Kaufrecht*", Beck, (1995), fq. 83.

Për ti dhënë përgjigje kësaj pyetjeje, rezulton se qëndrimet e praktikes gjyqësore kanë qenë të ndryshme. Kështu nga njëra anë, jurisprudenca ka mbajtur qëndrim se është e qartë se vullneti i palëve është të përjashtojnë në mënyrë të nënkuptuar zbatimin e Konventës dhe të zbatojnë ligjin e brendshëm të shtetit të zgjedhur nga palët.[32] Si rrjedhojë, ky ligji i brendshëm do të përdoret për të mbushur hapësirat e Konventës. Ndërsa nga ana tjetër, pjesa më e madhe e jurisprudencës mban qëndrimin të kundërt. Pra, nëse Konventa nuk përjashtohet në mënyrë të shprehur atëherë ajo do të zbatohet[33]. Gjithsesi, një palë kontraktuese ka të drejtën të provojë se qëllimi i saj ishte zbatimi i ligjit të brendshëm dhe jo i Konventës. Barra e provës, i takon palës që paraqet një pretendim, kjo palë duhet ta vërtetojë pretendimin e saj para gjykatës.

Konventa, në nenin 6 të saj, paraqet një dallim ndërmjet përjashtimit të zbatimit të Konventës, nga shmangja ose ndryshimi i efekteve të çdonjërës prej dispozitave të saj. Përjashtimi i Konventës nuk i nënshtrohet asnjë kufizimi ndërsa shmangia ose ndryshimi i efekteve të dispozitave të saj është i kufizuar, sidomos për nenin 12 kur shteti që rregullon kontratën ka nënshkruar rezervën në përputhje me nenin 96 (që kontrata të bëhet vetëm në formë shkresore). Në këtë rast, palët kontraktuese nuk mund të shmangin dhe duhet të zbatojnë vullnetin e shtetit për formën shkresore të kontratës, kjo është një shprehje e kufizimit te autonomisë kontraktore të palëve.

Në disa raste, palët në një kontratë, e cila nuk bën pjesë në fushën e zbatimit të Konventës mund të konsiderojnë se është në interesin e tyre ta rregullojnë marrëveshjen e tyre nga Konventa, kështu ata mund të përdorin mekanizmin "*opting in*". Ky moment nuk rregullohet shprehimisht nga Konventa e Vjenës, por është rregulluar në nenin 4 të Konventës e Hagës të vitit 1964. Një propozim për përdorimin e "*opt in*" erdhi nga Republika Demokratike Gjermane, gjatë Konferencës Diplomatike, sipas së cilës Konventa e Vjenës duhet të zbatohet edhe kur kushtet për zbatimin e saj nuk janë të mjaftueshme për ta rregulluar kontratën. Ky propozim u refuzua. Por, u argumentua se përfshirja e një dispozite të tillë në tekstin e Konventës, nuk ishte e nevojshme, pasi parimi i autonomisë kontraktore ishte mëse i mjaftueshëm për ti lejuar palët për të bërë "*opt in*" në Konventën e Vjenës.[34]

Konkluzione.

[32] Vendim Nr. -, datë. 19 Prill 1994, i Gjykatës të Arbitrazhit Itali. "*Gjykata argumentoi se: Konventa nuk do të zbatohet në këtë rast, pasi palët me vullnetin e tyre kishin zgjedhur si ligj të zbatueshëm ligjin Italian (i referohet ligjit të brendshëm duke përjashtuar në mënyrë të nënkuptuar CISG). Italia është shtet kontraktues i Konventës ndërsa Japonia nuk është shtet kontraktues i saj. Megjithatë, vetë arbitrat kishin mendime të ndryshme, njëri prej tyre parashikon se nuk kemi të bëjmë me përjashtimin të zbatimit të Konventës pasi nuk kemi një përjashtim të shprehur të saj, pra në këtë rast duhet zbatohet neni 1(1)(b) duke zbatuar Konventën, pra nuk kemi të bëjmë me një nga përjashtimet e Konventës sipas nenit 6 të saj*".

[33] Vendim Nr. T-8/08, datë, 28 Janar 2009 i Gjykatës të Arbitrazhit, Serbi. "*Gjykata argumentoi se: në çështjen e ngritur ndërmjet një shitësi Serb dhe një blerës Shqiptar me objekt shitjeje dhe shpërndarje medikamentesh, duke qenë se palët me marrëveshje ndërmjet tyre kishin përcaktuar se kontrata do të rregullohej në përputhje me normat e zbatueshme dhe Ligjet e Republikës të Serbisë, atëherë në këtë rast, do të zbatohej Konventa sipas nenit 1(1)(b). Shqipëria në atë kohë ende nuk e kishte ratifikuar Konventën ndërsa Serbia ishte shtet kontraktues i CISG, duke qene se palët kishin zgjedhur si ligj të zbatueshëm për kontratën e tyre ligjin Serb atëherë CISG ishte i zbatueshëm*".

[34] Uncitral Digest of Case Law on the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods, Edicioni 2012, (United Nation 2012), fq.34.

Si konkluzion, mund të themi se Konventa është një ligj uniform i cili ka për qëllim të standardizojë normat në fushën e shitjes ndërkombëtare të mallrave duke krijuar më shumë siguri dhe stabilitet ne këtë fushë. Heqja e barrierave, nëpërmjet unifikimit të ligjit që rregullon formimin dhe përmbajtjen e kontratave për shitjen ndërkombëtare të mallrave, e bën më të lehtë tregtinë dhe ul shpenzimet e veprimeve për të gjitha ato shtete që e kanë nënshkruar ose zbatuar Konventën.

Aktualisht, Konventa është një nga aktet më të përdorura në botë, lidhur me shitjen ndërkombëtare të mallrave. Ky përfundim, rezulton nga pjesëmarrja në të, i një numri të konsiderueshëm shtetesh nga rajone gjeografike të ndryshme, faza të ndryshme të zhvillimit ekonomik e politik dhe sisteme të ndryshme juridike, ekonomike e shoqërore. Sot, rreth 83 shtete e kanë ratifikuar apo nënshkruar Konventën, midis të cilave, sikurse pamë edhe Republika e Shqipërisë.

Gjithashtu, mund të themi se kjo Konventë i jep një rëndësi parësore parimit të autonomisë kontraktore të palëve, duke u lënë atyre mundësinë të përjashtojnë ose kufizojnë zbatimin e të gjithë Konventës apo dispozitave të caktuara të saj.

Referenca:

Doktrinë

Butler A. E, "*A Practical Guide to the CISG; Negotiations throught litigation*" Aspen Publishers, (2007).
Eörsi G, "*International Sales: the U.N. Convention on Contracts for the International Sales of Goods*", New York (1984).
Ferrari F, "*La Vendita Internazionale. Applicabilità e Applicazioni della Convenzione delle Nazioni Unite sui Contratti di Vendita Internazionali di Beni Mobili*".
Ferrari F, "*The CISG's sphere of application*".
Galgano F, "*E Drejta Private*" (Botimi i tretë) Luarasi University Press, (2006).
Herber R, "*Kommentar zum einheitlichen UN-Kaufrecht*", Beck, (1995).

Honnold J. O, "*Uniform Law for International Sales*", Dordrecht, (1982).

Huber P, Mullis A "*The CISG A new textbook for students and practitioners*", Sellier European law publisher (2007),
Nuni A, "*E Drejta e Biznesit*", (2006).
Schlechtriem & Schwenzer: "Commentary on the UN Convention on the International Sale of Goods (CISG)", Third Edition, Oxford University Press (2010).
Schlechtriem P, Butler P "*UN Law on international sales*", Springer, (2009).
Schlechtriem P, "*Uniform Sales Law - The Experience with Uniform Sales Laws in the Federal Republic of Germany*" (Juridisk Tidskrift, 1991/92).

Tutulani-Semini M, "*E drejta e detyrimeve dhe kontratave*" Pjesa e Posaçme, Skanderbeg books (2006).
UNCITRAL Digest of Case Law on the United Nations Convention on Contracts for the International Sale of Goods, (Edicioni 2012).
Velicu D, "*La vendita internazionale di merci", Profilo Comparatistico*" Aracne (2007).

Jurisprudencë

Vendim Gjyqësor Nr. 10 Ob 518/95. datë: 6 Shkurt 1996 i Oberster Gerichtshof.
Vendim Gjyqësor Nr. 22 U 4/96, Datë 21.05.1996 i Oberlandesgericht Köln, Gjermani.
Vendim Gjyqësor Nr. 4 O 369/99, datë 19 Janar 2001 i Landgericht Flensburg, Gjermani.
Vendim Gjyqësor Nr. VIII ZR 159/94, datë: 8 Mars 1995 i Gjykatës se Lartë e Gjermanisë.
Vendim Gjyqësor, Nr. 5, Datë 14.01.1998 i Gjykatës së Apelit të Parisit.
Vendim Nr. 98 CIV 961 RWS, 99 CIV 3607 RWS, datë: 21 Gusht 2002 i Gjykatës së Distriktit Federal, New York-SHBA.
Vendim Nr. -, date 25 Shkurt 2004 i Gjykatës së Padoves.
Vendim Nr. -, datë. 19 Prill 1994, i Gjykatës të Arbitrazhit Itali.
Vendim Nr. 11 95 123/357, datë 8 Janar 1997 i Gjykatës së Apelit Luzern, Zvicër.
Vendim Nr. 7 U 3771/97, date 28 Janar 1998, i Gjykatës së Apelit të Mynihut.
Vendim Nr. T-8/08, datë, 28 Janar 2009 i Gjykatës të Arbitrazhit, Serbi.

The principles of foster care in bulgarian legislation

Elitsa Kumanova [35]

UDC: 347. 63/.64:340.13 (497.2)

Abstract:

The report examines the foundations of the legislation of child protection in Bulgaria. The promulgation of foster care as a new approach to child-bringing in order to protect their best interests put a lot of problems in the field of family law and social assistance services. At present there is a sustained state policy in child protection.

Key words: rights of children, foster care, foster family

The principles of the legislation of the children are set out in the Preamble of the UN Convention on the Rights of the Child. They are related to the recognition of the children fundamental need for special care and assistance by providing a suitable environment for their upbringing. The main intention of the Convention is raising and educating children in the spirit of the basic human values - peace, dignity, tolerance, freedom, equality and solidarity. It declares that "the child due to his physical and mental immaturity, needs special safeguards and care, including appropriate legal protection, before and after birth."

[35] Law Faculty, University of Ruse, Bulgaria

According to the international standards of children protection the proper conditions for the provision of alternative care for children are situations where children are placed by the competent authorities in order to ensure alternative care at home in a family other than the biological family of the child. This family select, train, approve and monitor the provision of such care. Great contribution in this respect delivers the Declaration on the rights of the child /in fact series of statements related to the rights of the child/ with author Eglantine Jebb, the founder of the international organization" Save the Children". The Declaration contains ideas about the possibility of children to be provided with conditions and means of their normal development, to be assisted to develop their talents, to provide them with of health and social services. These ideas are enshrined in the Charter of the organization "Save the Children" adopted in Geneva on 23 February 1923 and approved by the League of Nations.

The child's upbringing in a family environment is a fundamental principle of the Child Protection Act, promulgated in 2000. The next year – 2001 - started the establishment of an institutional structure to implement the state policy in the field of child protection. At the national level it is represented by the State Agency for Child Protection as a specialized body of the Council of Ministers. At municipality level it is represented from the Directorates " Social assistance" of the Social Assistance Agency. The departments for child protection in these directorates implement legal measures in favor of children at risk.

Children at risk are children:

a) who do not have parents or have been permanently deprived of their care;

b) who have become victim of abuse, violence, exploitation or any other inhuman or degrading treatment or punishment either in or out of his or her family;

c) for whom there is a danger of causing damage to their physical, mental, moral, intellectual and social development;

d) who are afflicted with disabilities and difficult to treat illnesses.

The object of the protection in a family environment is to support the children and family. The placement of the children outside the family is considered as a last resort for

protection after depletion and all options to protect the family. This legislative approach ensures a balance between the urgency of the measures and ensures that the children shall not be separated from their parents against their will, except when competent authorities determine that such separation is necessary for interests the child.

In this sense placement outside the family itself serves as a protective measure after exhausting all other options. Under current Bulgarian legislation, the directorates "Social Assistance" carry current practical activities, define and implement concrete measures for the protection of children and monitor their implementation.

According to Child Protection Act /CPA/ protection measures where the child is derived from their family environment are:

1. Accommodation in a family of relatives or friends;
2. Adoption;
3. Accommodation in a foster family;
4. Provision of social services - residential;
5. Accommodation in a specialized institution;
6. Police protection.

The foster care is a temporary measure for children protection, which is regulated by the Child Protection Act; the Family Code; Ordinance on the conditions and procedures for application, selection and approval of foster families and placing children.

The implementation of the foster care has the following principles:

• Respect for the best interest and protection of the rights of the child;

• respect the dignity and personality of the child;

• placement of the child as close to his parents and /or other significant people • ensuring regular contact between the child and his biological parents when it is in his interest;

• respect the rights of the biological parents and the child to participate in making decisions about the child's future;

• equality and partnership between the actors;

• foster families are partners in helping improve interaction and care for children;

• confidentiality of information;

• temporary accommodation.

These principles are implemented through the following activities:

• provision for a certain period of time safe and secure family environment for children to contribute to their full physical, mental and emotional development;

• prevention of institutionalization of children and support for biological parents in crisis situations;

• preparation of the child for independent living, learning and social skills;

• preparation of children placed in institutions, for reintegration in their biological family or adoption.

The legal definition of "foster care" is defined in Article 34a of CPA, where it is defined as a measure of child protection, which includes raised in a family environment of a child who is placed in the family of relatives or in foster family. In accordance with the CPA in foster family can be accommodated child whose parents, guardians or trustees without any substantial reason permanently miscare for him; a child who is a victim of domestic violence and a serious risk of harm to the child's physical, mental, moral, intellectual and social development; abandoned child living on the streets or with friends.

Foster care is considered several types and is determined on an assessment of the needs of the specific child and in accordance with the goals that should be achieved . In Article 3 of the Ordinance on conditions and procedures for application, selection and approval of foster families and placing children are identified following types of placement in a foster family:

• Short-term foster care- this means that the child will live with a foster family for a short period of time /weeks or months/, but no more than one year. This allows biological parents with the assistance of social workers to improve their parental skills, to find a job, to be able to care for their children, to secure home in which to live together. After changing their life status children are returned to their parents.

• Long-term foster care, this is a variant of foster care that is offered to children whose parents no longer can take appropriate cares. This is likely to happen when:

1) parents are deceased;

2) parents have abandoned the child;

3) where the child is placed in an institution and biological parents are not interested in it;

4) parents have many children and find it difficult to care for all;

5) parents suffer from serious physical or mental diseases and need to stay on treatment longer in the hospital.

This foster care is possible and when the attempts of providing safe family environment of the child /reintegration into the biological family or adoption / has failed in the short-term accommodation. The long-term placement in a foster family does not exclude the child from the adoption register and do not terminate the efforts of social workers on its possible reintegration.

• Emergency foster care is taken when there is an imminent threat to life and health of the child. Urgent need for placement in a foster family there when:

1) the child is in dire situation- earthquake, flood, fire, whereby injured or killed the child's parents and it remains alone;

2) the child /children are under police protection;

3) the child /children are victims committed violence

4) the child /children are victims of trafficking

5) the child /children are under to 3 years of age.

• Replacement foster care is performed in cases where:

1) the child is placed in long-term foster family and the foster parents need annual leave, the child may be moved to another foster family for a very short period of time. Usually this is another foster family, which the child knows in advance. This kind of care enables children who live in orphanages to spend a short time with foster families without being placed in them;

2) to support families of relatives who have placed children;

The type of placement is determined by social workers taking into account the needs of the child, the purpose of its accommodation and the action plan of the child.

Children are accommodated either in voluntary foster family or in professional foster family. The provisioning of an approved foster family include undergoing basic training and financial support after contracting with he directorates od social assistance. The fosterfamily receives a monthly allowance and one-off benefits. In voluntary foster care child receives a monthly allowance depending on years of age.

For example:

- children up to 7 years receive three times the amount of guaranteed minimum income - around 195 levs;
- children from 7 to 14 years received 3.5-fold amount of guaranteed minimum income - about 227.50 levs;
- children from 14 to 18 years receive 4 times the guaranteed minimum income - about 260 levs.

All children in foster families are entitled to a one-time annual aid amounting to 325 levs. This amount is used to meet the urgent needs of children, such as birthday, first day of school.

For children with physical and mental disabilities pay a supplement of 75% of guaranteed minimum income, regardless of the income of the family, about 48.75 lev

The professional foster care includes an employment contract with one parent from the foster family that has undergone basic training and further training for education and childcare. The professional foster parent receives salary and a monthly allowance, as well as ad hoc aid for the needs of the accommodated children.

Professional foster families receive a monthly salary:

- for raising a child -130% of the minimum salary;
- for raising two children - 140% of the minimum salary;
- for raising more children - 150 percent of the minimum salary.

In the professional foster family are accommodated children under 3 years of age; disabled children; children - victims of violence and trafficking; children, to which is attached the measure "protective custody" after the expiry of its term; children under replacement Foster care.

The implementation of the foster care successfully replaced the negative tradition in Bulgaria from the past 50-60 years of the institutionalization of children at risk. In the process of providing the service "foster care" the biological family and legal representatives of the child may act as a full partner and their opinion is sought and taken into account in all decisions on the fate of the child. The biological parents are provided with necessary support and are directed to services that would help the process of reintegration during the period of placement of the child in the foster family. The statistical data indicate that candidates wishing to be foster parents increase. "Foster care" is still a new service and need more information and time for recruitment, but interest in it is growing and will benefit children raised in institutions. The raise of number of people willing to help the disadvantaged children proves the sentence of Maria Montessori: “If a child lives in an atmosphere of friendship and mutual need, he learns to find love in the world”.

Bibliography

1. Kusev, I. Fundamentals of Social Work. S., 1998
2. Baldjieva M., My Book for Foster Care. S., 2012
3. Nenovski N., Human Rights. S., 1994

RREGULLIMI LIGJOR DHE SITUATA AKTUALE E ORGANIZATAVE SINDIKALE NË SHQIPËRI

LEGAL REGULATION AND ACTUAL SITUATION OF TRADE UNION ORGANIZATIONS IN ALBANIA

ARJAN GJINI[36]

EJONA XHEMALAJ[37]

UDC: 342.734:331.105.44(495.6)

Abstract

This paper has been written to treat an essential element of labor law: trade unions, generally defined as democracy indicators. One of the most important areas of civil rights are labor laws, or legal rights of employees, which deal with the relations between employers and employees as provided in the Labor Code of the Republic of Albania. When conflicts of interests arise between employers and employees, the latter are the most vulnerable, and trade unions work as instruments to insure their protection and to deal with any problem created at work. Trade union organizations are independent social organizations, created as volunteering unions of employees. Their purpose is the representation and protection of the economic, professional and socio-legal rights of their members. Trade unions are considered the most important part of democracy as they relate to the interests of many individuals, protecting their fundamental rights, right to life, employment, education, and to receive health and other useful services. Based on their relevance, it is the duty of each state to undertake policies in order to guarantee freedom of associations, and on the other hand, every state is obligated to not intervene in limiting the freedom of these associations. The basic principles that should guide syndicalism are solidarity, independence, democratization, accompanied by volunteering and assurance; principles that are the basis of every democratic state. Currently we are influenced by many

[36] Pedagog i Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. E-mail: arjan.gjini@umsh.edu.al

[37] Pedagoge e Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. E-mail: ejona_xhemalaj@hotmail.com

factors that do not guarantee a peaceful and normal climate in the Albanian society, where there are many vulnerable social layers. Because of this vulnerability, there are some main objectives our country needs to take in regard, in concrete terms; we need institutional support, social policies by the state and the improvement of the current legal regulation. This paper focuses on the legal regulation of trade unions, European trade union models, and treatment of factors that affect in the evolution of trade unions in the Albanian society.

Key words: trade unions, democracy, labor law, freedom of association, legal regulation.

I. Hyrje

E drejta e punës, si një degë e së drejtës civile, ndalet në trajtimin e instituteve thelbësore lidhur me marrëdhëniet e punës. Ajo përfshin një tërësi të drejtash juridike të cilat kanë të bëjnë me marrëdheniet e punës ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve, të parashikuara në Kodin e Punës dhe ligje specifike. Ky punim, ndalet në trajtimin e një elementi të domosdoshëm të së drejtës së punës, organizatat sindikale. Ato janë pjesë përbërëse e së drejtës sindikale, që përfaqëson tërësinë e normave juridike që rregullojnë pozitën juridike të organizatave sidikale, kontratave kolektive, të drejtën e grevës si dhe zgjidhjen e konflikteve të punës. [38]

Organizatat sindikale cilësohen si një nga shyllat e demokracisë, kjo për shkak të lidhjes së tyre me interesat e shumë individëve dhe siguristh me të drejtat e tyre themelore. Nga përplasja e interesave të palëve, punëdhënës e punëmarrës, janë punëmarrësit ata më të pambrojturit, e për të përballuar çdo problematikë të krijuar në punë, krijojnë sindikatën si një instrument sigurues për ta. Pra, organizatat sindikale cilësohen si organizime të grupimeve të ndryshme profesionale, me ide dhe qëllime të përbashkëta, në interes të mbrojtjes së tyre nga çdo fenomen dhe praktikë dëmtuese, si gjatë proçesit të punësimit ashtu dhe kushteve të tjera gjatë jetës së tyre.[39]

Sindikatat kanë si qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe përfaqësimin e interesave ekonomike dhe shoqërore të anëtarëve të tyre, për këtë arsye, ato cilësohen si pjesa më profesionale dhe më cilësore e shoqërisë civile. Pra, shoqëria i jep një vend të veçantë sindikatave pasi ato organizojnë dhe përfaqësojnë njerëz, që për shkak të pamundësisë së tyre në

[38] Kudret Cela, *"E drejtë e punës"*, Tiranë, 2011, fq. 509.
[39] Minella S. Mano, *"Sindikata si pjesë e shoqërisë demokratike"*, Tiranë, 2004, fq. 82.

mënyrë individuale, dhe për shkak të pamundësisë së tyre sociale, ekonomike ose fizike, e kanë të vështirë që t'i bëjnë prezente mendimet e tyre në procesin politik, ekonomik e shoqëror të vendit.[40] Pra, organizatat sindikale janë një aset i domosdoshëm i çdo shteti demokratik, për këtë arsye çdo shtet duhet ndërmarrë politika favorizuese lidhur me garantimin e lirisë sindikale, duhet të japi përkrahjen e nevojshme insitucionale, si dhe të sigurojë mosndërhyrjen në kufizimin e kësaj lirie.

E drejta për t'u bashkuar në organizata sindikale, cilësohet si një e drejtë themelore, e parashikuar shprehimisht në nenin 50 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Lidhur me proçedurën e krijimit, liritë sindikale dhe ndalimin e ndërhyrjes, kemi parashikimin e tyre në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë.

Pavarsisht ekzistencës së një kornize ligjore të organizuar, nevoja për politika favorizuese, rregullim ligjor dhe zbatueshmëri të legjislacionit, cilësohen si prioritete lidhur me këtë fushë të së drejtës.

II. Vështrim Historik

Ndër vite, lëvizjet e punëtorëve, të ndikuara nga faktorë të shumtë politik, ekonomik e shoqëror, kanë qenë një shtysë e madhe në rrugën e zhvillimit të sindikatave. Por, vendi yne, ka një histori relativisht të re lidhur me lëvizjet sindikale, kjo si pasojë e prapambetjes ekonomike dhe shoqërore të vendit.

E para lëvizje e organizuar punëtore është ajo e vitit 1854 e emëruar "Vegjëlia Shkodrane". Në vitin 1857 me iniciativën e Zef Jubanit u themelua në Shkodër një shoqëri punëtore e cila kishte statutin e saj. Në vijim, në vitin 1902, me iniciativën e Shtjefën Ingrizit u formua përsëri në Shkodër një shoqëri e tillë, e cila më pas u shpërnda nga presioni i autoriteteve të kohës.[41] Në vitin 1905, krijohet në Shkodër shoqëria punëtore "për ndihmë reciproke" me iniciativën e Kol Dikës, e formuar nga një rreth ilegal në të cilin bënin pjesë zejtarë, punëtorë dhe disa intelektual. Në Shkodër, po në këtë vit, për herë të parë në vendin tonë u festua dita e 1 Majit, të cilës i bëri jehonë dhe shtypi i kohës.

[40] Kol Nikollaj, *"Konfederata e sindikatave të Shqipërisë, organizatë demokratike",* Tiranë, 2014, fq. 113.
[41] Kol Nikollaj, *"Konfederata e sindikatave të Shqipërisë, organizatë demokratike",* Tiranë, 2014, fq. 11.

Pas shpalljes së pavarësisë, Shqipëria nisi të funksiononte si një shtet i vetëm, por gjendja e prapambetur e vendit nxiti organizimin e punëtorëve në sindikata. Në vitin 1913 në Shkodër u ngrit përsëri "Shoqëria ndihmëtare". Në Gjirokastër, në vitin 1918 u krijua organizata për mbrojtjen e interesave të mësuesëve dhe në vitin 1920 në Korçë u krijuan shoqëri punëtorësh tashmë me një program të përcaktuar.

Vitet 1925-1939 sollën ndryshime pozitive lidhur me lëvizjen sindikaliste në Shqipëri. Në Korcë, në vitin 1933, u krijua për herë të parë Shoqëria "Puna". Në vijim, në vitet 1934-1935, u krijuan shoqëri profesionale të punëtorëve rrobaqepësve, këpucarëve, të shoferëve e të nënpunësve privatë. Shoqëritë sindikaliste të kohës, i drejtoheshin punëdhënësit dhe qeverisë lidhur me kërkesat ekonomike, respektimin e 8-orëshit të punës, rritjen e pagës, sigurimin në punë etj. Në 28 nëntor 1935 u organizua greva e parë në historinë e lëvizjes sindikale, e cila në 11 shkurt 1936 u shndërrua në një grevë të përgjithshme. Me pushtimin e vendit nga Italia dhe fillimin e Luftës së Dytë Botërore, këto organizata sindikale u shpërndanë.[42]

Pas çlirimit dhe vendosjes së diktaturës marrëdhëniet e punës u centralizuan, pra nuk bëhej fjalë për një lëvizje të vërtetë sindikale. Në vitet e diktaturës bëhej fjalë për bashkime profesionale të cilat zbatonin politikën e Partisë se Punës. Baza e rregullimit ligjor të bashkimeve profesionale në Shqipëri ishte sanksionuar për herë të parë në Ligjin Nr 82, datë 9 Korrik 1945 "Mbi kohën e shërbimit, mbrojtjen dhe shpërblimi në punë" (në nenin 7 të këtij ligji). Vlejnë të përmenden gjithashtu Kodi i Punës i vitit 1947 dhe Kodi i Punes i vitit 1956. Formalisht çdo mosmarrveshje që nuk mund të zgjidhej prej palëve në konflikt, zgjidhej prej sindikatave dhe punëdhënësve. Kur kjo nuk arrihej, mosmarrëveshjet zgjidheshin nga Arbitrazhi i Ministrisë së Asistencës Sociale. Kodi i Punës i vitit 1980, në nenin 12 të tij, shpallte parimin se "punëtoret dhe nënëpunësit kanë të drejtë të organizohen në Bashkime Ptofesionale", por ideologjizmat, politizimi dhe demagogjia ishin ende të pranishme dhe në këtë periudhë.

Pas rënies së regjimit diktatorial, në vend u krijuan kushte të përshtatshme për lindjen e marrëdhënieve të punës midis punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe gjithashtu lindjen e sindikatave të para në Shqipëri. Në vitin 1991 kemi të bëjmë me sindikatën e parë shqiptare, sindikatën e pavarur të minatorëve.

[42] Kudret Cela, *"E drejtë e punës"*, Tiranë, 2011, fq. 597.

Në 29.04.1991 parlamenti i parë pluralist miratoi ligjin "Për Sindikatat në Republikën e Shqipërisë", i cili më vonë u përfshi në Kodin e Punës. Në vijim, pushuan së ekzistuari Bashkimet Profesionale dhe filloi një riorganizim i ri i sindikatave në kushtet e ekonomisë së tregut, duke respektuar anëtarësimin mbi baza vullnetare dhe bindjet politike të të gjithë anëtarëve. [43]

Ndërsa në botë, sindikatat e lidhin zhvillimin e tyre me lindjen dhe rritjen e kapitalizmit. Si një lëvizje e organizuar, sindikalizmi e ka origjinën e lindjes në shekullin e 19-të në Britaninë e Madhe, Evropën Kontinentale, dhe Shtetet e Bashkuara. Shoqatat e para të punëtorëve filluan të shfaqen në Britani në shekullin e 18, por ato mbetën sporadike dhe jetëshkurtër edhe përgjatë pjesës më të madhe të shekullit të 19. Kjo pjesërisht e ndikuar për shkak të konfliktit mes punëdhënësve dhe qeverisë, pasi kjo e fundit e kundërshtonte këtë formë të re të politikës dhe ekonomisë.

Këto lëvizje në Britani favorizuan aktivizmin politik, gjë që çoi në formimin e Partisë së Punës në vitin 1906, ndërsa sindikatat amerikane ndoqën marrëveshjet kolektive, si një mjet i punëtorëve për të siguruar përfitimet e tyre ekonomike.

Vlen të përmendet se organizatat sindikale, pavarsishtë zhvillimeve historike, kanë pasur një ndikim afatgjatë si rregullatore të marrëdhënieve të punës, pasi parimet dhe praktikat e sindikatave janë të rrënjosura në sistemet ekonomike të shumicës së vendeve industriale. [44]

III. Rregullimi ligjor i Organizatave Sindikale në Shqipëri

Kreu XVI i Kodit të Punës, trajton organizatat sindikale duke u ndalur në proçedurën e krijimit të organizatave sindikale, liritë sindikale dhe ndalimin e ndërhyrjes. Konkretisht, Neni 176 i këtij kreu, jep përkufizimin dhe qëllimin kryesorë të organizatave sindikale: *"Sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve janë organizata profesionale shoqërore të pavarura që krijohen si bashkime vullnetare të punëmarrësve ose punëdhënësve. Qëllimi i tyre është përfaqesimi dhe*

[43] Kol Nikollaj, *"Konfederata e sindikatave të Shqipërisë, organizatë demokratike",* Tiranë, 2014, fq. 23.
[44] Encyclopedia Britannica, *"Trade union"* http://www.britannica.com/

mbrojtja e të drejtave dhe interesave ekonomike, profesionale dhe shoqërore të anëtarëve të tyre."[45]

Pika e dytë e këtij neni, parashikon mundësinë e krijimit të federatave dhe konfederatave nga organizatat e punëmarrësve dhe të punëdhënësve, gjithashtu dhe të drejtën e anëtarësimit në to. Konkretishtë, "*organizatat e punëdhënësve dhe të punëmarrsëve kanë të drejtë të krijojnë federata e konfederata dhe të anëtarësohen në to. Federatat krijohen nga bashkimi vullnetar i dy ose më shumë organizatave profesionale. Konfederatat krijohen nga bashkimi vullnetar i dy ose më shumë federatave."*[46]

Në këtë pikë, vlen të përmendet organizata sindikale më e madhe dhe më e organizuara në Shqipëri, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, e themeluar më 5 Qershor 1991, në Tiranë, me pjesëmarrjen e delegatëve nga të gjitha Federatat Sindikale të degëve të ekonomisë. KSSH u ngrit mbi baza vullnetare, e nxitur nga nevoja e punonjësve për të mbrojtur vëtveten në kushtet e reja social ekonomike e shoqërore.

Qëllimet kryesore të KSSH janë:

Ruajtja dhe zhvillimi i një organizate Sindikale Kombëtare të fuqishme, të bashkuar, pluraliste, demokratike;

Punësim të plotë dhe të zgjedhur lirisht, mirëqënie dhe standartizim më të mirë të jetesës për të gjithë anëtarët e sindikatës, përfshirë sigurimin e pagave, pensioneve dhe rregullimin e kohës së punës;

Integrimin e plotë të grave në organizatat sindikale dhe promovimin në mënyrë aktive të barazisë gjinore në strukturat e saj vendimmarrëse të të gjitha niveleve;

Mbështetjen e të drejtave të të rinjëve për punë të denjë, edukim dhe trajnim, si dhe pjesëmarrjen e tyre të plotë në të gjitha nivelet vendimmarrëse.[47]

Pika e tretë e nenit 176 të Kodit të Punës, parashikon përfshirjen në nocionin sindikatë edhe të personave të tjerë jo punëmarrës, konkretisht, pensionistët dhe të papunët mund të anëtarësohen në organizatat e punëmarrësve.

[45]Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 176/1.
[46]Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 176/2.
[47]Faqja zyrtare e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë. http://kssh.org/

Neni 177 i Kodit të Punës, parashikon numrin minimal të anëtarëve themelues të organizatave sindikale, pra akti i krijimit dhe statuti i çdo organizate profesionale duhet të nënshkruhen nga jo më pak se 5 anëtarë themelues për organizatën e punëdhënësve dhe jo më pak se 20 anëtarë themelues për organizatën e punëmarrësve.[48] Kjo dispozitë parashikon si dokumenta kryesorë të organizatës sindikale, Aktin e krijimit dhe Statutin, si dhe në vijim, parashikon formën ligjore dhe përmbajtjen e këtyre akteve. Në statut detyrimisht duhet të përcaktohen: emri i organizatës; vendi ku ndodhet selia e saj; qëllimet e saj; kushtet e pranimit, të dorëheqjes dhe të përjashtimit të anëtarëve; të drejtat dhe detyrat e anëtarëve; përbërja dhe funksionimi i organeve drejtuese, si dhe kohëzgjatja e mandateve; sipas rastit, përkatësia në federatë ose në konfederatë; masat që merren në rast shpërndarje.[49]

Fitimi i personalitetit juridik lidhet me dorëzimin e aktit të krijimit dhe statutit në gjykatë, e parashikuar në nenin 178 të Kodit të Punës, ku në bazë të vlerësimit, gjykata me vendim i njeh këto subjekte si persona juridik. Po kjo dispozitë, në pikën e dytë, parashikon afatin prej 60 ditëve nga dorëzimi i statutit në Gjykatën e Tiranës, që organizata sindikale të fitoj personalitet juridik, me përjashtim të rasteve kur gjykata jep vendim të kundërt.

Për të ruajtur individualitetin dhe personalitetin e vet, nenet 179 dhe 180 të Kodit të Punës, përcaktojnë se asnjë organizatë profesionale nuk mund të ketë emrin e një organizate ekzistuese. Kjo kërkesë i shërben edhe individualizimit të përgjegjësisë së tyre në raste të caktuara. Çdo organizatë profesionale është e detyruar të depozitojë një kopje të statutit të saj pranë Ministrisë së Punës, në dobi të kësaj garancie.[50]

Në vijim, Kodi i Punës trajton liritë sindikale, konkretisht, çdo organizata sindikale organizon lirisht administrimin dhe veprimtarinë e saj, gjithashtu harton lirisht programin e saj.[51]

Një nga parimet kryesore që parashikon kjo dispozitë, është ndalimi i diskriminimit ndaj përfaqësuesëve të sidikatës, parim ky që udhëheq sindikalizmin në çdo vend demokratik.

Neni 181 i Kodit të Punës parashikon rastin e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi pa pëlqimin e organizatës së punëmarrësve, zgjidhje që konsiderohet e pavlefshme. Ligji parashikon gjithashtu disa raste përjashtimore të zgjidhjes së kontratës së punës edhe

[48] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 177/1.
[49] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 177/2.
[50] Kudret Çela, *"E drejta e punës"*, Tiranë, 2011, fq. 586.
[51] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 181.

papëlqimin e organizatës së punëmarrësve, konkretisht, kur punëmarrësi shkel ligjin, kontratën kolektive të punës, kontratën individuale të punës ose nëse punëdhënësi provon që zgjidhja e kontratës është e domosdoshme për veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjes. Gjithashtu, për sa i përket ndryshimit të kushteve të kontratës së punës të përfaqësuesve të organizatës së punëmarrësve, kjo dispozitë parashikon se ndryshimet mund të bëhen vetëm me pëlqimin e punëmarrësit, gjithashtu dispozita parashikon dhe rast përjashtimor.

Neni 181 i Kodit të Punës, në vijim trajton detyrimin e punëmarrësit për të garantuar kushtet dhe lehtësitë e nevojshme për përfaqësuesit e organizatave të punëmarrësve për ushtrimin normalisht të funksioneve të tyre. Për këtë qëllim punëdhënësi duhet: a) të lejojë hyrjen e tyre në mjediset e punës; b) të lejojë shpërndarjen e njoftimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës së punëmarrësve; c) t'u japë kohën e nevojshme për të marrë pjesë në veprimtaritë e këtyre organizatave brenda dhe jashtë vendit; ç) të lejojë dhe t'u krijojë lehtësi në mjediset e punës për grumbullimin e kuotizacioneve të organizatës, si dhe për organizimin e mbledhjeve dhe të takimeve.[52]

Neni 182 i Kodit të Punës, parashikon mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të organizatës së punëmarrësve në gjykatë. E drejta për një pro*çes* të rregullt ligjor garanton të drejtën e çdo personi që për mbrojtjen e interesave të tij të ligjshme, t'i drejtohet gjykatës ose organeve kompetente shtetërore.[53]

Gjykata Kushtetuese në interpretimin që i bën të drejtës për t'ju drejtuar gjykatës, e cilëson atë: *si të drejtën që gëzon çdo individ për të ngritur padi në një gjykatë që ka juridiksion të plotë për të zgjidhur çështjen, që sanksionon në vetvete jo vetëm të drejtën e individit për t'ju drejtuar gjykatës por edhe detyrimin e shtetit që t'ia garantojë atij këtë akses*. Gjykata Kushteuese shprehet se *në rast se mohohet një e drejtë e tillë, procesi konsiderohet jo i rregullt, sepse aksesi në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.*

Pra, kjo dispozitë garanton të drejtën e çdo organizate punëmarrësish për t'ju drejtuar gjykatës për mbrojtjen e interesave të tyre.

[52] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 181.
[53] Luan Omari, Aurela Anastasi, *"E drejta kushtetuese",* Tiranë, 2010, fq. 183.

Përveç detyrimit të shtetit lidhur me garantimin e lirisë sindikale, nga ana tjëtër qëndron detyrimi lidhur me mosndërhyjen në kufizimin e kësaj lirie. Neni 184 i Kodit të Punës, parashikon se ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave profesionale nga organet shtetërore.[54] Në vijim, për t'i dhënë siguri juridike këtij rregullimi ligjor, në dispozitën vijuese, legjislatori ka parashikuar se organizata sindikale mund t'i drejtohet gjykatës për të ndaluar çdo veprim ndërhyrjeje ose kërcënimi ndaj saj.

Neni 184 i Kodit të Punës, gjithashtu parashikon dhe ndalimin e çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave të punëmarrësve nga punëdhënësit ose organizatat e punëdhënësve.

Si akte, ose veprime të ndërhyrjes së punëdhënësit ose të një organizate punëdhënësish konsiderohen ato veprme të parashikuara në Nenin 186 të Kodit të Punës. Konkretisht, përfshihen veprimet që nxisin krijimin e organizatave të punëmarrësve që mbizotërohen nga një punëdhënës ose një organizatë punëdhënësish, që mbështesin organizata punëmarrësish me mjete financiare apo mënyra të tjera, me qëllim që t'i vendosin këto organizata nën kontrollin e një punëdhënësi ose organizate punëdhënësish; pengojnë krijimin, funksionimin ose administrimin e një organizate punëmarrësish; dëmtojnë punëmarrësin për shkak të përkatësisë ose veprimtarisë së tij sindikale, duke e diskriminuar atë.

Neni 187 i Kodit të Punës, parashikon shpërndarjen e organizatave sindikale, e cila rregullohet sipas mënyrës së caktuar në statut. Ashtu si shpërndarja, edhe struktura e brendshme organizative dhe kompetencat e organeve, rregullohen sipas statuteve përkatëse.

IV. Organizatat Sindikale në Bashkimin Europian

Gjatë dekadës së fundit, sindikatat në të gjithë Evropën janë pothuajse universalisht duke humbur anëtarësinë, fuqinë negociuese dhe po influencohen ndjeshëm nga politika. Në të gjithë BE-në, sindikatat po dëmtohen nga globalizimi, kjo e dukshme dhe në perëndim, ku ato kanë statusin e një shtylle thelbësore sociale. Vërehet një rënie e ndjeshme në industrinë e prodhimit në shkallë të gjerë, e cila konsiderohet si baza kryesore e sindikatave.

[54] Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, Kreu XVI, Neni 184.

Për disa dekada, ekonomia e tregut, si në perëndim dhe në lindje ka sjellë një rritje të shpejtë të forma të ndryshme atipike të punësimin, një rritje pasigurie në tregun e punës dhe rritje të papunësisë. Këto ndryshime në Europë, kanë përfshirë ndjeshëm punëtorët e rinj, të cilët janë veçanërisht të prekur nga pasiguria e tregut të punës. Statistikat tregojnë një rënie të dendësisë së anëtarësimit gjatë tre dekadave të fundit. Përbërja e anëtarësisë sindikale dominohet kryesisht nga punëtorë meshkuj të sektorit shtetëror dhe kryesisht të sektorit të prodhimit, me përfaqësim të dobët nga sektori privat. Dendësia është në vlera nën mesataren për grupmoshat e reja.

Pavarsisht kësaj krize, në shumë vende, ka pasur një kthesë aktive drejt organizimit. Disa sindikata kanë riorganizuar strukturat e tyre në mënyrë inovative, duke ripërcaktuar qëllimin e tyre dhe vizionin social, e nga ana tjetër duke ristrukturuar apo gjetur qasje të reja ndaj angazhimit politik.

Sindikatat pa mbështetje insitutcionale e legjitimitet publik, mbeten në pozita të dobëta për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve. Në përgjithësi sindikatave i mungon mbështetja institucionale, ato mbeten të varur nga burimet e tyre, burime të cilat janë të varfëra. Në praktikë, kemi raste të sndikatave që gëzojnë mbështetje institucionale. Kjo e fundit, ka reduktuar tradicionalisht nevojën për të rekrutuar anëtarë, ku si shembull tipik janë vendet nordike.

Sindikatat në të gjithë Evropën konsiderojnë si sfidë me rëndësi ndërmarrjen e politikave sociale për të arritur një organizimi model, kjo kryesisht për të forcuar përfaqësimin e grave, të rinjve dhe punëtorëve të pasiguruar.

Përfaqësimi i interesave të grave të punësuara ka qenë prej kohësh një çështje e diskutueshme për sindikatat në Evropë. Në gati çdo konfederatë, ka komitete të veçanta për gratë e punësuara. Këto organizma kanë ndërmarrë nisma të shumta për të siguruar trajnime të veçanta për pjesëmarrjen e grave në pozicione përfaqësuese dhe për futjen e kuotave ose të vendeve të rezervuara në organet vendimmarrëse.

Në shumicën e vendeve, sindikatat kanë krijuar struktura të veçanta, me një buxhet të dedikuar për punëtorët e rinj. Kjo politikë është bërë një prioritet për shumë sindikata dhe konfederata, pasi vërehet një rritje e numrit të punëtorëve të pasiguruar, treguesi i cili cënon burimet e organizatave dhe dobëson kapacitetin e tyre për të vepruar.

Shembull është Franca, e cila ka një organizim të dedikuar për të rinjtë; disponon burime për rekrutimin, trajnimin, si dhe ka krijuar qendrat dhe agjenci të përkohshme të punës, ku shumë punëtorë të rinj janë të punësuar.

Spanja dhe Portugalia, kanë numrin më të madh të punëtorëve të rinj të pasiguruar. Në këto vende, sindikatat kryesore, kanë krijuar departamente të veçanta për punëtorët e rinj, emigrantët, si dhe për gratë. Italia, është gjithashtu një shembull i vendit ku janë krijuar konfederata të veçanta për punëtorët e përkohshëm.

Sfidat për sindikatat janë të dukshme, por mbi të gjitha, në shumicën e vendeve duhet ndërmerren politika favorizuese dhe duhet sigurohet përkrahja institucionale. Shumë sindikata kanë humbur besimin në kapacitetin e tyre për të arritur një ekonomi më të mirë dhe një shoqëri më të mirë. Sindikatat duhet të besojnë, dhe të demonstrojë se një e ardhme më e mirë është e mundur.[55]

V. Konkluzione

Që nga krijimi e deri në ditët tona, organizatat sindikale, veçanërisht në Shqipëri, janë hasur në ndryshime të njëpasnjëshme. Ndryshime të cilat lidhen me faktorë social, krizën ekonomik dhe ndikime të ndjeshme të politikës.

Fuqia e lëvizjes punëtore në Shqipëri, në çdo moment ka qenë e lidhur me kushtet e përgjithshme ekonomike. Kriza ekonomike, në vendet në zhvillim si Shqipëria, ka ndikuar dukshëm në ndryshimet që kanë prekur vitet e fundit të drejtën sindikale. Sektori i industrisë prodhuese, i konsideruar si fortesa e sindikatave në vendin tonë, vitet e fundit ka pësuar një rënie të ndjeshme, kjo e lidhur me pamjaftueshmërinë si nga ana e burimeve njerëzore, ashtu edhe nga ana e burimeve financiare.

Ekonomia e tregut ka sjellë një rritje të shpejtë të sektorit privat dhe krijimin e tregut informal të punësimit. Ndërkohë në Shqipëri, sipas statistikave, rezulton se sektori privat është shumë më pak i përfshirë në organizata sindikale se sektori shtetëror.

[55] Magdalena Bernaciak, Rebeça Gumbrell-Miccormick, Richard HymanTrade, "*Unions in Europe, Innovative Responses to Hard Times".*

Gjatë zhvillimit historik të organizatave sindikale, vërehet se veprimi i drejtpërdrejtë i politikës, ka ndikuar në krijimin e marrëveshjeve kolektive, të cilësuara si mjeti kryesor i zgjidhjes së mosmarrëveshjeve mbi pagat, kushtet e punës, si dhe çështje të tjera lidhur me marrëdhënien e punës. Nga ana tjetër, lidhur me faktorin politik, në varësi të rrëzimit apo krijimit të qeverive, të cilat në historinë e Shqipërisë kanë qenë të shumta, vërehen luhatje të numrit të anëtarësimeve në organizatat sindikale.

Shpesh herë, bindjet politike bëhen shkak diskriminimi ndaj anëtarëve të sindikatave dhe si pasojë lind pasiguria për vendin e punës. Pra, faktori politik ndikon ndjeshëm tek subjektet e marrëdhënies së punë, mes tyre ka koordinim të pamjaftueshëm, mungesë bashkëpunimi dhe solidariteti.

Aktualisht gjendemi mes pengesash e faktorësh që nuk garantojnë një klimë të qetë e normale të shoqërisë shqiptare, në veçanti të shtresave të pambrojtura. Të drejtat e punëmarrësve për të themeluar grupime sindikale dhe ushtrimi i lirë i funksionit të tyre, janë të drejta të fituara nga vetë ata, nëpërmjet një aktiviteti dhe një proçesi të veshtirë në përballje me shumë pushtete dhe shume faktorë.

Sindikalizmi si nxitës e mbrojtes, si faktor kryesor i ndryshimeve pozitive, duhet të marrë përgjegjësitë e tij përmes një aksioni konkret në kohën e duhur me profesionalizëm dhe veprime demokratike. Çdo strukturë sindikale duhet të funksionojë demokratikisht, pa u ndikuar nga faktorë të jashtëm dhe e mbrojtur nga çdo ndërhyrje arbitrare në funksionimin e saj. Ndërtimi demokratik i institucineve sindikale, është garanci në drejtim të respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Nisur nga kjo, përmirësimi i kuadrit ligjor, sigurimi i mbështetjes institucionale dhe aplikimi i politikave sociale duhet të jetë prioritet i shoqërisë sonë.

Bibliografia

Kudret Çela, “E drejtë e punës”, Shtypshkronja Ilar, Tiranë, 2011.

Kodi i Punës i Republikes së Shqipërisë.

Kol Nikollaj, “Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, organizatë demokratike”, Tiranë, 2014.

Minella Mano, “Sindikata si pjesë e shoqërisë demokratike”, Onufri, Tiranë, 2004.

Luan Omari, Aurela Anastasi, “E drejta kushtetuese”, Shtëpia Botuese ABC, Tiranë, 2010.

Trade Unions & Child Labour, në kuadër të Projektit të ILO\ACTRAV “Hartimi i Strategjive Sindikale Kombëtare e Ndërkombëtare për të Luftuar Punën e Fëmijëve”, Tiranë, 2005.

Trade Unions in Europe, Innovative Responses to Hard Times. Magdalena Bernaciak, Rebecca Gumbrell-Miccormick, Richard Hyman, April 2014.

Encyclopedia Britannica, *"Trade union”* *http://www.britannica.com/topic/trade-union*

Twinning Project, Instrument for Pre-Accession Assistance (IPA), Support to Albanian Civil Service Reform, Tiranë, 22-26.02.2016.

E DREJTA E PERSONAVE HOMOSEKSUALË PËR TË KRIJUAR FAMILJE SIPAS LEGJISLACIONIT SHQIPTAR

Dr. Xhensila KADI[56]

UDC: 447.626-055.34(496.5)

Abstract

In the recent years we have had exciting developments across many jurisdictions about the rights of same-sex couples. It seems as a tipping point being reached in relation to their legal recognition and protection.

With regard to our country, as in many other countries, the family constitutes a very important element that affects the development of the individual, it is considered as the base cell of the society. It is true that the Albanian legislation guarantees a special protection to marriage, but it does not necessarily connect the marriage to the protection of the family. Based on the Constitution of Albania, we note that it protects the family in general including the alternative forms of the family, as the cohabitation, an institution provided for the first time in the current family code.

The purpose of this paper is to analyze the current situation of the homosexual persons and their right to have a family. The legal discourse on the status of same-sex couples raises problems in terms of legitimacy, democracy and separation of powers.

The future spouses sexuality cannot be overlooked when we treat the conditions of marriage stipulation. The legal discipline regarding the homosexual marriage is found in countries like Spain, Netherlands, etc. In Albania, we have not yet approved a law that allows the contraction of marriage between persons of the same sex, but we are very close to the recognition of the cohabitation between these persons.

Key words: *same-sex couples, family, marriage, cohabitation.*

Hyrje

Vitet e fundit, në vende të ndryshme, vihen re zhvillime për sa i përket njohjes dhe garantimit nga ligji i të drejtave të homoseksualëve. Këtu përfshihet e drejta për mos u diskriminuar në vendin e punës, e drejta për të patur marrëdhënie të njohura ligjërisht si edhe e drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje. Nuk mund të lemë pa përmendur faktin se,

[56] Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, UT, xhensila.kadi@fdut.edu.al

akoma, ekziston një numër i madh shtetesh, , ku në pjesën më të madhe të tyre vazhdon diskriminimi kundër çifteve homoseksuale. Në anën tjetër, së fundmi, janë realizuar një sërë reformash në Europë, në Amerikën e Veriut, në Amerikën e Jugut, dhe në shumë vende të tjera. Shumë nga këto reforma janë shkaktuar dhe janë zhvilluar përmes proceseve gjyqësore dhe gjykimit para gjykatave kombëtare, rajonale, dhe ndërkombëtare.

Një numër i madh shtetesh, aktualisht, nuk i lejon dhe nuk i garanton të drejtën për të krijuar familje personave homoseksualë. Këto shtete nuk i garantojnë asnjë njohje ligjore çifteve LGBT (lesbike, gei, biseksualë, transeksualë). Janë këto asimetri që na nxisin të meremi me këtë çështje, pra me anën ligjore të situatës në të cilën ndodhen çiftet homoseksuale në vendin tonë.

Në këtë punim, do të limitohemi në trajtimin e të drejtës së personave homoseksualë për të krijuar familje, duke lënë mënjanë çështje të tjera të rëndësishme ligjoreqë dalin në të gjithë botën nga diskriminimi në bazë të orientimit seksual. Në ditët e sotme, numri i çifteve homoseksualë që i drejtohen gjykatës për të kërkuar garantimin e të drejtave të tyre sa vjen dhe rritet. Në përgjigje të këtyre situatave, gjykatat e disa shteteve kanë qenë progresive, dinamike, madje edhe kreative në interpretimin që i kanë bërë ligjit, ndërsa disa të tjera kanë qenë konservatore, statike dhe janë limituar në interpretimin leteral të ligjit. Në çdo rast, pavarësisht nga rezultati përfundimtar, është e padiskutueshme se drejtimi apo rrjedha që kanë marë vendimet e gjykatave ka ndikuar në sistemin ligjor të shumë shteteve. Natyra e kërkesave që depozitohen në gjykata ndryshon në varësi të sistemit ligjor për të cilin bëhet fjalë.

Në shtetet ku ka vakum ligjor për sa i përket statusit të çifteve të së njëjtës gjinie, partnerët kryesisht kërkojnë që të njihen të drejtat e tyre si "çift", ndërsa në vendet ku çiftet e të njëjtës gjinie mund të martohen apo mund të regjistrohen si partnerë, personat i drejtohen gjykatës për të kërkuar njohjen e të drejtave të tjera më specifike, të tilla si e drejta për të birësuar fëmijë, etj.

Për sa më sipër, duke u fokusuar në vendimet e gjykatave nuk mund të mendohet, në asnjë mënyrë, se synojmë të minimizojmë rëndësinë e ligjit. Përkundrazi, roli i ligjit dhe i ligjvënësit në perceptimin dhe hartimin e kuadrit ligjor që i përshtatet zhvillimeve dhe ndryshimeve të shoqërisë është thelbësor dhe nuk mund të mos meret në konsideratë. Kjo vlen sidomos në situatën kur theksi vendoset në interpretimin dhe zbatimin e parimit të mosdiskriminimit, që përbën një parim të përgjithshëm të së drejtës.

Në vendin tonë, si rrjedhojë e kulturës otomane, e cila përsa i përket raporteve të individëve me bazë marrëdhëniet e tyre erotiko-sociale ishte liberale, shoqëria filloi të bënte ndryshime nga prirja e saj konservatore. Për shumë shqiptarë të vjetër, këto ishin shenja liberalizimi. Kultura e haremeve nisi të zbusë disi parimet e ashpra të shqiptarëve për të cilët pushka, lufta dhe burrëria ishin tipare që duhet të karakterizonin meshkujt.

Gjurmë të kulturës popullore që zë në gojë homoseksualizmin si një pjesë të natyrshme të jetës i gjejmë në ato zona ku turqit gjetën përkrahje më të madhe dhe nisën të zhvillojnë kulturën e tyre, duke pasur parasysh edhe faktin se këto zona kanë qenë ndër zonat më të varfra dhe më të prapambetura. Këtu mund të përmendim Shqipërinë e Mesme, zonë në të cilën ky fenomen, pavarësisht se nuk pranohej hapur nga shoqëria, nuk shihej si akt kriminal. Nuk gjendet ndonjë folklor i veçantë në lidhje me këtë fenomen në treva të tjera, sidomos në ato të veriut. Por, përsëri duhet thënë se këto shfaqje të tolerancës kundrejt këtij

fenomeni nuk kanë të bëjnë me qëndrimin e shumicës së shoqërisë shqiptare. Veriu i Shqipërisë u pushtua shumë vonë nga turqit dhe, për më tepër, ka pasur treva të cilat turqit nuk arritën ti pushtonin.

Sikurse thamë edhe me lart, shqiptarët duke qenë një popull tepër i vuajtur, i mësuar me luftë, i izoluar, larg përkujdesjeve për veten dhe me një mentalitet tepër patriarkal, shumë burrëror dhe tejet të patolerueshëm ndaj femrave, nuk arrinin të pranonin fenomene të tilla si homoseksualizmi. Për ta, kjo ishte një tradhëti ndaj dhuntisë së të qenit mashkull.Nga ana tjeter, ky fenomen ka qenë më pak i përhapur tek femrat. Kanuni, ligj ky shumë i rëndësishëm i asaj periudhe, sidomos për shqiptarët e veriut, përmban pjesë ku flitet për *virgjinat*. Ato ishin femra të cilat visheshin si meshkuj, luftonin dhe punonin si meshkuj, luanin rolin e mashkullit në shoqëri dhe familje dhe nuk martoheshin.

Në periudhat e mëvonshme mund të themi se fenomeni i homoseksualizmit, në varësi të momenteve politike dhe shoqërore, filloi gjithmonë e më tepër të bëhet tabu.
Shoqëria shqiptare vazhdonte ta quante homoseksualizmin si fenomen jo normal bazuar mbi parimin se çdo shfaqje njerëzore që dilte në kundërshtim me rregullat e pranuara të shumicës përbente një anormalitet moral. Homoseksualet nuk pranoheshin nga opinioni publik, nuk respektoheshin nga shoqëria e cila i konsideronte ata si njerëz të pamoralshëm dhe të sëmurë.
Me vendosjen e regjimit komunist, homoseksualizmi u përfshi në veprat penale dhe dënohej me burg. Gjatë kësaj periudhe vihet re nje sjellje shumë agresive e shoqërisë ndaj homoseksualëve. Ata nuk pranoheshin në shoqëri, ishin objekt i talljeve dhe denoncimeve edhe nga njerëzit më të afërt të tyre. Kjo situatë zgjati për afro 50 vjet.

Pas viteve ’90, edhe pse u shfuqizuan dënimet penale, mentaliteti ndaj homoseksualeve nuk ndryshoi. Për pjesën më të madhe të shoqërisë homoseksualizmi mbetet simbol i njerëzve të sëmurë, të shthurur, të degjeneruar, shpeshherë edhe atyre me nivel të ulët shkollor.

Aktualisht, personat homoseksualë janë bërë më aktivë përsa i përket kërkesave që i drejtojnë ligjvënësit mbi garantimin e të drejtave të tyre. Ata kërkojnë të sigurojnë të drejtën për të krijuar familje dhe të drejtën për të patur fëmijë. Në këtë drejtim, në maj të këtij viti ata kanë protestuar në Tiranë, para selisë së qeverisë, duke kërkuar ligje dhe masa shtesë për të mbrojtur liritë dhe të drejtat e tyre njerëzore. Por, pavarësisht gjithçkaje, një pjesë e mirë e popullsisë vazhdon të mos i pranojë dhe të mos i respektojë.

1. Instituti i martesës sipas legjislacionit shqiptar

Martesa përbën një bashkim civil midis midis dy personave të gjinive të ndryshme, të cilët synojnë jetesën në çift, dhe që realizohet para nëpunësit të gjendjes civile. Është e vështirë për të dhënë një përkufizim për martesën, por sipas doktrinës juridike, martesa përfaqëson një bashkim juridik ndërmjet personave të gjinive të ndryshme të cilët synojnë një jetesë të përbashkët si dhe realizimin e interesave personale dhe pasurorë duke formuar kështu një bashkësi në drejtim të kontributit dhe mbarëvajtjes së familjes.[57] Ajo bazohet në vullnetin e palëve i cili synon krijimin e një familje.

[57] Omari, S., E Drejta Familjare, Botimi i dytë, fq. 38.

Qëllimi i themelimit të një familje sa më të qëndrushme, e cila është në interes jo vetëm të bashkëshorëve, por edhe të gjithë shoqërisë, ka detyruar ligjëvënësin të mos mjaftohet me parashikimin e disa kushteve që garantojnë deklarimin e një vullneti të lirë, siç ndodh në rastet e veprimeve të tjera juridike, por të kërkojë edhe plotësimin e disa kushteve fizike dhe morale nga ana e bashkëshortëve të ardhshëm. Sikurse theksohet me të drejtë në literaturën juridike, ekzistenca e këtyre kushteve për lidhjen e martesës, nuk cënon lirine e individit për të lidhur martesë, pasi ato vijnë në zbatim të parimeve themelore, mbi të cilat është ndërtuar rendi juridik.

Gjatë gjithë kohërave është konsideruar që qënia humane shoqërohet nga instikti i bashkimit të sekseve, bashkim ky i pranuar si nga parimet morale ashtu edhe ato fetare.[58] Martesa nuk shihet vetëm si një akt personal dhe privat, ajo lidhet gjithashtu me interesin publik. Kjo ide përforcohet akoma më shumë me parashikimin në kushtetutë të të drejtës për të lidhur martesë. Lidhja e martesës është, njëkohësisht, një e drejtë kushtetuese dhe universale. Neni 53, pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikon: "Kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje". Kjo e drejtë parashikohet edhe në dokumentet ndërkombëtare, si DUDNJ[59] dhe KEDNJ[60].

E drejta për të lidhur martesë është pjesë e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, i cili i fiton këto të drejta me lindjen gjallë, dhe i mbart ato gjatë gjithë jetës së tij. Është pikërisht shteti, ai i cili duhet të sigurojë garantimin e tyre nëpërmjet ligjit.

Martesa përbën kategori të veprimit juridik. Legjislacioni shqiptar përcakton se personat që dëshirojnë të lidhin martesë duhet të respektojnë disa kushte, të cilat klasifikohen në kushte materiale dhe kushte formale. Ndërsa kushtet formale lidhen me procedurën që duhet të zbatohet në lidhjen e martesës, ato materiale lidhen me përmbajtjen dhe klasifikohen në kushte materiale pozitive dhe kushte materiale negative. Në kushtet materiale pozitive përfshihen ato kushte që duhet të ekzistojnë në mënyrë që të lidhet martesa dhe të jetë e vlefshme. Kushtet materiale pozitive të domosdoshme për lidhjen e martesës janë pëlqimi i lirë, ndryshimi i gjinive dhe mosha madhore[61].

Me bashkim në martesë kuptojmë: marrëdhëniet biologjike, psikologjike, morale, juridike dhe materialo-ekonomike midis një burri dhe një gruaje. Martesa është një bashkim i një burri dhe një gruaje, i rregulluar me ligj. Qëllimi kryesor i saj është krijimi i familjes.[62] Lidhja e martesës sjell realizimin e disa qëllimeve. Këtu mund të përmendim qëllimin natyror, i cili ka të bëjë me krijimin dhe vazhdimësinë e marrëdhënieve bashkëshortore midis burrit dhe gruas, dhe si rrjedhojë, lindjen dhe rritjen e fëmijëve. Pra, mund të themi se martesa është një nevojë biologjike për çdo individ.

Një tjetër qëllim, për të cilin lidhet martesa, është ai moral sipas të cilit martesa nënkupton dashurinë midis bashkëshortëve, ndihmën, respektin dhe përkrahjen e ndërsjelltë midis tyre, çka e bën martesën më të fuqishme.

Një rëndësi të veçantë luan dhe qëllimi shoqëror i martesës që diktohet nga vetë karakteri dhe roli i saj në shoqëri. Për shoqërinë, martesa është një domosdoshmëri, sepse

[58] Omari, S., E Drejta Familjare, Botimi i dytë, fq. 45.
[59] Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.
[60] Konventa Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut.
[61] Omari, S., E Drejta Familjare, Botimi i dytë, fq. 46.
[62] Begeja, K., E Drejta familjare e R.P.S të Shqipërisë, Tiranë 1984, fq. 97.

lindja, rritja dhe edukimi i shëndoshë i fëmijëve, përbën një nga detyrat e rendësishme të saj. Shoqëria e njeh martesën si një institut juridik dhe e vendos atë dhe familjen nën mbrojtjen e shtetit dhe të shoqërisë.[63]

Vetë shteti zhvillon politika të tilla që të nxitë personat të lidhin martesë duke i siguruar mbrojtje më të madhe martesës si një nga format kryesore të krijimit të familjes. Nëse i referohemi Kodit të Familjes, vërejmë se ka një numër të konsiderueshëm nenesh që trajtojnë dhe rregullojnë institutin e martesës. Ky institut gjen një rregullim të hollësishëm në kod për sa i përket kushteve që duhet të respektohen për lidhjen e martesës, procedurën e lidhjes, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesa, zgjidhjen dhe pasojat e zgjidhjes, etj.

Në kulturën tradicionale shqiptare dhe sidomos në zonat rurale mbizontëronte ideja se gruaja duhet të lindë sa më shumë fëmijë duke qenë se fuqia mbrojtëse në ndikimin e çdo familjeje përcaktohej nga numri i meshkujve.

Në shoqëritë paraindustriale shumica e lidhjeve martesore përcaktoheshin nga interesa ekonomike, që kishin të bënin me punimin e tokës, me zhvillimin e artizanatit etj.

Në shoqërinë tradicionale shqiptare krijimi i lidhjeve martesore ndikohej shumë nga interesat e fisit, veçanërisht nga dëshira për fuqizimin e tij ndërmjet forcimit të marrëdhënieve me fiset e tjera. Kështu, lidhjet martesore kuptoheshin e realizoheshin si aleanca ndërmjet fiseve të dy bashkëshortëve të ardhshëm.

Në shoqëritë moderne, sidomos në ato më të zhvilluara ekonomikisht, kryesore në përcaktimin e lidhjeve martesore është dashuria e individëve për njëri-tjetrin, duke plotësuar në këtë mënyrë një nga kushtet thelbësore për lidhjen e martesës, konkretisht, pëlqimin e lirë.

Ndryshimi i gjinisë, kusht për lidhjen e martesës

Aktualisht, sipas legjislacionit shqiptar çdo person ka të drejtë të vendosë lirisht nëse do të lidhë martesë ose jo si edhe të zgjedhë lirisht bashkëshortin. Ashtu si e përmendëm edhe në paragrafin më sipër, e drejta për të lidhur martesë, përbën një të drejtë kushtetuese.

Kodi ynë i familjes nuk jep një përcaktim të qartë të konceptit të bashkëshortëve të ardhshëm. Gjithsesi, në termat e Kodit të Familjes, "burrë", "grua" nënkuptojnë se ligjvënësi e ka formatuar në mënyrë të plotë ekzistencën e sekseve të ndryshme.[64] Në bazë të nenit 7 të KF: "Martesa mund të lidhet ndërmjet një burri dhe një gruaje që kanë mbushur moshën 18 vjeç".

Prej këtej rrjedh edhe një prej çështjeve më të debatueshme në ditët e sotme që ka të bëjë me kufizimin e përkatësisë gjinore që duhet të ketë bashkëshorti tjetër, çka do të thotë që martesat homoseksuale nuk janë të lejuara nga legjislacioni shqiptar aktual.

Kemi të bëjmë me një kusht shumë të rëndësishëm. Ligjvënësi ynë e konsideron absolutisht të domosdoshëm këtë kusht, i cili rregullohet në të njëjtën dispozitë që përcaktohet edhe limiti i moshës që duhet të kenë arritur bashkëshortët e ardhshëm në mënyrë që të mund të lidhin martesë. Por, në ndryshim nga mosha, që përbën një kusht material pozitiv që mund të shmanget me autorizimtë gjykatës për shkaqe me rëndësi, ndryshimi i gjinive përbën një kusht që nuk mund të shmanget në asnjë rast. Në këto kushte, e drejta për të zgjedhur partnerin kushtëzohet nga fakti se ai duhet të jetë i gjinisë tjetër, në të kundërt

[63] Neni 49 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
[64] Mandro, A., Meçaj, V., Zaka, T., Fullani, A., "E drejta familjare", "KRISTALINA KH", Tiranë 2006, fq. 118.

martesa do të jetë e pavlefshme sepse nuk është respektuar një nga kushtet thelbësore për lidhjen e saj, pikërisht, ndryshimi i gjinive.

Për një pjesë të doktrinës[65], martesa e lidhur midis personave të së njëjtës gjinie është inekzistente ose e paqënë duke qenë se nuk prodhon pasoja as edhe një çast të vetëm. Ndryshe nga rasti i pavlefshmërisë së martesës, pasojat e së cilës varen edhe nga dijenia ose jo e ekzistencës së shkakut të pavlefshmërisë, në rastin e inekzistencës kjo nuk ka rëndësi. Një martesë e tillë do konsiderohet sikur nuk është lidhur asnjëherë dhe nuk do të sjellë asnjë pasojë.

Ekzistojnë shtete që pranojnë martesën ndërmjet personave të të njëjtit seks, bëjnë lobime që ky fenomen të pranohet gjithandej pasi njerëzve ju takon e drejta për të zgjedhur lirisht partnerin pavarësisht gjinisë.

Thelbi i debatit juridik ka të bëjë me faktin se pjesa më e madhe e kundërshtimeve lidhet me faktin që nuk duhet të quhet martesë por të marrë një emërtim tjetër.[66]

Madje, legjislacioni ynë nuk njeh as martesat homoseksuale të lidhura në shtetet e tjera, që lejojnë lidhjen e martesava mes personave të të njëjtës gjini. Një marrëdhënie e tillë juridike me elemente të huaja, nuk do të njihet e as do të jetë e vlefshme në territorin shqiptar. Ligji i huaj nuk zbatohet kur efektet e zbatimit të tij janë dukshëm në kundërshtim me rendin publik apo mund të sjellin pasoja, të cilat janë haptazi të papajtueshme me parimet themelore, të përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjin shqiptar. Në rast papajtueshmërie, zbatohet një dispozitë tjetër e përshtatshme, që i përket të drejtës së shtetit të huaj dhe, kur kjo mungon, zbatohet ligji shqiptar.[67]

Ky ndalim i njohjes së vlefshmërisë të martesave homoseksuale në Shqipëri, rrjedh si pasojë e faktit se bie ndesh me atë çka përmendëm në paragrafin më sipër, rendin publik. Ndaj, në rastin e martesave homoseksuale, nuk mund të bëhet njohja nga legjislacioni shqiptar, sepse shkelen normat e rendit publik, kushtet e lidhjes së martesës, dhe konkretisht, kushti i ndryshimit të gjinive mes bashkëshortëve të ardhshëm.

2. Bashkëjetesa, alternativë për krijimin e familjes

Familja përbën një formacion social shumë të rëndësishëm për zhvillimin e individit dhe të gjithë shoqërisë, ajo konsiderohet si qeliza bazë e shoqërisë. Është e vërtetë se legjislacioni shqiptar garanton një mbrojtje të veçantë për martesën, por ajo nuk e lidh domozdoshmërisht mbrojtjen e familjes, me martesën. Për natyrën juridike të martesës ekzistojnë dy koncepte kryesore: martesa është *kontratë sociale*, dhe martesa është *institut juridik*.[68] Kushtetuta e mbron familjen në përgjithësi duke përfshirë këtu dhe forma të tjera, alternative, të krijimit të familjes siç është bashkëjetesa, ose bashkimi i lirë faktik i dy personave me gjini të ndryshme, e parashikuar për herë të parë në kodin aktual të familjes. Kodi i familjes i 2004-ës e parashikon në dy dispozita bashkëjetesën, konkretisht në nenin 163 dhe në nenin 164.

Neni 163 jep përkufizimin ligjor të bashkëjetesës: bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetesë e përbashkët që ka karakter stabiliteti

[65] Omari, S., E Drejta Familjare, Botimi i dytë, fq. 208-213.
[66] Idem.
[67] Neni 7, Ligji Nr.10 428, datë 2.6.2011, "Për të drejtën ndërkombëtare private".
[68] Podvorica, H., E drejta Familjare, Shtëpia Botuese "ROMINOR", Prishtinë 2005, fq. 67.

dhe vazhdueshmërie. Ajo çka na tërheq vëmendjen përsa i përket përkufizimit të bashkëjetesës lidhet me faktin se ligjvënësi e ka parashikuar shprehimisht ndryshimin e gjinisë midis personave që bashkëjetojnë duke "përjashtuar" mundësinë e bashkëjetesës midis personave të së njëjtës gjinie. Mendojmë se një formulim i tillë i dispozitës mund të lidhet me një pakujdesi në momentin e hartimit të kodit duke qenë se legjislacioni shqiptar nuk parashikon asnjë sanksion në rastin kur personat që bashkëjetojnë nuk janë të gjinive të ndryshme. Madje mund të themi se, në legjislacionin shqiptar, kjo është e vetmja mundësi që këta persona kanë për të krijuar familje.

Në anën tjetër, mendojmë se mungesa e parashikimit apo "lejimit" të bashkëjetesës midis personave të së njëjtës gjinie ishte rrjedhojë e realitetit shqiptar të kohës.

Aktualisht, pritet të çohet në Kuvend drafti për "Kodin e Familjes", në të cilin parashikohet edhe lejimi i bashkëjetesës midis personave të së njëjtës gjinie. Për rrjedhojë, edhe personat me prirje homoseksuale që jetojnë në Shqipëri do të kenë mundësinë që të krijojnë familje duke qenë legjislacioni ynë se do të njohë bashkëjetesën mes tyre.

Ndryshon situata në rastin e martesës midis personave të të njëjtës gjinie. Në këtë rast, ashtu si e përmendëm edhe më sipër, martesa do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme dhe nuk do të sjellë asnjë pasojë ligjore si në aspektin personal ashtu edhe në atë pasuror.

Kushtetuta mbron edhe familjen e krijuar nga një nënë ose baba i pamartuar duke trajtuar në mënyrë të barabartë fëmijët e lindur jashtë martese me ata të lindur nga martesa. Në këtë aspekt, arrijmë në konkluzionin se, të njëjtën mbrojtje do të gëzojë edhe familja e krijuar nga një prind me prirje homoseksuale. Mbrojtja e veçantë e familjes dhe e martesës është e lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me gëzimin real të së drejtës për jetë familjare normale. Një analizë e dispozitave përkatëse të kushtetutës të sjell në konkluzionin se këto dispozita, përmbushin elementet më të rëndësishëm, që sigurojnë gëzimin e një jete familjare normale, siç janë: e drejta për të krijuar një familje, e drejta për të jetuar me familjen, e drejta për të respektuar barazinë bashkëshortore, si dhe mbrojtja e posaçme e fëmijëve. Të gjitha këto elemente janë të lidhura me disa të drejta të tjera kushtetuese të rangut të parë, sidomos me të drejtën për të gëzuar një jetë private të qetë pra, të drejtën për të respektuar intimitetin e jetës familjare.[69]

Konkluzione

Në qoftë se ligji lejon që një çift heteroseksual të ketë akses në këtë burim të marrëdhënies familjare, që është martesa, dhe i mohon këtë të drejtë një çifti homoseksual, kjo do të thotë se ne e garantojmë të drejtën për të lidhur martesë në disa situata të caktuara duke anashkaluar disa raste të tjera, pavarësisht se kërkohet e njëjta gjë. Për këtë arsye, mund të themi se argumenti që përdoret kundër martesave homoseksuale bie në kundërshtim me instiktet dhe përmbajtjen e dinjitetit njerëzor. Kjo na bën të mendojmë se kultura që formon vlerat tona është pronë e vetëm disave prej nesh, konkretisht e atyre që kanë forcën dhe pushtetin për ta gdhendur dhe paraqitur atë në formën që ata dëshirojnë.

Në gjykimin tonë, kjo përbën një gabim të madh pasi, për një shoqëri të lirë, gama e ideve dhe vlerave ju përket të gjithëve.

[69] Anastas, A., Të Drejtat e Gruas në legjislacionin Shqiptar, 2010.

Shqipëria është një vend demokratik që ka në themel të saj respektimin e të drejtave të njeriut. Përveç se marrëdhënie juridike, martesa është edhe një marrëdhënie shoqërore. Për rrjedhojë, mund të themi se martesa përfaqëson tërësinë e individëve që përbëjnë shoqërinë dhe evolimet që pëson ajo. Duke u bazuar në këtë fakt, mendoj se legjislacioni duhet të pasqyrojë ndryshimet e shoqërisë duke përmbushur në këtë mënyrë një nga detyrat e tij, konkretisht, rregullimin e marrëdhënieve mes individëve në shoqëri. Kemi shumë shembuj të përshtatjes së legjislacionit me kushtet socialo-ekonomiko-politike të shoqërisë.

Në këtë rast, kemi të bëjmë me parime të padiskutueshme që lidhen me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe konkretisht me lirinë e tij për të zgjedhur dhe jetuar i lirë jetën e tij duke përfshirë këtu orientimin seksual. Për më tepër, Kushtetuta e vendit tonë nuk e ndalon ligjvënësin të miratojë ligje që garantojnë të drejtën e personave homoseksualë për të krijuar familje.

Mendoj se familja tradizionale, ajo e përbërë nga burri, gruaja dhe fëmijët, ka pësuar rënie në shumë vende europiane si pasojë e faktit se shumë çifte heteroseksuale zgjedhin të mos martohen, zgjedhin të zgjidhin martesën apo zgjedhin të mos bëjnë fëmijë.

Pavarësisht kohës në të cilën jetojmë, vërejmë se shoqëria jonë vazhdon të jetë konservatore në lidhje me këtë fenomen. Frika se me pranimin e martesave homoseksuale mund të humbasë kuptimi dhe përkufizimi i familjes tradicionale bën që një pjesë e madhe e shoqërisë të jetë skeptike në pranimin e martesave homoseksuale.

Vazhdojmë të përballemi me mitin se pranimi i martesave homoseksuale do të sjellë rritjen e numrit të homoseksualëve në vend.

Por, pavarësisht gjithçkaje, nuk mund të lemë pa përmendur projektin për të njohur dhe rregulluar në kod bashkëjetesën midis personave të së njëjtës gjinie. Në këtë mënyrë, edhe në vendin tonë, homoseksualët mund të krijojnë familje dhe kjo e fundit të njihet me ligj.

Bibliografi

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998.
- Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 9062, datë 08.05.2003.
- Ligji Nr.10 428, datë 2.6.2011 “Për të drejtën ndërkombëtare private”.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “ Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
- Anastas, A., “Të Drejtat e Gruas në legjislacionin Shqiptar”, 2010.
- Begeja, K., E Drejta familjare e R.P.S të Shqipërisë, Tiranë 1984.
- Mandro, A., Meçaj, V., Zaka, T., Fullani, A., “E drejta familjare”, “KRISTALINA KH”, Tiranë 2006.
- Omari S., “*E drejtë familjare*”. Botim i dytë. Tiranë, 2008.
- Podvorica, H., “E drejta Familjare”, Shtëpia Botuese “ROMINOR”, Prishtinë 2005.

MENAXHIMI DETEKTIV I SITUATAVE KRIMINALE

DETECTIVE MANAGEMENT OF CRIMINAL SITUATIONS

Dashmir Nasufi

UDC: 341.242.24(4-672EY)(091)

Abstract

Detective management is an expression basically used in the science of criminal law and other similar sciences that in the aspect of ethics signifies the administration and leading the cases with a special professional and investigative devotion. Appliance of the detective acts is very flexible that differs from the limit of other managers, where the principal of detective management can affect as a prevention of undesired situations and affects in the work improvement of one organization and eliminates possible practical risks that can appear during the development of activities of one organization.

The subject of detective management as a specific subject with international unified character cannot be judged by its performance, but from the results that reach the dependents of the organization. Due to this argument the waste majorities of scientists accept the fact that reaching the result can be done through people with detective abilities and using in practice these abilities.

Detective activities in countries members of UE, is accepted in serious manner as a profession that reflects in comparative review of the legislation that deals with the EU industry of private security, which is been brought as a final report but ratified in the European Conference for Private Security held Brussels on December 12 and 13, 2001. The report shows the efforts for the law regulative harmonization of the detective activities in member countries of the UE.

For the first time Detective activities in R. of Macedonia are adjusted in 1999 with the law for Detective Activities. According to the available data until the beginning of the year 2009 in R. of Macedonia there was no detective company registered, which unfortunately is an argument of failure.

Detective management introduces the summary of operative-technical measures and means taken by the detectives with the purpose of detecting and proving (facts and arguments) the committed criminal act. Each committed criminal act has its specifics, for what we cannot talk for taking the unified measures and activities by the detective, for detecting the criminal acts. A common thing of the criminal acts is only the description in the Criminal Code. Only the committed criminal act presents activities taken against the law by the perpetrator of the criminal act, respectively each perpetrator has its modus operandi of committing the act.

Keywords: detective, criminal act, the Penal Code, detective management etc.

1. HYRJE

Menaxhimi detektiv është term që përdoret në shkencat penalo-juridike dhe shkenca të tjera të ngjashme që në aspektin etik simbolizon administrimin dhe udhëheqjen e çështjeve me një përkushtim të veçantë profesional dhe hulumtues.

Menaxheri detektiv përveç se duhet të jetë talent praktik në intuitën e gjërave që do të ndodhin por edhe duhet të ketë aftësi për të hetuar paraprakisht dhe për të administruar brenda dhe jashtë një organizate.

Me fjalë të tjera menaxhimi detektiv është menaxhim me karakteristika të veçanta në parapërgatitjen e çështjeve dhe objektivave të veçanta për të realizuar një çështje me administrim të përgjithshëm menaxhimi.

Vlen të theksohet se të gjithë menaxherët në një organizatë kryejnë funksione të njëjta bazë por **menaxherët detektiv kanë role të veçanta në jetësimin e çështjeve dhe aktiviteteve paraprake, që ndryshon në varësi të pozitës**.

Aplikueshmëria e veprimeve detektive është fleksibile që dallon nga kufiri i menaxherëve të tjerë, ku parimi i menaxhimit detektiv mund të ndikojë si prevencion i situatave të papëlqyeshme dhe ndikon në përmirësimin e punës së një organizate dhe eliminon rreziqet e mundshme praktike që mund të paraqiten gjatë zhvillimit të veprimtarisë së një organizate.

Lënda e menaxhimit detektiv si lëndë specifike me karakter të unjësuar ndërkombëtar gjykohet jo nga performancat, por nga rezultati që arrijnë vartësit e një organizatë. Kjo ka bërë që shumë studiues të pranojnë që arritja e rezultateve bëhet nëpërmjet njerëzve me aftësi detektive dhe vënien në praktikë të këtyre aftësive.

Paraqitjen e veprimtarisë detektive e gjejmë që para dy shekujsh.Si bazë e veprimtarisë detektive na paraqiten SHBA, por në Evropë paraqitet më vonë në shtetet kapitaliste siç janë: Anglia, Franca dhe Holanda.

Zhvillimi i shoqërisë kapitaliste në fillimet e saja bazohej në të drejtën e pronësisë dhe me vetë atë edhe me mbrojtjen e të mirave të tyre si dhe sigurinë e kapitalistëve. Për ta realizuar të drejtën e tyre, kapitalistët përveç shfrytëzimit të shërbimeve lidhur me mbrojtjen e sigurisë së tyre dhe sigurisë së të mirave materiale, të cilat shërbime në raport me kushtetutat e shteteve të tyre i merrnin nga policia si organ shtetëror, shfrytëzonin edhe shërbime detektive nga individë dhe kompani të cilat ishin në pronësi private. Nga kjo mund të vijmë në konkludim se bëhet fjalë për dy lloje të veçanta të sigurisë .Njëra që e siguron shteti nëpërmjet policisë si organ shtetëror dhe lloji i dytë i sigurisë që e siguronin detektivët privatë dhe kompanitë që ofrojnë shërbime detektive. Edhe pse flasim për dy lloje të sigurisë vlen të theksojmë që të dy llojet e sigurisë edhe pse jepen nga ana e organit shtetëror dhe personave dhe kompanive private,megjithatë në punën e tyre ata ndihmohen ndërmjet veti.

Megjithatë që atëherë deri sot nëse bëjmë analizë të vendimeve ligjore ekzistuese në fushën e sigurisë vijmë në përfundim se ai bashkëpunim është i njëanshëm nga veprimtaria private detektive kah veprimtaria e organeve shtetërore përkatëse,d.m.th policia.

Ajo gjithmonë paraqitet në rol te veçantë shikuar nga më shumë aspekte:

-E para - lejen për punë për detektivin privat e jep organi shtetëror përgjegjës gjegjësisht policia,

-E dyta - kontrollin dhe mbikëqyrjen ndaj detektivit privat e kryen policia,

-E treta - detektivi mund të quhet ex oficio është i detyruar që nëse gjatë punës së tij vjen në dijeni për një vepër të kryer për të duhet ta lajmëroj policinë,

-E katërta-puna e policisë financohet nga ana e shtetit gjegjësisht buxhetit,ndërsa puna e detektivit privat financohet nga ana e kërkuesit të shërbimit,

-E pesta- shikuar nga aspekti ligjor policia ka autoritet më të gjerë gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj (duke filluar nga mënyra e mbledhjes së informacioneve deri te përdorimi i mjeteve të forcës si dhe përdorimi i mjeteve për ndjekje të komunikimeve elektronike), të cilat nuk janë të disponueshme për detektivin privat.

Megjithatë nëse sigurinë e pronës dhe njerëzve i vëzhgojmë në aspektin e të drejtave themelore të njeriut,të dy llojet e sigurisë për realizimin e qëllimit përfundimtar duhet që të bashkëpunojnë sa më afër njëri me tjetrin. Për fat të keq personat zyrtar i nënçmojnë veprimtaritë private detektive.

Fjala detektiv rrjedh nga fjala latine detegere qe d.m.th zbulim,të zbulohet diçka. Për herë të parë këtë term e gjejmë në formë të shkruar në romanin “Shtëpia e ftohtë“ e shkrimtarit Charls Dikens në te cilën vepër roli kryesor inspekrori Beket paraqitet si oficer detektiv.

Në kohët e sotme veprimtaria detektive në shtetet e Evropës në veçanti në shtetet e UE –së intenzitetin e saj e arrin në dekadat e fundit.

Në këtë mënyrë të zhvillimit në veprimtarinë detektive ndikojnë më shumë faktorë, para së gjithash zhvillimi i sektorit privat të sigurisë, i cili është i kushtëzuar dhe përcaktuar nga vëllimi, kualiteti dhe dinamika e ndryshimeve të pasurive private si formë dominante dhe e shenjtë.

Veprimtaria detektive në vendet anëtare të UE-së është pranuar në mënyrë serioze si profesion që është reflektuar në shqyrtimin krahasues të legjistlativës e cila e rregullon industrinë e sigurisë private në UE, gjë e cila është sjellur edhe si raport përfundimtar por është miratuar edhe në konferencën evropiane për siguri private që u mbajt në 12 dhe 13 dhjetor të vitit 2001 në Bruksel.Ky raport tregon për përpjekjet për harmonizim të rregullativës juridike të veprimtarisë detektive në vendet anëtare të UE-së.

Të gjitha 27 shtetet anëtare të UE-së veprimtarinë detektive e rregullojnë me anë të legjistlacioneve të tyre kombëtare, dhe kështu përballen me ndryshime serioze.

Edhe RM si shtet pretendues për anëtare me të drejta të plota e UE-së do të duhet që t'a autorizojë legjislacionin e vet, i cili e rregullon veprimtarinë detektive.

Sfidat që qëndrojnë para UE-së lidhur me rregullimin juridik-unifikimin e veprimtarisë detektive para se gjithash lëvizin në drejtim të:

-Kushtet e themelimit të firmave për siguri private,

-Kufizimin e kompanive private të sigurisë, sa i takon pronarëve dhe ekipit menaxhues,

-Parakushtet që duhet ti plotësojnë kompanitë private në lidhje me lejen për kryerje të kësaj veprimtarie,

-Parakushte dhe edukim të detektivëve të ardhshëm,

-Legjistlativa që e rregullon përdorimin e armëve të zjarrit,

-Dispozitat në lidhje me përdorimin e qenve zyrtarë dhe

-Dispozitat që i takojnë kryerjes së kontrollit dhe sanksioneve në industrinë e sigurisë private.

Veprimtaria detektive për herë të parë në RM është rregulluar në vitin 1999 me ligjin për veprimtari detektive.Sipas të dhënave të disponueshme deri në fillim të vitit 2009 në RM nuk ishte regjistruar asnjë kompani detektive që për fat të keq është një fakt humbës.Përgjigjen lidhur me regjistrimin e kompanive private detektive duhet ta kërkojme në rregullativën ligjore e cila është shumë e paqartë sepse nuk i lë hapësirë detektivit për punim kualitativ dhe profesional, gjegjësisht kemi një ngatërresë të paqartë të ingerencave ndërmjet sektorit privat dhe atij shtetëror të sigurisë, në vendimet ligjore nuk është caktuar në mënyrë të prerë (decide) çfarë është e lejuar dhe çfarë jo për detektivin gjatë mbledhjes së informative dhe të dhënave e cila gjithsesi përfaqëson një pengesë serioze për kryerjen me sukses të veprimtarisë detektive.

2. ZHVILLIMI I MENAXHIMIT DETEKTIV

Në kohët e sotshme në shtetet evropiane veprimtaria detektive duket si pjesë e një industrie me përfitime të mëdha,të cilën sa më shpejtë të jetë e mundur duhet ta rregullojë gjegjësisht ta sistemojë rregullativa që e përfshin këtë sferë.Vetëm në këtë mënyrë mund të ndiqen ndryshimet globale në jetën shoqërore dhe normalisht si pjesë më e shprehur e jetës shoqërore është siguria e jetës dhe e pasurisë. Kur flasim për sigurinë e njerëzve dhe pasurisë nuk mundemi të mos e theksojmë që menaxhimi detektiv e plotëson sigurinë e njerëzve dhe pasurisë të cilën qytetarët e marrin nga organet shtetërore përgjegjës për sigurinë e tyre.

Rritja e kriminalitetit e cila sjell deri në pasigurinë e njerëzve në njërën anë dhe shkallë e ulët e efikasitetit të policisë nga ana tjetër gjithsesi që menaxhimit detektiv si siguri privare do ti mundësojë respekt më të madh në shoqëri.

Realisht në të ardhmen mund të presim që prespektiva e menaxhimit detekitv të lëvizë në drejtimet e mëposhtme:

-Zhvillim permanent të veprimtarisë detektive,

-Rritja e kërkesës së shërbimeve nga kompanitë detektive,

-Përmirsimi i rregullativës ligjore në fushën e veprimtarisë detektive, dhe

-Partneritet të barabart me sektorin shtetëror.

3. MENAXHIMI DETEKTIV ME VEPRAT PENALE

Menaxhimi detektiv paraqet përmbledhjen e masave dhe mjeteve operativo-teknike dhe taktike të ndërmarra nga detektivi me qëllim të zbulimit dhe provimit (fakte dhe prova) të veprës penale të kryer. Cdo vepër penale e kryer ka specifikat e saj për çka nuk mund të flasim për ndërrmarrje të masave dhe veprimeve te unifikuara nga ana e detektivit për zbulimin e veprave penale. E përbashkët e veprave penale është vetëm përshkrimi i tyre në kodin penal.Vetë kryerja e veprës penale paraqet veprime të kundërligjshme të ndërmarra nga kryerësi i veprës penale gjegjësisht çdo kryerës ka modus operandi të kryerjes.

E përbashkët në kryerjen e hetimit gjatë menaxhimit detektiv është përgatitja e planit për punë.

Plani për punë paraqet udhëzues themelor për kryerje hetimi me sukses e cila në fund duhet të japë rezultate me vetë zbulimin e kryerësit të veprës penale. Në thelb plani duhet të jetë gjithpërfshirës me propozim real të masave dhe mjeteve operative, trajtim të dyshimeve për vepër të kryer penale në mënyrë reale (mjetet e kryerjes së vepres penale, koha e kryerjes, motivet e kryerjes dhe të gjitha rrethanat tjera të cilat janë të rëndësishme për zbulimin e kryerësit të veprës penale) si dhe kryerësin e mundshëm të veprës penale.

Pas pranimit të paraqitjes për nje vepër penale të kryer, detektivi është i detyruar që ti studiojë të gjitha informacionet që ka në dispozicion në lidhje me atë vepër penale. Pas studimit të informacioneve të pranuara është e nevojshme që të fillojë me përgatitjen e planit operativ gjegjësisht duhet ti përpunojë të gjitha verzionet për atë vepër penale me qëllim që tu përgjigjet të gjitha 9 pyetjeve të arta të kriminalistikes. Plani fillestar i përgatitur assesi nuk duhet të duket si i pandryshueshëm dhe statik por si një kategori e ndryshueshme dhe dinamike. Kjo ndodh për arsye se me fillimi e mbledhjes së të dhënave lidhur me veprën e kryer penale (faktet verbale dhe materiale) do të paraqiten të dhëna të cilat ndoshta nuk do të jenë identike me verzionet e parashikuara në planin fillestar dhe për këtë arsye plani fillestar i përgatitur duhet që të pësojë ndryshime.

Ndërmarja e masave dhe veprimeve operative duhet të vërtetohet me saktësi si një detyrë konkrete e dhënë, me anë të së cilës autorizohet detektivi përkatës, dhe secila detyrë duhet të ketë afat të caktuar për kryerjen e saj.

Verzionet paraprake janë të përgjithshme, me mbledhjen e të dhënave nga ana e detektivit, verzionet gradualisht konkretizohen, gjegjësisht arrijmë deri te eliminimi i verzioneve të bëra paraprakisht.

Cdo plan operativ duhet të fillojë me përcaktimin e personit përgjegjës, si dhe të gjithë detektivët tjerë të përfshirë në plan. Kryerja e planit operativ paraqet një punë operative. Nëse vetëm njëra lidhëse e zinxhirit në planin operativ nuk funksionon siç duhet, suksesi për zbulimin dhe vërtetimin e veprës penale zvogëlohet.

Gjithmonë koha nga kryerja e veprës penale deri në zbulimin e saj është në anën e kryerësit. Megjithatë duhet të kihet parasysh që të mos shpejtohet me ndërmarrjen e masave operative, pasi që veprimet e përshpejtuara mund të sjellin deri te pasojat e padëshirueshme gjegjësisht deri të kahëzimi i hetimit detektiv në drejtim të gabuar i cili në fund nuk do të japë rezultatet e dëshiruara.

Në planin operativ, përveç potencialit kadrovik i cili merr pjesë në kryerjen e hetimit, duhet të parashikohen mjetet e nevojshme materiale teknike që janë të nevojshme gjatë aplikimit të hetimit detektiv. Pa posedimin e mjeteve materiale teknike të nevojshme gjatë kryerjes së hetimit, i njëjti nuk mund të ketë sukses. Mosrespektimi i afateve mund të sjellë deri te shkatërrimi i pjesshëm ose i plotë i gjurmëve materiale të cilat rrjedhin nga vepra penale, ikja e kryerësit të v.p,fshehjen e lëndëve të cilat rrjedhin nga v.p si përfitime material, krimin e alibisë nga ana e kryerësit etj.

Nëse ka nevojë, mvarësisht nga vepra penale e kryer përvec planit të përgjithshëm mund të përgatiten edhe plane të konkretizuara, gjë që mvaret nga situatat e krijuara. Prandaj është e nevojshme që në planin e përgjithshëm të parashikohen më shumë verzione dhe me eliminimin e tyre të arrihet deri te verzioni i vërtetë i cili do të përgjigjet në 9 pyetjet e arta të kriminalistikës:

1. Cfarë ka ndodhur?

2. Kush është kryerës i veprës penale?

3. Kur është kryer vepra?

4. Ku është kryer vepra penale?

5. Si është kryer v.p?

6. Me çfarë është kryer v.p?

7. Me kë e ka kryer kryerësi v.p?

8. Përse është kryer v.p (motivi)?

9. Kë ose çfarë ka sulmuar kryerësi i v.p?

Vendosja e një ose një numri më të vogël të verzioneve nuk ka perspektivë, gjegjësisht arrihet deri në një situatë të bllokimit të plotë të zbulimit të kryerësit të veprës penale.

Përgatitja e një plani kualitativ mundëson zbulim të shpejtë dhe efikas të kryerësit të veprës penale. Mospasja e një plani, i referohet një pune spontane e cila jep shanse minimale për zbulim të suksesshëm të kryerësit të veprës penale.

Pas zbulimit të kryerësit të veprës penale është e detyrueshme që të bëhet një analizë e planit sipas të cilit veprohej për zbardhjen e rastit. Analiza para së gjithash është e nevojshme që të shikohen të gjitha aspektet pozitive dhe negative të planit sipas të cilit veprohej gjatë zbulimit të kryerësit të veprës penale. I suksesshëm është vetëm ai plan sipas të cilit janë ndërmarrë masat dhe veprimet e planifikuara, kryerësi i v.p është zbuluar, u është përgjigjur të nëntë pyetjeve të arta të kriminalistikës ndërsa padia penale është përpunuar.

Duhet të theksojmë se në disa vepra penale, ku ndërmarrja e masave operative-taktike dhe teknike është e patjetërsueshme për shkak të shpejtësisë, disa masa dhe veprime ndërmerren edhe para përgatitjes së planit operativ, ato masa dhe veprime të ndërmarra me vetë përpilimin e planit inkorporohen në të duke theksuar se ata masa dhe veprime janë ndërmarrë më.

4. PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

4.1 Perfundime

Mendojmë se menaxhimi detekriv i veprave penale nuk është i përcaktuar sic duhet me ligj dhe nuk ka ndonjë theks të vecantë as në Kodin Penaltë Republikës së Maqedonise, por as edhe në Kodet Penale të shteteve të tjera Ballkanike pasi që i është dhënë një përparësi e madhe menaxhimit tësituatave krimiale nga ana e policisë dhe organeve tjera shtetërore. Nga ana tjetër nuk u jepet mundësi agjensioneve private detektive që në mënyrë private t,i ndjekin gjurmët e kryerësve të veprave kriminale dhe zbulimin e zbardhejen e tyre sic ndodh në vendet e zhvilluara.

Formulimet ligjore nuk janë bërë në mënyrëne përshtatshme dhë në harmonizim me ligjet e shtetev të zhvilluara të Unionit Europian dhe SHBA-së.

4.2 Rekomandim

Rekomandojmë harmonizim të ligjeve me ato të vendeve Perëndimore me qëllim të dhënies së mundësive të hapjes së këtyre agjensioneve për detektivë privat me qëllim të ardhjes në ndihmë të institucioneve përkatëse për zbulimin e krimit dhe mbledhjen e informacioneve në lidhje me kryerësit e veprave penale.

Kjo gjë duhet të bëhet në mënyrë qe të kushtëzohen edhe hapjet e këtyre agjensioneve duke u kërkuar që të kenë së paku dy ekspertë në fushen kriminalistike dhe penale, por edhe me anë të testimit nga një agjension i vecantë shtetëror në suaza të Ministrisë për Punë të Brendshme.

Literatura e shfrytezuar:

Lajiq O, 2004: Pozita dhe rroli i policisë në procedurën para penale ose pas penale, Bezbednost, nr.1. Beograd

Hysi. V. Hyrje ne kriminologji dhe Penologji, Tirane, 2000.

Vodinelic. V. Kriminalistika, Zagreb, 1990.

Halili. R. Kriminlogjia, Prishtine, 2005.

Krapac D, 1982: Provat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në procedurën penale, Zagreb.

Milosheviq, n Milojeviq S, 2001: Bazat e metodologjise së shkencës së sigurisë, Beograd.

Krstiq O, 2003: Prognozimi i kriminalitetit, Beograd

Angeleski M. 2005 Kriminalistika operative, Shkup.

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë, 1996, Shkup
Ligji per Polici
Evidenca operative e arkivit të MPB të RM

Apelimi i Vendimeve në Procedurën Administrative Doganore – Analizë Komparative

Dr. Sc. Orhan M. Çeku

Dr. Sc. Ismail Mehmeti

Dr. Sc. Mentor Shaqiri

UDC: 339.543(497.115)

Abstract

The role and importance of the Customs System for the local economy is very high. But, customs system in contemporary conditions and circumstances has evolved by adapting to the economic integration and harmonization of legislation needs arising from integration processes. Although states are independent and they define its domestic legislation, in our time it is needed harmonization of the positions expressed in international agreements which also turn into domestic laws.

In this paper it is discussed and analyzed the appeal of administrative decisions in customs procedure by positive legislation in the Republic of Kosovo. The paper has comparative character, because it is discussed the appeal procedure foreseen by the legislation of the Republic of Albania. Within the exposition is briefly treated the procedure relating to the judicial control of administrative customs acts.

The appeal of decisions presents and expresses guarantee of freedom and human rights. For human rights protection there are foreseen institutional mechanisms for the implementation of this function.

In this paper are used methods like: descriptive method, analysis and synthesis methods and methods of doctrinal interpretation and normative method.

Key words: Appeal, procedure, customs, administrative, law, decisions.

1. Hyrje

Procedura administrative është ai lloj i procedurës i cili udhëhiqet nga organi i administratës shtetërore, në bazë dhe për zbatimi të ligjit, me kërkesën e palës ose ex oficio (sipas detyrës zyrtare), përfundimi i së cilës rezulton me marrjen e vendimit konkret administrativ. Procedura administrative doganore është procedurë e veçantë e administrative e cila rregullohet me ligj special, i cili ligj i përgjigjet specifikave të procedurës relevante administrative. Ligj special në këtë procedurë është Ligji për Dogana (Kodi Doganor). Procedura administrative doganore ushtrohet nga autoritetet publike në Republikën e Kosovës. "Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre".[70]

Në praktikën juridike gjatë udhëheqjes së procedurës ndodhin situata ku organet e administratës gabimisht aplikojnë ligjin material. Kjo ndodh për shumë arsye. Mirëpo, në mënyrë që të evitohen dhe të korrigjohen gabimet eventuale në zbatimin e ligjit – ligji ka paraparë mjetet juridike të goditjes së vendimeve apo apelimin e vendimeve administrative.

Përmes procedurës apeluese mundësohet korrigjimi i gabimeve, realizohet kontrolli i punës së administratës, sigurohet zbatimi i drejtë i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut.

Procedura në lidhje me mjete juridike të goditjes së vendimeve zhvillohet në dy mënyra: procedura administrative në lidhje me mjetet juridike administrative (ankesa dhe kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve) dhe procedura apo kontrolli gjyqësor i vendimeve administrative – konflikti administrativ.

E drejta për apelim të vendimeve është parim kushtetues. Me kushtetutën është paraparë dhe garantohet e drejta e ankesës kundër akteve administrative të vendosura në procedurë në shkallë të parë para gjyqit, organi administrativ ose organizatave apo institucioneve tjera të cilat kryejnë autorizime publike. Në bazë të kësaj e drejta kushtetuese në ankesë nuk mundet të jetë e suspenduar me ligj apo ndonjë rregullore tjetër.

"Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj".[71]

Nga përkufizimi i mësipërm të cilin e jep Kushtetuta e Kosovës, kuptojmë se ndaj secilit vendim (aktgjykim, vendim apo aktvendim në procedurën penale, civile apo administrative) lejohet paraqitja e mjeteve juridike të goditjes së vendimeve, përveç nëse me ligj të caktuar nuk parashihet ndryshe.

"Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të kërkojnë revokimin, shfuqizimin ose ndryshimin e aktit administrativ në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Ligj për ankimin administrativ."[72]

[70] Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 3.2
[71] Ibid, neni 32
[72] Ligji për Procedurën Administrative në Republikën e Kosovës Nr. 02/L-28, neni 126

Ankesa përdoret nga pala e pakënaqur me vendimin e një organi. Pala e pakënaqur e përdor të drejtën e ankesës kur mendon se me vendimin e marrë i janë shkelur të drejtat ligjore nga organi me vendimin e nxjerrur në procedurë administrative. Lidhur me ankesën vendos organi i instancës më të lartë, pasi që konsiderohet së është organ më i specializuar dhe evitimin e konfliktit të interesave. Pra ankesa ka karakter suspensiv (e shtynë ekzekutimin e vendimit) dhe instancional (për të vendos organi më i lartë apo një kolegj profesional).

Ankesa, pra, është mjet i rregullt juridik i goditjes së vendimeve. Ankimi ndaj veprimtarisë së akteve të organeve të administratës publike është mjet juridik i rëndësishëm për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të individëve dhe subjekteve të tjera të së drejtës. Ankimi administrativ është një mjet juridik i subjektit, nëpërmjet të cilit kërkohet shfuqizimi ose ndryshimi i aktit administrativ. Ai përbën një instrument të rëndësishëm kontrolli të veprimtarisë administrative. Nëpërmjet animimit çdo palë e interesuar kundërshton paligjshmërinë ose parregullsinë e ndonjë akti administrativ (e pretenduar), si dhe refuzimin e paligjshëm të organit administrativ për nxjerrjen e aktit.[73]

Parimisht në drejtësi dhe sistemin juridik, ankesa ka karakter suspenziv (e shtyn ekzekutimin e vendimit deri sa të vendoset lidhur me ankesën nga organi i shkallës më të lartë), por ekzistojnë edhe situata ligjore të ndryshme (nga rregulli i përgjithshëm ekzistojnë përjashtimet), si p.sh. Kodi Doganor dhe i Akcizave i Republikës së Kosovës parasheh që vendimet e doganës janë menjëherë të zbatueshme. Kështu sipas nenit 13 të Kodit: "Më përjashtim të rasteve të parapara në nën paragrafin e dytë të nenit 275, vendimet e sjella do të jenë të zbatueshme menjëherë nga Dogana". Në mënyrë të njëjtë çështjen në fjalë e rregullon edhe Ligji për Procedurën Administrative Ligji Nr. 02/L-28. Sipas këtij ligji:

"Zbatimi i aktit administrativ nuk pezullohet vetëm kur:

a) akti administrativ synon mbledhjen e taksave, tatimeve ose të ardhurave të tjera buxhetore;

b) akti administrativ ka të bëjë me masa policore;

c) pezullimi i zbatimit të aktit ndalohet me ligj;

d) zbatimi i menjëhershëm është në interes të rendit publik, shëndetit publik dhe interesave të tjera publike.[74] Në këtë aspekt duke u bazuar nga veprimtaria e administratës doganore e cila konsiston kryesisht me mbledhjen e të hyrave publike (taksa doganore, taksa e akcizës dhe TVSH-ja), sipas legjislacionit doganor janë menjëherë të zbatueshme pa marrë parasysh nëse pala e pa kënaqur apelon vendimin e tillë.

Funksioni i ankesës është që përmes përdorimit të mjeteve ligjore të mundësohet hulumtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të parë nga ana e organit të shkallës së dytë. Organi i shkallës së dytë e hulumton rregullsinë e aktit ligjor në krahasim me zbatimin e ligjit formal dhe material dhe në krahasim me tërësinë dhe rregullsinë e gjendjes së vërtetuara faktike dhe në pikëpamje të përmbledhjeve të këtyre elementeve ligjshmërinë dhe rregullsinë e këtij vendimi.

[73] Sokol Sadushi, "E drejta Administrastive 2" , Tiranë, 2008, fq. 205

[74] Ligji për Procedurën Administrative në Republikën e Kosovës Nr. 02/L-28, neni 128.2

Ligji për procedurën administrative në Republikën e Kosovës njeh dy mjete të rregullta juridike të goditjes së vendimeve: ankesën dhe kërkesën për rishqyrtimin e vendimeve.

"Personat fizikë dhe juridikë kanë të drejtë të kërkojnë revokimin, shfuqizimin ose ndryshimin e aktit administrativ në përputhje me rregullat e vendosura nga ky Ligj për ankimin administrativ.

E drejta e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të ushtrohet në mënyrat e mëposhtme:

a) përmes kërkesës për rishqyrtim drejtuar nëpunësit përgjegjës për aktin;

b) përmes ankimit drejtuar organit më të lartë."[75]

Në procedurën administrative doganore, Ligji për procedurën administrative shërben si burim subsidiar apo plotësues, pasi që procedura doganore është procedurë e veçantë dhe rregullohet me ligj special. Ligji për procedurën administrative si ligj i përgjithshëm në procedurën administrative doganore zbatohet në dy raste: rasti i parë kur ligji special (Kodi Doganor dhe i Akcizave) shprehimisht kërkon zbatimin e tij dhe në rastin e ekzistimit të zbrastirave juridike në ligjin special.

Sipas legjislacionit doganor të Republikës së Kosovës mjet i rregullt i goditjes së vendimeve është kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve doganore.

Në vijimi të këtij punimi vijon shpjegimi i procedurës apeluese ndaj vendimeve doganore në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.

2. Apelimi i Vendimeve në Procedurën Administrative Doganore sipas Legjislacionit në Republikën e Kosovës

Procedura administrative doganore është procedurë e veçantë administrative e cila aplikohet në procesin e marrjes së vendimeve në kuadër të sistemit doganor të një vendi. Si e tillë ajo rregullohet me ligj të veçantë. Organi kompetent për udhëheqjen e kësaj procedurë është administrata doganore. Në Republikën e Kosovës institucioni kompetent për udhëheqjen e procedurës administrative doganore është Dogana e Kosovës. "Dogana është i vetmi institucion në Kosovë, i cili ka kompetencë për të kryer detyra doganore dhe detyra tjera që i caktohen Doganës nga Qeveria e Kosovës."[76] Nga kjo nënkuptohet se përveç aspektit të marrjes së vendimeve në procedurë të rregullt doganor, Dogana e Kosovës është kompetente të zhvillojë edhe procedurën në lidhje me ankimin ndaj vendimeve të saja.

Procedura ankimore në Doganën e Kosovës rregullohet me Kodin Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Kodi Doganor dhe i Akcizave i Republikës së Kosovës si mjet të rregullt juridik të goditjes së vendimeve e njeh kërkesën për rishqyrtim të vendimit.

Sipas dispozitave të Neni 291 të Kodit Doganor dhe Ligjit nr. 04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, Ligji nr. 03/L-109,: "1. Çdo person ka të drejtën e ushtrimit të kërkesës për rishqyrtimin e vendimit të sjellë nga Dogana, i cili ka të

[75] Ibid, neni 126

[76] Kodi doganor dhe i akcizave i Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-109, neni 9.1

bëjë me aplikim e legjislacionit doganor, dhe atë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. 2. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit ushtrohet pranë Doganës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të kundërshtuar".

"Kërkesa për rishqyrtim të vendimit paraqitet në Sektorin e Ankesave në Doganën e Kosovës në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të shkallës së parë.

"Sektori i ankesave në rishqyrtim të vendimit doganor mund të:

a). refuzoj kërkesën për rishqyrtim dhe konfirmon vendimin e kundërshtuar;

b). aprovon kërkesën dhe anulon vendimin e kundërshtuar;

c). aprovon kërkesën dhe revokon vendimin e kundërshtuar;

d). aprovon kërkesën pjesërisht dhe ndryshon vendimin e kundërshtuar.

Sektori i ankesave doganore vendos në kërkesë për rishqyrtimin, përmes aktit me shkrim brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e pranimit të kërkesës.[77]

Në kuadër të Doganës së Kosovës në përputhje me dispozitat ligjore të përmendura në paragrafin paraprak është themeluar Sektori i ankesave i cili shërben si shkallë e dytë e shqyrtimit të vendimeve doganore. Sektori i ankesave ka mundësi më të mëdha ligjore për vendosje. Ndoshta një mangësi e këtyre ndryshimeve ligjore është se afati për marrjen e vendimit nga sektori i ankesave është zgjatur nga 30 në 60 ditë.[78]

Kërkesa për rishqyrtim të vendimit dhe ankesa paraqitën në formë shkresore apo me shkrim dhe duhet të përmbajë disa elemente esenciale, nga të cilat kuptohet themeli juridik i ankimimit, e ato janë: emrin dhe adresën e ankuesit, aktin administrativ, të nxjerrë apo të munguar, që kontestohet, shkaqet e ankimit, çdo dokument tjetër që konsiderohet i rëndësishëm nga ankuesi. Në praktikën juridike procedurale administrative kemi raste kur nuk pranohet kërkesa për ankimin. Janë ato raste kur ankesa nuk është e lejuar, është paraqitur jashtë afatit të paparë ligjor, kur ankesa paraqitet nga pala e paautorizuar, kur akti administrativ i ankimuar konsiderohet i ligjshëm dhe i rregullt prima facie nga organi që shqyrton ankimin, etj.[79]

"Ankimi duhet të paraqitet në formë shkresore. Kërkesa e shkruar duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

a) emrin dhe adresën e ankuesit;

b) aktin administrativ, të nxjerrë apo të munguar, që kontestohet;

c) shkaqet e ankimit;

d) çdo dokument tjetër që konsiderohet i rëndësishëm nga ankuesi.

Organi që shqyrton ankimin ndihmon ankuesit në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për ankimin."[80]

Me nxjerrjen e vendimit nga Sektori i ankesave doganore përfundon procedura administrative doganore sipas mjetit të goditjes së vendimeve. Vendimi i nxjerr nga Sektori i ankesave doganore është vendim përfundimtarë në procedurë administrative. Pra, ndaj vendimit

[77] Ligji nr. 04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, Ligji nr. 03/L-109, neni

[78] Orhan Çeku, "E drejta Doganore", Kolegji "Pjetër Budi" Prishtinë, 2014, fq. 342

[79] Ibid, fq. 342-343

[80] Ligji për Procedurën Administrative në Republikën e Kosovës Nr. 02/L-28, neni 133

të sektorit të ankesave nuk lejohet paraqitja e ndonjë mjeti tjetër juridik në procedurë administrative. Kundër vendimeve të Sektorit të ankesave doganore lejohet inicimi i Konfliktit administrativ në gjykatën relevante.

2.1. Procedura apeluese kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative doganore

Siç theksuam më lartë vendimi i Sektorit të ankesave doganore është vendim përfundimtarë në procedurën administrative doganore dhe ndaj tij nuk lejohet parashtrimi i ndonjë mjeti tjetër juridik në procedurë administrative. Kjo nënkupton që pala e pakënaqur ndaj vendimit të Sektorit të ankesave doganore mund të paraqet çështjen në gjykatë.

Nëse nuk është në kundërshtim me dispozitat përmbajtëse në këtë kod, dispozitat e Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L- 222 duhet të gjejë aplikimin për gjithë procedurën e ankesave. Në rast se edhe me këtë ligj nuk është paraparë rregullimi i ndonjë dispozite të procedurës së ankesës, do të gjejë zbatim Ligji i procedurës së përgjithshme administrative si ligj subsidiar."[81] Kundër vendimit të Sektorit të ankesave doganore, pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore te Prishtinës, në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën tatimore dhe procedurat, Ligji nr. 03/L-222."[82]

Procedurat para gjykatës kompetente rregullohen nga rregullat procedurale të përcaktuara me Ligjin për plotësim dhe ndryshim të Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222, Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, Ligji për Konfliktet Administrative nr. 03/L-202. Kundër vendimit te gjykatës kompetentet, pala e interesuar mund te paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në pajtim me Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222.

Sipas Ligjit për Gjykatat në Republikën e Kosovës: "Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj."[83] Pra, sipas përkufizimeve të Ligjit për Gjykatat, apelimi i vendimit përfundimtarë në procedurë administrative para gjykatës kompetente paraqet inicimin e "Konfliktit Administrativ". Konflikti administrativ rregullohet me ligj të veçantë, pra me Ligjin për Konfliktin Administrativ.[84]

[81] Ligji nr. 04/L-099 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, Ligji nr. 03/L-109, neni 12. pika 9 dhe 10

[82] Ibid, neni 12

[83] Ligji për Gjykatat në Republikën e Kosovës Ligji Nr. 03/L-199, neni 14.1

[84] Ligji për Konfliktin Administrativ është ligj i përgjithshëm dhe vlen për të gjitha rastet e inicimit të konfliktit administrativ para gjykatës kompetente në Republikën e Kosovës. Apelimi i vendimeve administrative doganore në gjykata rregullohet paradoksalisht edhe me tri ligje tjera: Ligji nr. 04/L-099 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit

Për parashtrimin e konfliktit administrativ në gjykatë për vendimet doganore merren parasysh katër ligje: Ligji për Konfliktin Administrativ Ligji nr 03/L-202, Ligji nr. 04/L-099 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222 dhe Ligji për Gjykatat Ligji nr. 03/L-199.

Me Ligjin për Konfliktin Administrativ Ligji nr 03/L-202 "rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente, vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik dhe palëve të tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative rregullon në përgjithësi zhvillimin e procedurës gjyqësore ndaj akteve administrative përfundimtare."[85]

"Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar. Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ pas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj."[86] Në këtë rast sipas Ligjit për Konfliktin Administrativ ndaj vendimeve të Sektorit të ankesave doganore mund të filloi konflikti administrativ. Kjo për arsye se plotësohet kushti i parë ligjor – vendimi i nxjerrë në shkallë të dytë.

Ligji nr. 04/L-099 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë zhvillimin e procedurës gjyqësore ndaj vendimeve të Sektorit të ankesave doganore e referon tek Ligji për plotësim dhe ndryshim e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222, Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, Ligji për Konfliktet Administrative nr. 03/L-202 dhe nga ndonjë ligj tjetër relevant ne Kosovë. Kundër vendimit te gjykatës kompetentet, pala e interesuar mund te paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në pajtim me Ligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222.
Ligji për plotësim dhe ndryshim e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222, Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199 parasheh që në kuadër të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës të themelohet Divizioni Fiskal. "Divizioni Fiskal, themelohet dhe mbështetet nga Këshilli Gjyqësor në Kosovë, në pajtim me Ligjin mbi Gjykatat."

"Divizioni Fiskal është përgjegjës për të gjykuar në shkallë të parë çdo vendim nga Departamenti i Ankesave në lidhje me taksat, detyrimet doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

Juridiksioni i ankesave të Divizionit Fiskal, i mbulon tatimet dhe detyrimet në vijim:

- tatimin mbi të ardhurat personale;
- tatimin mbi të ardhurat e korporatave;
- ligjin e TVSH-së;

nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë, Ligji Nr. 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr. 03/L-222 dhe Ligji për Gjykatat Ligji nr. 03/L-199

[85] Ligjin për Konfliktin Administrativ në Republikën e Kosovës, Ligji nr 03/L-202, neni 1

[86] Ibid, neni 13 dhe 14

- detyrimet doganore;
- detyrimet e akcizës;
- tatimi mbi pronën e paluajtshme;
- çdo tatim ose kontribut tjetër të aplikuar në Kosovë.” (Ligji nr. 03/L-222, neni 81B)

Kundër vendimeve të Divizionit Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore, mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit.

Siç po kuptohet nga dispozitat e këtij ligji, intenca e ligjdhënësit shkon në favor të krijimit të një institucioni të specializuar në strukturën e Sistemit Gjyqësor të Republikës së Kosovës. Ne jemi të mendimit se krijimi i Divizionit Fiskal në kuadër të Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore të Prishtinës do të duhej të parashihej me Ligjin për Gjykatat e Republikës së Kosovës, sepse po krijohet përshtypja ligjore se ky divizion po themelohet në përputhje me një ligj tjetër (Ligji për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Ligji Nr. 03/L-222).

Kjo procedurë dhe shpërndarja e dispozitave në lidhje me procedurën gjyqësore ndaj akteve administrative doganore është e pa nevojshme. Ne mendojmë se ligjdhënësi në Kosovë ka dështuar pa përvojë në miratimin e ligjeve.

Procedura në lidhje me konfliktin administrativ duhet thjesht të rregullohet me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Në Kodin Doganor do të mjaftonte të theksohet fakti se ndaj vendimeve të Sektorit të ankesave doganore pala e pakënaqur mund të inicioj konfliktin administrativ në përputhje me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Kompetenca e gjykatave për zgjidhjen e konfliktit administrativ përcaktohet me Ligjin për Gjykata dhe nuk ka nevojë të përmendet ky fakt me ligje tjera. Në këtë mënyrë ligjdhënësi do të eliminonte paqartësitë dhe konfliktet eventuale të ligjeve përkatëse.

3. Procedura e Apelimit të Vendimeve Doganore sipas Legjislacionit të Republikës së Shqipërisë

Në funksion të reformave strukturore të gjithëmbarshme dhe përmirësimit të bazës ligjore e cila është e nevojshme për plotësimin e kritereve për procesin e anëtarësimit në Unionin Evropian, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me 31.07.2014 ka miratuar Kodin Doganor të ri Ligji nr. 102/2014 i datës 31.07.2014. Ky akt normativ është shpallur në “Fletoren Zyrtare” nr. 134 me datë 22.08.2014. Ky Kod në tërësi do të hyjë në fuqi më 1.01.2017. Në disa pjesë nga 1.01.2015. Në kuadër të këtij punimi do të analizojmë procedurën apeluese sipas Kodit të ri doganor.

Kodi doganor i ri është në përputhje me standardet e promovuar nga Unioni Evropian. Sipas Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë “Legjislacion doganor” është kuadri ligjor, i përbërë nga:

a) Konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

b) Kodi Doganor;

c) Legjislacioni për tarifën doganore dhe nomen-klaturën e kombinuar të mallrave, në Republikës së Shqipërisë;

ç) Aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi.”[87]

Nga hierarkia taksative e përcaktuar me Kodin Doganor kuptojmë se konventat dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë në fushën e doganave dhe tregtisë ndërkombëtare kanë përparësi në zbatim në raport me ligjet nacionale. Kjo dispozitë e Kodit Doganor buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Kështu sipas Kushtetutës “ Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.”[88]

Pothuajse në mënyrë identike është rregulluar kjo çështje me dispozitat kushtetuese në Republikën e Kosovës. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara dhe ratifikuara dhe normat e detyrueshme të së drejtës ndërkombëtare kanë epërsi ndaj ligjeve të Republikës së Kosovës.[89]

Përgjegjës për implementimin e legjislacionit doganor është Administrata Doganore e Republikës së Shqipërisë.

Sipas Kodit të ri Doganor Ligji nr. 102/2014 i datës 31.07.2014 “Fletorja Zyrtare” nr. 134, datë 22.08.2014, “Administrata doganore përbëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe degët doganore. Ajo është nën varësinë e Ministrisë së Financave. Degët doganore janë nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave. Ato përbëhen nga një ose disa zyra doganore. Organizimi, funksionimi dhe kompetencat e administratës doganore përcaktohen në këtë Kod, në ligje specifike dhe me vendim të Këshillit të Ministrave, të dala në zbatim të tyre.”[90]

Struktura e Administratës Doganore sipas ligjit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministri të Financave në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publik.

Sipas strukturës aktuale Administrata Doganore e Shqipërisë udhëhiqet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe katër departamente: Departamenti Administrativ, Departamenti Operativ dhe Hetimor, Departamenti teknik dhe Departamenti i Akcizës.[91]

“Administrata Doganore shqiptare ka luajtur një rol të rëndësishëm për verifikimin dhe vjeljen e detyrimeve doganore që duhen paguar, parandalimin, verifikimin dhe luftën ndaj veprimtarisë së kontrabandës, shkeljeve dhe trafikut të paligjshëm të mallrave të ndaluara.”[92]

---

[87] Kodin Doganor i Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 102/2014 i datës 31.07.2014, 6.2
[88] Kushtetuta e Shqipërisë, neni 122 pika 2 dhe 3
[89] Kushtetuta e Kosovës, neni 19.2
[90] Ligji nr. 102/2014 neni 7 paragrafet 1, 2 dhe 3
[91] http://www.dogana.gov.al/sq/node/138: ueb sajti zyrtar i Doganës së Shqipërisë
[92] Ana Mema,: “Sistemi doganor në Republikën e Shqipërisë”, Mikrotezë, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Departamenti Administrim Publik, Durrës, 2014, fq. 40

3.1. Apelimi i vendimeve doganore

Pa rënë ndesh me dispozitat e konventave ndërkombëtare ankimi i vendimeve doganore në mënyrë taksative rregullohet me Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Sipas neni 281 të Kodit doganor: "Çdo person ka të drejtë të ankohet kundër çdo vendimi të marrë nga autoritetet doganore, në lidhje me një borxh dhe/ose vendosjen e sanksioneve në lidhje me zbatimin e këtij Kodi. E drejta e ankimit mund të ushtrohet fillimisht pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave e, më pas, përpara autoriteteve gjyqësore, sipas dispozitave në fuqi."[93]

D.m.th. ndaj vendimeve të autoriteteve doganore palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesë tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave si organ i shkallës së dytë për vendosje. Ankesa ndaj vendimit të autoriteteve doganore mund të parashtrohet në lidhje me një borxh dhe/ose me një sanksion. Sipas nenit 282 të Kodit Doganor:

"1. Kundër vendimit të autoriteteve doganore kompetente, shkelësi mund t'i paraqesë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave një kërkesë ankimore të arsyetuar, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit.

2. Për të paraqitur ankesën, ankimuesi duhet të paguajë shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, sipas përkufizimeve të këtij titulli, si dhe të garantojë për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave shumën e sanksioneve të aplikuara për shkeljen, objekt konflikti.

3. Ankimuesi duhet të bashkëshoqërojë ankimin me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e tij.

4. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave merr një vendim brenda 60 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës ankimore dhe ky vendim u njoftohet menjëherë ankimuesit dhe autoriteteve doganore kompetente. Nëse brenda kësaj periudhe nuk merret një vendim, ankimuesi mund t'u drejtohet autoriteteve gjyqësore, në përputhje me përcaktimin e pikës 6, të këtij neni.

5. Nëse ankesa nuk pranohet, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave bën kalimin e menjëhershëm të shumës së garancisë në llogarinë e saj. Nëse kërkesa pranohet, autoritetet doganore duhet t'i kthejnë ankimuesit shumën e përgjithshme të detyrimeve të importit ose eksportit, si dhe të lirojnë garancinë.

6. Kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, ankimuesi mund të ankohet pranë autoriteteve gjyqësore brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të mospranimit të ankesës, ose brenda 45 ditëve nga mbarimi i afatit të shqyrtimit të ankimit, të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni.

7. Në rast se autoritetet gjyqësore pranojnë ankesën, autoritetet doganore duhet t'i kthejnë ankimuesit shumën e paguar. Kthimi i kësaj shume mund të bëhet vetëm pasi vendimi i autoriteteve gjyqësore kompetente merr formë të prerë.

8. Në rast se ankimuesi nuk plotëson kushtet kumulative, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, ankimimi konsiderohet sikur nuk është bërë.

9. Në rast se ankimuesi nuk ankimon ose konsiderohet se nuk ka ankimuar, sipas përcaktimeve të pikës 8, autoritetet doganore marrin të gjitha masat për të proceduar me vjeljen e shumës së

[93] Ligji nr. 102/2014, neni 281

borxhit të sanksioneve përkatëse, në bazë të procedurave të përcaktuara në këtë Kod për vjeljen e detyrueshme të borxhit.

"Ankimi ndaj vendimit të autoriteteve doganore kompetente për vendosjen e sanksioneve nuk shkakton pezullimin e zbatimit të vendimit në konflikt."[94]

Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave të Shqipërisë në lidhje me ankesën e paraqitur, përbën vendim përfundimtar në procedurën administrative doganore. Ndaj këtyre vendimeve lejohet inicimi i konfliktit administrativ në përputhje me Ligjin për Konfliktet administrative.

4. Përfundimi

Nga shtjellimet e mësipërme kuptuam se apelimi i vendimeve në procedurë administrative në përgjithësi dhe në procedurën administrative doganore në veçanti është parim kushtetues dhe përbën një nga elementet e garantimit të të drejtave të njeriut.

Procedura administrative doganore në Kosovë rregullohet me ligj special, me Kodin Doganor dhe të Akcizave si ligj primar, ndërsa si burim subsidiar me ligjin për procedurën administrative. Kodi Doganor dhe i Akcizave parasheh si mjet të rregullt juridik të goditjes së vendimeve doganore, kërkesën për rishqyrtim të vendimeve.

Kundër vendimit të Doganës së Kosovës, pala e pakënaqur mund të paraqes kërkesë për rishqyrtim të vendimit në Sektorin e ankesave doganore në Doganën e Kosovës. Sektori i ankesave doganor ka afat 60 ditë për të vendosur në lidhje me ankesën. Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të filloi konflikt administrativ në Gjykatën Themelor të Prishtinës. Në Gjykatën Themelor të Prishtinës, përkatësisht në Departamentin Administrativ është krijuar Divizioni Fiskal i cili ka kompetencë ekskluzive të shqyrtoi paditë ndaj vendimeve doganore dhe në lidhje me tatimet. Pra, është divizion i specializuar i cili gjykon vetëm për fushën e doganave, tatimeve.

Në Republikën e Shqipërisë është miratuar Kodoi i ri Doganor i cili është një akt normativ modern dhe në përputhje me Kodin Doganor të Unionit Evropian. Sipas këtij Kodi, ndaj vendimeve të shkallës së parë të marrë nga Dogana, pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë tek Drejtori i Përgjithshëm i Doganave. Kundër vendimit të Drejtorit pala e pakënaqur mund të paraqes mund t'i drejtohet autoriteteve gjyqësore në konflikt administrativ brenda afatit prej 45 ditësh.

Kur analizohet procedura e tillë në dy shtetet, shihen dallime dhe përputhshmëri si vijon:

- **Në Republikën e Kosovës si mjet juridik ndaj vendimeve doganore është kërkesa për rishqyrtim të vendimeve, ndërsa në Shqipëri ankesa;**
- **Ndaj vendimeve të marra në shkallë të parë në Kosovë vendos Sektori i ankesave doganore ndërsa në Shqipëri Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, afati për kthimin e përgjigjes është 60 në të dy shtete;**

[94] Ligji nr. 102/2014, neni 283

- **Vendimi i marrë nga Sektori i ankesave doganore dhe i Drejtorit të Përgjithshëm në Shqipëri përbën vendim përfundimtar në procedurën administrative doganore;**
- **Kundër vendimit në shkallë të dytë në Kosovë mund të paraqitet padi në konfliktin administrativ brenda afatit prej 30 ditësh ndërsa në Shqipëri brenda afatit prej 45 ditësh;**
- **Kërkesa për rishqyrtim të vendimit në Kosovë dhe ankesa në Shqipëri nuk e shtyjnë ekzekutimin e vendimit.**

Literatura

Çeku, Orhan M.: "E drejta doganore", Kolegji "Pjetër Budi", Prishtinë, 2014,

Mema, Ana: "Sistemi doganor në Republikën e Shqipërisë", Mikrotezë, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Juridike, Departamenti Administrim Publik, Durrës, 2014,

Sadushi, Sokol, E drejta Administrative 2, Tiranë, shtator, 2008,

Akte normative

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Ligjit për Procedurën Administrative në Republikën e Kosovës, Ligji Nr. 02/L-28

Kodit Doganor dhe i Akcizave në Kosovës Kodi Nr. 03/L-109

Ligji Nr. 04/L-099 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Kodit nr. 03/L-109 Doganor dhe të Akcizave në Kosovë,

Ligji për Gjykatat në Republikën e Kosovës Ligji Nr. 03/L-199

Ligji për Konfliktin Administrativ Ligji nr 03/L-202

Ligji për plotësim dhe ndryshim e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222

Kodi Doganor Ligji nr. 102/2014 i datës 31.07.2014 - Fletore Zyrtare nr.134, datë 22 gusht 2014

Burime interneti

http://www.dogana.gov.al/sq/node/138

SEANCA E DËGJIMIT NË PROCEDURËN E ARBITRAZHIT

Mr.Sc Kastriote VLAHNA

UDC: 341.637

Abstract:

In fairness, as a rule, the parties decide to entrust arbitration dispute settlement, they are themselves, who appoint the arbitrators to hear the case. Obviously the appointment of arbitrators and the parties decide on the rules of procedure, under which the case should be examined. Usually, the rules of procedure contained an arbitration agreement, but it can also happen that the arbitration agreement expressly stated not to do so. In such cases, you can apply the rules of the arbitral proceedings, which contains the Hague Convention of 1907 for the peaceful resolution of international disputes. Also, for such cases may the arbitral tribunal itself authorized to issue rules of procedure.

Hyrja

Dinamizmi i shpejtë i ndryshimeve shoqërore dhe ekonomike në ditet e sotme karakterizohet me rritjen e numrit të kontesteve. Ashtu që me njohjen e mirë të zgjidhjesë së kontesteve para gjykatave gjithnjë e më shumë rëndësi po i jepet metodave alternative në zgjidhjen e kontesteve siç janë: *Pajtimi gjyqësorë, ndërmjetësimi dhe arbitrazhi*. Të shumta janë arsyet për çka paditësi e inicon procedurën kontestimore. Pra, pavarësisht nga qëllimi i udhëheqjes së ndonjë procedure kontestimore qëllimi i palëve është i orientuar në drejtim të marrjes së shpejtë të vendimit gjyqësor me të cilën do të mënjanohet çdo paparashikueshmëri në të drejtën kontestuese ndërmjet palëve. Në anën tjetër, shteti nga gjykata pret vendime ligjore e këto të dyja shpesh është vështirë të harmonizohen. Palët shkojnë nga ajo që vendimet gjyqësore të bëhen menjëherë të formës së prerë ndërsa shteti dëshiron të sigurojë mundësinë e rishqyrtimit shtesë të rregullësisë së aktgjykimit. Ashtu që për shkak të sigurisë juridike dhe çdo kontesti

duhet t`i vijë fundi në këtë është qëllimi i egzistimit të institutit të plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor. Arbitrazhi si një alternativë vendimëmarrje detyruese private-jopublike shumë e përdorshme në një numër të madh të kontesteve kryesishtë të kontesteve civile. Në këtë procedurë vendimi për zgjidhjen e kontesteve merret nga pala e tretë neutrale (arbitri apo arbitratë). Në këtë aspekt shihet se kemi të bëjmë me një gjyq që në aspektin e përgjithshëm mund të themi se: arbitrazhi është një nga mënyrat alternative me të shpejta dhe efikase të zgjedhjes së kontesteve që sot trended e shoqëris moderne e kerkojn . Në këtë mënyrë bizneset janë të interesuara në zgjidhjen e shpejtë dhe jo burokratike të kontesteve. Arbitrazhi është procedurë e cila ditëve të tashmë globalisht dominon në kontestet në mes të bizneseve. Kontestet më të komplikuara dhe me vlera më të mëdha zgjidhen nga tribunalet e arbitrazhit nëpër gjithë botën. Procedura e arbitrazhit është transparente dhe ofron mjete të kontrollit të procedurës nga palët. Procedura është e paraparë me rregullat e arbitrazhit, por kohëzgjatja, administrimi i provave dhe disa elemente të tjera të procedurës vendosen në pajtimin e të dy palëve në kontest. Palët kanë të drejtë të propozojnë nga një arbitër i cili mendojnë se ka kapacitete profesionale dhe etike të shërbejë si i pa-anshëm dhe i pavarurë nga asnjë rrethanë e ardhëshme. Pala tjetër ka të drejtë ta kontestojë emërimin e arbitrit të propozuar nga pala tjetër nëse dëshmonë se ai nuk mund të jetë i pavarur, në këtë rast dy arbitratë e propozuar nga palët emërojnë arbitrin e tretë. Ky balancim pamundëson që njëra palë të dëmtohetë nga vendimi i tribunalit të arbitrazhit kjo është njëra nga arsyet kryesore se përse arbitrazhi dita ditës avansohet më shumë në zgjidhjen e kontesteve private –civile në mes të individëve.

1. SEANCA E DËGJIMIT

Procedura e arbitrazhit mund të zhvillohet në mënyrë e cila konsiderohet e dobishme ndaj qëllimit, me kusht që me palët të veprohet barabarsisht dhe të ju jepet mundësia e dëgjimit të tyre. Procedura e arbitrazhit fillon më datën kurë kërkesa të jetë pranuar nga pala mbrojtëse (i padituri) përveq nëse palët mirren vesh ndryshe.[95] Në secilën fazë të procedurës gjykata e arbitrazhit mund të mbajë seancë dëgjimore për dëshmitarët t`i dëgjoj ekspertët si dhe u mundëson palëve të shfaqin qëndrimet e tyre lidhur me dëshmitë. Procedura e arbitrazhit dukshëm dallohet nga procedura gjyqësore ndër të tjera me raportin e saj ndaj rregullave të procedurës. Për procedurën gjyqësore pjesa më e madhe e rregullave është e natyrës imperative (ius cogens) ashtu që e drejta procedurale nuk i autorizon palët që me marrëveshjen e tyre të caktojnë rregullat sipas së cilave gjykata do të veprojë (parimi i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë).[96] Nëse mbahet seancë orale arbitrazha është e detyruar me kohë t`i fton palët të marrin pjesë në seancë. Arbitrazhi kërkonë nga palët të gjitha provat të cilat vërtetojnë thëniet në padi apo kundërpadi.[97] Për zgjidhjen e kontestit të caktuar gjykata e arbitrazhit me kujdesin më të madh përcaktohet cilat prova do ti shtjellojë në procedurë. Më me rëndësi është të respektohet parimi i

[95] Morina, Iset, " Arbitrazhi dhe Procedura e Arbitrazhit",. Prishtinë 2015. Fq ..
[96] Musa, Mustafë, ''E Drejta e Arbitrazhit'', Gjilan. 2012. Fq. 80
[97] Neni 26,i rregullave të Arbitrazhit nga Ligji Model të UNCTRAL-it.

barazisë së palëve në procedurën e arbitrazhit gjatë shtjellimit të provave ku ato duhet ta kenë pozitën e barabart. Për të ardhur deri te provat e nevojshme gjykata e arbitrazhit mund të kërkojë ndihmë nga gjykatat shtetërore për sigurimin e vendimeve të ndryshme dhe për shtjellimin e provës nga ana e gjykatës shtetërore kur këto nuk është e mundur ti stjellojë gjykata e arbitrazhit. [98] Aktori kryesorë i procedurës së arbitrazhit është arbitri ai udhëheqë me procedurën dhe menazhon me lëndën e kontestit. Kreu i V i Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin, parashehë në mënyrë të përgjithshme mënyrën e udhëheqjes së procedurës së arbitrazhit. Me qëllim që të arrihen rezultate sa më të mira të menaxhimit të lëndës dhe përfundimit të procedurës sa më shpejtë dhe marrjën e vendimit të drejtë. Gjat udhëheqjes së rrjedhës së procedurës së arbitrazhit arbitri duhet ta mbajë nën kontrollë tërë procesin organizon kohën e fillimit, kohëzgjatjen pushimin dhe shtyerjen eventuale të seancës. Seanca e tribunalit të Arbitrazhit mbahet me dyer të mbyllura me qëllim që të ruhet fshehtësia e fakteve provave dhe vendimit përfundimtar.[99] Në qoftë se një arbitër është zëvendësuar, procedura do të vazhdojë në fazën ku arbitëri i cili u zëvendësua ka pushuar së kryeri funksionet e tij apo të saj, përveç nëse tribunali i arbitrazhit nuk vendos ndryshe.[100]

1.1. Renditja e procedurës

Me mungesë të marrëveshies ndërmjet palëve, Tribunali i Arbitrazhit organizon rrjedhën e procedures që përherë të mos mbajë sancë dëgjimore, kur konsideron se kjo është e panevojshme ose kur palët këtë e kërkojnë, çka këtë çështie e konstaton edhe dispozita e nenit 21, paragrafi 1, i Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin. Por nëse përcaktohet për mbajtjen e seancës dëgjimore, me kohë do t`i paralajmërojë palët që të kenë mundësi t`i përgadisin provat dhe faktet të cilat dëshirojnë t`i paraqesin në seancën dëgjimore, siç e parasheh Ligji i Kosovës për Arbitrazh.[101] Paditësi paraqet aktin iniciues-padinë e cila përmban pjesën hyrëse, referatin, provat dhe faktet si dhe pjesën përmbyllëse. I padituri paraqet përgjigjien në padi, e me të cilën iu pþrgjigjet provave dhe fakteve të padisë e cila gjithashtu përmban, pjesën hyrëse, referatin me provat dhe pjesën përmbyllëse. Paditësi iu përgjigjet me kundërargumente pretendimeve të të paditurit[102]. I padituri konteston provat e paditësit dhe prezenton provat e tij, nëse i lejohet, meqë shpesh edhe nuk lejon replikat, duplikatet etj, për hire të mosëzvarritjes të procedures.[103]

Të gjitha deklaratat, dokumentet apo informatat e tjera të cilat njëra pale ia dërgon Tribunalin e Arbitrazhit, u dërgohet edhe të gjitha palëve tjera pjesëmarrëse të procedures. Kjo vlen edhe për raportet e ekspertëve ose provat e tjera në formë të shkuruar, të cilat janë relevante dhe në të cilat Tribunali i Arbitrazhit mund ta mbështet vendimin e tij.[104] Parashtresat e palëve të cilat i dërgohen Tribunalit të

[98] Musa, Mustafë, ''E Drejta e Arbitrazhit'', Gjilan. 2012. Fq. 84.
[99] Ligji Nr.02/L-75,Neni nr 21, marrë nga: http://www/gazetazyrtare.com.
[100] Përmbledhje e rregullave të Arbitrazhit 2011, Neni 15, fq 9.
[101] Ligji Nr.02/L-75,Neni 21 paragrafi 2, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com
[102] Matrial nga lënda, ''E Drejta Ndërkombëtare Tregëtare'', pregaditur nga: Prof.Dr.Ass. Halim Bajraktari. Prizren, 2012.
[103] Arbitrazhi, EMSG, sponzoruar nga USAID, 2008, Moduli 8, fq 5
[104] Ligji Nr.02/L-75,Neni nr 21, paragrafi 3, marrë nga: http://www/gazetazyrtare.com

Arbitrazhit ia mundësojnë të njëjtit, që nga të njëjtat të njoftohet se çka është kontestuese ndërmjet palëve dhe në bazë të tyre, se ku do të përqëndrohen palët dhe cilat janë çështie kyqe. Arbitrat vlerësojnë provat dhe faktet e prezentuara nga palët dhe në fund edhe në pjesën përmbyllëse. Pra pas dëgjimit të palëve arbitri e shpallë të mbyllur seancen dëgjimore, por sipas nevojës me vetëinciativë e rihap seancën dëgjimore në çdo moment para marrjes së vendimit meritor.[105]

2. ROLI I ARBITRAVE GJATË SEANCËS SË DËGJIMIT

Arbitërat janë çelësi i tërë procesit të arbitrazhit. Rrjedhja e procedurave të arbitrazhit, deri diku, varet nga rregullave e arbitrazhit të aplikueshme për rastin konkret, por në një masë të madhe, ndikohen nga mënyra e menaxhimit të lëndës nga arbitërat.[106] Kreu 5 i Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin e parasheh në vija të trasha mënyrën e udhëheqjes së procedurave të arbitrazhit, gjë kjo që u jep arbitërave liri të konsiderueshme për menaxhimin e seancave dëgjimore. Në mënyrë që të arrihet një zgjidhje e shpejtë, ekonomike, dhe e drejtë e kontesteve, arbitërat duhet të marrin parasysh faktorët në vijim.[107].

2.1. Mbajtja e dëgjimit nën kontroll

Megjithëse natyra jo formale e arbitrazhit është njëra ndër përparësitë kryesore të tij, kjo nuk do të thotë se arbitërit nuk duhet të ushtrojnë kontroll mbi procesin e dëgjimit. Arbitërat duhet të kërkojnë zbatimin e orarit të dakorduar dhe të sigurojnë që koha e fillimit, kohëzgjatja e pushimeve dhe e shtyrjeve të seancave të respektohet me përpikëri.[108]. Rregullat e Arbitrazhit të Kosovës parashohin që dëshmitarët dëgjohen dhe merren në pyetje në bazë të kushteve të përcaktuara nga tribunali i arbitrazhit.[109]

2.2. Të vepruarit me autoritet dhe profesionalizëm

Marrë parasysh nivelin e lirisë së veprimit të cilin e gëzojnë arbitërat në procesin e arbitrazhit, mund të thuhet se ata gëzojnë një masë më të madhe të autoritetit se sa gjyqtarët. Arbitërat nuk duhet të jenë pasiv gjatë procedurave por duhet ta menaxhojnë rastin me autoritet dhe në mënyrë të rreptë. Megjithatë, edhe pse arbitërave u lejohet të ndërmarrin të gjitha masat të cilat ata i konsiderojnë të nevojshme për realizimin e një procesi efektiv dhe ekonomik, ata gjithashtu duhet të kenë kujdes që të mos e shndërrojnë atë në proces arbitrar dhe autokratik. Satisfaksioni i palëve është ajo që në masë të madhe e bën dëgjimit të suksesshëm ose të dështuar.[110]

2.3. Menaxhimi efektiv i rastit

[105] Po aty. Neni 22.
[106] Programi i USAID-it në Kosovë për përmbarim dhe legjislacion komercial,/ Nëntor 2014, fq 84.
[107] Ligji Nr.02/L-75,Neni 5, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com
[108] Programi i USAID-it në Kosovë për përmbarim dhe legjislacion komercial,/ Nëntor 2014, fq 84
[109] Ligji Nr.02/L-75,Neni 9, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com
[110] *Programi i USAID-it në Kosovë për përmbarim dhe legjislacion komercial,/ Nëntor 2014, fq 85*

Arbitërat duhet të sigurojnë që procedurat të realizohen në mënyrë sa më ekspeditive dhe ekonomike që të jetë e mundur, dhe për këto arsye, veçanërisht në raste të mëdha, menaxhimi i mire i rastit duhet të fillojë edhe para se dëgjimi të fillojë. Arbitërat duhet të realizojnë telefonata konfernciale, afate kohore, orar të aktiviteteve për paraqitjen e provave, të përcaktojnë orarin për paraqitjen e avokatëve të palëve, të sugjerojnë formatin e paraqitjeve, të njoftohen shumë paraprakisht për disponueshmërinë e dëshmitarëve, dhe t'i aplikojnë udhëzimet e tjera me qëllim të realizimit të suksesshëm të procedurave. Arbitrazhit institucional mund të jetë shumë e dobishme në këtë drejtim si institucioni të do të mbajnë shënimet e procedurave dhe të sigurojë mbështetje administrative sipas nevojës.[111]

2.4. Mbajtja e përqëndrimit

Avokatët nganjëherë janë në gjendje t'i shpien arbitërat në drejtimin e gabuar, me qëllim të ngadalësimit të procedurave në favor të klientit të tyre. Në raste të këtilla, arbitërat duhet t'i përcaktojnë prioritetet dhe t'i përqendrojnë pjesëmarrësit në çështjet përkatëse. Ata/ato duhen t'i drejtojnë sjelljet e palëve dhe të sigurojnë që palët të flasin vetëm për çështjet që janë relevante për rastin konkret.[112].

2.5. Teknikat tjera relevante

Arbitërat, përveç elementeve të lartcekura, duhet poashtu të sigurojnë që të ketë një bashkëpunim të vazhdueshëm kur bëhet fjalë për shkëmbimin e dokumenteve mes vetë palëve dhe mes tyre dhe tribunalit.[113] Përveç kësaj, ata duhet të insistojnë që të ketë seanca të gjata dhe të pandërprera dëgjimore gjatë një periudhe të caktuar kohore. Ata duhet të kërkojnë nga palët që t'i sigurojnë njëri-tjetrit dhe tribunalit një listë të dëshmitarëve të cilët planifikojnë t'i thërrasin. Është gjithashtu e dobishme për arbitërat që të sigurojnë që argumentet e palëve t'i kufizojnë për një kohë të caktuar.

2.6. Qështiet kyqe në të cilat përqëndrohet avokati i aftë gjat séances së dëgjimit

Atributet e një avokati (këshilltari) të suksesshëm në fakt varen në bazë të një vlerësimi shumë subjektiv. arbitërave të ndryshëm u pëlqejnë elemente të ndryshme kur bëhet fjalë për paraqitjet e avokatëve gjatë një dëgjimi të arbitrazhit. Sido që të jetë, ekzistojnë disa teknika efektive dhe joektive për të cilat shumë arbitër janë pajtuar.

Këto teknika janë paraqitur në tabelën më poshtë:[114]

Teknikat Efektive të Avokatëve	Teknikat Joefektive të Avokatëve
Bëni paraqitje të shkurta dhe të qarta;	Mos bëni deklarata të gjata dhe jo-

[111] *Po aty .*
[112] *Po aty, fq 85.*
[113] *Ligji i Kosovës për Arbitrazh Nr.02/L-75,Neni 21, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com*
[114] *Programi i USAID-it në Kosovë për përmbarim dhe legjislacion komercial,/ Nëntor 2014, fq 86*

	relevante;
Bëni paraqitje të logjikshme dhe të lehta për t'u kuptuar;	Mos e përsëritni veten;
Jepni pikat më të fortat në fillim;	Mos u shfaqeni të paorganizuar dhe të papërgatitur;
Trajtoni arbitërat me respekt të madh;	Mos e ndërpreni arbitërin;
Demonstroni njohuri të shkëlqyeshme të fakteve;	Mos u bëni argumentative;
Organizoni dokumentet dhe shkresat;	Mos u bëni të zhurmshëm ose ofendues;
Përqendrohuni në çështjet kyçe;	Mos i injoroni faktet e rastit dhe mos ngurroni të pranoni gabimin;
Mbani shikim të vazhdueshëm me të gjithë arbitërat;	Mos i injoroni praktikat e rëndësishme tregtare dhe komerciale;
Qëndroni të qetë, bindës, dhe professional;	Mos bëni paraqitje teatrale;
Pranoni faktet e sakta në mënyrë të ndershme, edhe nëse nuk të janë në favor tuajin;	Mos i paraqitni argumentet të cilat bazohen në fakte që nuk qëndrojnë;
Bëni paraqitje vizuale përmes fotove ose teknikave të tjera;	Mos u paraqitni shumë armiqësor kundrejt avokatit kundërshtarë;
Shpërndani provat materiale;	Mos iu ikni pyetjeve të arbitërave;
Jeni të gatshëm për t'ju përgjigjur të gjitha pyetjeve si dhe ti pranoni ato;	Mos u bëni pyetje retorike arbitërave;

3. QËSHTIET E PROVAVE, DËSHMITARËVE DHE MENDIMI I EKSPERTIT GJAT SEANCËS SË DËGJIMIT

Gjykata e arbitrazhit vendos nëse të mbaj seancë të dëgjimit në formë verbale për paraqitjen e dëshmive, për argumentim verbal, ose procedura të kryhet në bazë të dokumenteve dhe materialeve

të tjera, gjithëherë kjo vlen nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe, *pra vullneti i palëve është parimi kryesor*.

Për mbajtjen e séances dëgjithmore dhe të ndonjë takimi të gjykatës së arbitrazhit kur është e nevojshme të inspektohen mallrat, pasuritë e tjera ose dokumentet, palëve ju jepet një afat i arsyeshëm (paralajmërues).[115] Komunikimi i të gjitha veprimeve, sikurse deklaratat, dokumentet apo informatat e tjera që jepen që i jepen gjykatës së arbitrazhit, gjykata e ka për obligim që t`ia komunikoj secilës pale. Gjithashtu edhe secili raport i ekspertëve apo document dëshmie mbi të cilin tribunali i arbitrazhit mund të mbështetet në marrjen e vendimit, që duhet me kohë t`iu komunikohet palëve.[116] Qështia e afateve lidhur me komunikimin e të gjitha veprimeve nga gjykata e arbitrazhit është përcaktuar me rregullat ndërkombëtare. Sipas këtyre afateve, gjykata e arbitrazhit komunikimin e deklaratave me shkrim, përfshirë deklaratën e kërkesës dhe deklaratën e mbrojtjes, nuk duhet të tejkalojë afatin dyzet e pesë (45) ditë. Mirpo gjykata e arbitrazhit mund të zgjat afatin kohorë nëse konstaton se një gjë e tillë është e arsyeshme.[117] E drejta e arbitrave që ti njoftojnë dëshmitarët dhe nga ta të kërkojnë dokumente të cilat do të shërbejnë si dëhmi, është e përcaktuar edhe tek Ligji federal për arbitrazhin të SHBA-ve. Sipas përcaktimit nga ky ligj, arbitrate nuk kanë të drejtë të përdorin masa detyruese ndaj dëshmitarëve që nuk bashkëpunojnë, por vetëm mund të kërkojnë nga gjykata kompetente që ta urdhërojnë dëshmitarin t`i  përgjigjet ftesës dhe t`ia deklaroj dënimin i cili do të zbatohet ndaj tij nëse ai nuk bindet.[118] Sipas rregullores AAA (American Arbitration Asociation), palët mund t`i propozojnë të gjitha dëshmitë të cilat konsiderohen të nevojshme, ndërsa arbitrate mund të kërkojnë nga palët që t`i paraqesin faktet e nevojshme për marrjen e vendimit në contest.[119]

Pra arbitrate vendosin për dëshmit e ofruara nga dëshmitarët, se a janë të dobishme dhe se a do të prezentohen, gjithashtu dhe mund ti ftojnë dëshmitarët për të ju kërkuar paraqitjen e mjeteve të caktuara po qëse e shohin të arsyeshme, si dhe kërkojnë nga palët dhënien e betimit për të vërtetu që faktet dhe provat të cilat i paraqesin pran arbitrave janë të vërteta dhe të bazueshme.[120]

Ligji i Kosovës për Arbitrazhin parasheh që secila palë e ka barrën e të provuarit për faktet të cilat e mbështesin padinë, përkatësisht, përgjigjen në padi dhe varet nga tribunali i arbitrazhit të

[115] Thaqi, Ramadan,''E Drejta e Arbitrazhit'', Prishtinë, 2012, fq 183.

[116] Neni 24,i rregullave të Arbitrazhit nga Ligji Model të UNCTRAL-it

[117] Po aty, neni 25. Gjithashtu sipas Ligjit model për Arbitrazhin (UNCTRAL)`në nenin 27 thuhet: ``Tribunali i arbitrazhit apo një pale me miratimin e tribunalit të arbitrazhit mund të kërkojë nga një gjykatë kompetente e këtij Shteti ndihmë për marjen e dëshmive. Gjykata mund të ekzekutoj kërkesën Brenda kompetencave të sajë dhe në pajtim me rregullat e saj për marrje të dëshmive``.

[118] Ligji federal për arbitrazhin (United States Arbitration Act), i miratuar më 12.07.1925,, i kodifikuar më 30.07.1947, ndërsa është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 1954, 1970 dhe 1990.

[119] Menjëherë pas nxerrjes së Ligjit federal për arbitrazhin (1962) është themeluar arbitrazhi institucional në SHBA`Shoqata Amerikane e Arbitrazhit (American Arbitration Asociation- AAA), si organizat e pavarur për tër teritorin e SHBA-ve. Ky institucion merret me të gjitha llojet e kontesteve të arbitrazhit, kombëtare dhe ndërkombëtare.

[120] Neni 25 i rregullores,``American Arbitration Association,(Arbitratio Rules),,/marrur nga www.adr.org.

vendosë për pranueshmërinë, relevancën, vërtetësinë dhe peshën e provave të paraqitura. Tribunali i arbitrazhit mund të kërkojë nga palët që të paraqesin dokumente ose prova tjera brenda afatit të caktuar nga ai.[121]

Ndryshe nga gjykatat, arbitrazhi nuk përqendrohet në formalitetet e paraqitjes së **provave,** por në sigurimin e dëshmive relevante të cilat u ndihmojnë arbitërave të kuptojnë sa më mirë kontestin përkatës. Siç mund të shohim prej dispozitave të Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin, arbitërat kanë diskrecion të vendosin se cilat prova janë relevante dhe të pranueshme, dhe t'i përjashtojnë provat të cilat janë ata i konsiderojnë si jorelevante. Këto kompetenca të zgjeruara për trajtimin e provave, megjithatë, bartin me vete edhe përgjegjësinë e vlerësimit me shumë kujdes të provave. Përveç kësaj, për t'i përshpejtuar proceset, arbitërat mund të imponojnë metoda të paraqitjes së provave të cilat nuk janë të zakonshme për gjykatat. Për shembull, arbitrat mund të kërkojnë nga avokatët të sigurojnë informata biografike të dëshmitarëve të cilët do të dëshmojnë në procesin e arbitrazhit, me qëllim që të mos i përkushtohet kohë parashtrimit të pyetjeve lidhur me identitetin e dëshmitarit, përvojës së tij të punës, lidhjes me rastin, ose kualifikimeve arsimore që i posedon. *Kur bëhet fjalë për **dëshmitarët**, Ligji i Kosovës për Arbitrazhin parasheh që në rast se palët vendosin të ftojnë dëshmitarë, së paku 15 ditë para mbajtjes së seancës së dëgjimit, secila palë duhet t'ia dorëzojë tribunalit të arbitrazhit dhe palës tjetër emrin edhe adresën e dëshmitarit, çështjen për të cilën do të dëshmojë dhe gjuhën në të cilën do ta paraqes dëshminë.* Ngjashëm me të gjitha rregullat e arbitrazhit, Ligji i Kosovës për Arbitrazhin i lejon deklaratat e dëshmitarëve të paraqiten edhe në formë të shkruar, të nënshkruara nga dëshmitari, me kusht që dëshmitari në fjalë të jetë në dispozicion të palëve, nëse njëra palë kërkon ekzaminimin e tij/saj.[122]

Është me rëndësi të theksohet që edhe pse deklarata me shkrim ose dëshmia mund të shfrytëzohet si zëvendësim i ekzaminimit të drejtpërdrejt të dëshmitarit në seancë të dëgjimit, ajo nuk e ka të njëjtën peshë nëse dëshmitari nuk është i disponueshëm për ekzaminim. Me arritjet e reja teknologjike, disa tribunale të arbitrazhit tani po lejojnë deklaratat e incizuara me video-kamerë ose video-transmetime direkt, me ç'rast, edhe pse dëshmitari nuk është fizikisht i pranishëm në dhomën ku po zhvillohet dëgjimi, arbitërat dhe avokatët megjithatë mund t'i parashtrojnë pyetje. *Përveç provave të paraqitura nga palët, si dhe dëshmive të dhëna nga dëshmitarët, tribunali i arbitrazhit mund të angazhojë një ose më shumë **ekspert** për t'i raportuar atij me shkrim lidhur me çështje specifike të përcaktuara nga tribunali*. Nëse tribunali vendosë për një gjë të tillë, ai mund ta urdhërojë një palë që ekspertit t'i jep çdo informatë të nevojshme, të përgatisë ose t'i ofrojë qasje në dokumente ose sende për shqyrtim, në mënyrë që ai ta përgatisë raportin. Pas pranimit të raportit të ekspertit, tribunali i arbitrazhit u dërgon palëve nga një kopje të raportit dhe palëve u jepet mundësia t'i paraqesin mendimet e tyre me shkrim mbi raportin. Eksperti, pasi të ketë dorëzuar raportin me shkrim, paraqitet në seance, gjatë së cilës palët mund ta marrin atë në pyetje.[123] Nëse palët vetë kanë

[121] *Ligji i Kosovës për Arbitrazh Nr.02/L-75,Neni 23, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com*
[122] *Po aty. Neni 24.*
[123] *Po aty. Neni 25.*

propozuar ekspert, ato duhet t'i identifikojnë kualifikimet e ekspertit para mbajtjes së tribunalit të arbtirazhit. Meqenëse palët shpesh emërojnë ekspert të ndryshëm cilët vijnë me konkludime diametralisht të kundërta, është zakonisht më efikase dhe e drejtë që tribunali i arbitrazhit ta emërojë një ekspert të paanshëm, i cili do të jetë në dispozicion të të dyja palëve që ta marrin në pyetje.[124]

3.1. Shtjellimi i provave

Për vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike Tribunali i Arbitrazhit shtjellon provat gjatë seancës dhe se barra për të provuar faktet të cilat mbështesin themelësinë e padisë i bartë paditësi ndësra ato që pretendojnë në vërtetimin e përgjigjies në padi i bartë i padituri. Lidhur me pranueshmërinë apo jo të provave për peshën e të njejtave vendosë Tribunali i Arbitrazhit i cili gjithashtu nga palët mund të kërkojnë edhe prova tjera në afat të caktuar.[125]

3.2. Dëshmitarët

Secili person që thirret për dëshmitar ka për detyrë t`i përgjigjet ftesës, si dhe të dëshmoj. Si dëshmitar mund të pytet personi i cili ka aftësi të jap informata mbi fakte që duhet të provohen.[126] Pala e cila propozon dëshmitar qëndrojnë në obligim që më së paku pesmbëdhjetë (15) ditë, para mbajtjes së séances dëgjimore, duhet t`ia dorëzojnë Tribunalit të Arbitrazhit dhe pales kundërshtare emrin dhe adresën e dëshmitarit, në çfarë rrethana duhet të dëgjhet dhe në cilën gjuhë do ta paraqesë dëshminë.[127] Sipas Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin thuhet: se deklaratat e nënshkruara nga dëshmitari, me kusht që dëshmitari të jetë në dispozicion për palët nëse njëra pale e kërkonë ekzaminimin e dëshmitarit.[128] Përshkak të arritshëris terminologjike, në kohët e sotme mundësohet dëgjimi i dëshmitarëve edhe nga distanca në rastë se ata mungojnë nga salla ku mbahet seanca e dëgjimit.

Dëgjimi i palëve në mënyrë jot ë drejtëpërdrejtë mund të bëhet nëpërmjet video kamerave, ose video transmetimit direkt.[129] Kjo është e përcaktuar dhe nga Ligji i Arbitrazhit të Kosovës, sipas të cilit thuhet se: Tribunali i arbitrazhit mund të urdhërojë që dëshmitarët, duke përfshirë edhe dëshmitarët ekspertë, do të merren në pyetje me anë të mjeteve të telekomunikacionit që nuk kërkojnë praninë e tyre fizike në seancën dëgjimore (të tilla si video-konferencë).[130] Gjithashtu duhet të thekësohet se ndaj dëshmitarëve arbitrazhi nuk mund të marrë masa shtërnguese. Kjo vlen edhe për pjesmarrësit tjerë në procedure.[131] Kundër tyre nuk mund të shqiptohen dënime.[132]

---

[124] *Matrial nga lënda, ''E Drejta Ndërkombëtare Tregëtare'', pregaditur nga: Prof.Dr.Ass. Halim Bajraktari. Prizren, 2012.*
[125] *Musa, Mustafë, ''E Drejta e Arbitrazhit'', Gjilan. 2012. Fq 86.*
[126] *Ligji i procedurës kontestimore `LPK`, nr. 03/L-006. Neni 339 par. 1 dhe 2.*
[127] Neni 26,i rregullave të Arbitrazhit nga Ligji Model të UNCTRAL-it.
[128] Ligji i Kosovës për Arbitrazh Nr.02/L-75,Neni 24 par 2, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com
[129] Matrial nga lënda, ''E Drejta Ndërkombëtare Tregëtare'', pregaditur nga: Prof.Dr.Ass. Halim Bajraktari. Prizren, 2012.
[130] Përmbledhje e rregullave të Arbitrazhit 2011, Neni 29, fq 14.
[131] Brestovci, Faik,``E drejta Procedurale civile II, Prishtinë 2006, fq 150.

3.3. Ekspertët

Në rastë se Tribunali i Arbitrazhit nuk posedon njohuri të caktuara profesionale lidhur me një qështje të caktuar, atëher vet tirbunali cakton ekspertët nga lëmia gjegjëse, të cilët do t`i ndihmojnë Tribunalit të Arbitrazhit për vendosjen e çështies. Në momentin e caktimit të ekspertit është shum me rëndësi të caktohet se çka kërkohet nga eksperti.[133] Pas konsultimit me palët, tribunali i arbitrazhit mund të emërojë një ose më shumë ekspertë të pavarur për ti raportuar tribunalit, me shkrim, për çështje të veçanta që do të përcaktohen nga tribunali i arbitrazhit. Një kopje e përshkrimit të punëve të ekspertëve, hartuar nga tribunali i arbitrazhit, do ti dorëzohet palëve.[134] Tribunali i arbitrazhit mund të emëroj një ose më shumë ekspertë për të raportuar mbi çshtjen e veçantë që do të përcaktohet nga tribunali i arbitrazit, përveqë nëse palët janë marrë vesh ndryshe. Gjithashtu eksperti pas dorëzimit të raportit të raportit me shkrim dhe me gojë, ai duhet të marrë pjesë në seancën dëgjimore, ku palët kanë mundësin për ti bër pyetje dhe për të paraqitur dëshmitarët ekspertë për të dëshmuar pikat në fjalë.[135]

Eksperti duhet, në parim para pranimit të emërimit, të paraqesë në gjykatën e arbitrazhit si dhe palëve, një përshkrim të kualifikimeve të tij ose të saj dhe një deklaratë mbi paanësinë dhe pavarësinë e tij apo të saj. Brenda kohës së urdhëruar nga tribunali i arbitrazhit, palët duhet të informojnë tribunalin e arbitrazhit nëse ato kanë ndonjë kundërshtim në lidhje me kualifikimet, paanësinë, apo pavarësinë e ekspertit. Tribunali i arbitrazhit do të vendosë menjëherë nëse do të pranoj ndonjë kundërshtim të tillë. Pas emërimit të një eksperti, një pale mund të kundërshtoj kualifikimet, pa-anësinë ose pamëvarësinë e ekspertit vetëm nëse kundështimi është për arsye të cilat kjo pale i ka kuptuar pas emërimit të ekspertit. Tribunali i Arbitrazhit do të vendos menjëherë nëse duhet ndërmarrë ndonjë veprim.[136] Palët do ti japin ekspertit çdo informacion relevant ose ti parashtrojnë për inspektim të gjitha dokumentet ose sendet relevante që ai ose ajo mund të kërkojë prej tyre. Midis një pale dhe ekspertit në lidhje me rëndësinë e informacionit ose parashtrimit të kërkuar qdo mosëmarrëveshje, do ti referohet tribunalit të arbitrazhit për vendim. Pas marrjes së raportit të ekspertit, tribunali i arbitrazhit do të dorëzojë një kopje të raortit palëve, të cilat do ta kenë mundësinë për të shprehur, me shkrim, mendimin e tyre mbi raportin.[137] Tribunali i arbitrazhit mund ta urdhërojë një palë që ekspertit t'i jep çdo informatë të nevojshme, të përgatisë ose t'i ofrojë qasje në dokumente ose sende për shiqim. Pas pranimit të raportit të ekspertit, tribunali i arbitrazhit ua dërgon palëve nga një kopje të raportit me ç'rast palëve u jepet mundësia që me shkrim ta shprehin mendimin e tyre lidhur me raportin. Përveç nëse palët janë pajtuar ndryshe, me kërkesë të palës ose nëse tribunali i arbitrazhit këtë e konsideron të nevojshme, eksperti, pasi të ketë dorëzuar raportin me

[132] Ligji i procedurës kontestimore `LPK`, nr. 03/L-006. Neni 479.
[133] Thaqi, Ramadan,''E Drejta e Arbitrazhit'', Prishtinë, 2012, fq 87.
[134] Përmbledhje e rregullave të Arbitrazhit 2011, Neni 30 par 1, fq 14.
[135] German Arbitration Law 98,/ section 1049. 1and 2.
[136] Po aty. Neni 30 par 2, fq 14.
[137] *Matrial nga lënda, ''E Drejta Ndërkombëtare Tregëtare'', pregaditur nga: Prof.Dr.Ass. Halim Bajraktari. Prizren, 2012.*

shkrim, dëgjohet në seancë, gjatë së cilës palët kanë mundësi ta marrin ekspertin në pyetje. Gjatë kësaj seance të dëgjimit, palët mund të paraqesin ekspertët e tyre për të dhënë mendimin e tyre në lidhje me çështjet e ngritura.[138]

3.4. Bashkëndërgjyqsit

Bashkëndërgjyqësia në procedurën e arbitrazhit është e mundshme vetëm nëse të gjithë bashkëndërgjyqësit kanë lidhur kontratën për gjykatën e arbitrazhit me palën kundërshtare dhe nëse të gjithë bashkëndërgjyqësit janë të pajtimit për arbitrate të cilët ata i emërojnë. Duhet potencuar se bashkëndërqyqësia në procedurën e arbitrazhit është e lejuar, pos në rastet kur kjo me rregullore gjegjëse shprehimisht është ndaluar. Kur është në pyetje bashkëndërgjyqësia e rëndomtë, atëher nuk ekziston kurrfar problemi për pjesëmarrjen e të gjithë ndërgjyqësve në procedurën e arbitrazhit, por kur është fjala për bashkëndërgjyqësit e obigueshëm, atëherë nuk mund të ketë procedure të arbitrazhit nëse të gjitha palët nga shprehja e lire e vullnetit nuk sqarohen për pjesëmarrjen në procedurën e arbitrazhit. Është me rendësi të ceket se nuk ka kurrfarë presioni lidhur me caktimin e arbitrave dhe të gjithë arbitrate duhet të emërohen në mënyrën që u përgjigjet secilit prej bashkëndërgjyqësve.[139]

3.5. Ndërhyrësi

Ndërhyrësi në procedurën e arbitrazhit është pale e interesuar për vendosjen e kontestit, dhe kjo ndërhyrje është e lejuar nëse shprehimisht e parasheh kontrata e arbitrazhit dhe nëse me këtë pajtohen të dy palët apo pajtohen arbitrat. Për ndërhyrje në procedure ndërmjetë pales së cilës i është bashkangjitur ndërhyrësi, duhet të eksiztojë interesi juridik për ndërhyrje në procedurë, gjithashtu duhet të jetë pëlqimi i të gjitha palëve dhe gjykatës së arbitrazhit si dhe të jetë e parapar me marrëveshjen e arbitrazhit kjo ndërhyrje.[140]

4. MOSVEPRIMI I PALËS

Palët duhet të veprojnë në përputhje me rregullat e arbitrazhit të aplikueshme për rastin e tyre, dhe njëri prej kushteve është që palët t'i sigurojnë tribunalit të arbitrazhit padinë dhe përgjigjën në padi brenda afateve kohore të dakorduara nga palët ose të caktuara nga tribunali, si dhe të paraqiten në seancën dëgjimore të caktuar për rastin e tyre.[141] Megjithatë, ekzistojnë shumë raste në të cilat njëra palë nuk i siguron këto dokumente me kohë ose nuk paraqitet fare në seancën dëgjimore.

Për këto raste, Ligji i Kosovës për Arbitrazhin parasheh që nëse Paditësi nuk e paraqet padinë e tij dhe nuk ka arsyetim të mjaftueshëm për këtë, tribunali i arbitrazhit e mbyllë procedurën e arbitrazhit.

---

[138] *Ligji i Kosovës për Arbitrazh Nr.02/L-75,Neni 25 par 1 dhe 2, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com*
[139] *Musa, Mustafë, ''E Drejta e Arbitrazhit'', Gjilan. 2012. Fq 87,88.*
[140] Po aty.
[141] Ligji i Kosovës për Arbitrazh Nr.02/L-75,Neni 20, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com

Kjo për arsye se, nëse Paditësi tërhiqet, kjo nënkupton që ai nuk dëshiron ta ndjek të Paditurin, që ka qenë arsyeja kryesore pse procedura e arbitrazhit do të kishte filluar në rend të parë.[142] Nëse, në nën tjetër, i padituri nuk e paraqet përgjigjen e tij në padi sipas nenit 20, paragrafi 1, tribunali i arbitrazhit vazhdon me procedurën dhe mungesa e paraqitjes së përgjigjes në padi nga i padituri nuk do të konsiderohet si pranim i pretendimeve të paditësit.[143]

Nëse njëra palë nuk merr pjesë në seancën e dëgjimit, tribunali i arbitrazhit mund ta vazhdojë procedurën e arbitrazhit dhe ta nxjerrë vendimin në bazë të provave me të cilat disponon.[144] Kështu që, sikurse procedurat nga shumë rregulla të arbitrazhit, arbitrat vazhdojnë me procedimin e rastin dhe marrin vendim bazuar në të dhënat të cilat iu janë paraqitur atyre. Simbas Ligjit Gjerman për arbitrazhin thuhet që: nëse paditësi nuk arrin të komunikoj pales së paditur deklaratën e tij të kërkesës, tribunali i arbitrazhit e mbyll seancën.[145] Nëse i padituri nuk arrin të komunikojë deklaratën e tij të mbrojtjes në përputhje me seksionin 1046 subs. 1, tribunali i arbitrazhit do të vazhdojë procedurën pa e trajtuar dështimin e tillë në vetvete si një pranim i pretendimeve të paditësit.[146] Nëse cilado palë nuk paraqitet në seancë gojore ose për të paraqitur dëshmi të dokumentuara brenda një afati të caktuar, tribunali i arbitrazhit mund ta vazhdojë procedurën.[147]

Ligji i Kosovës poashtu parasheh që kurdo që njëra palë është në dijeni të një shkelje nga pala tjetër të ndonjë dispozite të ligjit ose të marrëveshjes së arbitrazhit, ajo duhet ta deklarojë kundërshtimin e saj mbi këtë. Nëse pala nuk e bën këtë, atëherë konsiderohet se ajo ka hequr dorë nga e drejta për të kundërshtuar mbi shkeljen.[148] Për shembull, njëra palë mund të njoftohet se pala tjetër e ka shkelur marrëveshjen e arbitrazhit duke e paraqitur rastin para një gjykate. Nëse pala e cila nuk bën shkelje nuk e kundërshton këtë fakt që në momentin kur i është bërë e njohur, do të konsiderohet që kjo palë ka hequr dorë nga e drejta për të kundërshtuar.[149]

4.1. Heqia dor për të kundërshtuar

Nëse gjatë procedures njëra pale është në dijeni se pala tjetër ka bërë ndonjë shkelje të ndonjë dispozite ose të marrëveshjes së arbitrazhit, ajo duhet të paraqes kundështimin për këtë çështie. Nëse pala nuk e bënë këtë konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta për të kundërshtuar për këtë shkelje.[150] Ky institute është shumë i rëndësishëm në situatën kur në arbitrazh lajmërohet shtetasi i

[142] Po aty. Neni 26 par 1.
[143] Po aty. Neni 26 par 2.
[144] Po aty. Neni 26 par 3.
[145] German Arbitration Law 98,/ section 1048. subs 1.
[146] Po aty. Section 1048. subs 2.
[147] *Po aty. Section 1048, subs 3.*
[148] *Ligji i Kosovës për Arbitrazh Nr.02/L-75, Neni 27, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com.*
[149] *Rregullat e Arbitrazhit në Kosovë (Neni-31 par 1.2.3 dhe Neni-33) përmbajnë dispozita të ngjashme lidhur me mosveprimin e palës dhe heqjes dorë për të kundërshtuar.*
[150] *Neni 4, i rregullave të Arbitrazhit nga Ligji Model i UNCTRAL-it. Si dhe Neni 27 i Ligjit për Arbitrazh i Kosovës.*

huaj i cili dëshiron të dijë qëndrimin edhe sa i përket kësaj ka arbitrazh i cili udhëheqet nështetin e shtetasit tjetër.[151]

4.2. Pajtimi i palëve gjatë seancës dëgjimit

Gjat seancës së dëgjimit mund të ndodh që palët në kontest të pajtohen, që do të thot se ende pa marrë një vendim gjykata e arbitrazhit vetë palët mund të kriojnë ujdi mes vete. Kështu që nëse palët pajtohen para nxerrjes së vendimit për zgjidhjen e kontestit Tribunali i Arbitrazhit e ndërprenë procedurën.

Me kërkesën e palëve, Tribunali i Arbitrazhit mund të dokumentojë pajtimin e palëve në formë të një vendimi të arbitrazhit sipas kushteve për të cilat janë pajtuar palët, përveç nëse përmbajtja e pajtimit cenon ose është në kundërshtim me rendin public ``Orde publik``, normave morale dhe dispozitave imperative.

Vendimi i tillë ka efektin e njejtë sikur një vendim meritor. Vendimi duhet të përmbaj kushtet dhe përmbajtjen e pajtimit.

Përfundimi

Një gjë duhet ditur se Kosova ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara, kuptohe se nuk është nënshkruese e konventave dhe traktateve lidhur me vendimet e arbitrazhit. Megjithatë në pajtim me Ligjin e Kosovës për investimet e huaja, Kosova është pajtuar për zbatimin e Konventës për zgjidhjen e kontesteve në mes të shteteve dhe shtetasëve të huaj, rregullat e Arbitrazhit të çendrës ndërkombëtare për Zgjidhjen e kontesteve të investimeve, rregullat e Arbitrazhit të komisionit të organizatës së kombeve të bashkuara për ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare (Rregullat UNICITRAL), Rregullat e Arbitrazhit të Odës Ekonomike Ndërkombëtare (Rregullat ICC), dhe Konventën për Njohjen dhe Zbatimin e vendimeve të Huaja të Arbitrazhit (Konventa e Nju Jorkut). Zgjidhja e kontesteve afariste ndërmjet bizneseve të Kosovës ka filluar të bëhet përmes Qendrave të arbitrazhit, të cilat funksionojnë në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës dhe asaj Amerikane.

Procedurat e Arbitrazhit janë të çarta transparente, ka mundësi të zgjidhën arbitrat nga palët - arbritrat janë shumë ekspeditivë, argumentet vendosën në mënyrë të saktë, në mënyrë të organizuar dhe në fund me pajtueshmërinë e të dy palëve, vjen deri te vendimi përfundimtar. Palët përveq që mund ti zgjedhin disa nga rregullat e procedures së arbitrazhit siq janë (vendi mbajtjes së seancës, zgjedhja e arbitrave) gjithashtu kan të drejtë që në cildo faze të zhvillimit të procedures ti paraqesin provat apo faktet. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, tribunali i arbitrazhit vendosë se a do të mbahet seanca e dëgjimit ose procedura do të zhvillohet në bazë të dokumenteve dhe materialeve të tjera të shkruara, ose nëse do të kombinohen të dy këto procedura. Nëse palët nuk e kanë përjashtuar mbajtjen e seancave të dëgjimit, tribunali i arbitrazhit mbanë seancat e dëgjimit në

[151] *Musa, Mustafë, ''E Drejta e Arbitrazhit'', Gjilan. 2012. Fq 89.*

një fazë të përshtatshme të procedurës, nëse një gjë e tillë kërkohet nga pala. Seancat e dëgjimit nuk janë publike, përveç nëse palët janë dakorduar ndryshe. …Provat dhe faktet mund ti paraqesin në mënyr gojore apo me shkrim, si dhe me paraqitjen e ekspertëve të zgjedhur nga vet palët apo dhe nga tribunali i arbitrazhit nëse këto e sheh të nevojshme, nga ndërgjyqësit apo dhe nga ndërhyrësit në procedur. Provat të ofruara nga palët qofshin ato të verteta apo jo, tribunali i arbitrazhit i shqyrton dhe vendos se a jan të nevojshme që ti perdorin për dhënjen e vendimit përfundimtar. Seanca e dëgjimit është mjaft e rëndësishme si për palët në procedur ashtu dhe për tribunalin e arbitrazhit, pasi që nga kjo séance dëgjimore palët mund të vijnë deri tek ujdia mes tyre, kshtu që me pajtimin mes tyre procedura përfundon.

Bibliografia

1. Arbitrazhi, EMSG, sponzoruar nga USAID, 2008, Moduli 8;
2. Brestovci, Faik,``E drejta Procedurale civile II, Prishtinë 2006;
3. German Arbitration Law 98,/ section 1048;
4. Ligji federal për arbitrazhin (United States Arbitration Act), i miratuar më 12.07.1925,, i kodifikuar më 30.07.1947, ndërsa është ndryshuar dhe plotësuar në vitin 1954, 1970 dhe 1990;
5. Ligji i Kosovës për Arbitrazh Nr.02/L-75,Neni 20, marrë nga :http://www/gazetazyrtare.com;
6. *Ligji i procedurës kontestimore `LPK`, nr. 03/L-006;*
7. Morina, Iset, " Arbitrazhi dhe Procedura e Arbitrazhit",. Prishtinë 2015;
8. *Musa, Mustafë, ''E Drejta e Arbitrazhit'', Gjilan. 2012;*
9. Përmbledhje e rregullave të Arbitrazhit 2011;
10. *Programi i USAID-it në Kosovë për përmbarim dhe legjislacion komercial,/ Nëntor 2014;*
11. Thaqi, Ramadan,''E Drejta e Arbitrazhit'', Prishtinë, 2012

TË DREJTAT E PËRAFËRTA ME TË DREJTËN E AUTORIT

mr.Sc Kastriote VLAHNA

UDC: 347.78

Abstract

Copyright is a property right that exists in literary and artistic works that are original intellectual creations. Work Copyright protected by copyright, are not limited to novels, but in poetry, drama, works of reference, articles, computer programs, databases, films, musical compositions, paintings, drawings, photography, sculpture , architecture, advertisements, maps and drawings Copyright teknike.Të protect the rights of all literary and artistic works to create while using our intelligence and our imagination, provided that it is expressed in a tangible form. People who are creators are commonly called 'writers' even if they are really painters, photographers, writers, artists, composers etc. Laws Copyright provide copyright protection for their literary creations and artistic, generally referred to as "works" .The Author right and related rights protection is an essential component in the promotion of human creativity and innovation. Giving authors, artists and creators stimulate in the form of recognition and fair economic reward their increased activity and production and may increase results. Ensuring the existence and applicability of human rights, individuals and companies can more easily invest in the creation, development and global distribution of their works. This, in turn, helps increase access to and enhance the enjoyment of culture, knowledge and entertainment and also stimulates economic and social development. The field of copyright and related rights has expanded enormously over the last several decades of progress spectacular technological development that, in turn, providing new ways of distribution creations by such forms of communication such as satellite broadcasting and DVD. Wide dissemination of works via the Internet raises difficult questions about copyright and related rights to this global medium. At international level, the World Intellectual Property Organization is involved in the ongoing debate to help shape new standards for the protection of copyright in cyberspace.Në this regard, the Organization administers the WIPO Copyright Treaty and the WIPO performances and phonograms treaty, known as "internet Treaties". Trinidad and Tobago acceded to both the WIPO Copyright Treaty and the WIPO performances and phonograms treaty on November 28, 2008. These treaties clarify international norms aimed at preventing unauthorized access to and use of creative works on the Internet.

Hyrja

Për shkak të rrezikut të vazhdueshëm të të mirave materiale, që do të mund të shkatërrohen apo të humben , shumë forma të mbrojtjes që përfshin metodat e fshehjes, mbylljes, monitorimi dhe mbajtjes, si dhe një sistem përkatës të mbrojtjes ligjore të pronës materiale, janë zhvilluar gjatë historisë së qytetërim të njeriut.

Produktet e mendjes njerëzore janë mallrat jo-materiale, vlera e të cilave shtrihet në riprodhimit të tyre, përdorimin dhe prezantimin ndaj njerëzve të tjerë, kështu që ata nuk mund të mbrohen duke u fshehur, duke mbyllur, ose duke ndërmarr masa të tjera të mbrojtjes fizike. Për të mbrojtur këto lloj të mallrave dhe në këtë mënyrë për të inkurajuar krijimtarinë e njeriut që kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror të një sistemi përkatës të mbrojtjes ligjore të pronësisë intelektuale është zhvilluar dukshëm krimtaria intelektuale e subjektit të së drejtës, sin ë aspektin kulturor, artistik dhe shkenxor. Përdorimi i pa-autorizuar ose riprodhimi i lëndëstëe pronës intelektuale paraqesin shkelje të të drejtave, ndërsa e drejta e pronarit për shkatërrimin e tij, e përdorin atë, dhe të përfitojnë nga ajo është e mbrojtur nga mjetet dhe institucionet e sistemit juridik. Pronësia intelektuale përfshin të drejtën e autorit dhe të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit, si dhe të drejtave të pronësisë industriale.

E Drejta e Autorit është e drejtë ekskluzive e autorëve për shkatërrimin e veprave të tyre letrare, shkencore ose artistike, dhe punon duke mbuluar fusha të tjera të krijimtarisë; Të drejtat e lidhura në mënyrë të ngjashme të lidhen me të drejtat e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe të organizatave transmetuese;

Pronë industriale përfshin të drejtat nga të cilat prodhuesit e mbrojtur nga konkurrentët interesat e tyre të biznesit, pozicionin e tyre në treg dhe investimet e tyre në kërkimin shkencor, zhvillimin dhe promovimin.

Aspekte të veçanta ose karakteristikat e një produkti, mund të jetë i mbrojtur nga një ose disa forma të ndryshme të pronësisë intelektuale, plotësimin njëri-tjetrin. Zgjidhje e re e një problemi teknik është e mbrojtur nga një patentë, formë e re e jashtme apo paraqitja e një produkti mbrohet nga një dizenjo, dhe një shenjë që shërbejnë për të dalluar produktet ose shërbimet nga produktet apo dhe shërbimeve të ngjashme në treg është i mbrojtur nga një markë tregtare.

Rezultatet e krijimtarisë intelektuale mund të mbrohet nga format përkatëse të pronësisë intelektuale, në varësi të fushës së veprimtarisë si i shqetësuar.

1. ***KUPTIMI I PËRGJITHËSHË I TË DREJTËS SË AUTORIT***

E drejta e autirit si lëmi e veqantë përfahin krijimtarinë e autorit e cila krijohet në lëminë e letërsisë, shkencës dhe artit. Autori, personi fizik i cili me krijimtarinë shpirtërore dhe intelektuale të tij, për krijimet e të cilit arrijnë formën e caktuar ligjore, e cila gëzon mbrojtje logjore dhe si e tillë përbëhet nga krijimi

original në lëminë e letërsië, shkencës dhe artit.[152] E drejta e autorit është e drejta ekskluzive e kopjimit të një vepre krijuese ose për të lejuar dikë të bëj diqka të atill, kjo lejueshëri mvaret nga normat ligjore mbi të drejtat e autorit.[153] *Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të",* vepër artistike *është çdo krijim origjinal, intelektual i një personi fizik, i materializuar pavarësisht nga forma a mënyra e të shprehurit, që ka për qëllim të prekë ndjesitë e njeriut*. Ndërsa përsa i përket së drejtës së autorit, mund të themi se kjo e fundit është një prerogativë që i atribuohet autorit të veprës (shkrime, konferenca, vepra dramatike, koreografike, fonografike etj). E drejta e autorit përmban në vetvete një të drejtë fitimprurëse dhe një të drejtë morale.[154]

1.1. Aplikimi i të drejtave të autorit

Autorët e punimeve në letrare, shkencore dhe artistike dhe të tjera fusha të krijimtarisë kanë të drejtën ekskluzive për të përdorur ose për të autorizuar të tjerët të përdorin veprat e tyre. E drejtë e tillë e autorit, si dhe sistemi i instrumenteve ligjore që mbrojnë një të drejtë të tillë quhet e drejta e autorit.[155] E drejta e autorit aplikohet te të gjitha veprat origjinale letrare, shkencore dhe artistike. Këto përfshijnë: librat, muzikën, skulpturat, pikturat, fotografitë, filmat, programet radio-televizive, programet kompjuterike. Pra e drejta e autorit përfshihet edhe te subjektet e tjera, në të cilën përfshihen regjistrimi i tingujve (të tilla si rregjistrimet, kasetat dhe kompakt disqet) performancat e interpretuesve dhe sinjalet e komunikimit.[156]

1.2. Të drejtat që parashikon e drejta e autorit

Kriuesit original të veprave të mbrojtura me të drejtën e autorit, dhe trashëgimtarëve të tyre, kanë të drejta të caktuara themelore.[157] Ata mbajnë të drejtën ekskluzive për përdorim ose të autorizojnë të tjerët për të përdorur veprën mbi kushte dhe marrëveshje të rëna dakord. Kriuesi i veprës mund të ndaloj ose të autorizoj:

- Riprodhimin e veprës në forma të ndryshme, të tilla si publikimet e shtypura ose regjistrimin e ringujve;
- Performancën e tij publike, sin ë një dramë ose vepër muzikore;
- Regjistrimet e tij, për shembull: në formën e kompakt disqeve, kasetat ose videokasetat,
- Transmetimet e saj me anë të radios, kabllor ose satelitor;
- Përkthimet në gjuh të tjera ose pershtatja e saj, të tilla si një novel në sken.[158]

2. *TË DREJTAT E PËRAFËRTA ME TË DREJTAT E AUTORIT*

[152] Aliu, Dr. Abdulla*, E Drejta e Autorit,* Prishtinë 2014, fq. 11. 12.
[153]Shiko:http://europa.eu/legislation_summaries/internal_market/businesses/intellectual_property/l26032_fr.html
[154] De Broglie, Gabriel: *Le droit d'auteur et l'internet, Rapport du groupe de travail de l'Académie des sciences morales et politiques,*Paris, 2000.
[155] Shiko:http://www.dziv.hr/en/intellectual-property-protection/copyright/
[156] Guillien, Raymond dhe Vincent, Jean: *Lexique des termes juridiques,* Toulouse, 2007.
[157] Colombet, Claude: *Propriété littéraire et artistique et droits voisins,* Paris, 1999.
[158]Shiko:http://europa.eu/legislation_summaries/internal_market/businesses/intellectual_property/l26032_fr.html

Një fushë e të drejtave të lidhura me të drejtën e autorit është zhvilluar me shpejtësi në pesëdhjetë(50) vitet e fundit.[159] Të drejtat e ngjashme janë të drejtat që kanë çështjen e tyre të veçanta subjekti, i cili është kryesisht e lidhur me të drejtën e autorit. Në lidhje me lëmi të ngjashme, ato janë quajtur edhe të drejtat e lidhura me të drejtën e autorit ose të të drejtave të lidhura thjesht.[160] Veprat artistike zakonisht bëhet të gatshme për publikun nëpërmjet shërbimeve të performuesve, producentëve të fonogrameve dhe transmetuesve. Mendoni, për shembull, për një këngë që lëshohet në radio. Kur autorët (tekst shkruesi dhe kompozitori i muzikës) e krijojnë këngën, atëherë ajo performohet nga këngëtarë dhe muzikantë, të incizuar nga producent i fonogrameve dhe përhapur nga transmetuesi.[161] Performimi, incizimi dhe transmetimi i veprave kërkon një investim të madhe të kohës dhe parave. Për të mundësuar kthim të investimit dhe nxitje të më shumë veprave të bëhen të gatshme për publikun, qeveritë japin të drejta speciale performuesit, producentëve të fonogrameve dhe transmetuesve. Këto të drejta quhen të drejta e lidhura sepse ata janë ngushtë të lidhura me të drejtat e autorit.[162] Kohëzgjatja e të drejtave e lidhura varet nga ligjet vendore të secilit shtet. Në përgjithësi, mbrojtja minimale zgjat: për performues, 50 vite nga fundi i vitit në të cilën performanca është caktuar në një fonogram; për producentët e fonogrameve, 50 vite nga fundi i vitit në të cilin fonogrami publikohet dhe për transmetuesit, 20 vite nga fundi i vitit në të cilin zhvillohet transmetimi.[163]

Në lidhje me faktin se ata janë të afërt me të drejtën e autorit ata janë quajtur edhe të drejtat fqinje për të drejtën e autorit. Sipas Autorit dhe të Drejtave të ngjashme Aktit ato përfshijnë:

- E drejta e interpretuesit
- E drejta e prodhuesve të fonogrameve
- E drejta e producentëve të filmit
- E drejta e organizatave të transmetimit
- E drejta e botuesve në edicionet e tyre
- E drejta e prodhuesve të bazave të të dhënave[164]

[159] Shiko:http://zshda.gov.al/?page_id=131 marrë më datën: 23.04.2015. ora 14:16.

[160]Shiko: http://europa.eu/legislation_summaries/internal_market/businesses/intellectual_property/l26032_fr.html

[161] OBPI në www.wipo.int,,// Këto informacione mund të gjenden në CLEA bazën me të

dhëna të OBPI-së **http://www.wipo.int/clea/en/index.jsp**

[162] Po aty, fq. 32.

[163]Shiko:http://europa.eu/legislation_summaries/internal_market/businesses/intellectual_property/l26032_fr.html

[164] Shiko: http://www.dziv.hr/en/intellectual-property-protection/copyright/

2.1. TË DREJTAT E INTERPRETUESËVE - (Përformuesëve)

Shumë vepra artistike nuk do të vlerësoheshin tërësisht pa ndihmën e Performuesve. Për shembull: përbërja muzikore zakonisht preferohet kur zhvillohet nga muzikant sesa të lexohet në faqe muzikore. E njëjta vlen edhe për shkresa, drama, madje edhe romane, që shumë njerëz preferojnëkur ata janë të perfomruar nga aktorë në skenë ose video xhirime.[165] Performuesit, si aktorët, muzikantët, kërcyesit dhe këngëtarët sjellin jetë veprave të autorëve. Me aktrimin e tyre, luajtja e instrumentit, kërcimi ose këndimi, performuesit interpretojnë veprat në stilin e tyre unik.

Interpretimet origjinale të veprave janë të vlefshme dhe prandaj të mbrojtura me të drejtat e lidhura.[166] Në disa vende, performuesit kanë gjithashtu të drejta të ngjashme sikur të drejtat morale të autorit. Këto të drejta mbrojnë performuesit kundër prishjes së performancës së tyre. Ajo gjithashtu mundëson që të kërkojnë emrat e tyre të përmenden në lidhje me performancën e tyre. Të gjitha të drejtat e përafërta me të drejtat e autorit janë të mbrojtura dhe të numëruara taksativisht edhe në ligjin e Kosovës mbi të drejtat e autorit, kështu duke filluar nga neni 130.

2.1.1.Të drejtat morale të interpretuesve

Interpretuesit kanë të drejtë ekskluzive që të tregojn emrin,pseudonimin apo shenjat e tyre, në rastin e shfrytëzimit të interpretimit(perforimit) të tyre. Vetë autorët e veprës, në rastin se gjat interpretimit të veprës së tyre cenohet nderi nderi i tyre,ose nga qdo deforim,shëmtim të interpretimit ata mund të kundërshtojnë dhe të bëjn të ndaluar interpretimin e veprës së tyre.[167]

Me rastin e vlersimit nëse me një formë konkrete të shfrytëzimit cenohet nderi dhe aspekti i interpretuesit merret parasysh masa të arsyeshërisë së interpretuesit.[168]

2.1.2. Të drejtat pasurore të interpretuesve

Interpretuesi ka të drejtë të lejoj apo të ndalojë: kështu si: fiksimin e intepretimit të drejtpërdrejtë, riprodhimin e interpretimit të tij në fonograme dhe videograme, shpërndarjen e fongrameve dhe videograme që përmbajnë interpretimin e tij, qiradhënien e fonogramit ose të videogramit që përmban interpretimin e tij, emërtimin radioteleviziv të interpretimit të tij në të gjallë, transpetimi publik të

[165] OBPI në www.wipo.int,,// Këto informacione mund të gjenden në CLEA bazën me të dhëna

të OBPI-së **http://www.wipo.int/clea/en/index.jsp**

[166] Po aty, fq.33.
[167] Shiko:http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ligji_per_te_Drejtat_e_Autorit_%28shqip%29.pdf
[168] Po aty. Neni 130.

interpretimit të tijë në të gjallë, përpunimin e interpretimit të tij tashmë të fiksuar, vënien e interpretimit të tij në dispozicion publik.[169]

2.1.3. Të drejtat e kompensimit

Interpretuesit kanë të drejtën e hises në kompensimin që merr prodhuesi i fonogramit, për komunikimin public të interpetimit të tyre nga fonogrami i botuar për qellime komerciale. Gjithashtu në rastë se interpretuesit ia kalojnë të drejtëe qiradhënies, prodhuesit të fongramit ose producentit të filmit i ruajnë të drejtëe kompensimit përkatës nga qiradhënia. Interpretuesit nuk mund të heqin dor nga kjo e drejtë.[170] Intepretuesit kan të drejtën e hises në kompenzim të veqant.[171]

2.1.4. Supozimi i kalimit

Me lidhjen e kontratës për prodhimin e filmit supozohet se interpretuesi ekskluzivisht dhe pa kufizime ia ka kaluar producentit të filmit të gjitha të drejtat e veta pasurore lidhur me interpretimin, nëse me kontratë nuk parashihet ndryshe. Gjithashtu për secilën të drejtë pasurore që do ta ketë kaluar, interpretues ka të drejtë të kompensimit përkatës nga ana e producentit të filmit. Intepretuesi nuk mund të heq dorë nga e drejta e referuar.[172]

2.1.5. Përfundimi i veprës audiovizuele

Nëse interpretuesi refuzon përfundimin e kontributit të vet për veprën audiovizuele ose nuk ka mundësi ta përfundoj atë, nuk mund të kundërshtoj që kontributi i tij tashmë i dhënë të shfrytëzohet për përfundimin e plotë të veprës. Interpretuesi gëzon të drejtat përkatëse për kontributin e deriatëhershëm.[173]

2.1.6. Përfaqësuesi i ansalblit të interpretuesve

Lidhur me administrimin e të drejtave të interpretuesve ansamblin e përfaqëson personi që është i autorizuar me shkrim nga shumica e anëtarëve të ansamblit. Nëse në interpretim të veprës pos ansamblit marrin pjesë dirigjenti, solisti dhe bartësi i roleve kryesore, të cilët nuk janë njëkohësishtë anëtarë të ansamblit, për administrimin e të drejtave nga ky ligj është i domosdoshëm pajtimi i të gjithë këtyre personave që janë në kontratë.[174]

2.1.7. Interpretimi nga mardhënia e punës

[169] LPDADP Neni 131
[170] Aliu, Dr. Abdulla, *E Drejta e Autorit,* Prishtinë 2014, fq 105.
[171] Shiko: http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ligji_per_te_Drejtat_e_Autorit_%28shqip%29.pdf- Neni 38 paragrafi 2.
[172] Po aty. Neni 38 paragrafi 3.
[173] Aliu, Dr. Abdulla, *E Drejta e Autorit,* Prishtinë 2014, fq 105.
[174] Po aty.

Në lidhje me interpretimet që janë rezultat i përmbushjes së detyrave të autorit pse udhëzimeve të punëdhënësit gjatë kohëzgjatjes së punësimit, rregulloret e këtij ligji i refereohen gjithashtu veprave të autorit të kriuara gjat mardhënies së punës.[175]

2.1.8. Kohëzgjatja e mbrojtjes

Të drejtat pasurore të interpretuesit zgjasin pesëdhjetë(50) vjetë nga interpretimi i bërë. Nëse interpretimi i fiksuar brendakësaj periudhe është botuar në mënyrë të ligjëshme ose i është komunikuar publikut, të drejtat e interpretuesit zgjasin pesëdhjetë(50) vjet që nga dita e botimit të pare ose e komunikimit të parë, varësishtë se cili veprim është bër më përpara.[176] Të drejtat morale të autorit zgjasin pa kufizime kohore.[177]

2.2. TË DREJTAT E PRODHUESVE TË FONOGRAMEVE

Të drejtat e prodhuesëve të fonogrameve janë njohur sepse është bërë e qartë që burimet e tyre kriuese, financiare dhe organizative janë të domosdoshme për sjelljen në publik, të regjistruara në formën e fonogrameve/ videogramave, pasi që konsiderohet i justifikuar interesi I tyre mbi burimet ligjore për marrjen e masave kundër përdorimeve të pa-autorizuara, të lidhura me bërjen dhe shpërndarjen e kopjeve të pa-autorizuara(piratuara) ose transmetimin (radiofonik, televiziv, kabllor etj) dhe komunikimin perms internetit.[178] Të drejtat e organizatave transmetuese janë njohura përshkak të rolit të tyre të madh në përcjelljen e veprave në publik dhe të interesit të tyre të justifikuar në kontrallin e transmetimit dhe ritransmetimit të tyre.[179]

Prodhuesit e fonogrameve kanë të drejtë ekskluzive të lejojnë apo të ndalojnë:

1. *riprodhimin e fonogrameve të veta;*
2. *shpërndarjen e fonogrameve të veta;*
3. *qiradhënien e fonogrameve të veta;*
4. *vënien e fonogrameve të veta në dispozicion të publikut;*
5. *përpunimin e fonogrameve të veta.*

2.2.1. E drejta e kompensimit për komunikimin e fonogrameve të publikut

Prodhuesi i fonogramit ka të drejtën e kompensimit për komunikim të publikut të fonogramit të tij të botuar për qëllime komerciale. Nëse me kontratë mes prodhuesit të fonogramit dhe interpretuesve nuk është parashikuar ndryshe,prodhuesi i fonogramit është i detyruar që gjysmën e kompensimit nga

[175] LDADP, neni 133.
[176] Aliu, Dr. Abdulla, *E Drejta e Autorit,* Prishtinë 2014, fq 106.
[177] LDADP, neni137, prgrafi 2.
[178] Gega. Dr. Fatos. Pronësia Intelektuale. Tiranë 2012.Fq 44.
[179] Po aty.

paragrafi 1. përcjellë interpretuesve, interpretimet e të cilëve gjenden në fonogramin e tij. Në kuptim të këtij neni, fonogramet të botuara për qëllime komerciale konsiderohen fonogramet e vëna në dispozicion të publikut.[180]

2.2.2. E drejta në kompensim të veçantë

Në rastet kur vepra e autorit, varësisht nga natyra e saj, mund të riprodhohet edhe për përdorim privat në kuptim të nenit 44 të këtij ligji në formë të realizimit të fiksimit audiovizuel, autori ka të drejtë në një pjesë të kompensimit të veçantë për një riprodhim të tillë të veprës së tij.[181] Pra personi fizik mund ta riprodhoj lirshëm një vepër, në çfarëdo bartësi, nëse këtë e bën për përdorim privat dhe pa interes të drejtpërdrejtë

apo të tërthortë komercial, si dhe nëse egzemplarët e tillë nuk do ti shpërndahen apo komunikohen publikut.[182] Pra, Prodhuesit e fonogrameve kanë të drejtën e hises në kompensimin e veçantë nga paragrafi 1. i nenit 38 të këtij ligji.[183]

2.2.3. Kohëzgjatja e të drejtave

Të drejtat e prodhuesit të fonogrameve zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga koha e fiksimit. Nëse brenda kësaj kohe fonogrami është botuar ligjshëm, të drejtat zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga botimi i tij i parë. Nëse gjatë kësaj periudhe fonogrami nuk është botuar ligjshëm, por i është komunikuar ligjshëm publikut, të drejtat zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga dita e komunikimit të parë të ligjshëm për publikun.[184]

2.3. TË DREJTAT E PRODUCENTËVE TË FILIMIT

Statusi i veçantë i posaçëm i producentit të filmit si "krijuesi ekonomik-organizative" të një vepre kinematografike dhe trajtimin e saj në ligj kanë qenë gjithmonë dhe përtej kufijve të pikave kryesore të grindjes së drejtës së autorit. Sidomos në Gjermani, pozita e prodhuesit të filmit është kritikuar shpesh si të qenë shumë i dobët dhe e përdorur pozitën e tij (gjoja) të fortë ligjor në vende të tjera si një model për propozime për reforma. Ky argument është pika e fillimit për këtë punë.[185] Tre "modele të mbrojtjes të

[180] Shiko: http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ligji_per_te_Drejtat_e_Autorit_%28shqip%29.pdf- Neni 139, paragrafi:1,2,3.
[181] Shiko:http://www.mkrs-ks.org/repository/docs/Ligji_per_te_Drejtat_e_Autorit_%28shqip%29.pdf- Neni 38.pargrafi 1.
[182] Po aty. Neni 44, paragrafi 2.1.
[183] Po aty. Neni 140.
[184] Po aty. Neni 141.
[185] Gregory. Nicholas``Prodhuesit dhe të drejtat për punën e filmit``Gjermani. 2010. Fq.372.

prodhuesit" janë ilustruar nga britanikët, ligjin austriak dhe gjerman dhe pyetje përputhshmërinë e tyre me ligjin Evropian.Fokusi është në studimin e ligjit gjerman të filmit, në veçanti të drejtat e performancës të producentit të filmit.[186] Prodhuesi i filmit do të ketë të drejtën ekskluzive për të riprodhuar transportuesin imazhit ose foto dhe të shëndoshë mbi të cilën puna film është përfshirë, të shpërndarë dhe përdorur për performancë publike, transmetimet apo qasje publike. Producenti i filmit gjithashtu ka të drejtë të ndalojë ndonjë shtrembërim ose uljen e transportuesit imazhit apo foto dhe regjistrimin e shëndoshë, e cila ka gjasa të rrezikojë interesat e saj legjitime në këtë.[187]

2.3.1. Të drejtat e producentëve të filmit

E drejta është e transferueshme. Producenti i filmit mund të japin një tjetër të drejtë të përdorë transportuesin imazhit ose foto dhe të shëndoshë në ndonjë ose të gjithë kundër llojit të rezervuara e përdorimit.[188]

Producentët e filmit kanë të drejtë ekskluzive të lejojnë apo të ndalojnë:

1. *riprodhimin e videogrameve të veta;*
2. *shpërndarjen e videogrameve të veta;*
3. *qiradhënien e videogrameve të veta;*
4. *.shfaqjen publike të videogrameve të tyre;*
5. *vënien e videogrameve të veta në dispozicion të publikut.*[189]

2.3.2. Të drejtat në kompenzim të vacant

Në rastet kur vepra e autorit, varësisht nga natyra e saj, mund të riprodhohet edhe për përdorim privat, në formë të realizimit të fiksimit audiovizuel, autori ka të drejtë në një pjesë të kompensimit të veçantë për një riprodhim të tillë të veprës së tij. Kompensimi i veçantë, për fiksim audiovizuel paguhet me rastin e shitjes së parë ose importimit të bartësve të rinj të zbrazët të tingullit ose të pamjes.[190] Producentët e filmit gëzojnë të drejtën e hises në kompensim të veçantë nga paragrafi 2. i nenit 38 të këtij ligji.[191]

---

[186] Shiko:http://dejure.org/gesetze/UrhG/94.html marr më datën: 24.04.2015, ora 14:14.

[187] Akti Copyright,,/ Pjesa 3 - Dispozita të veçanta për filma (§§ 88-95),,/Seksioni 1 - Film Punon (§§ 88-94) Konkretisht në nenin § 94.1 Schutz des Filmherstellers (mbrojtja e producentit të filmit).

[188] Po aty, neni 94.2. Schutz des Filmherstellers (mbrojtja e producentit të filmit)

[189] Ligji i Kosovës Nr. 04/L-065, Për të Drejtat e Autorit Dhe të Drejtat e Përafërta,, Neni 142.1.

[190] Ligji i Kosovës Nr. 04/L-065, Për të Drejtat e Autorit Dhe të Drejtat e Përafërta,, Neni 38.1.2. Gjithashtu: Kompensimi i veçantë nga paragrafi 1. i këtij neni për fotokopjim duhet të paguhet 3.1. me rastin e shitjes së parë ose Importimit të aparateve të reja për fotokopjim;3.2. për secilën fotokopje, nëse është bërë me pagesë, duke marrë parasysh numrin e mundshëm të tyre gjatë një viti.

[191] Po aty. Neni 143.

2.3.3. Kohëzgjatja e të drejtave

E drejta skadon pesëdhjetë vjet pas paraqitjes së transportuesit e imazhit ose të fotografisë dhe të zërit ose nëse përdorimi i saj i parë ligjor për komunikim publik u zhvillua më herët, pas kësaj, megjithatë, tashmë pesëdhjetë vjet pas prodhimit, në qoftë se transportuesi foto ose foto dhe është regjistruar muzikë brenda kësaj periudhe të botuar ose që përdoret për riprodhimin publik ligjërisht.[192] Dhe sambas ligjit të Kosovës për të drejtat e Autorit thuhet: ``*Të drejtat e producentëve të filmit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga fiksimi i parë i videogramit. Nëse gjatë kësaj periudhe videogrami është botuar ose i është komunikuar ligjshëm publikut, të drejtat e producentit të filmit zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga dita e botimit të parë ose e komunikimit të pare publikut, varësisht se cili veprim është bërë më përpara.*``[193]

2.3. TË DREJTAT SHËRBYESE MEDIAL AUDIOVIZUEL

Mediat audiovizuale propozojë për publikun një gamë të përmbajtjes së informacionit, nga llogaritë e bisedave para: kjo është një nga arsyet kryesore për atraktivitetin e tyre. Nuk është mendimi i Dominique Wolton, i cili beson se, duke pasur parasysh informacionin që propozojë medias, në veçanti, ato audiovizuale, individ i vetëm mund të përgjigjet: Pikëpamja e tij është marrja e një lloji të përmbajtjes media në kuptimin e plotë të fjalës. Prandaj ai nxit nënvlerësimit inteligjencën e publikut kurrë kritike.[194]

2.3.1. Të drejtat e shërbyesve medial audiovizuel

Shërbyesi medial audiovizuel ka të drejtë ekskluzive të lejojë apo të ndalojë:

1. *fiksimin e emisioneve të veta;*

2. riprodhimin e emisioneve të veta të fiksuara;

3. shpërndarjen e fiksimeve të emisioneve të veta;

4. riemetimin radioteleviziv të emisioneve të veta;

5. emetimin e mëtejmë të emisioneve të veta, kur kjo bëhet në ato vende ku hyrja e publikut është me pagesë;

6. vënien në dispozicion publikut të emisioneve të veta të fiksuara.

[192] Akti Copyright,,/ Pjesa 3 - Dispozita të veçanta për filma (§§ 88-95),,/Seksioni 1 - Film Punon (§§ 88-94) Konkretisht në nenin § 94.3 Schutz des Filmherstellers (mbrojtja e producentit të filmit).
[193] Ligji i Kosovës Nr. 04/L-065, Për të Drejtat e Autorit Dhe të Drejtat e Përafërta,, Neni 144.
[194] Shiko: http://de.education-medias.csa.fr61c9.systranlinks.net

2.3.2. Kohzgjatja e të drejtave

Të drejtat e shërbyesve medial audiovizuel zgjasin pesëdhjetë (50) vjet që nga dita e emetimit të pare radioteleviziv të emisionit të tyre.[195]

2.4. TË DREJTAT E PRODHUESVE TË BAZAVE TË TË DHËNAVE

E drejta e Autorit, përkatësisht Akti: rregullon në mënyrë përfundimtare të drejtat e prodhuesve të bazës së të dhënave. Pas kësaj, ai ka të drejtë për riprodhimin dhe të drejtat e shpërndarjes dhe të drejtën e komunikimit me publikun në lidhje me bazën e të dhënave si një e tërë ose në një pjesë të konsiderueshme të saj. Sa i përket pjesëve të jothelbësore të drejtat e tilla ekzistojnë vetëm në një qasje të përsëritur dhe sistematike kur aktet e shfrytëzimit të shfrytëzimin normal të bazës së të dhënave apo banak drejtuar të paragjykojë interesat legjitime të prodhuesit të bazës së të dhënave të paarsyeshme. Përveç kësaj, përdorimi i pjesëve jothelbësore është i lejuar.[196]

2.4.1. Mbrojtja e bazës së të dhënave

Mbrojtja e bazës së të dhënave apo e përmbajtjeve të saj zbatohet pavarësisht nga mbrojtja autorjuridike ose mbrojtja tjetër juridike. Të drejtat që ekzistojnë lidhur me materialin e ngërthyer në bazën e të dhënave dhe të shfrytëzimit të tij mbeten të paprekshme.[197]

2.4.2. Objekti i mbrojtjes

Mbrojtja e bazës së të dhënave në kuptim të këtij kapitulli zbatohet:

1. *ndaj tërë përmbajtjes të bazës së të dhënave;*
2. *ndaj çdo pjese thelbësore kualitative dhe kuantitative, si dhe kualitative ose kuantitative tëpërmbajtjes së saj;*
3. *ndaj pjesëve jothelbësore kualitative dhe kuantitative, si dhe kualitative ose kuantitative të përmbajtjes së saj, kur ato përdoren në mënyrë të përsëritur dhe sistematike, për çka bie ndesh me shfrytëzimin normal të kësaj baze të të dhënave ose me këtë preken së tepërmi interesat ekzistuese të ligjshme të prodhuesit të bazës së të dhënave.*[198]

2.4.3. Të drejtat e prodhuesve të bazave të të dhënave

Prodhuesi i bazës së të dhënave ka të drejtë ekskluzive të lejojë apo ndalojë:

[195] Ligji i Kosovës Nr. 04/L-065, Për të Drejtat e Autorit Dhe të Drejtat **e Përafërta,**, Neni 146.
[196] Ligji Gjerman , I të drejtave të autorit // Krijues i një të drejtave të bazës së të dhënave§ 87,,
[197] **Ligji i Kosovës Nr. 04/L-065, Për të Drejtat e Autorit Dhe të Drejtat e Përafërta,**, Neni 147.
[198] Po aty. Neni 148.1.

1. riprodhimin e bazës së tij të të dhënave;

2. shpërndarjen e bazës së tij të të dhënave;

3. qiradhënien e bazës së tij të të dhënave;

4. vënien e bazës së tij të të dhënave në dispozicion të publikut;

5. çfarëdo formë tjetër të komunikimit të bazës së vet të të dhënave për publikun.[199]

2.4.4. Të drejtat dhe detyrimet e shfrytëzuesve të ligjshëm

Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave ose të ekzemplarit të saj mund të shfrytëzojë lirshëm në mënyrë kualitative dhe kuantitative, si dhe kualitative ose kuantitative, pjesët

përdorë vetëm një pjesë të caktuar të bazës së të dhënave dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm për atë pjesë. Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave ose i ekzemplarit të saj nuk mund të bëjë veprime që janë në kundërshtim me shfrytëzimin normal të asaj baze të të dhënave ose me çka pa arsye do të prekeshin të drejtat e prodhuesit të asaj baze të të dhënave. Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave ose i ekzemplarit të saj nuk mund të shkelë të drejtën e autorit ose të drejtat e përafërta për veprat ose lëndët e ngërthyera në atë bazë të dhënash. Çdo përcaktim kontraktor në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.[200]

2.4.5. Punësimi dhe kontrata e porosisë

Kur baza e të dhënave është bërë nga personi i punësuar duke përmbushur detyrat e tij të punës ose sipas udhëzimeve të punëdhënësit, ose kur është bërë në bazë kontratës së porosisë, supozohet se të gjitha të drejtat për atë bazë të të dhënave i janë kaluar ekskluzivisht dhe pa kufizime punëdhënësit, përkatësisht porositësit, nëse me këtë ligj apo me kontratë nuk parashihet ndryshe.[201]

2.4.6. Kufizimet e të drejtave

Shfrytëzuesi i ligjshëm i bazës së publikuar të të dhënave mund të përdorë lirshëm pjesë thelbësore

të përmbajtjes së saj:

1. *për përdorim privat ose përdorim tjetër të brendshëm, nëse ka të bëjë me bazë jo elektronike të të dhënave;*

2. *për nevojat e ilustrimit të mësimdhënies ose hulumtimeve shkencore, me kusht që të*

[199] Po aty. Neni 149.
[200] Po aty. Neni 150, paragrafi 1,2,3,4.
[201] Po aty. Neni 151.

përmendet burimi, për qëllim jokomercial deri në masën e lejuar me ligj;

3. *për nevojat e sigurimit publik ose për të siguruar ecurinë e drejtë të veprimeve dhe raportimeve në procedurat administrative, parlamentare dhe gjyqësore.*

2.4.7. Kohzgjatja e mbrojtjes

Të drejtat e prodhuesit të bazës së të dhënave zgjasin pesëmbëdhjetë (15) vjet që nga bërja e plotë e saj. Nëse baza e të dhënave është publikuar në mënyrë të ligjshme gjatë kësaj periudhe, të drejtat zgjasin pesëmbëdhjetë (15) vjet që nga publikimi i parë i saj. Çdo ndryshim thelbësor kualitativ dhe kuantitativ si dhe kualitativ ose kuantitativ i përmbajtjes së bazës së të dhënave që rezulton me investim të ri thelbësor kualitativ dhe kuantitativ si dhe kualitativ ose kuantitativ do ta kualifikojë atë bazë të dhënash me kohëzgjatje të re të mbrojtjes. Si ndryshim thelbësor i përmbajtjes konsiderohen edhe shtojcat e njëpasnjëshme, fshirjet ose ndryshimet e tjera të bazës së të dhënave.[202]

2.5. TË DREJTAT E BOTUESVE

E drejta e botuesëve ``duke u bazuar nga Ligji Gjerman`` është e drejtë ekskluzive e një vepre të letërsisë apo muzikës (dmth: material klasës) e riprodhimit dhe përhapjes. Kjo është një pjes e të drejtave të autorit. Autorët normalisht u japin Botuesve të drejtat botuese, të një pune, e cila punë fillon me lidhjen e një kontrate botuese.[203]

Kontratat botuese në këtë kuptim ka për që prej gjysmës së parë të shekullit të 17-të. Në shekullin e 18 ajo ishte e zakonshme për të transferuar të drejtën e pronsis në një kontratë botuese (madje i trashëgueshëm) i dorëshkrimit të botuesve. Përmbajtja e kontratave të hershme botuese ishin ngjitur me të drejtat botuese, sidomos në nivelin e taksave, numri i kopjeve të lira dhe procedurave korrigjim.[204] Procedurat për ribotime u vendosën në shekullin e 18 në kontratat botuese. Por më vonë, kontrata botuese zhvilluar për të rregulluar shpërndarjen ekonomik mes autorit dhe botuesit.

Pronar i të drejtave botuese është autori i parë. Autori mund të caktojë të drejtat botuese te një person tjetër, për shembull, si për një botues. Pronari i të drejtave botuese ka të drejtë të vendosë për formë që do të shtypet libri. Magazinimit elektronik, megjithatë, nuk është i mbuluar nga të drejtat botuese, por kërkon një marrëveshje të veçantë. Përveç të drejtave botuese mund të ekzistojnë të drejtat tjera të pronarit dhe të

[202] Po aty. Neni 153, paragrafi 1,2.

[203] Harald Steiner: *Das Autorenhonorar – seine Entwicklungsgeschichte vom 17. bis 19. Jahrhundert*. Harrassowitz, Wiesbaden 1998, ISBN 3-447-03986-8 (*Buchwissenschaftliche Beiträge aus dem Deutschen Bucharchiv München*, Bd. 59), S. 63–65.

[204] *Harald Steiner: Das Autorenhonorar – seine Entwicklungsgeschichte vom 17. bis 19. Jahrhundert. Harrassowitz, Wiesbaden 1998, ISBN 3-447-03986-8 (Buchwissenschaftliche Beiträge aus dem Deutschen Bucharchiv München, Bd. 59), S. 65.*

drejtat morale në një punë. Botuese e drejtë në kuptim të Ligjit § Gjermanisht 8 Botuese (VerlG) është e drejtë ekskluzive e një vepre të letërsisë apo të muzikës (dmth material klasës) e riprodhimit dhe përhapjen. Kjo është një pjesë e të drejtave të autorit. Autort normalisht japin Botuesve të drejtat botuese në një punë duke plotësuar një kontratë botuese. [205]

2.5.1. E drejta e hises për kompenzim të veçantë

Botuesit kanë të drejtën e hises në kompensim të veçantë nga neni 38 paragrafi 3. i këtij ligji. E drejta nga paragrafi 1. i këtij neni zgjatë pesëdhjetë (50) vjet që nga botimi i ligjshëm i veprës.[206]

2.5.2. Veprat e publikuara në domenin publik

Personi që për herë të parë boton në mënyrë të ligjshme ose i komunikon publikut veprën ende të pa

publikuar dhe e cila bie në domenin publik gëzon mbrojtje të njëjtë siç është për të drejtat pasurore dhe të drejtat tjera të autorit. Të drejtat në kuptimin e paragrafit 1. të këtij neni zgjasin njëzetepesë (25) vjet që nga botimi i parë i ligjshëm, përkatësisht komunikimi i veprës për publikun.[207]

Kreu III

MISIONI I KOMUNITETEVE EVROPIANE LIDHUR ME TË DREJTA E PËRAFËRTA TË AUTORIT

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, dhe në veçanti Neni 211 i tij, gjithashtu duke pasur parasysh formulimin e një komunikate nga komisioni i Bashkimit Evropian në vitin 2014, mbi menaxhimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të lidhur me tregun e brendshëm, parlamenti Evropian më pesmbëdhjetë (15) Janarë 2004 deklaroi se mbajtësit e të drejtave duhet të përfitojë nga mbrojtja e të drejtave të drejtën e autorit dhe të drejtat të përafërta, pavarësisht se ku këto të drejta janë krijuar dhe pavarësisht kufijtë ose metoda e përdorimit për kombët gjatë gjithë jetës së tyre. Parlamenti Evropian më tej theksoi se çdo veprim nga Komuniteti në menaxhimin kolektiv të drejtat kufitare të drejtës së autorit dhe të lidhura duhet të forcojë besimin e artistëve, duke përfshirë shkrimtarët dhe muzikantë, që do të shpërblehet financiarisht përdorimin pan-evropiane të veprave të tyre krijuese.[208] Kështu që për mbrojtjen e të drejtave

[205] *Harald Steiner: Das Autorenhonorar – seine Entwicklungsgeschichte vom 17. bis 19. Jahrhundert. Harrassowitz, Wiesbaden 1998, ISBN 3-447-03986-8 (Buchwissenschaftliche Beiträge aus dem Deutschen Bucharchiv München, Bd. 59), S. 71.*

[206] *Ligji i Kosovës Nr. 04/L-065, Për të Drejtat e Autorit Dhe të Drejtat e Përafërta,, Neni 154, paragrafi1,2.*

[207] Po aty. Neni 155, paragrafi 1,2.

[208] Shiko: http://eur-lex.europa.eu/legal_content/ES/TXT/PDF/?uri=CELEX:32005H0737&from=ENGazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian////Diario Oficial de la Unión Europea

të autorit formulohen rregullore të veqanta për ti mbrojtë kto të drejta kështu që në nenin 14 të rregullores së formuluar nga Bashkimi Evropian thuhet kështu:

``Së pari duhet vazhdimisht të vlerësuar zhvillimin e tregut për muzikë online.``

a) "menaxhimit të drejtës së autorit dhe të drejtave të afërta për dispozitë e ligjshme të shërbimeve online të muzikës në nivel Komunitar "nënkupton ofrimin e shërbimeve të mëposhtme: licencimi i përdoruesit komerciale, verifikimin dhe kontrollin e të drejtave, zbatimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, mbledhjen e të drejtave dhe shpërndarjen e tyre midis bartësve të të drejtave;

b) "Veprat muzikore" nënkupton çdo punë muzikor ose të tjera lëndën e çështjes;

c) "Repertori" katalog i veprave muzikore e cila është administruar nga një menaxher i të drejtave kolektive;

d) "multi-territorial licencë" nënkupton një licencë që mbulon territorin më shumë se një Shtet Anëtar;

e) "menaxher drejtat kolektive" do të thotë çdo person i siguruar shërbimet e përmendura në pikën a) të disa bartësve të drejtat;

f) "Të drejtat linje" do të thotë çdo e Dere mëposhtme zgjodhi

i) të drejtën ekskluzive të riprodhimit që mbulon të gjitha riprodhimet e parashikuara në Direktivën

2001/29 / EC, në formën e kopjeve të paprekshme, e bërë në procesin e shpërndarjes online të punimeve muzikore,

ii) e drejta e komunikimit në publik të një pune muzikore, qoftë e drejtë të lejojë a ndalojë sipas Direktivës 2001/29 / EC ose e drejta për shpërblim të barabartë në përputhje me Direktivën 92/100 / EEC, e cila përfshin

Shërbimet webcasting (webcasting), radio Internet dhe simulcast (simulcasting) ose shërbimet praktikisht "të kërkesës" marrë në një kompjuter personal ose një telefon celular,

iii) të drejtën ekskluzive për të bërë në dispozicion një punë muzikore, në përputhje me Direktivën 2001/29 / EC, e cila përfshin shërbime "të kërkesës" dhe shërbime të tjera interaktive;

g) "bartës i së drejtës" është çdo person fizik ose juridik mban të drejtat në internet;

h) "përdorues komerciale" nënkupton çdo person të përfshirë në ofrimin e shërbimeve online të muzikës i cili ka nevojë për një mbajtësit e të drejtave të licencës për të siguruar servcios ligjore e muzikës online;

i) "marrëveshje reciproke përfaqësimi" nënkupton çdo marrëveshje dypalëshe ndërmjet menaxherëve të të drejtave kolektive nën e cila i jep një menaxher të drejtat kolektive të tjetrit e drejta për të përfaqësuar repertorin e saj në territorin e ky i fundit.[209]

Përfundime

Nga e gjithëpërmbajtja e këtij punimi, mund të themë që ``*E drejta e autorit nuk respektohet në vendet e Ballkanit. E Shqipëria dhe Kosova nuk bëjnë përjashtim nga kjo problematikë, ndaj dhe kohëve të fundit, krahas përmirësimit të legjislacionit, janë ngritur edhe grupe task-forcë, për të kontrolluar vjedhjet e krijimtarisë, ku më problem po rezulton pirateria digjitale.*``

Veli Hoti, zyrtar i lartë për Marka Tregtare dhe Promovime, pjesë e Agjencisë së Pronësisë Industriale në Kosovë, gjatë një seminari që u organizua këtë fundjavë në Tiranë, në një intervistë për KosovaPress, foli për problemet e piraterisë, legjislacionin, kontrollet e shtuara dhe mallrat e konfiskuara së fundmi.``*Ai thotë se Shqipëria dhe Kosova kanë një legjislacion të mirë në këtë drejtim krahasuar edhe me vende të tjerë të Rajonit dhe BE-së, veçse si në shumë sektor të tjerë ne duhet të punojmë me zbatueshmërinë e ligjeve.*``

Për atë që ndodhet në Tiranë, thotë se ka qenë shumë e rëndësishme për Kosovën duke pasur parasysh se kanë qenë edhe vendet e tjera të rajonit si; Shqipëria, Serbia, Mal i Zi, Maqedonia, dhe ekspertët ndërkombëtarë na kanë dhënë disa ligjërata për përvojën evropiane.

"Mendoj që duhet të krahasohemi me vendet evropiane dhe jo me vendet e rajonit për shkak se vendet e rajonit nuk janë aq shumë larg nesh, ka disa vende me të cilat ne jemi më mirë se ato. Ne mund të krahasohemi me disa vende të Evropës, që edhe pse janë vende të BE-së nuk do të thotë se zbatimin e këtyre të drejtave e kanë në mënyrë perfekte, sikurse Gjermania ose Holanda. Ne mund të themi se si Kosovë dhe si Shqipëri, legjislacionin që është me rëndësi e kemi të harmonizuar me direktivat evropiane. Ne tani kemi arritur në atë fazë ku duhet të fokusohemi më tepër në ndërgjegjësimin e qytetarëve tanë, duke iu shpjeguar atyre se mjetet juridike ekzistojnë vetëm se ata duhet ta bëjnë shfrytëzimin. Por ne në Kosovë kemi marrë zotimin se në rast të nënshkrimit të marrëveshjes së stabilizim-asociimit, ne ligjërisht do të mundohemi të krijojmë mbrojtje të njëjtë të kësaj fushe me vendet e BE-së. Por me rëndësi është që për të dyja vendet si për Shqipërinë dhe për Kosovën, me rëndësi është që të fokusohemi në zbatimin e këtyre të drejtave".

[209]Shiko: http://eur-lex.europa.eu/legal_content/ES/TXT/PDF/?uri=CELEX:32005H0737&from=ENGazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian////Diario Oficial de la Unión Europea

"Task-forca në Kosovë ka ndërmarrë disa aksione kohëve të fundit. Neve kemi marrë disa aksione në Prizren. Anëtarët e task-forcës, Policia e Kosovës, inspektorati i tregut dhe zyra për të drejtën e autorit kanë dalë në Prizren, kanë hulumtuar se cilat janë dyqanet të cilat shesin mallra apo produkte të cilat ne mendojmë se shkelin të drejtën e autorit dhe pastaj ditën tjetër kanë vepruar në bashkëpunim me këto institucione të task-forcës, dhe kanë konfiskuar më tepër se sa 3 mijë CD, në Prizren. Pastaj ka pasur raste edhe në Ferizaj; është hulumtuar janë sekuestruar një numër i madh i CD-ve. Këto CD kanë pasur përmbajtje të këngëve, filmave, ose video-lojëra, të cilat task-forca i ka vërejt që këto shiten pa autorizim dhe si rezultat i kësaj ka dalë që ato janë shkelje të së drejtës ë autorit, prandaj janë konfiskuar".

"Ka pirateri. Për shembull, ne në Kosovë kemi disa qendra të fotokopjimit, të cilat i bëjnë fotokopjimet e librave të ndryshëm pa lejen e autorit. Tani çfarë kemi vërejtur ne nga aksionet e task-forcës, ndikim pozitiv ka qenë që shumë fotokopje kanë marrë autorizim nga profesorët që ti fotokopjojnë librat; që i bie që edhe pse qendra fotokopjuese e fotokopjon librin, një pjesë e fitimit të fotokopjes shkon te autori i librit. Si task-forcë në Kosovë tani anëtarët janë fokusuar më tepër më luftimin e piraterisë digjitale, sepse ka shumë uebsajte të cilat ofrojnë linçe apo lidhje të uebsajteve të ndryshme, ku pastaj vërehet se ato vendosin materiale të cilat shkelin të drejtën e autorit për shembull në muzikë apo filma, dhe këtë vit janë identifikuar një numër i madh i ubesajteve. Presim që shumë shpejt këto uebsajte të bllokohen për territorin e Kosovës dhe në bashkëpunim ndërkombëtar edhe serverët e tyre kudo që janë edhe jashtë territorit të Kosovës të bllokohen dhe thjesht të njoftohen institucionet përgjegjëse, ku serverët ilegalë gjenden", bënë të ditur ai. E i pyetur për vjedhjet e këngëve nga vet këngëtarët, tha se kjo është çështje mes këngëtarëve nëse duan ta padisin njëri – tjetrin.

"Praktikisht kjo është më tepër një çështje personale e këngëtarëve, për shkak se kjo ka të bëjë më tepër me të drejtën e performimit, ose e drejta e kopjimit, normalisht. Po kjo pastaj nuk i pëfshin institucionet. Kjo pastaj është çështje e këngëtarëve, mes këngëtarëve, të cilët përmes padisë mund ta padisin njëri-tjetrin për shkelje të së drejtës së autorit siç është vjedhja e këngëve , përndryshe nuk është se task-forca kundër piraterisë mund të angazhohet në këtë çështje për shkak se është çështje mes palëve dhe kjo është në të drejtën civile, pra kjo është çështje që varet nga disponimi i palëve". *Tanimë janë në fazën kur do fillojnë me veprime drastike duke kujtuar që Ligji fillon nga gjoba deri te dënimi me burgim!*.

Bibliografia\

1. Aliu. Abdulla, *E Drejta e Autorit*, Prishtinë 2014;
2. Akti Copyright,,/ Pjesa 3 - Dispozita të veçanta për filma,/ Seksioni 1 - Film Punon,/ Konkretisht në nenin § 94.3 Schutz des Filmherstellers (mbrojtja e producentit të filmit);
3. De Broglie, Gabriel: *Le droit d'auteur et l'internet, Rapport du groupe de travail de l'Académie des sciences morales et politiques,*Paris, 2000;
4. Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian////Diario Oficial de la Unión Europea./- http://eur-lex.europa.eu/legal content/ES/TXT/PDF/?uri=CELEX:32005H0737&from=EN;
5. Gregory. Nicholas``Prodhuesit dhe të drejtat për punën e filmit``Gjermani. 2010;
6. Guillien, Raymond dhe Vincent, Jean: *Lexique des termes juridiques*, Toulouse, 2007;
7. Harald Steiner: *Das Autorenhonorar – seine Entwicklungsgeschichte vom 17. bis 19. Jahrhundert*;

8. Harrassowitz, Wiesbaden 1998, ISBN 3-447-03986-8 (*Buchwissenschaftliche Beiträge aus dem Deutschen Bucharchiv München*, Bd. 59);\
9. Ligji i Kosovës Nr. 04/L-065, Për të Drejtat e Autorit Dhe të Drejtat e Përafërta;
10. Ligji Gjerman , I të drejtave të autorit // Krijues i një të drejtave të bazës së të dhënave§ 87;
OBPI në www.wipo.int,,// Këto informacione mund të gjenden në CLEA bazën me të dhëna të OBPI-së: **http://www.wipo.int/clea/en/index.jsp;**

IDEJA DHE RATIFIKIMI I TRAKTATIT REFORMUES TË LISBONËS

Ma. sc. Refik Latifi

Abstract

EU policies and its success as a European organization are connected with the Treaties establishing (the primary sources of law of the EU), signed since its existence, such as the Treaty of Paris, the Treaty of Rome, the Maastricht Treaty, the Amsterdam Treaty, the Treaty of Nice, then the Constitution for Europe to the Lisbon Reform Treaty. This Treaty is the Institutional Treaty of the European Union, based on the Constitutional Treaty of the EU.

The Lisbon Treaty marks an important step in the road to the European Union towards further consolidation of common values on which it is created. This Treaty gives citizens and parliaments more support in what happens at the European level, and gives Europe a clearer voice and stronger in the world while protecting national interests. With the entry into force of the Lisbon Treaty on 1 December 2009, the European Union can finally conclude a saga over institutional reform, at least for the foreseeable future, but this does not exclude the possibility of further changes to the Regulation the European Union, if in the future it will be necessary for any given point.

Key words: *Union Treaty Reform, Europe, Community, etc.*

Hyrje

Traktati i Lisbonës shënon një hap të rëndësishëm të rrugës së Bashkimit Evropian drejt konsolidimit të mëtejshëm të vlerave të përbashkëta mbi të cilat është krijuar ai. Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, më 1 dhjetor 2009, reformimi dhe modernizimi i institucioneve evropiane bën të mundur promovimin e plotë të objektivave të Bashkimit Evropian në shërbim të qytetarëve dhe shteteve anëtare, si

dhe konsolidon urën lidhëse mes qytetarëve dhe projektit evropian, të nisur në fillim të viteve 50 drejt "pajtimit" dhe "unifikimit" të kontinentit evropian[210].

Në fillim të shekullit 21, jo vetëm në radhët e vendeve anëtare të UE-së por në përgjithësi, në Evropë, vazhduan diskutimet teorike rreth ardhmërisë së Evropës dhe identitetit politik, juridik dhe kushtetutës evropian. Këto debate teorike nuk mbetën pa ndikim nga diskurset zyrtare politike, brenda të cilave dilema kryesore ishte cili do të jetë identiteti politik evropian në shekullin 21?

Padyshim Evropa nuk është vendi që ishte para 50 vitesh, as edhe pjesa tjetër e botës, gjithçka ka ndryshuar. Në një botë që ndryshon vazhdimisht, BE-ja po ballafaqohet me çështje të reja si globalizimi, ndryshimet demografike, ndryshimi i klimës, nevoja për burime të energjisë së qëndrueshme dhe kërcënimet lidhur me sigurinë. Këto janë sfidat që ballafaqohet Evropa në shekullin 21. Shikuar në ecurit e deri tashme, shtetet e BE-së nuk mund t'i arrijnë apo të përballen të vetme me këto sfida, mirëpo veprimi i unifikuar si një trung i vetëm i BE-së mund të ofroj rezultate dhe t'iu përgjigjet brengave të qytetarëve të tërë unionit. Kjo është arsyeja se pse BE-ja duhet të modernizohet. Dihet se më zgjerimet e fundit Unioni ka arritur numrin 28 anëtaresh, dhe paraqitet nevoja për mjete efektive dhe koherente në mënyrë që Unioni t'u rezistoj sfidave dhe ndryshimeve shumë rapide që sot po ndodhin në botë.[211]

Ideja e Traktatit të Lisbonës

Për shkak të procesit të zgjerimit të raundit te pestë me dhjetë ose dymbëdhjetë anëtarë të rinj dhe të pakënaqësive të reformave të sjella nga Nica, u vendos të procedohet me miratimin e një teksti kushtetues evropian, detyra e hartimit të të cilit iu pat besuar nga Këshilli Evropian. Si rezultat i kësaj, më 5 dhjetor 2001 në Laeken (Belgjikë), Shefat e Shteteve ose Qeverive, miratuan një Deklaratë mbi të Ardhmen e Bashkimit Evropian, në të cilën BE-ja pranoi të bëhej më demokratike, transparente dhe efektive dhe të trasonte rrugën për një kushtetutë. Hapi i parë për arritjen e këtij qëllimi ishte themelimi i konventës evropiane, kryesuar nga ish-Presidenti francez, *Valeri Zhiskar d'Esten,* me detyrën për të hartuar kushtetutën evropiane. Më 18 korrik 2003, kryesuesi, në emër të konventës, zyrtarisht ia dorëzoi

[210] *Versioni i Konsoliduar i "Traktatit të Bashkimit Evropian" dhe "Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian"*, botim i Ministrisë së Integrimit Evropian, 2008, f. 5.
[211] Blerim Reka, *Kushtetuta e UE - Rubikoni i Supranacionales*, Logos - A, Shkup, 2007, f. 161.

Presidentit të Këshillit Evropian propozim traktatin e hartuar nga konventa. Ky propozim u miratua, me disa ndryshime të caktuara, nga Shefat e Shteteve ose Qeverive më 17 korrik në Bruksel, pas anëtarësimit të 10 shteteve të reja anëtare më 1 maj 2004 dhe zgjedhjeve për Parlamentin Evropian në mes të qershorit 2004. Kushtetuta kishte për qëllim të kthente Bashkimin Evropian dhe Komunitetin Evropian (të cilët deri atëherë i kishim të njohur), në një Bashkim Evropian të vetëm, të bazuar në një Traktat Kushtetues. Vetëm Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike do të vazhdonte të ekzistojë si komunitet i veçantë, edhe pse do të vazhdonte të asocohet me Bashkimin Evropian Union. Kur shtetet e panë që Kushtetua nuk do të hyje në fuqi, për shkak se u refuzua nga referendumet e mbajtura në Francë dhe Holandë, shtetet u përpoqën të ruanin disa prej çështjeve të saj, por duke u dhenë një formë tjetër. Metoda e zgjedhur për ketë qëllim konsistonte në ruajtjen e traktateve origjinale duke futur në formën e amendamenteve dispozitat kryesore të kushtetutës. Aspektet kushtetuese shuhen, hiqet termi kushtetute, shuhen referencat ndaj përparësisë, hiqet tekstit i kartës së të drejtave, hiqen simbolet e Bashkimit etj.[212]

Pas periudhës dy vjeçare të reflektimit, një pako e re e reformave u iniciua në gjysmën e parë të vitit 2007. Kjo pako reformash përfaqësonte një hap më larg nga ideja e kushtetutës evropiane, nën të cilën të gjitha Traktatet ekzistuese do të revokoheshin dhe do të zëvendësoheshin me një tekst të vetëm të quajtur 'Traktati i themelimit të Kushtetutës për Evropë'. Mirëpo, Traktati Reformues u hartua ashtu si Traktatet e Mastrihtit, Amsterdamit dhe Nicës, të cilat u bënë ndryshime fondamentale Traktateve ekzistuese të Bashkimit Evropian, që forconte kapacitetin e BE-së për të vepruar përbrenda ose jashtë Unionit, për të shtuar legjitimitetin e vet demokratik dhe për të shtuar përgjithësisht efikasitetin e veprimit të BE-së. Në pajtim me traditën, Traktati Reformues u quajt Traktati i Lisbonës. Traktati u hartua jashtëzakonisht shpejt, kryesisht për shkak të faktit se gjatë konkluzave të takimit të Këshillit Evropian më 21 dhe 22 qershor 2007 në Bruksel, Shefat e Shteteve ose Qeverive përcaktuan hollësisht si dhe në çfarë mase duhet të inkorporohen ndryshimet e biseduara gjatë Konferencës Ndërqeveritare 2004, në Traktatet ekzistuese. Qasja e tyre ishte e pazakontë pasi që ata nuk u kufizuan në implementimin e udhëzimeve të përgjithshme nga një Konferencë Ndërqeveritare, por hartuan strukturën dhe përmbajtjen e ndryshimeve që duhej të bëhen, dhe shpesh hartuan terminologjinë e saktë të një dispozite. Pikat kryesore të mosmarrëveshjes ishin ndarja e kompetencave midis Unionit dhe shteteve anëtare, ardhmëria e politikës së përbashkët për siguri dhe punë të jashtme, roli i ri i parlamenteve nacionale në procesin e integrimit, përfshirja e Kartës për të

[212] Jean Paul Jacque, *E Drejta Institucionale e Bashkimit Evropian, Përktheu*: Valbona Nano, Tiranë, 2010, f 21.

Drejta Fondamentale në të drejtën e Unionit dhe progresi i mundshëm në fushën e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor lidhur me veprat penale.[213]

Në nisje të Presidencës Gjermane, në fillim të 2007, Kancelaria Angela Merkel bëri përpjekje për të nxjerrë BE-në nga kriza. Me rastin e përvjetorit të 50 të nënshkrimit të Traktateve të Romës, drejtuesit e shteteve vendosën, që deri në vitin 2009 të përmbyllnin një marrëveshje tjetër. Edhe një herë u zhvilluan bisedime të ashpra, por gjithsesi në qershor të vitit 2007 u ra dakord për linjat e përgjithshme të marrëveshjes. U thirr një konferencë qeveritare, së cilës iu dha një mandat i ngushtë. Pas një kohe relativisht të gjatë konferenca paraqiti një tekst-marrëveshje në tetor të vitit 2007. Dhe Marrëveshja e re u nënshkrua gjatë një seance speciale të Këshillit në Lisbonë në dhjetor të vitit 2007. Përpara se të hynte në fuqi, kjo marrëveshje duhej të ratifikohej nga të gjitha 27 shtetet anëtare dhe Parlamenti Evropian.[214]

Traktati i Lisbonës i njohur fillimisht si Traktati i Reformës, u nënshkrua nga shtetet anëtare të Bashkimit më 13 dhjetor 2007 dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Ai ndryshoi Traktatin e Bashkimit Evropian (TBE) dhe Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian. Traktati Themelues i Komunitetit Evropian tashmë quhet Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Qëllimi i Traktatit ishte të plotësonte procesin e reformës së nisur me Traktatin e Amsterdamit dhe Traktatin e Nicës, me qëllim rritjen e eficencës dhe legjitimitetit demokratik të Bashkimit, si dhe rritjen e koherencës së veprimeve të Bashkimit. Bisedimet për reformimin e Bashkimit Evropian kishin filluar që në vitin 2001 dhe rezultati i parë ishte projekti i Kushtetutës Evropiane, i cili u rrëzua nga referendumet e zhvilluara në Francë dhe Holandë. Më pas, u propozua Traktati i Reformës, në të cilin ndryshimet kryesore përfshijnë heqjen e strukturës me shtylla dhe heqjen e konceptit të Komunitetit, i cili tashmë është zëvendësuar me Bashkimin. Gjithashtu, Traktati i atribuon personalitet juridik Bashkimit Evropian, rrit votimin me shumicë të kualifikuar në Këshillin e Ministrave, rrit përfshirjen e Parlamentit Evropian dhe parlamenteve kombëtare, si dhe rrit rastet e procedurës së vendimmarrjes së përbashkët (tashmë procedura e zakonshme) për miratimin e legjislacionit. Traktati i Lisbonës themelon dy poste të reja, i dyti nga të cilët nuk është krejtësisht i ri. Bëhet fjalë për postet e Presidentit të Këshillit Evropian (me kohë të plotë) dhe Përfaqësuesit të Lartë për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë që është në të njëjtën kohë Zëvendës

[213] Borchardt Klaus Dieter, *ABC - ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian,* Botimi në shqip "Ministria e Integrimit", Tiranë, Shqipëri, 2010, f. 13.

[214] Wolfgang Schumann, *Bashkimi Evropian,* po aty, f. 65.

President i Komisionit si dhe merr përsipër detyrat e Komisionerit për marrëdhëniet e jashtme. Ai kryeson gjithashtu Këshillin e Ministrave të Jashtëm. Traktati i dha efekt ligjor Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian dhe vendosja e rregullave të daljes së një shteti anëtar nga Bashkimi Evropian.[215]

Titulli i plotë i Traktatit quhet "*Traktati i Lisbonës për Ndryshimin e Traktatit të Unionit Evropian dhe Traktatit Themelues të Unionit Evropian".* Traktati i Lisbonës është pra një "Traktat Ndryshues" (Traktat amendamentimi), i cili përbëhet kryesisht nga ndryshimet e miratuara në traktatet ekzistuese, emri i tij zyrtar është për këtë arsye "Traktati i Lisbonës për Ndryshimin e Traktatit të Unionit Evropian dhe Traktatit Themelues i Unionit Evropian, i nënshkruar në Lisbonë më 13 dhjetor të vitit 2007".[216]

Ratifikimi i Traktati të Lisbonës

Në bazë të nenit 6, Traktati i Lisbonës duhet te kishte hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 2009, nëse deri në atë kohë të gjithë dokumentet e ratifikimit do të ishin depozituar pranë qeverisë italiane. Traktati zyrtarisht u nënshkrua nga Shefat e Shteteve apo Qeverive të 27 shteteve anëtare të BE-së, më 13 dhjetor 2007, në Lisbonë. Mirëpo, procesi i ratifikimit për këtë Traktat ishte jashtëzakonisht i vështirë. Edhe pse Traktati i Lisbonës, ndryshe nga Traktati që themelon Kushtetutën për Evropë, u ratifikua me sukses në Francë dhe në Holandë, në fillim u ballafaqua me pengesën e referendumit të parë në Irlandë, më 12 qershor 2008 (53.4% kundër, nga gjithsej 53.1% votues). Vetëm pas një varg garancash ligjore mbi fushëveprimin (e kufizuar) të Traktatit të ri, qytetarët e Irlandës votuan në referendumin e dytë për Traktatin e Lisbonës, në tetor 2009. Këtë herë Traktati fitoi mbështetjen e gjerë të popullatës irlandeze (67.1% për, nga gjithsej 59% votues). Suksesi i referendumit në Irlandë gjithashtu trasoi rrugën për ratifikimin e Traktatit të Lisbonës në Poloni dhe në Republikën Çeke. Në Poloni, Presidenti Kacinski nënshkroi instrumentin për ratifikim, i kushtëzuar nga rezultati i favorshëm në referendumin e Irlandës. Presidenti çek, Vaclav Klaus, po ashtu në fillim deshi të priste referendumin irlandez, por pastaj nënshkroi instrumentin e ratifikimit, të kushtëzuar nga garancia se 'Dekretet Beneš' të vitit 1945, të cilat ndalonin zbritjen në zonat e Republikës Çeke që më parë i takonin Gjermanisë, do të mbeten të paprekura nga Traktati i Lisbonës, dhe sidomos nga Karta e të Drejtave Fondamentale, e përfshirë në Traktatin e BE-së. Pas gjetjes së zgjidhjes për këtë

[215] *Fjalorth për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*, Ministria e Integrimit Tiranë, 2010, f. 156.
[216] *Fletorja zyrtare e Unionit Evropian,* 2007 C /306/01.

kërkesë, Presidenti çek nënshkroi instrumentin e ratifikimit, më 3 nëntor 2009. Kështu, procesi i ratifikimit përfundoi në të gjitha shtetet anëtare (27 shtete), dhe Traktati i Lisbonës hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Traktati i Lisbonës shkriu Bashkimin Evropian dhe Komunitetin Evropian në një Union Evropian të vetëm. Fjala 'Komunitet' zëvendësohet kudo me fjalën 'Union'. Unioni zëvendëson dhe trashëgon Komunitetin Evropian.[217]

Ratifikimi i Traktatit Reformues-Lisbonës nga 27 shtetet anëtare të BE-së, dhe procedurat e ratifikimit nga shtete anëtare:

- Austria-Parlamenti aprovoi më 24 prill të vitit 2008 dhe është kompletuar më 13 maj të vitit 2008, 2/3 me shumicë në të dy dhomat;

- Belgjika-Parlamenti kompletoi më 10 korrik të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë në 7 regjion edhe dhomat federale;

- Bullgaria-Parlamenti aprovoi më 21 mars të vitit 2008 dhe është kompletuar më 28 prill të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë;

- Qipro-Parlamenti kompletoi më 3 korrik të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë (veto e presidentit);

- Republika Çeke-Parlamenti pati vonesa për shkak të Gjykatës Kushtetuese procesi u pezullua që në mes të tetorit të vitit 2007, kurse është aprovuar së pari nga dhoma e ulët më 6 maj, dhe është kompletuar më 3 nëntor të vitit 2009, pasi Gjykata Kushtetuese Çeke përcaktoi se Traktati i Lisbonës nuk është antikushtetues. Në të njëjtën ditë, presidenti Klaus nënshkroi. Me shumicë të thjeshtë apo 3/5 e parlamentit dhe senatit:

- Danimarka-Parlamenti aprovoi më 24 prill të vitit 2008 dhe është kompletuar më 29 maj të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë (mbi 50% e anëtarëve të parlamentit prezent);

- Estonia-Parlamenti ka kompletuar më 11 qershor të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë;

- Finlanda-Parlamenti ka paraqitur në parlament në mars të vitit 2008 dhe është kompletuar më 11 qershor të vitit 2008. 2/3 e shumicës:

[217] Borchardt Klaus Dieter, *ABC - ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian,* Botimi në shqip Ministria e Integrimit, Tiranë, Shqipëri, 2010, f. 14.

- Franca-Parlamenti aprovoi më 6-7 shkurt të vitit 2008 dhe është kompletuar me 14 shkurt të vitit 2008 me Amendament kushtetues, shumicë të thjeshtë në të dy dhomat, dhe 3/5 në kongres:

- Gjermania-Parlamenti aprovoi nga dhoma e ulët më 24 prill dhe nga dhoma e lart më 23 maj të vitit 2008, ratifikimi i kompletuar me shumicë të thjeshtë në të dy dhomat dhe aprovimi i presidentit:

- Greqia-Parlamenti kompletoi më 11-12 qershor të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë;

- Hungaria-Parlamenti aprovoi më 17 dhjetor të vitit 2007 dhe është kompletuar më 6 shkurt të vitit 2008, 2/3 e shumicës;

- Irlanda, me referendum popullor më 12 qershor të vitit 2008, (53.4% kundër, nga gjithsej 53.1% votues), në referendumin e dytë në tetor 2009, fitoi mbështetjen e gjerë të popullatës irlandeze, (67.1% për, nga gjithsej 59% votues, më 15 tetor të vitit 2009 nënshkroi presidentja Meri Mek Alis më Amendament kushtetues dhe është kompletuar më 21-22 tetor të vitit 2009;

- Italia-Parlamenti kompletoi më 8 gusht të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë në te dy dhomat;

- Letonia-Parlamenti Aprovoi më 8 maj të vitit 2008 dhe është kompletuar me 16 qershor të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë;

- Lituania-Parlamenti kompletoi më 8 maj të vitit 2008 më shumicë të thjeshtë;

- Luksemburgu-Parlamenti aprovoi më 20 korrik të vitit 2008 dhe është kompletuar me 21 korrik të vitit 2008 nga Parlamenti me shumicë të thjeshtë;

- Malta-Parlamenti aprovuar më 28 janar të vitit 2008 dhe është kompletuar më 6 shkurt të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë;

- Holanda-Parlamenti kompletoi më 8 korrik të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë në te dy dhomat;

- Polonia-Parlamenti aprovoi më 10 prill të vitit 2008, kurse procesi i kompletuar në parlament dhe qeveri me 10 prill të vitit 2009 u bë nënshkrimi i presidentit më shumicë të thjeshtë apo 3/5 e parlamentit dhe senatit, mbi 50% e anëtarëve të të dy dhomave;

- Portugalia-Parlamenti aprovoi më 23 prill të vitit 2008 dhe është kompletuar më 17 qershor të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë;

- Rumania-Parlamenti aprovoi më 4 shkurt të vitit 2008 dhe është kompletuar 11 mars të vitit 2008 me shumicë të thjeshtë;

- Sllovakia-Parlamenti aprovoi më 10 prill të vitit 2008 dhe është kompletuar me 24 qershor të vitit 2008, 3/5 me shumicë;

- Sllovenia-Parlamenti aprovoi më 29 janar të vitit 2008 dhe është kompletuar me 24 prill të vitit 2008, 2/3 me shumicë;

- Spanja-Parlamenti kompletoi më 15 korrik të vitit 2008 me shumicë absolute nga Kongresi dhe shumicë të thjeshtë në Senat;

- Suedia-Parlamenti procesin e ka filluar më 3 korrik; Parlamenti voton tekstin në vjeshtë 2008 shumicë të thjeshtë;

- Mbretëria e Bashkuar-Parlamenti aprovoi nga dhoma e përfaqësueseve më 11 mars të vitit 2008, kurse u aprovua nga anëtarët e dhomës së Lordëve në verë të vitit 2008 dhe është kompletuar më 16 korrik të vitit 2008, me shumicë e thjeshtë në të dy dhomat.[218]

Traktati i Lisbonës i njohur fillimisht si Traktati i Reformës u nënshkrua nga shtetet anëtare të Bashkimit më 13 dhjetor 2007 dhe hyri në fuqi më 1 dhjetor 2009. Me Traktatin e Lisbonës zhduken temat "Komunitet evropian" dhe "komunitar", ndërsa

Bashkimi Evropian dhe Komuniteti Evropian shkrihen në një Bashkim të vetëm Evropian. Dy aktet juridike ndërkombëtare në përbërje të Traktatit të Lisbonës janë Traktati mbi Bashkimin Evropian dhe Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian që rrjedh prej TKE dhe ka pak a shumë të njëjtën strukturë. Qëllimi i Traktatit të Lisbonës është të kompletojë procesin e reformës së nisur me Traktatin e Amsterdamit dhe atë të Nisës, me qëllim rritjen e efiçencës dhe legjitimitetit demokratik të Bashkimit, si dhe rritjen e koherencës së veprimeve të Bashkimit.[219]

[218] http://www.euractiv.com/en/future-eu/ratifying-treaty-lisbon/article-170245.

[219] *Fjalorth për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*, Ministria e Integrimit Tiranë, 2010, f. 155.

Traktati i Lisbonës, është emërtim i përbashkët për të dy traktatet, të aprovuara në Lisbon më 13 dhjetor 2007 dhe atë: Traktati mbi Unionin Evropian (TEU) dhe Traktati mbi Funksionimin e Unionit Evropian (TFEU) kanë bazën e njëjtë juridike.[220]

Mirëpo, TEU dhe TFEU nuk kanë natyrë kushtetuese. Terminologjia e përdorur në Traktate, në përgjithësi reflekton këtë ndryshim të qasjes nga propozimi i mëparshëm i kushtetutës. Shprehja 'kushtetutë' nuk përdoret më; 'ministri i jashtëm i BE-së' tani thirret 'Përfaqësues i Lartë i Unionit për Politikë të Punëve të Jashtme dhe Sigurisë'; dhe definicionet për 'ligj' dhe 'ligj kornizë' janë braktisur. Traktatet e ndryshuara nuk përmbajnë as artikuj që u referohen simboleve.

Traktati i Lisbonës gjithashtu braktis 'tre shtyllat' e BE-së. Shtylla e parë, e cila përbëhet kryesisht nga tregu i vetëm dhe politikat e Komisionit Evropian, bashkohet me shtyllën e dytë, që përbëhet nga politika e punëve të jashtme dhe sigurisë, dhe shtylla e tretë, e cila përfshin bashkëpunimin policor dhe gjyqësor lidhur me veprat penale. Megjithatë, procedurat speciale që kanë të bëjnë me politikën e punëve të jashtme dhe të sigurisë, përfshirë këtu edhe mbrojtjen evropiane, mbeten në fuqi; deklaratat e Konferencës Ndërqeveritare të bashkangjitura në Traktat theksojnë natyrën e veçantë të kësaj fushe dhe sidomos përgjegjësitë e Shteteve Anëtare në këtë aspekt.[221]

Me hyrjen në fuqi të Traktatit Reformues-Lisbonës nga 27 shtetet anëtare të BE-së, do të përmbyllej faza e integrimit politik evropian e filluar në vitin 1999 me Konventën për Kartën e të Drejtave Themelore të UE-së pastaj me Traktatin e Nicës (2000), me Deklaratën e Lakenit (2001), me Konventën për të Ardhmen e Evropës (2002-2003), Traktatin për krijimin e Kushtetutës për Evropën (2004), referendumet negative në Francë dhe Holandë (2005) dhe periudhën e ashtuquajtur të reflektimit (2005-2007).[222]

Konkluzione

Si përfundim mund të themi se Traktati i Lisbonës paraqet vetëm një dokument bazë, i cili tenton t'u jep kahe zgjidhjes së problemeve me të cilat ballafaqohet BE-ja, mirëpo se si kjo do të realizohet në praktikë,

[220] Official Jurnal of the UE, C115, Vol, 51, 9, May, 2008.

[221] Profesor Borchardt Klaus Dieter, *ABC - ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian,* Botimi në shqip Ministria e Integrimit, Tiranë, Shqipëri, 201, f. 16.

[222] Andrew Duff, *True Guide to the Treaty of Lisbon" (ALDE),* 2008, f. 13.

varet nga shume faktorë dhe nga sjellja e shteteve në drejtim të respektimit të dispozitave të Traktatit. Megjithatë, edhe ky dokument nuk ka arritur të jetë i përsosur për t'u ballafaquar me të gjitha problemet reale, ndërsa për të gjitha problemet tjera që do të paraqiten gjatë kohës, do të duhet të ndërmerren edhe hapa të mëtejshme në plotësimin e dispozitave të tij në të ardhmen. Me ndryshimet e fundit sfida më e madhe e BE-së është përhapja e paqes dhe sigurisë përtej kufijve të Bashkimit Evropian. Për të tejkaluar këtë sfidë, BE-ja zhvillon një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë, ashtu që të mund të veprojë si një forcë për stabilitet, bashkëpunim dhe mirëkuptim në botë.

Në fund, BE-ja dëshmon sesi vendet munden që me sukses t'i bashkojnë resurset ekonomike e politike për interesa të përbashkëta. Ai shërben si model i integrimit ndërmjet vendeve në regjionet tjera të botës.

Referenca:

1. *Versioni i Konsoliduar i "Traktatit të Bashkimit Evropian" dhe "Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian"*, botim i Ministrisë së Integrimit Evropian, 2008.
2. Jean Paul Jacque, *E Drejta Institucionale e Bashkimit Evropian, Përktheu*: Valbona Nano, Tiranë, 2010.
3. Blerim Reka, *Kushtetuta e UE - Rubikoni i Supranacionales*, Logos - A, Shkup, 2007.
4. Borchardt Klaus Dieter, *ABC - ja e së Drejtës së Bashkimit Evropian*, Botimi në shqip "Ministria e Integrimit", Tiranë, Shqipëri, 2010.
5. Wolfgang Schumann, *Bashkimi Evropian*, 2006.
6. *Fjalorth për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*, Ministria e Integrimit Tiranë, 2010.
7. *Fletorja zyrtare e Unionit Evropian*, 2007 C /306/01.
8. *Fjalorth për Integrimin Evropian, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit Evropian*, Ministria e Integrimit Tiranë, 2010.
9. Official Jurnal of the UE, C115, Vol, 51, 9, May, 2008.
10. Andrew Duff, *True Guide to the Treaty of Lisbon" (ALDE),* 2008.
11. http://www.euractiv.com/en/future-eu/ratifying-treaty-lisbon/article-170245.

SISTEMET ZGJEDHORE DHE NDIKIMET E TYRE NË SISTEMIN POLITIK

(ELECTORAL SYSTEMS AND THEIR IMPLICATI ON THE POLITICAL SYSTEM)

Mr. Muaz Agushi[223]

UDC: 316.334.3:324(497.7)

Abstract

The election process takes place according to different legislative regulative, depending on the specifics and conditions where they are organising and also depending on the types of laws, number of voters, political system, government, etc.

The election system and the practical development of the elections, should not, under any circumstance, discriminate the voters and different political groups. Organisingfair, free and correctelectionsthat gives to all the political parties equal possibilities of being voter from the voters and also that does not discriminate different political groups, is one of the main and most important requirements of democracy.

Also free and democratic elections represent the central institution of democratic systems. This is claimed as a result of the fact that the government and the power of state should be based only in the free will of the voters who elect the government and the state institutions.

Free and democratic elections make sure that there is competition between political groups and also offer options and more political alternatives. European societies, and not only them, have continuously tried to build a stable and promising democracy, also transparent and based on consolidated rules and laws.

Therefore, democratic elections offer political pluralism and create possibilities for political ,,war,, of political parties aiming to taking place, participate in the state structure and be part of the state government. In democracy, there are nopermanent mandates . This means that all the state departments and government have temporary mandate . Free elections also give possibility to the citizens to directly take part on the political decision making.

[223] PHD cand. South East Europian University, Tetovo - Macedonia

Keywords: political system, democratic systems, political parties, government, election process.

Organizimi dhe administrimi i zgjedhjeve

Në përcaktimet për demokracinë përfaqësuese, zgjedhjet kanë rol qendror. Koncentrimi i vullnetit politik nëpërmjet përfaqësimit vërtetohet nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhje. Zgjedhjet, gjithmonë u referohen agjendave politike, me një fjalë atyre agjendave të cilat, reflektojnë gjendjen dhe pozitën e institucioneve. Zgjedhjet, varësisht nga natyra e tyre, u referohen po ashtu, edhe faktorë relevantësiç janë isntitucionet kryesore (Presidenca, Parlamenti etj.) si dhe rregullave e ligjeve, bashkëpunimit, aktiviteteve të caktuara etj.

Organizimi, administrimi i zgjedhjeve, si dhe operacionalizimi i tyre, janë elementet kruciale dhe qendrore të zgjedhjeve. Detyrat dhe objektivat e punës, si edhe për secilin institucion të organizuar, përfshihen mbi bazën e procedurave të caktuara dhe të detyrave specifike. Organizimi dhe implementimi i një procesi, për rrjedhoj, bëhet në bazë të komponenteve organizative, dhe "këto komponente, janë: detyrat, autoriteti, përgjegjësia, teknologjia, marrëdhëniet etj." [224]

Procesi zgjedhor, asnëjherë nuk është i lehtë për t'u zbatuar. Në procesin e organizimit të zgjedhjeve, padyshim që shtrohen detyra të shumëta, si për institucionin që ato i organizojnë po ashtu, edhe për institucionet, subjektet politike garuese, kandidatët, partitë politike, vëzhguesit, votuesit, mediat, shoqatat civile etj. Teoricientët dhe studiuesit vlerësojnë se, pavarësisht se "cili organ i shpallë ato, kryetari i parlamentit apo presidenti i republikës, në vendimin për shpalljen e zgjedhjeve, caktohet afati brenda të cilit duhet të zhvillohen aktivitetet parazgjedhore, si dhe dita kur duhet të zhvillohen ato".[225]

Ndër kërkesat kryesore të demokracisë, është e drejta e votës dhe liria e fjalës dhe organizimit për të gjithë. E drejta e votës, lira e fjalës dhe e organizimit politik vlerësohen se, janë ndër kategoritë kryesore të demokracisë. Përmes inkurajimit dhe zhvillimit të këtyre kategorive, zgjedhjet promovojnë konkurencën politike mes subjekteve politike garuese. Në çfarë mënyre zgjedhjet e promovojnë konkurrencën politike? Pse e drejta e votës është ndër kërkesat kryesore të demokracisë?

Zgjedhjet, konsiderohen si alternativë apo mekanizëm për shmangien e oligarkisë. Përfaqësimi i shoqërisë, bazuar në sistemin zgjedhor që mundëson qeverisje më të denjë përfaqësuese, ndikon në funksionalizimin e institucioneve, dhe në shprëndarjen e pushtetit: nga një grup relativisht i vogël njerëzish me interesa të ngushta, te një grup shumë më i gjerë i cili, është zgjedhur me votën e popullit. Oligarkia, është formë e qeverisjes autarkike ku pushteti përqëndrohet te një

[224] Kasimati, Mimoza, Manxhari, Mimoza, Sjellje organizative. Tiranë, 2005. fq. 198-199.
[225] Haxhiu, Sadik, Zgjedhjet, Sistemet zgjedhore dhe Proceset zgjedhor (Aspekti juridik, politik dhe krahasuese). Kapitulli XI: Shpallja dh eadministrimi i zgjedhjeve, fq. 319.

rreth i ngushtë i njerëzve, të cilët në shumicën e rasteve janë njerëz të pasur. Kështu, "shoqëria duhet të ketë shumëllojshmëri mendimesh për t'ju kundërvënë qeverisjes nga një grup i vogël (oligarkisë) dhe për t'u siguruar që zgjedhësit të kenë shumë alternativa kur të votojnë"[226].

Shoqëria demokratike, duhet të promovojë konkurrencën e lirë të votës, me një fjalë, vullnetin e shoqërisë. Partitë, duhet të luftojnë për zgjedhësit pa pengesa dhe në kushte të njëjëta. Sistemi i zgjedhjeve dhe ecuria praktike e zgjedhjeve, nuk duhet të diskriminojë zgjedhësit dhe grupimet politike. Pikëpamjen se, organizimi i zgjedhjeve të lira të cilat u ofrojnë partive politike mundësi të barabarta te zgjedhësit, dhe që nuk diskriminojnë grupimet politike, është ndër kërkesat kryesore të demokracisë në shkencën politike e promovon për herë të parë, Robert A. Dahl[227].

Gjithashtu, zgjedhjet e lira, të drejtpërdrejta dhe demokratike paraqesin institucion qendror të sistemeve demokratike. Kjo sepse, autorizimet e pushtetit duhet të bazohen vetëm në vullnetin e atyre që zgjedhin organet e pushtetit.

Zgjedhjet e lira dhe demokratike, sigurojnë konkurencën midis subjekteve me opsione dhe alternativa të ndryshme politike. Pra, zgjedhjet demokratike afirmojnë pluralizmin politik dhe krijojnë hapësirë për *'luftën'* politike të partive politike, me qëllim të marrjes, të ruajtjes apo participimit në strukturën e pushtetit shtetëror. Në demokraci, nuk ka mandate të përhershme. Kjo nënkupton faktin, që të gjitha organet dhe bartësit e pushtetit shtetëror, marrin mandatin për intervale të kufizuara kohore. Përpos këtij aspekti, zgjedhjet nuk janë vetëm formë e legjitimimit të pushtetit politik, por edhe formë përmes së cilës qytetarët marrin drejtpërdrejt pjesë në vendimet politike.

Brenda bashkësive të cilat janë të shtrira jashtëzakonishtë shumë në aspektin horizontal, ku konkurrenca e grupeve drejt majave të pushtetit politik është e madhe për t'u diferencuar, zgjedhjet janë mekanizmi që ofrojnë këtë diferencim në mënyrën demokratike dhe paqësore. Përderisa, "në shtetet totalitare ky diferencim bëhet përmes formave tjera jo demokratike, siç janë puqet e shtetit ose grusht shtetet, diferencimi nga kontributet që ai grup ka dhënë për bashkësinë, apo diferencimi nga faktori i trashëgimisë që karakterizonte shtetet me sistem monarkik të qeverisjes, në demokraci diferencimi ndodh në bazë të zgjedhjeve të drejtpërdrejta, të kufizuara në aspektin kohor, dhe të lira"[228].

---

[226] Kval – Mellbye – Tranoy, Politika dhe Demokracia, Prishtinë, 2006. Fq. 18.

[227] Feraj, Hysamendin, Shkenca Politike (Një Hyrje), Tiranë, 2004. Fq. 21.

[228] Më shumë rreth diferencimit të elitave qeverisëse nga shtrirja horizontale në shtetet me sistem totalitar të qeverisjes (fashizmit dhe komunizmit), shih: Llambro Filo, Historia për Sistemet e Qeverisjes, Extra, Tiranë, 2003. Në këtë libër, Llambro Filo shqyrton mënyrën se si është ngritur në pushtet Hitleri në Gjermani, apo Stalini në Bashkimin Sovjetik. Diferencimi i këtyre njerëzve është bërë përmes metodave jo demokratike, grabitjes së pushtetit nga Hitleri në Gjermani, apo përmes luftërave brenda Partisë Komuniste nga Stalini në Bashkimin Sovjetik.

Nga zhvillimi i proceseve zgjedhore, burojnë institucionet qeverisëse të shtetit. Zgjedhjet janë mekanizmi kryesor që mundësojnë nxjerrjen e një elita politike, e cila merr përgjegjësinë për qeverisje me shtetin në afat të kufizuar kohor. Nxjerrja e një elita politike e cila qeverisë me shtetin, është vlera kryesore e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Pse zgjedhjet kanë edhe dimensionin e burimit kryesor të institucioneve qeverisëse? Ku qëndron argumenti i disa teoricienëve të cilët mendojnë se, zgjedhjet janë edhe si procedurë për ngritjen e institucioneve qeverisëse? Cila është ideja e Sartorit lidhur me kuptimin vertikal të zgjedhjeve?

Në kontekst të mëtejmë të studimit të problemit, rrjedhimisht, si pasojë e kësaj rrethane, zgjedhjet marrin kuptimin e qasjes, metodës apo procedurës. Ky aspekt, domethënë zgjedhjet si procedurë e ardhjes në pushtet, i japin atributin e vërtetë atyre: atributin demokratik. Ky aspekt, mund të kuptohet më mirë në kontekst të përkufizimit që jep për zgjedhjet Sartori. Por, cili është kuptimi i zgjedhjeve të lira në demokraci? Giovanni Sartori, filozofi italin i demokracisë, pohon se, "ndërtimi vertikal i demokracisë mbështetet në zgjedhjet e lira, të përsëritura kohe pas kohe dhe konkuruese ndërkaq që , pikërisht në zgjedhjet kemi jo vetëm zbatimin vendimtar po edhe të plotë të 'sundimit të shumicës' dhe si sundim konkret edhe si rregull loje"[229].

Zhvillimet politike bashkëkohore që i referohen integrimeve transnacionale kontinentale, nxjerrin në pah një model tjetër të zgjedhjeve. Ky model i zgjedhjeve, i referohet institucioneve transnacionale siç është Bashkimi Evropian. Parlamenti Evropian, si institucion i BE-së, legjitimitetin e vet që prej vitit 1979, e merr nga qytetarët. Qytetarët e shteteve anëtare të BE-së, zgjedhin drejtpërdrejt anëtarët e Parlamentit Evropian. Fushëveprimtaria e Parlamentit Evropian shtrihet tek përgjegjësitë transnacionale, sidomos në fushën ekonomike dhe në atë të drejtësisë. Pra, "për dallim prej zgjedhjeve brenda një shteti ku qytetarët zgjedhin deputet në organin legjislativë që kanë mandat për të shqyrtuar çështje në nivel nacional; deputetet e Parlamentit Evropian kanë mandat për të vendosur vetëm për çështje që i referohen kompetencave transnacionale[230].

Padyshim, zgjedhjet për Parlamentin e Bashkimit Evropian, janë një fenomen i ri në teoritë akademike lidhur me zgjedhjet. Për herë të parë kemi rastin kur qytetarët zgjedhin deputetët të cilët nuk kanë mandatë për të vepruar për të gjitha çështjet (vetëm për kompetencat transnacionale), bartin sovranitet të kufizuar dhe dalin përtej kontekstit nacional.

Shoqëria e organizuar, nënkupton shoqërinë shtetërore. Por, prej nga lindë pushteti ? Prejardhja e pushtetit, buron nga lloji i sistemit politik të cilin, e përdorë shoqëria e caktuar, apo shteti i caktuar. Në demokraci, pushteti buron nga vullneti i lirë i popullit, dhe ky vullnet, kryesisht vjen nga sistemi pluralist që mbështetet në zgjedhje të lira, të drejta, të pa anshme, demokratike. Prandaj, në proceset zgjedhore kanë rëndësi jo vetëm mënyra e zbatimit të zgjedhjeve, por,

[229] Sartori, Giovanni, Edhe një here për teorinë e demokracisë. Tiranë, 1998. F-148.

[230] Ëessels, Ëolfgang, Evropa prej A deri në ZH (origj: Europa von A bis Z Taschenbuch der europaischen Integration), Prishtinë, 2004.

sidomos fakti i përdorimit të sistemit zgjedhor meqë, nga zgjedhjet buron edhe pushteti legjitim: i dalë, nga vota e lirë e popullit.

Sistemet zgjedhore, përparësit dhe të metat

Për ta kuptuar më mirë rëndësinë e sistemeve zgjedhore, është e udhës që të bëhen krahasime në mes të sistemeve zgjedhore, për t'i parë përparësitë dhe të metat e tyre. Sistemi mazhoritar ose i shumicës, është një nga sistemet zgjedhore, i cili për herë të parë është zbatuar në qeverisjen parlamentare. Numri i shteteve që e aplikojnë këtë sistem, është i theksueshëm. Prandaj, cilat elemente më shumë e veçojnë këtë sistem, ndryshe nga sistemet e tjera elektorale.

Sistemi mazhoritar, i përdorë në proceset zgjedhore, zonat e vogla zgjedhore, përkatësisht zonat e vogla elektorale në krahasim me sistemin e proporcional me lista të mbyllura, sipas të cilit sistem, zakonisht vjen në përdorim një zonë e vetme elektorale (me zona elektorale me nominime të një kandidati).

Zbatimi i këtij sistemi, është model i modifikimit të procesit dhe zbatimit të tij: mes sistemit mazhoritar, dhe atij të pastër - proporcional. Ky sistem, ka edhe të tjera prioritete. E zvogëlon në masë shumë të madhe faktin e votave eventuale të dështuara. Ky sistem, po ashtu, u hapë rrugë partive politike dhe grupeve të tjera, veçanërisht pakicave nacionale për t'u bërë pjesë e parlamentit. Si shembull, e marrim Kosovën. Ky shtet i ri, e aplikon këtë sistem gjë që ka mundësuar në masë të madhe që parlamenti, të jetë i përfaqësuar nga pothuajse të gjtha nacionalitetet, dhe të jetë heterogjen edhe nga aspekti i përfaqësimit partiak. Por, kur është fjala për përfqësimin e nacionaliteteve, duhet kujtuar që vendet e rezervuara për komunitetin serbë, i ka garantuar Korniza Kushtetutese e Ahtisarit. Dhe sipas një ligji të pashkruar, në Kuvendin e Kosovës, vazhdimisht formohet një grup parlamentar që quhet "6 plus" dhe i cili, kushtimisht formohet nga deputetët minoritar, dhe ky koalicion mundëson përfaqësim të gjerë dhe të oarganizuar parlamentar.

Si konstatim, mund të themi se, të tri këto sisteme zgjedhore, kanë anët e tyre pozitive dhe negative. Sistemi mazhoritar, eliminon nga skena politike partitë politike me numër të vogël të votuesve, diskriminon minoritetet në zgjedhje në kuptimin e mandateve, dhe krijon një numër të madh të votave të dështuara. Sistemi gjysmë proporcional, në një anë favorizon sistemin mazhoritar me zona të vogla elektorale, kurse në anën tjetër sistemin proporcional zgjedhor, ku ndërprehet lidhja e deputetit nga zona elektorale, sepse deputeti nuk është përgjegjës para elektoratit të një zone, por përpara organeve më të larta të partisë së tij, e cila e ka propozuar në listën zgjedhore. Sistemi proporcional zgjedhor, i dobëson lidhjet me zonat elektorale, krijon një parlament mjaft heterogjen, ku një parti e ka të vështirë për ta fituar shumicën parlamentare. Me këtë, imponohet mjaft shumë nevoja që të krijohet një qeveri në përbërje të përfaqësuesve të partive të ndryshme politike me ide dhe synime të ndryshme. Kështu, domosdo duhet të krijohet një qeveri e koalicionit.

Në përgjithësi, të tri këto sisteme kryesore elektorale, përbëjnë bazën demokratike të organizimit dhe të implementimit të procesve zgjedhore. Shtetet që i kemi përzgjedhur si model krahasues, nuk ofrojnë ndoshta praktikat më të mira, meqë, siç u tha edhe më lart, vendimet për zbatimin e sistemeve të tilla zgjedhore në këto shtete, mund të mos kenë qenë detyrimisht të motivuara për përshtatshmërinë e tyre, por të kenë qenë të motivuara nga agjenda të caktuara politike.

Llojet e ndryshme të sistemeve, kanë specifika të veçanta që synojnë arritjen e objektivave të ndryshme. Sistemet proporcionale mund të organizohen në atë formë që, deputetët të zgjedhën përmes listave rajonale nëpër zona zgjedhore, në mënyrë që përgjegjësia e deputetit të lidhet me një komunitet të caktuar.

Listat e hapura, u mundësojnë qytetarëve përzgjedhjen e kandidatëve të preferuar brenda listës së partisë. Sistemet proporcionale, dallojnë edhe për nga format e numërimit të votave dhe ndarjes së mandateve. Në teori, llojet e sistemeve zgjedhore variojnë prej atyre të pastra proporcionale kombëtare, ku përqindja e votës kombëtare për një parti përkthehet me përqindje të njëjtë mandatesh në parlament, nëpër ato mazhoritare.

Nuk ekziston një mënyrë e duhur e krijimit të sistemit elektoral. Porse, procedurat e organizimit dhe të implementimit të procesve zgjedhore, duhet t'u përshtaten nevojave shoqërore dhe shtetërore, pra interesit të përgjithshëm. Në këtë drejtim, gjithnjë ka vend për ndryshime dhe reformime të sistemit zgjedhor. Shtetet, mundohen që sistemin e tyre zgjedhorë ta hartojnë në mënyrë që, ai të jetë sa më funksional për shoqërinë.

E përbashkëta e disa shteteve (Shqipëria, Maqedonia, Kroacia etj.) përdorin sisteme proporcionale me më shumë se një zonë zgjedhore, ku çdo zonë dërgon në parlament një numër të caktuar deputetësh. Disa shtete, kanë formuar kufijtë e zonave elektorale në mënyrë arbitrare mbi bazën e ligjit për zgjedhjet, duke krijuar zona me numër të përafërt ose të barabartë votuesish të cilat zona, dërgojnë përafërsisht numër të njëjtë deputetësh në parlament. Përkthimi i përqindjeve të fituara nga partitë nëpër zona në mandate parlamentare, bëhet përmes formulave të ndryshme. Kroacia, Shqipëria dhe Maqedonia përdorin formulën "D'hondt", ndërsa Sllovenia atë "Droop Quota".

Në shumicën e rasteve, si në Kroaci, Shqipëri dhe Maqedoni, kandidatët futen në parlament përmes listave të mbyllura të paracaktuara mëherët nga partitë politike. Vetëm në Sllloveni, aplikohet sistemi me listë të hapur, e ku votuesit mund të zgjedhin një kandidat të preferuar nga lista e partisë dhe kandidatët me më së shumti vota arrijnë të futen në parlament. Të gjitha shtetet, përveç Maqedonisë, kanë prag zgjedhor të cilat partitë dhe koalicionet duhet ta kalojnë në çdo zonë zgjedhore për të fituar mandate: Kroacia 5%, Sllovenia 4%, Shqipëria 3% për partitë, dhe 5% për koalicionet. Ndërkohë, të gjitha shtetet, përveç Kroacisë, kanë edhe kuota për përfaqësimin e femrave në listat zgjedhore: Sllovenia 25%, Maqedonia 30% dhe Shqipëria 30%. Sistemet zgjedhore të Shqipërisë dhe Maqedonisë nuk kanë masa të diskriminimit pozitiv ndaj pakicave etnike.

Në anën tjetër Kroacia, këtë çështje e rregullon duke krijuar një zonë të veçantë zgjedhore jo-gjeografike ku partitë e pakicave shtyhen për 8 ulëse të garantuara në Kuvend. Votuesit e pakicave duhet të zgjedhin nëse duan të votojnë në garën brenda zonës së tyre gjeografike, apo në zonën speciale të pakicave. Në anën tjetër, Sllovenia e ka të rezervuar nga një mandat parlamentar për pakicat hungareze dhe italiane. Këta deputetë zgjedhën përmes një procesi special zgjedhor, e ku votojnë vetëm pjesëtarët e këtyre pakicave.

Shqipëria dhe Sllovenia nuk kanë ndonjë sistem për përfshirjen e diasporës në zgjedhjet parlamentare. Kroacia, në anën tjetër, e ka një zonë të veçantë jo-gjeografike për diasporën prej ku mund të dalin deri në 12 mandate parlamentare, varësisht nga dalja e diasporës në zgjedhje. Maqedonia i rezervon tre vende për deputetë të diasporës, nga një për çdo kontinent/rajon gjeografik ku ky shtet ka diasporë.

Pasojat e zakonshme: Formula “D'Hondt” favorizon partitë ose koalicionet e mëdha (që mund të jenë dy ose tre, varësisht nga shteti), dhe dëmton partitë më të vogla. Megjithatë, efekti i keq ndaj partive të vogla zvogëlohet në rast se zonat janë më të mëdha, dhe ofrojnë më shumë mandate, gjë që u jep më shumë rast partive të vogla të fitojnë mandate nëpër zona.Formula “Sainte-Laguë”: Sipas kësaj formule, ndarja e mandateve bëhet në mënyrë proporcionale me anë të koeficientit. Numri total i votave të partisë, pjestohet me numrin e vendeve të cilat partia i ka të ndara, që fillimisht është zero për të gjitha partitë. Partia me koeficientin më të lartë, merr vendin e radhës dhe pastaj i rikalkulohet koeficienti i ri, deri sa të alokohen të gjitha mandatet. Sikurse edhe formula “D’Hondt”, me anë të kësaj metode favorizohen partitë e mëdha.

Formu;a “Droop quota”: Është metodë e disejnuar në mënyrë që të pamundësojë që kandidatët të arrijnë kuotën, pasi numri i mandateve është plotësuar. Pasojat e zakonshme: E meta më e madhe e përdorimit të kësaj formule, është transferi i votave nga një kandidat në kandidatin pasardhës, duke lejuar që mandatet të fitohen edhe nëse kuota nuk është arritur nga vet kandidati.

Përfundimi

Zgjedhjet, janë në radhë të parë burim i legjitimitetit politik të institucioneve politike të shtetit. Nga zgjedhjet, edhe buron legjitimiteti i institucioneve të cilat marrin përgjegjësi për qeverisjen e shtetit. Ky, padyshim që është dimensioni i parë më i rëndësishëm i zgjedhjeve.

Ndërtimi dhe zbatimi i këtyre parimeve, është bërë i mundshëm vetëm me luftën e përhershme shoqërore, dhe me ndërtimin e shtetit të së drejtës. Prandaj, vetëm përmes zgjedhjeve të lira, behet e mundur të transmetohet drejtpërdrejt vullneti politik i popullit në pushtetin shtetëror. Meqë vullneti zgjedhor, e shpreh bindjen dhe edukatën elektorale, në kushtet e demokracisë përfaqësuese, çfarë e aplikojnë shumica e shteteve me statusin e demokracive post-industriale, është e pamundur që qytetarët drejtpërdrejt të qeverisin me pushtetin shtetëror, atëherë aplikohet demokracia përfaqësuese, dmth., kur qytetarët e bartin vullnetin e tyre sovran te një grup përfaqësues i njerëzve.

Mirëpo, është fakt i pamohueshëm se organizimi i zgjedhjeve është në tërësi në duart e shtetit. Për ketë arsye, zgjedhje të lira dhe demokratike nuk mund të organizohen në çdo sistem. Në shtetet jodemokratike, organizimi i zgjedhjeve të lira dhe demokratike është një ideal pothuajse i paarritshëm. Në këto shtete, elita politike e cila qeverisë me shtetin i organizon zgjedhjet në përputhje me interesat dhe qëllimet e saja në mënyrë që vet të jetë fituese e këtyre zgjedhjeve.

Zgjedhjet janë mekanizmi kryesor që mundësojnë nxjerrjen e një elita politike, e cila merr përgjegjësinë për qeverisje me shtetin në afat të kufizuar kohor. Nxjerrja e një elita politike e cila qeverisë me shtetin, është vlera kryesore e zgjedhjeve të lira dhe demokratike.

Literatura

Arsim Bajrami, "Parlamentarizmi (Aspekte krahasuese)". Kapitulli IX: Sistemet Parlamentare në Demokracitë e Zhvilluara. Kolegji Fama. Prishtinë, 2010.

Arsim Bajrami, "Teoria dhe Praktikat Parlamentare (Ligjërata të autorizuara)". Fakuletit Juridik i Universitetit të Prishtinës. Prishtinë, 1997.

Etem Haziri, "Partitë Politike, Zgjedhjet dhe Sistmet Zgjedhore". Tetovë , 2015.

Etem Aziri, "Sistemet politike". Tetovë, 2012

Giovanni Sartori,"Ç'është demokracia", Dituria, Tiranë, 1998.

Giovanni Sartori, "Edhe një here për teorinë e demokracisë", Dituria, Tiranë, 1998

Manfred Schmidt, "Teoritë e demokracisë", Botim Universitar, Tiranë 2012.

Mimoza Kasimati, Mimoza Manxhari, "Sjellje organizative", SHBLU. Tiranë, 2005

Sadik Haxhiu, "Zgjedhjet, Sistemet zgjedhore dhe Proceset zgjedhor (Aspekti juridik, politik dhe krahasuese)". MASHT. Prishtinë, 2013.

Manual International IDEA për hartimin e sistemeve elektorale (Information Division).

Partitë politike shqiptare në Maqedoni dhe rroli i tyre

(Albanian political parties in Macedonia and their Role)

METALI ALILI

QASHIF BAKIU

UDC: 316.334.3:329) : 316.663 (497.7: =18)

ABSTRACT

In this scientific work is treated the flow of the process of the political pluralism in the Republic of Macedonia. Also a special accent is puted in the foundation of the first political parties and they'r role in the periods in wich they acted. The analysis also includes the development of Albanian political parties, they'r fragmentation, respectively the creation of the new subjects, which appear as a result of certain process within the oldest parties. Also are treated two types of statutory elements, which differs or makesAlbanian political parties similar. In the paper also is treated the element of creation of the ideological profile at the political parties. In focus are putted also the new elements which appear with the emergence of the new political subjects.

Key words: Political parties, political platform, political pluralism etc...

Shqiptarët ishin ndër të parët të cilët protestuan për heqjen e sistemit një ideologjik, duke u përcaktuar pro pluralizmit politik. Këtë element mund ta përforcoj edhe fakti se në periudhën e federatës jugosllave, një numër mjaft i madh i të burgosurve politik në Republikën e Maqedonisë, ishin të dënuar pikërisht për vepra penale kundër ideologjisë komuniste. Të pozicionuar kundër regjimit dhe kundër ideologjisë, nga ana e shumicës, si asaj maqedonase, poashtu edhe të shumicës tjetër në ish-Jugosllavi (me përjashtime të pjesshme të asaj kroate dhe sllovene).

Proceset politike të cilat kapluan mbarë ish-Jugosllavinë detyrimisht u reflektuan edhe në Republikën e Maqedonisë. Ndryshimet kushtetuese të cilat kapnin pjesën e pluralizmit ideologjik, rrjedhimisht erdhën në shprehje edhe në vendin tonë, me çfarë përfundimisht ra sistemi monist partiak dhe ideologjik – komunizmi. Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë, si organ më i lartë legjislativ, më 20 shtator 1990, miratoi 25 amadamentet kushtetuese, me të cilat u vendosën bazat ligjore të pluralizmit politik në Maqedoni. Ky moment paraqet edhe fundin e periudhës 45 – vjeçare të komunizmit, respektivisht të monizmit.

Megjithatë, paraqitja e partive politike shqiptare në Maqedoni, nuk mund të trajtohet sikurse paraqitja e partive maqedonase, serbe apo partive të tjera në ish-Jugosllavi. Si i tillë, organizimi i shqiptarëve në parti politike nuk paraqetë një përqasje e thjeshtë ,si trend I kohës,por si angazhim I logjikshëm I popullit shqiptar në Maqedoni për mbrojtjen e ekzistencës së këtij kombëtare dhe krijimit të kushteve të duhura për një perspektiv më të sigurtë.

Mundësia ligjore për krijimin e partive politike u shfrytëzua edhe nga popullata shqiptare, të cilët duke shfrytëzuar kornizën e re kushtetuese, rrjedhimisht edhe ligjore shprehën iniciativa për krijimin e partive politike. Fillimisht këto parti nuk do të paraqiten si parti etnike, edhe pse për nga bërthama – anëtarësia, duket qartë se janë parti etnikisht të pastra shqiptare. Nën presionin e pushtetit maqedonas, të pa shkëputur nga ideologjia komuniste dhe antishqiptare, partitë politike shqiptare fillimisht do të përpiqen që ambalozhojnë multietnicizmin në partitë e tyre me ndonjë anëtarë maqedonas, që kryesisht janë juristë të cilët mirren me regjistrimin e partisë. I tillë është rasti i Partisë për Prosperitet Demokratik, e cila paraqet një përfaqësues maqedonas si sekretar. Megjithatë kjo gjë shumë shpejt do të humbet si fenomen, duke krijuar partitë etnikisht të pastra.

Në vazhdën e krijimit të partive politike, menjëherë pas rënjes së sistemit monist, shqiptarët e Republikës së Maqedonisë do të organizohen në dy parti politike - Partinë për Prosperitet Demokratik (PPD) dhe Partinë Demokratike Popullore (PDP). Sikurse vërehet nga emërtimi i partive politike të para shqiptare, mungon prefiksi apo sufiksi etnik, një element që bënë dallim nga shumica e partive politike maqedonase, të cilat regjistrohen në këtë periudhë. Edhe pse në bllokun politik maqedonas ka përjashtime të këtij fenomeni, megjithatë edhe në këto raste prezente në emërtim është emri shtetëror “i/e Maqedonisë”, me çfarë megjithatë kemi një lloj identifikimi, për dallim nga shtetet me demokraci të zhvilluar.

Duhet potencuar fakti se partitë politike shqiptare në Maqedoni u paraqitën në kushte dhe rrethana mjaftë specifike, duke pasur parasysh presionin e vazhdueshëm që kishin popullata shqiptare në këto troje. Prandaj edhe pikësynimet, realizimi dhe elementet e tjera të funksionimit të tyre duhet analizuar në kontekst të kushteve dhe rrethanave në të cilën ato kanë vepruar.

Partia për Prosperitet Demokratik (PPD)

Sikurse thamë më lartë, në dhjetëvjeçarin e fundit të shek. XX, R. Maqedonisë hap një faqe të re në historinë e saj, duke legalizuar pluralizmin politik. Si rezultat i kësaj në Maqedoni fillimisht lindën edhe dy parti politike shqiptare, ndër të cilat e para do të jetë Partia Për Prosperitet Demokratik-PPD. Kjo parti, për nga mënyra e themelimit, iniciativa, forma e organizimit dhe forma e veprimit, më shumë ngjan me një lëvizje kombëtare të shqiptarëve në R. Maqedonisë, se sa me një parti politike. Duhet potencuar fakti se shqiptarët këtë parti politike e pranuan me një entuziazëm të madh dhe një pritshmëri mjaft të lartë.

"Partia Për Prosperitet Demokratik u themelua më 16 prill 1990 në fshatin Xhepçisht Komuna e Tetovës, me mbajtjen e Kuvendit Themelues. Kjo parti ishte ndër të parat që u regjistrua në regjistrin e Ministrisë së Punëve të Mbrendshme, në Tetovë, më 15 maj, 1990, me vendimin nr.1535/1, me nr. rendor 337, të datës 25.05.1990. Partia Për Prosperitet Demokratik lind si rezultat i një entuziazmi të madh te shqiptarët e Maqedonisë. Kjo parti prezantonte idenë e funksionimit të shtetit juridik. Gjithashtu, ishte ithtarë e Parlamentit bikameral-dy dhomësh, duke konsideruar se populli shqiptarë në Maqedoni është popull shtet formues".[231]

Partia për Prosperitet Demokratik, si parti e parë e shqiptarëve në Maqedoni, që pas themelimit të saj, menjëherë krijoi shtrirje mjaft të gjërë në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarë në vend. Kjo parti për një kohë shumë të shkurtër krijoi strukturat e saj lokale, duke krijuar një aparat të fuqishëm partiak. Një gjë e tillë do të ishte vendimtare në veprimin e kësaj partie në jetën politike në Maqedoni, gjë që më së shumti vjen në shprehje në periudhën 1990-1998, kur kjo parti në bllokun shqiptarë do të jetë fituese e të gjitha zgjedhjeve, si atyre parlamentare poashtu edhe atyre lokale, në nivel vendi. Megjithatë një diçka e tillë do të jepte edhe kundërefektet e veta. Pikërisht duke pasur shtrirje të gjërë, anëtarësi të madhe, grupe interesi të ndryshme, mundësitë për krijimin e fraksioneve janë të mëdha. Në këtë mënyrë, edhe kjo parti nuk ngeli imune ndaj fenomeneve të kësaj natyre që janë të zakonshme për vendet demokratike. "Popullata shqiptare edhe pse jetonte ende nën ethet e torturave të monizmit e përqafoi PPD-në si një "foshnjë të lindur pas kohe" dhe e vendosi tërë energjinë e vet pozitive në shërbim të saj. Për një kohë të shkurtër kjo parti i mori te gjitha karakteristikat e një lëvizjeje mbarëpopullore. Ajo rekrutoi ne rradhët e veta brenda një kohe te shkurtër pjesen më të madhe të shqiptarëve të interesuar për lëvizje politike në vend, pa asnjë përzgjedhje. PPD-ja nuk tregoi kujdes kundrejt zgjerimit të anëtarësisë dhe sa me shumë zgjeroi antarësinë, aq me reale bëheshin mundësit që për shkak të hapësirës manovruese dhe interesave të veçanta kjo valle te ndahej në valle edhe më të vogla. Fillimisht ishte e vështirë për shqiptarët të kuptonin se partitë politike që nga moment i prezantimit të kandidatëve për zgjedhjet aktuale me qellim marrje dhe ushtrimin e pushtetit shtetëror, gradualisht veçoheshin nga masa (anëtarësia) dhe viheshin ne shërbim të

[231] Jusuf Zejneli; Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë; Tetovë; 2013, fq. 46

grupeve më të vogla që artikulonin përveç interesit të përgjithshëm që proklamonte partia, edhe shumë interesa të tjera që shpeshëherë superonin mbi interesin e përgjithshëm.[232]

Kryetar i parë i Partisë për Prosperitet Demokratik u zgjodh Nevzat Halili, një intelektual i shquar i kohës, profesor në Gjimnazin e Tetovës. Ai fillimisht merr përkrahje nga figura dhe veprimtarë të shumtë të çështjes kombëtare, duke mos i munguar edhe përkrahja nga elita intelektuale e kohës.

Në zgjedhjet e para pluraliste të vitit 1991 PPD konkuroi në të gjitha njësitë zgjedhore ku kishte shqiptarë, pavarësisht nëse ata ishin shumicë apo pakicë. Duke u nisur nga fakti se sistemi zgjedhor në këto zgjedhje ishte mazhoritar, PPD në pjesën më të madhe të njësive zgjedhore garoi si e vetme, ndërsa në një pjesë të njësive zgjedhore ajo garoi në koalicion me partinë tjetër shqiptare PDP. Në kuadër të këtyre zgjedhjeve kjo parti do të fitoj 15 deputetë në Parlament, plus pesë deputet në koalicion me PDP-në.

Më 12 shkurt 1994, në kongresin e II të PPD të mbajtur në Tetovë, kjo parti u nda dhe u mbajtën dy kongrese paralelisht. Në njërin kongres Kryetar u zgjodh Arben Xhaferi, kurse në të dytin Xheladin Murati, Kryetar i PPD. Pas një procesi gjyqësor e drejta për udhëheqje me PPD-në iu dha grupit të dytë.

Në zgjedhjet e dyta parlamentare të vitit 1994 PPD do të garoj e vetme, duke fituar sërish shumicën e deputetëve në bllokun politik shqiptar. Nëse në zgjedhjet e para ajo nuk kishte kundërshtarë, në këto zgjedhje kishte kundërshtarë Partinë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve (më vonë Partia Demokratike Shqiptare) dhe Partinë Demokratike Popullore (me përjashtim të disa zonave ku ishte në koalicion me këtë parti). Në këto zgjedhje PPD fitoi 13 deputetë.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 1998 në Republikën e Maqedonisë janë realizuar me sistem të kombinuar. Në këtë rast 100 deputetë janë zgjedhur me sistem mazhoritar, ndërsa 20 deputetë me sistem proporcional. Në këto zgjedhje PPD ka konkurruar në koalicion me Partinë Demokratike Shqiptare të Arben Xhaferit, dhe ka arritur të marrë 14 deputetë.

Në periudhën e 2000-2002 PPD-ja ka qenë mjaft aktive në skenën politike. Edhe pse në opozitë kjo parti politike ka pasur një rrol mjaft të rëndësishëm në zhvillimet politike në Maqedoni. Edhe pse është pikërishtë periudha kur kjo parti fillon të humb ekskluzivitetin në elektoratin shqiptar në Maqedoni, kjo parti në periudhën e konfliktit të armatosur të vitit 2001 ka pasur një rrol mjaft konstruktiv, duke u bërë pjesë e iniciativave të përbashkëta të subjekteve politike shqiptare, për arritjen e paqes si dhe për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni. "PPD-ja gjatë vitit 2001 luajti rol konstruktiv , kryengritjen e shqiptarëve në Maqedoni së bashku me PDSH-në u angazhuan që këtë ta bëjnë çështje institucionale për zgjidhje të këtij konflikti.

[232] Etem Aziri; Partitë politike, zgjedhjet dhe sitemet zgjedhore, Shkup; 2015; fq. 142-143

PPD-ja ishte nënshkruese e Marveshjes së Ohërit kuptohet me pëlqimin e përfaqsuesëve politik të UÇK-së”.[233]

Në zgjedhjet e vitit 2002 kjo parti do ta shënoj rënjen përfundimtare. Në këto zgjedhje PPD do të merr vetëm tre deputet, duke mos arritur që të krijoj grup parlamentar. Këtë rezultat kjo parti do ta arrij edhe në zgjedhjet e vitit 2006, por për dallim nga herat e tjera kësaj rradhe ajo do të garoj në koalicion me Bashkimin Demokratik për Integrim.

Gjatë vitit 2008 me vendim të Kryesisë Qendrore të PPD-së, kjo parti do të shkrihet në Partinë Demokratike Shqiptare, ndërsa kryetari i atëhershëm i saj do të bëhet nënkryetar i PDSH-së. Ndërkaq një grup i aktivistëve të PPD-së vendosin ta ringjallin sërish partinë. Megjithatë nga kjo periudhë PPD-ja nuk arrin të konsolidohet, respektivisht nuk arrin të marrë mandat në zgjedhjet parlamentare të mbajtura.

Partia Demokratike Popullore

Partia Demokratike Popullore u themelua më 23 qershor 1990 në Tetovë. Kryetar i parë i saj do të jetë mjeku i njohur tetovar Jusuf Rexhepi, ndërsa rreht saj do të mblidhen edhe shumë intelektual të tjerë nga gjithë Maqedonia si Iljaz Halimi, Rami Tuda, Mersel Bilalli, Bedredin Ibrahimi etj.

PDP-ja në skenën politike do të paraqitet si parti kombëtare që i përkiste grupit të partive me orientim kah qendra e djathtë. Veçoria e PDP-së ishte ndërtimi i fizionomisë dhe individualitetit të vet, me cka dallohet dukshëm nga partite tjara politike. PDP ishte ndër partit e rralla ku mbretnonte një unitet mbrenda saj që shprehej me mirkuptim të ndërsjelltë dhe marrëdhënie të shëndosha në të. PDP-ja ishte iniciator i shumë iniciativave dhe proceseve kombëtare në R.e Maqedonisë. Kjo parti do të luaj një rrol të rëndësishëm në moment kyçe të historisë më të re të Maqedonisë, respektivisht në moment të rëndësishme për shiptarët e Maqedonisë. Kjo shihet me rastin e marrjes së qëndrimit që para miratimit të Kushtetutës në vitin 1991 të lëshohet Parlamenti poqese nuk përfillen kërkesat për avansimin e pozitës së shqiptarëve (këte qëndrim PPD-ja nuk e përfilli), të mos dilet në referendum për pavarësinë e Maqedonisë përderisa nuk definohet qartë pozita e shqiptarëve me një marrëveshje apo dekleratë. PDP do të luaj rrol aktiv në Referendumin për Autonomi politike dhe territorial të shqiptarëve të Maqedonisë të realizuar më 11 dhe 12 janar 1992. Gjithashtu PDP do të bëjë thirrje për

[233] Intervistë me ish-nënkryetarin e PPD-së, Qenan Aliu e realizuar enkas për nevojat e këtij punimi.

mospjesëmarrjen e popullatës shqiptare në rregjistrimin e 1992 dhe 1994. PDP gjithashtu ka mbështetur dhe kontribuar për themelimin dhe institucionalizimin e Universitetit të Tetovës.[234]

"PDP-ja u formua që të kontribuon në zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve, për një status më të avansuar të tyre. Këte përcaktim mundoheshim në çdo mënyrë ta demonstrojmë. Mu për këte arsye në zgjedhjet e para parlamentare më 1990 kërkuam që të merremi vesh me PPD-në rreth përcaktimit të kuadrove për deputet. Angazhimi ynë nuk ishte që me çdo kusht të sigurojmë numër të madh të deputetëve për PDP-në ngase e dinim që nuk do të merremi vesh me PPD-në. Në një situate të atillë dalja veç e veç në zgjedhje do të ndikonte në acarimin e marrëdhënieve të elektoratit e cila do të reflektonte negativisht në numrin e deputetëve shqiptarë. Intenca jonë ishte se si të përzgjedhim deputet cilësor të cilët do të mund me sukses ti përfaqësojnë interesat e shqiptarëve në Parlamentin e Maqedonisë".[235]

Në zgjedhjet e vetme parlamentare që ka marrë pjesë PDP si e vetme, do të fitoj një deputet, ndërsa në koalicion me PPD-në ajo do të merr edhe gjashtë deputetë të tjerë, me çrast në mandatin e parë parlamentar pluralist, kjo parti do të hyjë me grup parlamentar.

Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)

Kongresi i dytë partiak i Partisë për Prosperitet Demokratik, i mbajtur më 12 shkurt 1994 në Tetovë do të jetë një nga ngjarjet më të diskutueshme në historinë e pluralizmit politik të shqiptarëve të Maqedonisë. Ky kongres do të vijë menjëherë pas përfundimit referendumit për Autonominë politike shqiptare në Maqedoni. Edhe pse lëvizjet që ndodhnin në subjektin më të madh politik të shqiptarëve e paralajmëronin një gjë të tillë, shumë pak njohës të situatave politike kishin parashikuar një epilog të tillë. Kongresi isht paralajmëruar në momentin kur shpërthyen kundërthëniet brenda strukturave partiake drejtuese të këtij subjekti politik, në nivele qendrore por edhe në nivele lokale. Mbase pritshmëria e madhe nga ky kongres ngriti tensionin ndërmjet palëve, tension ky që kishte shpërthyer që më herët, por në kuluaret politike ishte mbajtur i fshehur. Në këtë Kongres, pritej të përcaktohet platforma e veprimit politik, çështje rreth së cilës ishin krijuar më shumë pozicione ndër të cilat dy më të rëndësishme, njëri rreth grupit që kishin qasje në pushtet dhe grupit tjetër aktivistësh dhe funksionarësh të ri, të udhëhequr nga kreu lokal i degës së Tetovës, Menduh Thaçi. Ky element mund të vështrohet edhe nga një këndvështrim tjetër, respektivisht grupi i afërt me udhëeqësinë e parë si dhe grupi i cili tentonte të merrte udhëheqësinë.

Më 12 Shkurt, 1994, në prezencë të një numri të madh të mysafirëve, si Sekretari i përgjithshëm i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Tritan Shehu, përfaqësuesi i Qeverisë së Kosovës, Muhamet Bicaj, kryetari i Partisë Demokratike Popullore, Iljaz Halimi, kryetari i

[234] Intervistë me ish-kryetarin e PDP-së Iljaz Halimi enkas për këtë punim
[235] Intervistë me ish-kryetarin e PDP-së Iljaz Halimi enkas për këtë punim

Forumit për të drejtat e njeriut, Milaim Fejziu si dhe përfaqësues të tjerë politik nga Shqipëria dhe Kosova, filloi me punë Kongresi i Dytë i PPD-së. Situata e tendosur ndërmjet dy grupeve në kongres u vërejt që në fillim, respektivisht gjatë diskutimit të Statutit të partisë. "Ndërkohë, një pjesë e ministrave dhe deputetëve duke u kapur pas çështjeve të parëndësishme statutare, dolën nga Salla e Pallatit të kulturës, ku ishte caktuar të mbahej Kongresi i Dytë i parakohshëm i PPD. Këtij grupi iu bashkëngjitën edhe një pjesë e vogël e delegatëve të Kongresit nga degë të ndryshme. Komisioni verifikues informoi të pranishmit se nga 244 delegatë të Kongresit, në sallën e Pallatit kishin ngelur 166 delegatë, prej të cilëve 125 të zgjedhur nga Kuvendet e degëve dhe 21 nga degët e diasporës. Gjithashtu, në Kongres merrnin pjesë edhe 14 kryetarë degësh (nga 17 kryetarë që ishin gjithësej) dhe 44 anëtarë të Kuvendit Qendror të përparshëm nga 55 gjithsej. Duhet theksuar se në Kongres vazhduan punën edhe deputetët : Mersin Pollozhani, Hysni Shaqiri, Nexhati Xhaferi dhe Zudi Emini".[236]

Pjestarët e ngelur në Shtëpinë e Kulturës ku kishte filluar punën Kongresi vazhduan punën e Kongresit, ndërsa për raportin e punës në vend që të fliste kryetari i deri atëhershëm ose sekretari i partisë, këtë gjë e ka bërë kryetari i degës së Tetovës, Menduh Thaçi, i cili ka shprehur një sërë kritikash ndaj udhëheqësisë së mëherëshme dhe politikave që kishin zbatuar në periudhën e katërvjeçarit të parë të funksionimit të PPD-së. Ai ka akuzuar rëndë bashkëpartiakët e tij për pozitën e popullsisë shqiptare në Maqedoni, si fajtor kryesor për diskriminimin dhe pozitën e dobët politike dhe juridike të shqiptarëve në R. Maqedoni. "Në dimensionin e brendshëm, shqiptarët ashtu si më parë nuk mund të ndikojnë në çështjet sistemore, në rregullimin shtetëror dhe në pozitën e tyre në sistem. Vendimet politike dhe të tjerat janë qendërzuar, komunat kanë kompetenca ceremoniale, ndërkaq shqiptarët në Kushtetutën e re e kanë statusin e pakicës".[237] Në vazhdim ai ka kërkuar dorëheqje kolektive të Kryesisë së PPD-së.

Në vazhdim të Kongresit në Shtëpinë e Kulturës së Tetovës, delegatët zgjodhën për kryetar Arbën Xhaferin, si dhe organin më të lartë partiak, Kuvendin Qendror, nga i cili u zgjodh edhe Kryesia Qendrore, ku përveç Xhaferit si kryetar, nënkryetarë u zgjodhën Menduh Thaçi, Shazim Memeti, Nexhibe Palloshi, si dhe sekretari i përgjithshëm dhe 10 anëtarë të tjerë të Kryesisë.

Ndërkaq në të njëjtën kohë me këtë Kongres, të "pakënaqurit" që u larguan nga Salla e Pallatit të kulturës, ishin grumbulluar në Sallën e Kuvendit të Komunës së Tetovës, për të vazhduar punën për mbajtjen e Kongresit paralel. Në këtë Kongres gjithashtu u zgjodhën organet partiake, Kuvendi Qendror, Kryesia dhe kryetari i saj, Xheladin Murati. Një gjë e tillë nënkuptonte ndarjen në dy pjesë të partisë së parë dhe më të madhe të shqiptarëve të Maqedonisë. Për situatën e krijuar, më së miri do të ilustronte titulli i gazetës së vetme në gjuhën shqipe në atë kohë Flaka "Cila është PPD-ja legjitime".[238]

[236] Zeqirija Rexhepi; Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990 – 2001; fq 80.
[237] Fjalimi i Menduh Thaçit në Kongresin e dytë të PPD-së, 1994.
[238] Shih. Flaka e vëllazërimit, " *Cila PPD është legjitime* ", Shkup, 25 shkurt 1994

Në kërkim të legjitimitetit, dy palët e dala nga Kongreset e ndryshme do të fillojnë një "luftë" të ashpër. Përderisa grupi i Arben Xhaferit kishte në posedim zyrat dhe vulat partiake, vetëm për disa ditë do të vij një vendim nga Gjykata e Tetovës me të cilin ky grupim detyrohej që të rikthente zyrat dhe vulat partiake grupit tjetër të udhëhequr nga Xheladin Murati. "Më 16 shkurt, 1994, në zyrat e Kryesisë së PPD të zgjedhur në Kongresin e ligjshëm që u mbajt në Pallatin e kulturës, u dorëzua dokumenti i gjyqit , në bazë të kërkesës së pjesës tjetër të PPD, sipas së cilës kërkoheshin vulat e partisë dhe çelësat e zyrave".[239] Megjithatë një gjë e tillë do të hapte një debat edhe më të ashpër, nëse Gjykata ndërhyri në punët e brendshme partiake ose jo. Mbetet simptomatike veprimi aq i shpejtë i organeve gjyqësore, për çfarë shumë njohës të situatave politike vlerësojnë se ka qenë e ndikuar nga funksionar të lartë shqiptarë, të cilët ishin pjesë e grupit të Muratit. Kjo përçarje nxorri në pah edhe një ndarje të re ndërmjet grupeve, duke i konsideruar përkrahësit e Xhaferit si "radikal", ndërsa përkrahësit e Muratit si të "moderuar".

Megjithatë një element mjaft interesant për këtë periudhë është qëndrimi i kryetarit të parë të PPD-së, Nevzat Halilit, i cili në një shkrim autorial gazetaresk, për ndarjen e PPD-së do të akuzoj Tiranën zyrtare. Ndërkaq, ndërhyrja e autoriteteve shqiptare, respektivisht përkrahja e tyre për krahun e Arben Xhaferit asnjëherë nuk u dokumentua.[240]

Një periudhë kohore krahu i Xhaferit do të insistonte në pozicionin se ishin përfaqësuesit legjitim të zgjedhur të PPD-së. Duke konsumuar të gjitha mekanizmat për këtë gjë, krahu i Xhaferit do të vendos themelimin e një subjekti të ri me emrin e partisë së vjetër dhe shtimin e prapashtesës "të shqiptarëve", respektivisht Partia për Prosertitet Demokratik të Shqiptarëve (PPDSH). Megjithatë kjo parti do të hasë në pengesa të reja për regjistrimin e saj, të cilat fillimisht vijnë për shkak të emrit të ngjashëm me PPD-në, pastaj për kryetarin e saj, i cili sipas organeve kompetente, edhe pse ishte i lindur dhe rritur në Tetovë, nuk kishte jetuar në 10 vitet e fundit në Maqedoni. Ndërkaq më vonë pengesë për regjistrimin e këtij subjekti politik do të ishte simboli partiak, i cili përmbante një version të shqiponjës dy krenare.

"Më 5 korrik të vitit 1997, Partia për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve dhe Partia Demokratike Popullore do të organizojnë Kongres të përbashkët me çrast do të bëhet bashkimi i këtyre dy subjekteve. "Me formimin e PPDSH-së e cila për dallim nga PPD-ja doli me një vizion dhe koncept tjetër politik për cështjen shqiptare e cila nuk dallonte nga orientimi politik i PDP-së u krijua një klimë politike për një bashkëpunim me të thellë në mesë këtyre dy partive.Meqë qasja ndaj fenomeneve dhe proceseve politike dhe angazhimi për zgjidhjen e statusit të shqiptarëve ishte e ngjajshme me PPDSH-në atëher ecja në dy binar paralel drejt një qëllimi nuk kishte kuptim. Ky qe shkaku që PDP-ja dhe PPDSH-ja më 5 korik 1997 u bashkuan dhe formuan PDSH-në. Ky ishte një shembull pozitiv për fuqizimin e kërkesave shqiptare ndaj pales maqedone dhe faktorit ndërkombëtar".[241] Si rezultat i këtij bashkimi pas zgjedhjeve parlamentare

[239] Zeqirija Rexhepi; Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990 – 2001; fq.
[240] Flaka e vëllazërimit, " Pikëpamje të ish kryetarit të PPD-së ", 18 shkurt. 1994
[241] Intervistë me ish-kryetarin e PDP-së Iljaz Halimi enkas për këtë punim

të vitit 1998 u krijuan kushtet që PDSH-ja të hyn në Qeveri me VMRO-DPMNE-në dhe AD. Gjatë mandatit qeveritar deri para konfliktit të vitit 2001 PDSH-ja luajti një rol të rëndësishëm në zgjidhjen e shumë problemeve të shqiptarëve në Maqedoni, me menaxhimin e luftës së Kosovës dhe konfliktit ndëretnik në Maqedoni. Gjatë kësaj qeverisje ndodhën shum ndryshime rënjësore siç ishin: u liruan të burgosurit politik shqiptar, forcat e Natos u lejuan të futen në Maqedoni si logjistik për Kosovën, u bënë ndryshime kadrovike në vertikale dhe horizontale në të gjitha institucionet shtetërore dhe publike ku përqindja e shqiptarëve u rrit nga 2 në 11%, u themelua kanali i tret televiziv në gjuhën shqipe, u rrit siguria te qytetarët shqiptar, u themelua Universiteti Evropës Juglindore në Tetovë, u ndihmua UT-ja për zhvillimin normal të procesit edukativo arsimor si dhe u ndihmua në përmirsimin e kushteve të punës,u investua në arsimin fillor dhe të mesëm, në kultur, rrjetin e rrugëve, kanalizimeve, u ngrit standardi dhe u përmirsua dukshëmn pozita ekonomike dhe politike e shqiptarve në Maqedoni etj.[242]

Divergjencat ndërmjet dy subjekteve kryesore të shqiptarëve në Maqedoni ishin të mëdha. Madje si në zgjedhje lokale, poashtu edhe në ato lokale, këto parti çonin luftë të vërtetë si në fushatat parazgjedhore poashtu edhe në ditën e zgjedhjeve. Një retorikë mjaft e ashpër ndërmjet krerëve të këtyre partive ka shënuar këtë periudhë kohore, ndërsa incidente të shumta janë shënuar ndërmjet aktivistëve të këtyre partive, si refleksion pikërisht i retorikave të udhëheqësve të tyre. Megjithatë këto divergjenca dhe ky tension do të ulej në maksimum në fund të vitit 1997 dhe në fillim fillim të vitit 1998, respektivisht në periudhën e luftës së Kosovës. Të ndikuar nga kjo situatë, këto dy parti fillimisht do të organizonin një protestë mjaft të madhe në Shkup në përkrahje të popullit të Kosovës, ndërsa më vonë do të ulen në tavolinën e bisedimeve për të unifikuar qëndrimin e tyre. Një gjë e tillë ndodhi pasi që ndjenjat nacionaliste pro-sllave të popullatës maqedonase u ngritën në maksimum, duke u solidarizuar me popullin serb, respektivisht duke ndjellur anti-shqiptarizëm edhe në Maqedoni. Me 9 shtator të vitit 1998 kemi nënshkrimin e marrëveshjes ndërmjet PDSH dhe PPD, më të cilën këto dy subjekte u morën vesh për të marrë pjesë në zgjedhje parlamentare në koalicion. Si rezultat i kësaj, subjektet shqiptare për herë të parë do të arrijnë të zgjedhin 25 deputet në Parlamentin e R. Maqedonisë.

Pas zgjedhjeve të vitit 1998 PDSH-ja do të bëhet pjesë e Qeverisë, të udhëhequr nga Ljubço Gjeorgjievski, respektivisht nga VMRO-DPMNE dhe Alternativa Demokratike. Në këtë iniciativë, kjo parti do të gjej përkrahjen edhe të dy deputetëve të PPD-së, Iljaz Sabriut dhe Mevlan Tahirit, me çrast do të arrij të grumbulloj 13 deputetë shqiptarë, respektivisht shumicën e përfaqësuesve shqiptarë, kundrejt 12 të PPD-së.

Rroli i PDSH-së pas konfliktit të vitit 2001, në masë të madhe ka qenë opozitar. Që nga zgjedhjet e vitit 2002, kjo parti do të vazhdoj të pësoj humbje të një pas njëshme nga subjekti i ri që u krijua nga përkrahësit e kryengritësve të vitit 2001, Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, respektivisht Bashkimit Demokratik për Integrim.

[242] Intervistë me ish-kryetarin e PDP-së Iljaz Halimi enkas për këtë punim

Edhe përkundër kësaj, kjo parti politike gjatë vitit 2006 për një periudhë prej 18 muajsh do të bëhet pjesë e koalicionit qeverisës, edhe përkundër faktit se kishte humbur zgjedhjet. Një gjë e tillë u arsyetua me koalicionimin me Partinë për Prosperitet Demokratik e cila kishte fituar tre mandate (por në koalicion me BDI-në), ashtuqë numri i deputeteve barazohej 14:14. Megjithatë dy deputetë të PPD-së Blerim Bexheti dhe Safet Neziri nuk iu bindën kryetarit të tyre të atëhershëm Abduladi Vejseli për të koalicionuar me PDSH-në, dhe të njëjtit u bënë pjesë e BDI-së. Një gjë e tillë thelloi kundërthënjet për pjesëmarrjen e PDSH-së në pushtet pa pasur legjitimitetin e popullit shqiptar.

Në këtë periudhë kohore, në vitin 2007 kryetari i PDSH-së, Arben Xhaferi do të jep dorëheqje, ndërsa në vend të tij do të vij kreu aktual, Menduh Thaçi.

Pas humbjes së zgjedhjeve të vitit 2008, nga kjo parti do të ndahet një krah mjaft i fuqishëm i udhëhequr nga nënkryetari i kësaj partie, si dhe ish-zëvendëskryeministri dhe ministër i shëndetësisë, Imer Selmani. Selmani me disa deputetë do të formojnë partinë Demokracia e Re, e cila do të veproj vetëm një periudhë të shkurtër. Duhet potencuar fakti se nga PDSH-ja, respektivisht nga anëtarë të lartë të kësaj partie, kanë dalur edhe disa parti të tjera, si Partia për Ardhëmri Demokratike e Alajdin Demirit, por edhe Partia Demokratike Kombëtare (edhe nga PPD-ja), Rilindja Demokratike Kombëtare, Lëvizja për Reforma e PDSH-së.

Partia Demokratike Kombëtare (PDK)

Një grup aktivistësh shqiptarë, të cilët kishin qenë aktiv në dy subjektet politik shqiptarë të mëhershëm, PPD dhe PDSH, të pakënaqur me statusin e shqiptarëve në Maqedoni si dhe me veprimin politik të partive shqiptare, në mars të vitit 2001 u formuar Partinë Demokratike Kombëtare. “Kjo parti politike më 12 mars 2001 mbajti Kuvendin Themelues në sallën e Teatrit të Dramës Shqiptarë në Shkup. Qëllimi i kësaj partie ishte arritja e përfaqësimit të drejtë të shqiptarëve në institucionet shtetërore, decentralizimi i pushtetit, elminimi i mbivotimit të shqiptarëve në Kuvend dhe të tjera”.[243] Në krye të kësaj partie do të ndalej Kastriot Haxhirexha, deputet i PPD-së nga Dibra, ndërsa pas tij do të rradhiteshin deputeti i PDSH-së Fadil Bajrami, kryetarët e komunave tëë Veleshtës dhe Dibrës, Tahir Hani dhe Imer Ollogu, Xhevat Ademi, si dhe mjaftë intelektual të njohur shqiptarë. Duke u nisur nga fakti se kjo parti u paraqit pothuajse në të njëjtën kohë me Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare, fillimisht kjo pati politike u pranua si përfaqësues politik i formacionit ushtarak. Kjo përshtypje u krijua pas prononcimeve të fuqishme të këtij subjekti, në mbrojtje të kryengritësve. Duhet potencuar se menjëherë pas kësaj RDK fitoi përkrahje të madhe në popullatë. Megjithatë, një moment shumë i rëndësishëm për këtë subjekt është takimi i liderit të saj Kastriot Haxhirexha me ambasadorin e Britanisë së Madhe Mark Dikinson, i cili e nënçmoi Haxhirexhën deri në atë masë saqë e detyroi të lexonte para gazetarëve një deklaratë që ia kishte përgatitur ai. “Maqedonia nuk do të ishte kjo që është nëse nuk do të

[243] Jusuf Zejneli; Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë; Tetovë; 2013, fq. 50

ishte diplomati britanik Mark Dikinson, i cili arriti që liderin më radikal të shqiptarëve Kastriot Haxhirexha ta ul në prehër, por edhe ta detyroj para kamerave të lexoj atë që ia shkruajti në letër, në një kohë kur lufta po merrte hov".[244] Kjo parti do të pësonte një debakël në zgjedhjet e vitit 2002, duke arritur të fitoj vetëm një mandat deputeti – Xhezair Shaqiri – Komandant Hoxha. Vetëm një vit më vonë kjo parti do të shkrihet në Bashkimin Demokratik për Integrim.

Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)

Bashkimi Demokratik për Integrim u themelua më 5 Qershor të vitit 2002. Kuvendi Themelues i kësaj partie ka dalur me një deklaratë me çfarë është shprehur iniciativa për themelimin e kësaj partie. "Duke u nisur nga: Vullneti i forcave progresiste që sollën ndryshimin rrënjësor të pozitës së shqiptarëve në Maqedoni për të vazhduar angazhimin e tyre në procesin e demokratizimit të mirëfilltë të Maqedonisë; përkrahja masovike që këto forca gëzojnë në popullatë dhe dëshira e shprehur e qytetarëve për inkuadrimin e tyre në jetën politike si garancë për realizim të barazisë së plotë të të gjithë qytetarëve në Maqedoni si kusht i domosdoshëm për paqë dhe stabilitet; Situata e rënduar politike, ekonomike dhe sociale në vend që kërkon qasje dhe ide të reja për t´u tejkaluar sa me shpejt, Lindi nevoja për themelimin e një partie të re që u emërtua Bashkimi Demokratik për Integrim", thuhet në Deklaratën e themelimit.[245] Në këtë deklaratë janë nënvizuar edhe qëllimet e kësaj partie si: Implementimin e plotë të Marrëveshjes së Ohrit; Maqedoni stabile, si interes parësor i të gjithë qytetarëve dhe si interes rajonal dhe evropian; Maqedoni multietnike, ku të gjithë qytetarët e saj do të ndjehen të lirë dhe të barabartë; Çrrënosjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe vendosjen e mekanizmave që do të pamundësojnë përhapjen e tyre; Integrimin e Maqedonisë në strukturat euro-atlantike, duke u nisur nga integrimi rajonal sipas modeleve më të avancuara europiane dhe botërore; Demokraci funksionale dhe shtet ligjor, me theks të veçantë në respektimin e të drejtave të njeriut. Këto element njëherit do të paraqesin edhe parimet bazë të funksionimit të kësaj partie në të ardhmen.

Megjithatë, procesit të krijimit të BDI-së do ti paraprijnë një sërë momentesh të rëndësishme. Fillimisht duhet potencuar se kjo parti del nga pjestarë të kryengritjes së armatosur të vitit 2001 dhe është një proces i vazdhueshëm i konfliktit të vitit 2001, që detyrimisht ndërlidhet me Marrëveshjen e Ohrit, respektivisht me përpjekjet për implementimin e kësaj marrëveshje. Fillimisht kemi idenë për themelimin e Këshillit Kordinues të partive politike shqiptare, i cili edhe u formua dhe Kryetar u zgjodh Ahmeti. Edhe pse ideja e formimit të Këshillit ishte e arsyeshme ai nuk funksionoi siç duhet me qëllim të realizimit të kërkesave të shqiptarëve, andaj ai shumë shpejt shpërbë. Në shpërbërjen e këtij Këshilli rrol të madh luajtën divergjencat ndërmjet anëtarëve të këshillit nga partitë e ndryshme politike. "Në atë kohë e bëmë Këshillin Koordinues dhe u pajtuam të gjithë, mirëpo me afrimin e zgjedhjeve të para

[244] http://ëëë.utrinski.mk/?ItemID=89D080EABCF0DA46BE006C52BBD181AD
[245] Deklarata e themelimit të BDI-së, 5 qershor 2002, http://ëëë.bdi.mk/documents/DEKLARATE-e-themelimit-te-partise.pdf

parlamentare pas konfliktit të 2001-shit hasëm në problem, mospajtim gjatë përpilimit të listave zgjedhore gjegjësisht emërimin e kandidatëve për deputet dhe në pamundësi të një liste të përbashkët dhe duke parë se partitë politike u kapën në mes veti PPD-ja dhe PDSH-ja. Pas këtyre mosmarrëveshjeve ne nuk mundnim të lëmë situatën pa udhëheqje dhe në konsulltim me njerzit e ish shtabit të luftës ishim të detyruar që mos të lëm ngecjen e procesëve të mëtutjeshme por të vazhdojm,dhe në bisedë e sipër me ish liderët e atëhershëm".[246] Duhet potencuar se Këshilli kordinues ishte organ mbipartiak, ndërsa qëllimi dhe ideja për krijimin e këtij organi ishte implementimi i Marveshjes së Ohrit. Ajo që është evidente, që në fillimet e këtij organi, vërhet tendenca që partitë politike shqiptare dëshironin të përfitonin më shumë nga Këshilli Koordinues, se sa të kontribonin në përmbushjen e qëllimeve të tij. Një gjë e tillë e bënte të paevitueshëm faktin për krijimin e një partie të re.[247]

Për shkurt kohë pas themelimit të BDI-së, kjo parti do të krijoj një strukturë me shtrirje në të gjitha viset ku jetojnë shqiptarë. Megjithatë më vonë kjo parti do të tentoj të shtrihet edhe në viset e Maqedonisë lindore ku nuk jetojnë shqiptarë. Një tendencë e tillë fillimisht u komentua si përpjekje e kësaj partie për tu etabluar si parti multietnike, ndërsa më vonë ky element do të marrë një dimension të ri. "Nga që problemët e shqiptarëve nuk ishin vetëm në Maqedoninë perëndimore por në të gjithë territorin e e Maqedonisë ku jetonin shqiptarët. Po të analizojmë mirë situatën si kanë rrjedhur punët në vitin 1963 me shembjen e tërmetit nën udhëheqjen e Rankoviqit, Maqedonija lindore kaloi në atë qendrore dhe filloi të futet edhe në atë perëndimore, kurse Dibrën dhe pjesët tjera i dërguan ka Manastiri, Kratova, Kumanova dhe pasi që ndodhi largimi prej vendeve të veta nuk nënkuptonte se në ata vende ka vetëm maqedonas. Duke mar parasysh kërkesën e popullit jo sllav që kufizohen me Bullgarinë, edhe pse janë të regjistruar si sllavë mirëpo jetën, doket, zakonet, traditat i kanë tonat të shqiptarëve. Ne si parti moderne nuk guxonim dhe nuk refuzonim askënd e asnjërit komunitet dhe besim fetar që dëshironte të jetë pjesë e jona. Detyra jon ishte që kushdo që të na bashkohet duhet të pranoj rregullat dhe programin ton partiak, dhe ne i kemi pranuar ngase ishte vullneti i popullit që jetonte në vende të ndryshme të Maqedonisë. E dimë se nuk lind gjë mirëpo reflekton pozitivisht duke guxuar edhe atje të thotë njeri se nuk jam anëtar as i VMRO-së e as i LSDM-së por jam anëtarë i BDI-së".[248]

Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) që në zgjedhjet e para parlamentare pas formimit të saj, të vitit 2002 u etablua fuqishëm në skenën politike, duke fituar shumicën absolute në bllokun politik shqiptar. Kjo parti arriti të fitoj 13 përqind të votave në nivel të vendit, duke fituar 16 deputetë dhe atë: Ali Ahmeti, Agron Buxhaku, Abdilaqim Ademi, Aziz Pollozhani, Ejup Rustemi, Fazli Veliu, Gzmi Ostreni, Hazbi Lika, Huseinxhevat Huseini, Hisni Shaqiri, Nazmi Beqiri, Nevzat Bejta, Rafiz Haliti, Talat Xhaferi, Teuta Arifi, Xheladin Shatku.[249]

[246] Intervistë me ish-nënkryetarin e BDI-së, Nazmi Beqiri, enkas për këtë punim
[247] Shih. Etem Aziri; Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni; Shkup; 2004, fq. 234-235
[248] Intervistë me ish-nënkryetarin e BDI-së, Nazmi Beqiri, enkas për këtë punim
[249] http://ëëë.sobranie.mk/rezultatet-zgjedhore-b06abc51-5428-4dd7-b806-326b55aaa7e2.nspx

Menjëherë pas kësaj, kjo parti do të bëhet pjesë e koalicionit qeverisës të udhëhequr nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë, me në krye Branko Cërvenkovskin. Sipas shumë njohësve të situatave politike, por edhe sipas shumë analizave, ky mandat paraqet edhe mandatin më të suksesshëm të kësaj partie. Brenda këtij mandati arrihet të ndryshohen pjesa më e madhe e ligjeve të parapara me Marrëveshjen e Ohrit. Gjithashtu në këtë mandat legalizohet edhe Universiteti i Tetovës. Në kuadër të këtij katërvjeçari bëhet rritje mjaftë e madhe e përqindjes së përfaqësimit të shqiptarëve në administratën shtetërore dhe atë publike, miratohet ligji për përdorimin e flamujve dhe simboleve kombëtare, avancohet përdorimi i gjuhës shqipe në institucione, miratohet Ligji i ri për ndarjen territoriale, me çrast komunat e Strugës dhe Kërçovës bëhen me shumicë shqiptare, avancohet decentralizimi i pushtetit lokal, instalimi i të drejtës së vetos apo votimit të dyfishtë të njohur si "votimi me rregullin e Badenterit", etj. Një gjë e tillë reflektoi në mënyrë të drejtpërdrejtë tek partneri maqedonas i koalicionit LSDM-ja, duke hasur në rënje shumë të madhe të rejtingut, gjë që rezultoi në humbjen e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare të vitit 2008.

Për dallim nga partneri i saj i koalicionit BDI-ja shënoi fitoren e rradhës në vitin 2008, kësaj rradhe në koalicion me PPD-në dhe me disa parti më të vogla. Bashkarishtë ky koalicion arriti të fitoj 17 deputetë. Por edhe përkundër kësaj, kjo parti do të ngel jashta koalicionit qeverisës, ndërsa si partner i VMRO-DPMNE-së për 18 muaj do të jetë PDSH-ja e Menduh Thaçit. Kjo gjë shkaktoi një krizë mjaft të madhe politike e reflektuar fillimisht me një protestë të BDI-së, për të vazhduar më vonë me mekanizma të ndryshëm politik të bllokimit në organin më të lartë ligjvënës, sidomos në ligjet të cilat parashihet të miratohen me votim të dyfishtë, apo "me rregullin Badenter". Kjo krizë çoi deri në "Marrëveshjen e Majit" të vitit 2008, të arritur ndërmjet liderëve të VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së, Gruevski dhe Ahmeti, e cila rezultoi me shpërbërjen e Parlamentit dhe shpalljen e zgjedhjeve të reja.

BDI me rezultat bindës i fitoi edhe zgjedhjet parlamentare të vitit 2011, duke arritur të fitoj 15 mandate deputeti në organin më të lartë ligjvënës. Ndërkaq, rezultatin më të lartë, të shprehur në mandate deputetësh, kjo parti do ta arrij në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të vitit 2014, duke arritur të marrë 19 deputetë.

Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK)

Figure 4. The measures to be taken from the government level to support the creation and development of SMEs



Source: Author's calculations

Cooperation with various local and international institutions in various fields is very important for business development. This cooperation is also important for the exchange of experiences between SMEs and other institutions. SMEs with production activities have stated that their greatest cooperation they have is with businesses that operate within the country. Their statements (figure 5) it appears that 17% have cooperation with central institutions, 28% with local institutions, 42% with businesses operating within the country and 13% with foreign businesses.

Figure 5. Cooperation with institutions



Source: Author's calculations

Forms of cooperation of SMEs with other institutions are mainly for professional capacity building, and also for the knowledge on the use of technological equipments. Enterprises within the country are seen to have a satisfied level of cooperation and it is growing.

Conclusions and Recommendations

A favourable environment and a strong sector of SMEs are seen as a manifestation of dynamism and flexibility throughout the economy. The private sector of many economies in

the world is dominated by small and medium enterprises, which provide the highest number of employment in the entire private sector. From all the research we've done and revisions of previous studies, we found that the role of these companies in an economy is indisputable. Through the creation of wealth and employment economic growth is the best way to reduce in a sustainable manner the poverty of a country. The development of SMEs in Kosova can contribute in facing the numerous challenges associated with economic development, the effects of inequality, high levels of unemployment, demographic growth and the need for structural changes. SMEs development offers many job opportunities which can help in reducing unemployment and facing of demographic challenges which are growing rapidly. Besides this, the development of this sector can contribute to strengthening the competitiveness and productivity, promoting revenue growth, both global and per capita income. This development is likely to promote the structural transformation of the sector due to its link with innovations and technological development.

The private sector in Kosova consists of micro, small, medium and large enterprises. Despite the fact that sector of SMEs is relatively new, this sector constitutes 98% of all enterprises in Kosovo, representing a huge potential in the generation of new jobs and economic development. The creation of suitable environment for business and a support of a sustained development of SMEs are the basic conditions for economic development and the growth of social welfare, as well as a source of employment, renovation and productivity. This is the reason that today's main objective of our institutions is working towards increasing and supporting of this sector in order to make it more attractive to young entrepreneurs.

A more attractive business environment would enable young entrepreneurs to enter this sector, and thus increase employment opportunities for interested individuals and reduce the country's poverty line. The removal of investment barriers, growth and new job opportunities depend on the levels of governance; and the simplification of administrative procedures is important for the promotion and development of the SMEs sector. It is generally recognized the opinion that barriers have greater impact on small and medium-sized than in large enterprises. The regulation of the business environment is the most effective way to alleviate these obstacles or limitations and to increase the contribution of SMEs on economic development. Simplification of administrative procedures is a key for the promotion of SMEs sector in Kosovo. As part of these efforts there is a number of major achievements which have come due to some improvements in the business environment, such as tax reforms, VAT collection through cash registers, and other improvements on administrative issues.

There were interviewed 300 enterprises for this research, by which it is seen that most of them belonged to the commercial sector, and this applies at Kosovo's level where it is considered that more than 50% of SMEs belong to this sector. Also we it is seen that most enterprises had as a target their growth and development in the future, aiming to increase the number of employees and thereby alleviating the level of unemployment in Kosovo. These enterprises are continuously faced with challenges and constraints that hinder their development because of the unfavourable business environment. The only way out, from the surveyed SMEs was seen the support from government institutions in creating an enabling environment for local and foreign investments. The totality of regulatory reforms and the

programs in general should be directed to the establishment of an attractive environment for local and foreign investments, and led by the objective of meeting the standards for integration in the European Union.

7. References

- Bajçinca, Enver, Some futures of investing SMEs in Kosovo, *Journal of Economics and Political Econimy, 2015 (309-316).*
- Beck, T. Asli Demirguc, K. & Levine, R. (2005). SMEs Growth, and Poverty: Cross-Country Evidence. World Bank.
- Berisha, Gentrit & Shiroka-Pula, Justina (2015). Defining Small and Medium Enterprises: a critical review, *Academic Journal Of Business Administration Law and Social Sciences, IIPCCL Publishing, Tirana Albania (17-28).*
- Besnik A. Krasniqi" Entrepreneurship and Small Business Development in Kosova, *Nova Science Publisher, New York, 2012*
- Binks, M. and Coyone, J. (1983). ''The birth of enterprise''. Hobart Paper 98, *Institute of Economic Affairs, London.*
- Bytyçi, Ilir, Enterpreneurship and Inovative SME'S as a key of Economic Development – Kosovo case, *European Journal of Business Economics and Acountancy, 2015 (14-21)*
- Curran, J., Stanworth, J. And Watkins, D. (1986). The survival of the small firms 1 – the economics of survival and entrepreneurship. Aldershot: Gower.
- Decker, M., Schiefer, G., Bulander, R.(2006).Specific Challenges for small and medium-Sized Enterprises (SMEs) in m-business.In: Filipe, J., Greene, T.(Publisher): *Proceedings of the International Conference on e-business. Setubal: INSTICC Press.169-174.*
- European Commission.(2005).The new SME definition: user guide and model declaration section. Brussels: *Office for Official Publications of the European Communities.*
- Ferhad Analoui and Azhdar Karami (2003). STRATEGIC MANAGEMENT in Small and Medium Enterprises. Printed by, *Great Britain: TJ International.*
- Govori, Arbiana, (2013), Factors Affecting the Growth and Development of SMEs: Experience from Kosovo, Mediterrean Journal of Social Sciences, MCSER Publishing, Rome Italy (701-708).
- Hilary, R., (2000). Small and medium sized enterprises and the business environment. Greenleaf Publishing.
- Kraja, Y., & Osmani, E. (2013). Competitive advantage and its Impact in Small and Medium Enterprises (Smes), (Case of Albania). *European Scientific Journal edition. 9(16):77-85.*
- Krasniqi, Enver H. & Krsniqi, Sokol, (2013). The Impact of Business barriers in Entrepreneurship and Firm's Growth – Kosovo's perspective, *International Journal of Business and General Menagement, (59-56).*
- Kume, V., Koxhaj, A. & Kume, A. (2009). SMEs - A key factor for economic growth and employment. *Journal of Enterpreneurship and Innovation, 1:41-49.*

- Mustafa, M., E. Kutllovci, P. Gashi, B. Krasniqi. 2006. "Small and Medium Businesses." *Establishment, management and business growth.* 21.
- Scott, M. and Bruce, R. (1987). Five stages of growth in small businesses. Long Range planning, vol 20 pp 45-52.
- Smallbone, D. (1991). ''Success and failure in new business start-ups''. *International Small Business Journal, 8 (2):pp. 34-45.*
- Storey., D. J. (1994). Understanding the Small Business Sector, Routledge, London.
- Sultan S.S.,(2007),*Competitive advantage of small and medium sized enterprises:* The Case of Jordan's Natural Stone Industry. Maasctricht.

BASHKËSIA JASHTËMARTESORE – ANALIZA JURIDIKO-KRAHASUESE E ZGJIDHJES LIGJORE DHE PROBLEMET NË PRAKTIKË NË REPUBLIKËN E SERBISË DHE TË MAQEDONISË

(NON-MARITAL COHABITATION-LEGAL COMPARATIVE ANALYSIS OF LEGISLATION AND PROBLEMS IN PRACTICE IN REPUBLICS OF SERBIA AND MACEDONIA)

DOC. DR. DRAGANA RANĐELOVIĆ*
MsC. LEMANE MUSTAFA*

UDC:347.628.41 (497.11.497.7)

„Legum...id circo omnes servi sumus, ut liberi esse possimus“
(Të gjithë jemi robër të ligjit që të mund të jemi të lirë)

Ciceron

Abstrakt:

In this paper, the authors willtry, through the legal comparative analysisthe legislationof Republics ofSerbiaand Macedonia, to determineto what extentin the terms of effects the marital and non-marital cohabitation areequal,orto what extenttherights of non-maritalpartners are recognized.The subject of analysisare primarilythe Constitution andfamily lawsof thesetwo republics, but also manyother regulationsgoverningissues relatingto the rightsand obligations of non-marital cohabitation partners.We will tryto point out thedeficiencys in thelegal regulations,thepractical problemsandsuggestpossiblebetter solutions.In fact, despite thatfamily lawsequatemarriage and non-marital cohabitation, they are not equaleitherdefacto ordejure. The main method in this paper is comparative because, given the cultural and historical heritage and closeness that exists between these two countries, decisions which could be arrived this way could be the best and most practical.Having in mind thementionedsocial and economicsimilarities, there are no realbarriers that certainsolutions can not be mutuallyincorporated intolegislation.

Departamenti i shkencave juridike i Universitetit të Novi Pazarit, docente në fushat shkencore të së drejtës civile dragana.randjelovic@hotmail.com
Departamenti i shkencave juridike i Universitetit të Novi Pazarit,asistente në fushat shkencore të së drejtës civile lemanemustafa@gmail.com

Key words: non-marital cohabitation, effects of non-marital cohabitation, rights and obligations ofnon-marital cohabitation partners, the inheritance rightsof non-marital cohabitation partners, alimentation of non-marital cohabitation partners.

Hyrje

Bashkësia jashtëmartesore është institucion i së drejtës familjare, të cilën shumë vështirë është ta definojmë në mënyrë universale, që në përgjithësi të mund të miratohet. Vëzhguar në aspektin juridiko-krahasues, historik, por edhe nga kushtet bashkëkohore, bashkësia jashtëmartesore ka pasur elemente të ndryshme konstituive. Njëra nga definicionet tradicionale është ajo sipas të cilës bashkësia jashtëmartesore është bashkëjetesa e dy individëve të gjinive të ndryshme, e cila lidhet në mënyrë joformale dhe në të njëjën mënyrë përfundon.[268] Megjithatë, në sistemet bashkëkohore, elementi i gjinive të kundërta më nuk është elemenet konstituiv për bashkësinë jashtëmartesore.[269]Bashkësia jashtëmartesore si bashkëjetesë e dy personave të lidhur vetëm me ndjenjën e dashurisë dhe dëshirën për të jetuar së bashku, pa ndonjë formë dhe regjistrim, është një insititucion i vjetër sa vetë martesa ligjore-pandan. Megjithatë, gjatë historisë, qëndrimi i ligjëvënësit ka lëvizur nga ndalesa deri në ingjorimin e bashkësisë jashtëmartesore. Pamvarësisht mosnjohjes së saj nga ana e ligjëvënësit, ajo ka vazhduar luftën e saj të qetë me martesën duke korrur fitore. Në praktikë, kjo fillojë të krijojë probleme juridike për të cilat as ekzistimi i rregullativave ligjore nuk mundën që ti japin zhgjidhje. Që kur praktika gjyqësore fillojë të lulëzojë me raste të tilla, por edhe me zgjidhje të ndryshme, të cilat rezultuan nga përpjekjet e gjyqëtarëve që me bindjet e tyre të lira gjyqësore dhe kreative, ti plotësojnë zbrazëtirat ligjore, është dashur që të vijë deri të ndërhyrja e Gjykatës Suprme të Jugosllavisë. Ajo solli udhëzues për mënyrën e zgjidhjes së kontesteve të cilat lindin në lidhje me bashkësinë jashtëmartesore, ku sipas të cilës, bashkësia jashtëmartesore nuk ka mundur të jetë bazë për fitimin e të drejtave pronësore dhe të detyrimeve të bashkëshortëve jashtëmartesorë, eventualisht vetëm kontestet pasurore kanë mundur të zgjidhen sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës pronësore, rrespektivisht sipas dispozitave mbi pasurimin e pabazë dhe fitimin pa bazë juridike. [270] Efektet juridiko-personale të bashkësisë jashtëmartesore edhe më tutje vazhdojnë të jenë të papranuara.

Arsyejet e rritjes së numërit të bashkësive jashtëmartesore janë të numëruar dhe mund të grupohen në ato juridike, ekonomike, sociale etj. Për këtë lloj të bashkësisë më së shpeshti vendosin çiftet e reja të cilët duan ta testojnë dashurinë e tyre, t'ju ikin zakoneve tradicionale, rrespektivsht duan jetesëtë përbashkët, të liruar nga shpenzimet materiale të cilat i imponon ligji dhe tradita me rastin e lidhjes së martesës. Megjithatë, ekzistonë një numër i madhë edhe i çifteve të moshuar të cilët gjithënjë e më shpesh vendosin që ta kalojnë jetën në bashkësi jashtëmartesore. Arsyejet për të cilat ato nuk vendosin për martesë, janë kryesisht të natyrës financiare(që ti ndajnë shpenzimet e jetësës, por edhe që ta ruajnë të drejtën e trashëgimisë në pronë sidomos për pasardhësit).

[268]G. Kovaček-Stanić,,Porodično pravo" Pravni fakultet u Novom sadu, 2014, faqe 184.

[269]Holanda, Norvegjia, Danimarka, Suedija, Franca, etj.

[270]Z. Ponjavić, Porodično pravo, Pravni fakultet u Kragujevcu, 2007, faqe 123.

Sipas të dhënave të Institutit Republikan të statistikave në Serbi, në bashkësi jashtëmartesore jetojnë 3,83% persona më të vjetër se 15 vjeç. Të dhënat për personat të cilët jetojnë në bashkësi jashtëmartesore, për herë të parë janë mbledhur më vitin 2011. Në mes dy regjistrimeve, numëri i personave në martesë në Serbi është zvogëluar për më shumë se 10%. Nga totali 6.161.584 persona më të vjetër se 15 vjeç, në Serbi 236.063 jetojnë në bashkësi jashtëmartesore, kurse mosha mesatare e tyre është 40,5 vjeç.Sipas të dhënave të publikuar nga Instituti Republikan i Statistikave, meshkujt të cilët jetojnë në bashkësi jashtëmartesore janë mesatarisht të vjetër 42,28 vjeç, kurse femrat 38,66 vjeç. Ashtu siç theksohet, në mes dy regjistrimeve (2002-2011) është zvogëluar numëri i personave në martesë për 11,1%, përderisa numëri i personave të cilët nuk janë në martesë është rritur, edhe atë; beqarët/tëpamartuarit për 11.6%, personat e ve për 4,8%, kurse të divorcuarit për 20,2%.[271] Për Maqedoninë nuk ekzistojnë të dhëna statistikore të ngjajshme. Disa nga këto bashkësi përfundojnë në martesë, por një numër i madhë i tyre ndërpriten ashtu siç kanë lindur, jashtë dispozitave inistitucionale.

Sa i përketë të dhënave statistikore lidhur me fëmijët e lindur jashtëmartesës, përqindja e lindjeve jashtëmartesës në raportë me numrin e përgjithshëm të foshnjeve të posalindur, në vitin 2000 për Serbinë është 20,7%, kurse për Maqedoninë 9,8%; në vitin 2005 në Serbi janë shënuar 22,7% kurse në Maqedoni 12,4%; në vitin 2006 në Serbi kemi 22,5% kurse në Maqedoni kemi 12,5%; në vitin 2007 në Serbi 22,3% kurse në Maqedoni 12,6%; në vitin 2008 në Serbi kemi 22,8% kurse në Maqedoni 12,2%.[272] Nga këto të dhëna statistikore mund të arrijmë në përfundim se në Serbi, numëri i fëmijëve të lindur jashtëmartesës thuajse është dyfish më i madhë se në Maqedoni, sigurisht se në këto dy vende ekziston trendi i rritjes nga viti në vit.

Duke u përpjekur që të përputhet gjendja faktike dhe juridike dhe njëheritë ti ofrohet mbrojtje familjes, pamvarësisht çfarë do baze ajo të ketë, Ligji mbi familjen në Republikën e Serbisë dhe të Maqedonisë, jep përkufizim edhe për bashkësinë jashtëmartesore. Me këtë, jo vetëm që ka fituar bazën e vet ligjore, por edhe të drejtat dhe detyrimet e partnerëve jashtëmartesorë kanë fituar korrnizën ligjore, por njëheritë i kanë shuar edhe disa keqëkuptime, edhe atë më të zakonshme janë nëse bashkëjetesa e një çifti gej paraqet bashkësi jashtëmartesore apoedhe atë e përbënë lidhja e vazhdueshme dhe stabile e tyre. Pamvarësisht dallimeve thelbësore historike në mes bashkësisë jashtëmartesore dhe asaj martesore, përpjekjet e saja sfidojnë çfarë do forme dhe kufizime, të cilat janë imponuar nga rregullimi ligjor i një shteti, prandaj edhe dallimet kanë filluar të zhduken.

Megjithatë, a thua këto kanë krijuar edhe një keqkuptim tjetër të ri, që bashkësia martesore dhe ajo jashtëmartesore janë të barabarta?

Rregullimi ligjor i bashkësisë jashtëmartesore sipas dispozitave të Republikës së Serbisë dhe Maqedonisë.

[271] file:///C:/Documents%20and%20Settings/Administrator/Desktop/U%20vanbra%C4%8Dnoj%20zajednici%20%C5%BEivi%203,83%25%20gra%C4%91ana%20Srbije%20_%20EurActiv%20Srbija.htm,(05.01.2016).

[272] http://www.doiserbia.nb.rs/img/doi/0038-982X/2010/0038-982X1001001S.pdf, (27.01.2016).

Kushtetuta e R. së Serbisë, si akti më i lartë juridik në një vend me të cilën duhet të jenë në përputhje të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në nenin 62 paragrafi5, thekson se: ,,Bashkësia jashtëmartesore barazohet me martesën, në përputhje me ligjin".Ligji mbi familjen në R.e Serbisë[273] rregullon bashkësinë jashtëmartesore si,, Bashkëjetesë e vazhdueshme e një burri dhe një gruaje, në mes të cilëve nuk ka pengesa martesor(partnerët jashtëmartesor)".[274]

Kushtetuta e R.së Maqedonisë, për dallim nga Kushtetuta e R. së Serbisë nuk e barazon bashkësinë jashtëmartesore me martesën. Ajo vetëm e përmend në nenin 40., kurse çështjen e statusit të saj dhe rregullimit ia lë ligjeve: ,, Raportet juridike në martesë, në familje dhe në bashkësi jashtëmartesore janë të rregulluara me ligj". Ligji mbi familjen në R.e Maqedonisë[275] rregullon bashkësinë jashtëmartesore në nenin 13.: ,, Bashkësia e një mashkulli dhe një femre e cila nuk është krijuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji(bashkësia jashtëmartesore) dhe e cila ka zgjatur më së paku një vit, është e barabartë me bashkësinë martesore, në aspektin e të drejtave në mbajtjen në mes veti dhe në lidhje me pasurinë e fituar gjatë kohës sa ka zgjatur kjo bashkësi".Nga këto përkufizime ligjore mund ti ndajmë këto elemente konstituive; bashkëjetesa e vazhdueshme, qëndrueshmëria, gjinia e kundërt dhe mosekzistimi i pengesave martesore.

Bashkëjetesa paraqet tërësinë e relacioneve në sferën emocionale, seksuale, ekonomike, prokreative, kulturore, intelektuale, sociale dhe të nevojave të tjera të gruas dhe të burrit.[276] Ajo paraqet brendësinë dhe përmbajtjen e martesës apo të bashkësisë jashtëmartesore. Megjithatë, përderisa për martesën jetesa e përbashkët është pasojë, për bashkësinë jashtëmartesore ajo paraqet kusht për ekzistimin e saj, rrespektivisht, përderisa bashkëjetesa nuk ekziston nga martesa mbetet vetëm një formë boshe, kurse tek bashkësia jashtëmartesore nuk mbetet asgjë. Tek martesa është e mundur që bashkëshortët të kenë vende të banimit të ndryshëm, megjithatë tek bashkësia jashtëmartesore kjo nuk është e mundur, ajo duhet të ketë edhe manifestimin e saj të jashtëm.[277] Bashkëjetesa vërtetohet sipas këtyre fakteve; banimi i përbashkët, ndarja e obligimeve ditore, raporti stabil dhe i njohur, menaxhim i përbashkët i financave, marrëdhënie seksuale të rregullta dhe partnerëttë jenë persona të përgjegjshëm dhe ta kuptojë rëndësinë e bashkëjetesës.[278]Bashkësia është element i pakundërshtueshëm i cili paraqet kusht të domosdoshëm për ekzistimin e bashkësisë jashtëmartesore si në Serbi poashtu edhe në Maqedoni.

Qëndrueshmëria. Shumica e sistemeve juridike në të cilën bën pjesë edhe R. e Serbisë, i shmanget definimit të gjatësisë së qëndrueshmërisë së bashkëjetesës e cila është e nevojshme me qëllim që ajo të mund të konsiderohet edhe ligjërisht si bashkësi jashtëmartesore, por ajo është e formuluar në aspektin e standarteve juridike të cilët gjyqëtari do ti interpretojë në çdo rast konkret. Gjyqëtarët për këtë çështje, në praktikë kanë marrë qëndrim që me rastin e definimit të qëndrueshmërisë së bashkësisë, nuk ka rëndësi thelbësore

[273],,Gazeta zyrtare e R. Srbisë", nr. 18/2005, 72/2011, 6/2015.
[274]Neni 4. paragrafi 1. Ligji mbi familjen i R.S.+
[275],,Gazeta zyrtare e Republikës së Makedonisë", nr. 80/92.
[276]S. Panov, Porodično pravo, Pravni fakultet, Beograd, 2010, faqe 144.
[277]Z. Ponjavić, Porodično pravo, Pravni fakultet u Kragujevcu, 2007., faqe 120.
[278]O. Jović, Brak ili vanbračna zajednica – pravo izbora, Zbornik radova „Novo porodično zakonodavstvo", Kragujevac, 2006, faqe 191.

dhe faktike nëse bashkësia jashtëmartesore ka zgjatur gjatëkohë, por me rëndësi është që partnerët të cilët jetojnë në të, të kenë vullnet dhe qëllim që ta krijojnë bashkëjetesën e përbashkët ku qëndrueshmëria nuk është e përkohëshme apo e kufizuar. Me rëndësi vendimtare është vetëdisimi, rrespektivisht vullneti i partnerëve jashtëmartesorë.[279] Ligji mbi familjen në R.e Maqedonisë, për dallim nga ai serb, e precizon gjatësinë e qëndrueshmërisë së bashkëjetesës në një vit. Kjo sjellë siguri të caktuar ligjore dhe dukshëm e redukton subjektivitetin e gjyqëtarit në vlerësimin e tij, në rastet e vëretetimit nëse ka ekzistuar bashkësia jashtëmartesore.

Gjinitë e kundërta theksohen në secilin përkufizim të definicionit të martesës dhe të bashkësisë jashtëmartesore në shumicën e vendeve. Sekset e kundërta është një bazë biologjike për martesën dhe bashkësinë jashtëmartesore dhe paraqet fakt biologjik i cili është përcaktuar nga qëllimi kryesor i martesës-lindja dhe rritja e fëmijëve.[280] Megjithatë, arsyetimi i tillë i supozimeve të cilat janë të nominuara si kushte të domosdoshme për plotëfuqishmërinë e martesës dhe bashkësisë jashtëmartesore, dhe të cilat mund të hasen thuajse në të gjitha literaturat të cilat merren me materien e martesës dhe bashkësisë jashtëmartesore, dhe me gjithë rrespektin dhe njohjen logjike, megjithatë ajo mund të haset në disa kritika. Në shumë vende është e lejuar lidhja e martesës edhe në mes të çifteve të gjinisë së njëjtë, më gjërë, më pakë apo pa asnjë kufizim. Megjithatë kritika jonë nuk ka të bëjë me idenë, që më mirë të përcillen trendet dhe zgjidhjet e vendeve më të zhvilluara[281], por në vetë qëllimin e martesës dhe në përkufizimin e homoseksualizmit. Gjithësesi një nga qëllimet kryesore të martesës dhe bashkësisë jashtëmartesore, është lindja dhe rritja e fëmijëve, por megjithatë ai nuk është i vetmi. Krijimi fizik, emocional, ekonomik, intelektual i bashkësisë në të cilën partnerët gjejnë ndihmë morale, emocionale dhe financiare, poashtu paraqet njërin nga arsyejet kryesore,pse çiftet përcaktohen për bashkëjetesë, dhe e cila mund të realizohet pamarrë parasysh gjinin dhe moshën. Nga ana tjetër, lindja dhe rritja e fëmijëve është e mundur të realizohet edhe në bashkësinë e gjinisë së njëjtë.[282]Megjithatë ajo që është më me rëndësi, dhe e cila asesi nuk has në mirëkuptim dhe në pranimin e gjërë të publikut, por edhe të juristëve, është fakti që homoseksualizmi nuk është sëmundje, por tashmë sjellje normale e zakonshme. Në bazë të vendimit të marrë në vitin 1992 nga Organizata Botërore e Shëndetësisë(World Healt Organization- WHO) homoseksualizmi është hequr nga lista e sëmundjeve. Homoseksualizimi është e drejtë natyrore e zgjedhjes së orientimit seksual. Kjo nuk është sëmundje të cilën mund ta fitosh gjatë jetës, nuk është ngjitëse dhe sigurisht nuk mund të shërohet. Shoqata e mjekëve serb është pajtuar lidhur me këtë vendim. Deri sa të bëhet sjellja e ligjeve dhe e ndryshimeve të paralajmëruara, të cilat do ja njohin të drejtat e bashkësive të krijuara nga personat e gjinisë së njëjtë në vendin tonë, të paktën juristët duhet

[279]file:///C:/Documents%20and%20Settings/Administrator/Desktop/RE%C4%8C%20ADVOKATA-%C4%8Desta%20pitanja%20_%20Advokatska%20kancelarija%20Cvjeti%C4%87anin%20&%20Partners.htm (16.1.2016).

[280]Z. Ponjavić, Porodično pravo, Pravni fakultet u Kragujevcu, 2007, faqe 84.

[281]NëDanimarkë, Holandë, Norvegji, Suedi, bashkësia e homoseksualëveështëplotësisht e barabartë me atëtëheteroseksualëve; nëFrancë, Belgjikë, Kroaci, Spanjëatyre u janëtënjohuradisatëdrejta.

[282]Raportetprindëroremundtëkrijohenedhe me rrugëligjore-adoptim, kursenjërangamundësitëmundtëjetëedherasti me amësinësurogative.

në tekstet e tyre ti harmonizojnë definicionet me qëndrimet zyrtare të organizatave kompetente.

Mosekzistimi i pengesave martesore. Pengesat martesore janë të definuara si fakte apo rrethana të cilat pengojnë lidhjen e martesës së plotëfuqishme. Ato mbrojnë interesat e bashkëshortëve të ardhshëm por edhe interesin shoqëror. Ligji mbi familjen në R. e Serbisë në pengesa martesore numëron; martesën ekzistuese, paaftësinë për të paragjykuar, miturinë, gjininë familjare, mungesën e vullnetit dhe raportet e kujdestarisë. Që bashkëjetesa e personave me gjini të kundërt të mund të njihet si bashkësi jashtëmartesore, e domosdoshme është që në mes tyre të mos ekzsitojnë pengesa martesore. Me rëndësi është të theksohet se me këtë përkufizim është delomuar një nga keqkuptimet më të përhapura. Do të thotë se praktika gjyqësore ka pasur raste ku një person pos bashkësisë martesore ka pasur lidhje stabile dhe të qëndrueshme me personin tjetër. Bashkësia e tillë nuk prezenton bashkësinë jashtëmartesore për shkak të mosekzistimit të monogamisë dhe nuk mund të jetë burim i të drejtave dhe obligimeve. Vetëm fëmijët e lindur nga një bashkësi e tillë janë të barabartë plotësisht me fëmijët e lindur në martesë dhe në bashkësi jashtëmartesore. Pa marrë parasysh prejardhjen, të gjithë fëmijët janë juridikisht të barabartë dhe kanë status të njëjtë juridik.

Ligji mbi familjen në R.e Maqedonisë nuk përmend pengesat martesore, por vetëm në një formulim jo adekuat i cili është dhënë në nenin 13. implikon mundësinë e ekzistimit të pengesave martesore, pamvarësisht pengesave martesore ne mes partnerëve. Që do të thotë se neni 13. parasheh që bashkësia e cila nuk është krijuar në pajtim me dipozitat ligjore konsiderohet bashkësi jashtëmartesore, me kusht që të ketë zgjatur së paku një vit dhe të jetë plotësuar kushti sa i përket gjinisë së kundërt. Ashtu si janë paraparë kushtet për lidhjen e martesës së plotëfuqishme nga neni 15.- 22., interpretimi ligjor dhe gjuhësorë i nenit 13. dërgon në konkulzionin se mosekzistimi i pengesave martesore nuk është kusht për ekzsitimin e plotëfuqishëm të bashkësisë jashtëmartesore. Me këtë rregullim ligjor jopreciz, rihapet një pasiguri juridike dhe mundësi për krijimin e situatave në praktikë të cilat do i cënojnë interesat e individëve por edhe disa nga interesat më të rëndësishme shoqërore. Ajo që është e domosdoshme të bëhet është ndjekja e shembullit, që bashkësia jashtëmartesore të futet si kategori e veçantë e të drejtës familjare dhe në mënyrë precize të definohet nocioni dhe kushtet për themelimin dhe plotëfuqishmërinë e saj.

Efektet juridike të bashkësisë jashtëmartesore

Ligji mbi familjen në R. e Serbisë, në nenin 4. paragrafi2. parasheh se partnerët jashtëmartesorë kanë të drejta dhe detyrime si të bashkëshortëve sipas kushteve të cilat janë parashikuar me këtë ligj. Nga ky formulim ligjor nënkuptohet se në aspektin e efektit juridik, martesa dhe bashkësia jashtëmartesore janë plotësisht të barabarta.

Ligji mbi familjen në R. e Maqedonisë, barazon martesën dhe bashkësinë jashëmartesore, mirëpo vetëm në aspektin e të drejtave në mbajtje në mes veti dhe në lidhje me pasurinë e fituar gjatë kohës sa ka zgjatur kjo bashkësi.(neni 13.).

Efektet e bashkësisë jashtëmartesore në statusin personal të partnerëve jashtëmartesorë. Në statusin personal bëjnë pjesë çështjet të cilat i përkasin emrit personal,

shtetësisisë dhe zotësisë për të vepruar. Përderisa martesa ndikon në të gjitha elementet e statusit personal (lidhja e martesës mundëson ndryshimin e mbiemrit, rrespektivisht fitimin e asaj që ka bashkëshorti; fitimin e shtetësisë së bashkëshortit sipas kushteve të përcaktuara; fitimin e zotësisë së plotë për të vepruar nga ana e personit të mitur i cili i ka mbushur 16 vite-emancipimi), kurse bashkësia jashtëmartesore nuk ndikon në statusin personal të partnerëve jashtëmartesorë.

Sa i përket ndryshimit të mbiemrit, ajo kryhet me rastin e lidhjes së martesës në procedurë pranë shërbimit të gjendjes civile.[283] Duke pasur parasysh se kjo procedurë nuk ekziston me rastin e krijimit të bashkësisë jashtëmartesore, e as nuk është e nevojshme rrespektimi i ndonjë forme, prandaj nuk është e mundur që të ndryshohet mbiemri në këtë mënyrë. Megjithatë, ekziston mundësia që edhe partnerët jashtëmartesorë të bartin të njëjtin mbiemër, vetëm nëse ndryshimi është bërë në përputhje me ligjin, duke rrespektuar kushtet e parashikuara.[284]Sa i përket mundësisë së fitimit të shtetësisë sipas kushteve më të lehta neni 17. i Ligjit mbi shtetësinë në R.e Serbisë[285] parasheh që i huaji mund ta marrë shtetësinë e R. së Serbisë me kusht që së paku tri vite të jetë në bashkësi martesore dhe njëkohësisht duke plotësuar edhe kushtet tjera. Ky formulim preciz përjashtohen mundësinë që bashkësia jashtëmartesore të jetë bazë për fitimin e shtetësisë.

Poashtu edhe Ligji mbi shtetësinë në R. e Maqedonisë[286] në nenin 9. parashtron të njëjtat kushte sipas të cilave i huaji nën kushte më të lehta mund ta fitojë shtetësinë maqedonase dhe kjo e drejtë nuk i njihet të huajve të cilët janë në bashkësi jashtëmartesore me personin që ka shtetësi maqedonase.Kur është në pyetje fitimi apo arritja e zotësisë për të vepruar, ligji poashtu përjashton dhe parasheh që zotësia e plotë për të vepruar arrihet me lidhjen e martesës me vendim gjyqësorë.[287] Nga kjo mund të nënkuptohet se themelimi i bashkësisë jashtëmartesore nuk paraqet bazë për arritjen e zotësisë së plotë për të vepruar të personit i cili ka zotësi të pjeshme për të vepruar dhe i cili i ka mbushur 16 vite përderisa nuk janë plotësuar kushtet tjera.[288]

Efektet e karkterit personal tëbashkësisë jashtëmartesore në aspektin e të drejtave dhe detyrimeve të partnerëve jashtëmartesorë. Në efektet juridike me karakter personal, Ligji mbi familjen në R. e Serbisë parasheh për partnerët martesorë të drejta dhe detyrime të cilat kanë të bëjnë me; kalimin e jetesës së përbashkët, rrespektimin dhe ofrimin e ndihmës, zgjedhjen e punës dhe profesionit, vendin e banimit dhe në lidhje me amvisërinë e përbashkët.Duke pasur parsysh që Ligji mbi familjen e barazon martesën dhe bashkësinë jashtëmartesore në aspektin e të drejtave dhe obligimeve, mund të përfundojmë se rregullat të cilat ndikojnë në efektin juridik personal, i përkasin edhe partnerëve jashtëmartesorë. Këto rregulla janë të karakterit imeprativ sepse bashkëshortët nuk mund ti ndryshojnë me vullnetin e tyre, por ato

[283]Për më shumë neni 348. Ligji mbi familjen në R.S-së dhe neni 31. i Ligjit mbi familje në R.M-së.
[284]Për më shumë neni 346, 347. Ligji mbi familjen në R.S-së dhe neni 5. Ligji mbi emrin personal në R.M-së.
[285],, Gazeta zyrtare e R. S-së.", nr.135/2004 dhe 90/2007.
[286],, Gazeta zyrtare e R.M-së" , nr.67/92 e datës 03.11.1992.
[287]Neni 11. pargrafi 2. Ligji mbi familjen në R.S-së dhe neni 79 Ligji i procedurës jashtëkontestimore në R.S-së.
[288]Përmëshumëneni 11. Parg. 3. Ligjimbifamiljennë R.S dheneni 93. Ligji I procedures jashtëkontestimorei R.M.

mund të kryhen edhe në mënyrë urdhëruese. Megjithatë, mosrrespektimi i tyre mund të çojë deri te humbja e disa te drejtave të cilat janë parashikuar me këtë ligj.[289]

Ligji mbi familjen në R. e Maqedonisë barazon martesën dhe bashkësinë jashtëmartesore vetëm në aspektin e të drejtave dhe detyrimeve të karakterit pasuror. Megjithatë, rrespektimi i të drejtave dhe detyrimeve të karakterit personal paraqesin kushtin natyror dhe të domosdoshëm për ekzistimin e bashkësisë jashtëmartesore. Përderisa nuk ka ndihmë dhe respektë reciprok, nuk mund të konsiderojmë se ekziston bashkësia jashtëmartesore ligjërisht e para së gjithash faktikisht.

Partnerët jashtëmartesorë janë të detyruar të bashkëjetojnë. Bashkëjetesa për bashkësinë jashtëmartesore, ashtu siç është thënë, nuk është vetëm brendësia dhe përmbajtja por edhe kushti i ekzistimit të saj, rrespektivisht mbarimi mund të çojë deri te shuarja e bashkësisë jashtëmartesore. Për dallim nga martesa, bashkësia jashtëmartesore përfshinë hapësirën e domosdoshme të bashkësisë, rrespektivisht është identike me kuptimin e banimit të përbashkët dhe mbajtjen e shtëpisë.[290] Megjithatë këto dallime faktike të martesës dhe bashkësisë jashtëmartesore mund të hasin në kritika. Që do të thotë se, pse duhet të merret si rregull, që mosekzistimi i bashkëjetetësës së vazhdueshme mund të sjellë deri te shuarja e bashkësisë jashtëmartesore. Më e drejtë do ishte që në përputhje me parimet kushtetuese, barabartësimin e këtyre dy bashkësive t'ja lëm gjykatës në çdo rast konkret që ajo vetë ta vlerësojë nëse ekziston ose jo. Në kushte bashkëkohore, sociale dhe ekonomikisht të pasigurta, shpesh partnerët janë të ndarë për shkak vendit të ndryshëm të punës apo shkollimit. Mirëpo, për derisa i kalojnë së bashku vikendet, pushimet vjetore, përderisa planifikojnë të ardhme të përbashkët, dhe për derisa gjatë kohës që nuk janë të ndarë nën rrethana të arsyeshme sillen si partnerë jashtëmartesorë, në situata të tilla, duhet të njihet ekzistmi i bashkësisë jashtëmartesore, a në rast të kontestit eventual rrethë pasurisë së përbashkët apo detyrimit për ushqim, do duhet të konsiderohet nëse bashkësia jashtëmartesore ka ekzistuar edhe gjatë kohës së ndarjes së tyre faktike. Neni 25. i Ligjit mbi familjen parasheh që bashkëshortët janë të obliguar të kalojnë jetesën së bashku dhe që reciprokisht të ndihmohen dhe të rrespektohen. Detyrimi i tillë nënkupton sjelljen e ndërsjelltë emocionale, morale dhe ndihmën ekonomike si dhe plotësimin e dëshirave dhe nevojave të ndërsjellta. Partnerët jashtëmartesorë janë të pavarur në zgjedhjen e punës dhe profesionit. Kjo pamvarësi është pasojë e parimit të barabartësisë e cila manifestohet në të drejtën martesore përmes autonomisë personale dhe ekonomike, sjellje e njëjtë edhe e partnerëve jashtëmartesorë.

Raportet pasurore të partnerëve jashtëmartesorë

Ligjëvënësit familjarë të R.së Serbisë dhe Maqedonisë poashtu janë të pajtimit sa i përket çështjes së raporteve pasurore të partnerëve jashtëmartesorë, dhe ato plotësisht i barazojnë me martesën. Në nenin 191. të Ligjit mbi familjen në R. e Serbisë shprehimisht parashihet që pasuria të cilën partnerët jashtëmartesorë e kanë arritur gjatë kohës së

[289]Në nenin 151. Parag.3. Ligji mbi familjen i R.S-së parasheh se nuk ka të drejtë në mbajtje bashkëshorti nëse pranimi i kërkesës së tij për mbajtje paraqet padrejtësi të dukshme për bashkëshortin tjetër.
[290]O. Cvejić-Jančić, Porodično pravo-bračno pravo, Pravni fakultet u Novom sadu, 2001. faqe 115.

bashkësisë jashtëmartesore, paraqet pasurinë e tyre të përbashkët. Në raportet pasurore të partnerëve jashtëmartesorë zbatohen dispozitat e Ligjit mbi familjen në lidhje me raportet pasurore të bashkëshortëve. Pasurinë të cilën partnerët jashtëmartesorë e kanë fituar para martesës apo gjatë martesës, me ndarje nga pasuria e përbashkët, rrespektivisht me trashëgimi, dhuratë apo me punë tjetër juridike e cila përmban të drejta ekskluzive, paraqet pasurinë e veçantë të secilit bashkëshortë dhe në mënyrë të pavarur mund ta disponojë dhe ta administrojë atë. Pasurinë e përbashkët e administrojnë dhe e disponojnë bashkërisht. Partnerët jashtëmartesorë marrëdhëniet e tyre pasurore mund ti rregullojnë edhe me kontratë. Para rregullimit të marrëdhënieve të tyre ato janë plotësisht të lirë në kufijtë e rregullave imperative, të rendit juridik publik dhe të mirave zakonore. Për lidhjen e këtyre kontratave kompetent janë zyrat e noterisë.

Partneri jashtëmartesorë i cili ushtron të drejtën prindërore ndaj fëmijës së përbashkët, ka të drejtë banimi në banesën ku pronarë është prindi tjetër i fëmijës, nëse ai dhe fëmija nuk kanë të drejtë në pronësinë e banësës ku janë shpërngulur.

Zgjidhje interesante ofron ligjëvënësi maqedonas kur janë në pyetje raportet pasurore të partnerëve martesorë dhe jashtëmartesorë, sepse këto raporte rregullohen me ligjin Ligji mbi pronësinë dhe të drejtat tjera reale[291], e jo me Ligji mbi familjen. Zgjidhjaligjore sa i përket pasurisë së përbashkët dhe asaj të veçantë është plotësisht e njëjtë sikurse në Ligjin mbi familjen në R.e Serbisë (neni 66.-80.). Në nenin 81. ligjëvënësi maqedonas shprehmisht i barazon partnerët martesorë dhe ata jashtëmartesorë sa i përketë administrimit, disponimit si dhe ndarjes së pasurisë.

Problemet në praktikë

Një nga problemet me të cilat partnerët jashtëmartesorë ballafaqohen në praktikë është vërtetimi i ekzistimit të bashkëjetesës. Kjo është një çështje thelbësore sepse nga kjo varet nëse ligji do e njeh bashkësinë e një burri dhe një gruaje si bashkësi jashtëmartesore dhe do i'a njehë të gjitha të drejtat dhe obligimet të cilat rezultojnë nga ekzsitimi i saj. Kjo poashtu është edhe problemi më i madhë, sepse, ashtu siç është cekur, për dallim nga martesa, për bashkësinë jashtëmartesore nuk udhëhiqet asnjë evidencë dhe as që kërkohet ndonjë formë për lidhjes e saj, rrespektivisht ajo nuk raportohet para organeve kompetente.

Ekzistojnë shumë mënyra për vërtetimin e ekzistimit të bashkëjetesës. Para së gjithash janë dëshmitarët ata të cilët mund me vëzhgimet e përditshme dëshmojnë nëse e njëjta ekziston apo jo. Këto janë, më së shpeshti personat të cilët jetojnë në rrethin e afërt dhe të cilët çdo ditë kanë qenë dëshmitarë të manifestimit faktik të bashkëjetesës së partnerëve jashtëmartesorë. Bashkësia poashtu mund të vërtetohet edhe përmes dëshmisë së vendbanimit, rrespektivsht nëse adresat e partnerëve përputhen, nga dëshmitarët të cilët vërtetojnë ekzistimin faktik të saj, padyshim që mund të jenë prova të cilat mundësojnë realizimin e të drejtave të partnerëve jashtëmartesorë. Krahas problemit rrethë dëshmimit të ekzistimit të bashkëjetesës, problemi tjetër ka të bëj me vërtetimin e lindjes dhe shuarjes së bashkësisë jashtëmartesore. Këto dy momente kohore kanë rëndësi për realizimin e disa të drejtave por edhe provimin e fakteve të caktuara. Kështu, për shembull, pasuria e veçantë e

[291] ,, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 18/2011

partnerëve jashtëmartesorë konsiderohet pasuria e cila është fituar para krijimit të bashkësisë jashtëmartesore, dhe partnerët jashtëmartesorë përgjegjen vet për obligimet të cilat i kanë ndërmarrë para themelimit të bashkësisë jashtëmartesore.

Sa i përket të drejtës së mbjatjes(detyrimi për ushqim), bashkësia jashtëmartesore është plotësisht e barabartë me martesën sipas dispozitave ligjore të Serbisë dhe të Maqedonisë.[292] Ligji parasheh gjatësinë e detyrimit për ushqim i cili është pesë vite nga momenti i përfundimit të bashkësisë. Për dallim nga martesa, për përfundimin e bashkësisë jashtëmartesore nuk kërkohet asnjë formë por ajo përfundon thjeshtë me vullnetin e partnerëve jashtëmartesorë, prandaj në praktikë paraqiten probleme rrethë vërtetimit të përfundimit të bashkësisë jashtëmartesore. Ky moment mund të jetë madje edhe më i ngadalshëm nga vetë momenti i themelimit të saj. Poashtu dilemat ekzistojnë edhe rrethë rrethit të personave për mbajtje. Që do të thotë, në mesin e të afërmve të gjakut, debitori i mbajtjes përcaktohet sipas rregullave të së drejtës trashëgimore për rendit ligjor trashëgues. Bashkëshorti është debitori i mbajtjes, si detyruesi i parë i trashëgimisë ligjore. Pasi që Ligji mbi trashëgiminë në R. e Serbisë si dhe vetë praktika gjyqësore, nuk i njohin partnerët jashtëmartesorë si trashëgimtarë ligjorë, atëherë shtrohet pyetja nëse ato mund të jenë debitor të mbajtjes.[293]

Sa i përket të drejtave të fëmijëve jashtëmartesorë që të dy shtetet janë të një pajtimi. Kushtetuta e R.së Serbisë dhe ajo e Maqedonisë, njëjtë sikurse edhe ligjet mbi familjen në këto dy vende, barazojnë fëmijët e lindur në martesë dhe jashtëmartesës në aspektin e të drejtave dhe detyrimeve. Por prap, sa i përket vërtetësimit të atësisë ekzistojnë dallime. Sipas ligjit, babai i fëmijës që ka lindur në martesë konsiderohet bashkëshorti i nënës së fëmijës. Kurse babai i fëmijës së lindur jashtëmartese konsiderohet burri të cilit atësia i është vërtetuar me njohje, rrespektivisht atij të cilit atësia iu është vërtetuar me vendim të plotëfuqishëm gjyqësorë.[294] Procedura është e komplikuar nga se nuk kemi supozime rrethë atësisë së partnerit jashtëmartesorë, por është e domosdoshme pranimi i tij përpara organit kompetent. Me përjashtim të rasteve kur fëmija lind me ndihmën biomedicinale, dhe për derisa partnerët jashtëmartesorë kanë dhënë pëlqimin e tyre, vlejnë supozimet për atësinë e tyre.Partnerët jashtëmartesorë në R.e Serbisë nuk kanë të drejtë që ta trashëgojnë njëri tjetrin. Kjo paraqet njërin nga lëshimet më të mëdha në materien e cila rregullon bashkësinë jashtëmartesore dhe i bëhet diskriminim partnerëve jashtëmartesorë dhe njëheritë i pamundësohet realizimi i të drejtave të tyre. Ligji mbi trashëgiminë në R.e Serbisë[295] në rrethin e trashëgimtarëve ligjor nuk numëron edhe partnerët jashtëmartesorë por vetëm bashkëshortët martesorë. E vetmja mundësi që atyre i mbetet është trashëgimia sipas ndonjë baze tjetër trashëgimore. Në praktikë gjykatat procedojnë në përputhje me Ligjin mbi trashëgimin dhe partnerëve jashtëmartesorë nuk i njihet e drejta që të jenë trashëgimtarë ligjorë.[296] Nëse e marrim parasysh Kushtetutën dhe Ligjin mbi familjen në R. e Serbisë, të cilët i barazojnë partnerët jashtëmartesorë dhe ata martesorë, parashtrohet pyetja nëse gjykatat me procedime të tilla mund ta kenë shkelur Kushtetutën dhe ligjin? Duke pasur në konsideratë që Kushtetuta dhe

[292]Për më shumë neni 152. Ligji mbi familjen i R.S-së dhe neni 185. i Ligjit mbi familjen i R.M-së
[293]S. Panov, Porodično pravo, Pravni fakultet Univerziteta u Beogradu, 2010, faqe 148
[294]Neni 45. Ligji mbi familjen i R. së Serbisë.
[295],, Gazeta zyrtare e R.Serbisë" , nr.46/95, 101/2003, 6/2015.
[296]Vendimi i Gjykatës së Rrethit të Çaçakut, 454/2007 nga 18.04.2007.

Ligji mbi familjen janë sjellur pas Ligjit mbi trashëgiminë, shtrohet pyetja nëse organet kompetente do duhej ti interpretonin dispozitat ligjore të cilat më parë janë sjellur dhe të cilat nuk kanë pasur ndryshime, kështu që të jenë në përputhje me nenin 62. paragrafi 5. i Kushtetutës së R. së Serbisë dhe neni 4. paragrafi 2 i Ligjit mbi familjen. Sepse edhe Ligji mbi familjen, e përdorë termin bashkëshortët e jo partnerët jashtëmartesorë. Në nenin 4. ato në thelb janë të barabartë, kurse çështja e terminologjisë mbetet me aq.

Për dallim nga ligjëvënësi serb, Ligji mbi trashëgiminë në Maqedoni[297]shprehimisht i njeh edhe partnerët jashtëmartesorë si trashëgimtarë ligjorë. Edhe pse është sjellur një dekad para Ligjit mbi trashëgiminë në Serbi, dhe me këtë zgjidhje ai ka ecur përpara dhe meriton lavdëratë sepse parandalon padrejtësi dhe diskriminime të shumta. Ligji mbi trashëgiminë në Maqedoni rregullon pozitën trashëgimore të bashkëshortëve jashtëmartesorë dhe të fëmijëve të lindur në bashkësi jashtëmartesore. Neni 3. përcakton parimin e barabartësisë në trashëgimi të gjithë qytetarëve dhe shprehimisht parasheh barabartësinë edhe në marrëdhënie jashtëmartesore. Ligji mbi trashëgiminë në R.e Maqedonisë në aspektin e të drejtave për të trashëguar barazon raportet martesore me ato jashtëmartesore. Poashtu shprehimisht i'a njeh të drejtat për të trashëguar edhe fëmijëve jashtëmartesorë përderisa marrëdhënia jashtëmartesore është vërtetuar në mënyrën e përcaktuar me ligj.[298] Partnerët jashtëmartesorë mund ta trashëgojnë njëri tjetrin si bashkëshortë vetëm nëse janë plotësuar disa kushte (nëse bashkësia jashtëmartesore deri në momentin e vdekjes e trashëgimlënësit ka zgjatur së paku 10 vite; nëse nga ajo bashkësi jashtëmartesore kanë lindur fëmijë, kurse bashkësia jashtëmartesore ka zgjatur së paku 5 vite; nëse në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, asnjëri nga personat të cilët kanë jetuar së bashku nuk kanë qenë ligjërisht në martesë me personin e tretë, apo nëse trashëgimlënësi ka qenë ligjërisht në martesë me personin e tretë, por ka dorëzuar kërkesë për shkurorëzim apo anulim të martesës, dhe pas vdekjes së tij është konstatur se padia ka fituar mbështetje juridike. Kur bëhet fjalë për pozitën e personave që kanë jetuar në bashkësi jashtëmartesore si trashëgimtarë, vlen të theksohet se personat që kanë bashkëjetuar nuk konsiderohen si trashëgimtarë të domosdoshëm.[299]

Që bashkëshortët jashtëmartesorë të konsiderohen si anëtarë të familjes së siguruesit tek Fondi për sigurim shëndetësorë, është e nevojshme para së gjithash dëshmia e bashkëshortit jashtëmartesorë që bashkëjetesa e tyre zgjatë së paku dy vite dhe dëshmia e dy dëshmitarëve rrethë ekzistimit të bashkësisë jashtëmartesore, e cila është e vërtetuar pranë organit kompetent komunal, rrespektivisht pranë gjykatës.[300]

Një nga problemet që paraqitet në praktikë është mosnjohja e të drejtës për lirim nga pagesa e tatimit në lidhje me bartjen e të drejtave absolute tek blerja e patundshmërive. Ligji mbi tatimin në pronë[301] në nenin 23. paragrafi 1.ka paraparë pagesën e tatimit në bartjen e të drejtave absolute tek bartja e pronësisë e paluajtshme. Neni 31. parasheh që tatim nuk paguhet mbi bartjen e të drejtave absolute lidhur me të drejtën e pronësisë së banesës apo të ndonjë apartamenti familjar, përkatësisht mbi pronësinë e pjesës së banesës apo të

[297],, Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë" nr.47 nga 12.09.1996.
[298]Neni 4. Ligji mbi trashëgiminë në R. e Maqedonisë.
[299]Hamdi Podvorica ,, E drejta trashëgimore" Prishtinë, 2006, faqe 18.
[300]http://www.rfzo.rs/download/Izdavanjeknjizice.pdf, (19.01.2016).
[301]Sl. glasnik RS", br. 26/2001, „Sl. list SRJ", br. 42/2002, „Sl. glasnik RS", br. 80/2002, 135/2001, 61/2007, 5/2009, 101/2010, 24/2011, 78/2011, 57/2012, 47/2013 i 68/2014.

apartamentit familjar të personit fizik, i cili blen banesën e parë për hapsirën, e cila për blerësin dhe anëtarët e familjes së tij është 40 m2, dhe të cilët nga 1 korriku i vitit 2006 nuk kanë pasur në pronësi apo në bashkëpronësi banesë e cila gjendet në territorin e R. së Serbisë, edhe atë 15 m2 për çdo anëtarë të familjes sipas kushteve të përcaktuara. Si blerës të banesës së parë famijare, sipas paragrafit 1 të këtij neni konsiderohen personat të cilët bashkëjetojnë me blerësin ; bashkëshorti, fëmijët e blerësit, të adoptuarit e blerësit, fëmijët e bashkëshortit, i birësuari i bashkëshortit, prindërit e blerësit, prindërit e tij adoptues, prindërit e bashkëshortit, adoptuesi i bashkëshortit blerës, të cilët kanë vendbanimin e njëjtë me blerësin e banesës së parë. Nga kjo rrjedhë se, në kuptimin e realizimit të të drejtave që mesatarisht të lirohen nga tatimi mbi bartjen e të drejtave absolute tek blerja e banesës, anëtarë familjarë të blerësit të banesës së parë, nuk konsiderohen partnerët jashtëmartesorë. Këtë qëndrim e ka marrë Ministria e financave ne vendimin e saj me nr. 430-03-00416/2011 të datës 09.09.2011.[302]

Kurse Ligji mbi tatimin në pronë në R.e Maqedonisë[303] i liron nga tatimi trashëgimtarët nga rendi i parë i trashëgimisë, duke parë parsysh që Ligji mbi trashëgiminë në rendin e parë të trashëgimisë i numëron edhe bashkëshortët jashtëmartesorë, nën kushtet e përcaktuara ligjore, prandaj mund të konkludojmë se ato janë të liruar nga pagesa e këtij tatimi.

Gjithsesi ndër problemet më të shpeshta me të cilët bashkëshortët jashtëmartesor ballafaqohen në praktikë pas pamundësisë për të trashëguar është edhe mosrealizimi i të drejtës në pension familjar të bashkëshortit jashtëmartesorë të vdekur(ndjerë). Ligji për sigurim pensional dhe invalidor[304] në nenin 28. Shprehimisht parasheh personat të cilët sipas këtij ligji konsiderohen si anëtarë të familjes të të siguruarit të vdekur dhe të cilët kanë të drejtë në pension familjarë, dhe këto janë; partnerët martesorë, fëmijët(e lindur në martesë dhe jashtë martesës të adoptuarit, thjeshtri që është i siguruar, rrespektivisht shfrytëzuesi i të drejtës së mbajtjes, nipërit, motrat dhe vëllezërit dhe fëmijët tjerë pa prindër apo fëmijët të cilët kanë njërin apo të dy prindërit të paaftë për punë plotësisht, i cili është siguruesi apo shfrytëzuesi i të drejtës së mbajtjes), prindërit (nëna dhe babi, njerku dhe njerka, dhe adoptuesit). Nga dispozitat ligjore parashihet se bashkëshortët jashtëmartesorë nuk konsiderohen sipas këtij ligji anëtarë të familjes së personit të siguruar e tani më të vdekur dhe si të tillë nuk kanë të drejtë në pension familjar. Në praktikë kemi raste, ku partnerët jashtëmartesorë të cilët kanë jetuar së bashku disa dekata kanë mbetur pa të ardhura pas vdekjes së partnerit. Gjykata Kushtetuese e Serbisë më 30.06.2011, ka refuzuar iniciativën përmes së cilës është kërkuar, që neni 28 i Ligjit për sigurim invalidor dhe pensional i R.së Serbisë të shpallet antikushtetues. *Kjo gjykatë këtë e ka bërë ngase nuk e ka autoritetin e ligjëvënësit („ Gjykata Kushtetuese...nuk krijon norma...[, ajo]...nuk ka rol dhe autorizime.....“.).* Në arsyetimin e saj, Gjykata Kushtetuese më tej deklaron ;.“. Gjykata Kushtetuese vëren se Kushtetuta.....vërteton që bashkësia jashtëmartesore është e barabartë me martesën në përputhje me ligjin...dhe për këtë arsyeje....ka vendosur që të udhëzojë

[302] http://urrgb.com/index.php?topic=4061.0, (18.01.2016).
[303] ,, Gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë” , nr.61/2004.
[304] ,,Gazeta zyrtare e R.S“, br. 34/2003, 64/2004, 84/2004, 85/2005, 101/2005, 63/2006, 107/2009, 110(2010, 93/2012, 62/2013, 108/2013, 75/2014 i 142/2014.

shkresë....Parlamentit të cilit do ti tregohet nevoja që dispozitat kontestuese të nenin 28... të hiqen....nga Kushtetuta dhe nga instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara"[305]

Ligji për sigurim invalidor dhe pensional i Maqedonisë[306] përmban formulime të njëta ligjore dhe në nenin 57. shprehimisht janë paraparë anëtarët e familjes së bashkëshortit martesor, pra të të siguruarit të vdekur, përkatësisht përjashtimi i bashkëshortëve jashtëmartesorë nga kjo dispozitë pamundëson që atyre ti realizohet kjo e drejtë. Në këtë mënyrë, të dy ligjet, jo që bëjnë vetëm diskriminimin e bashkëshortëve jashtëmartesorë por edhe drejtëpërdrejtë shkelin Kushtetutat të cilat e barazojnë bashkësinë jashtëmartesore me atë martesore, përkatësisht ligjet mbi familjen të cilët theksojnë shprehimisht që partnerët jashtëmartesorë janë të barabartë me ata martesorë në aspektin e realizimit të të drejtave dhe detyrimeve të tyre.

Sipas nenit 176. paragrafi 2. të Ligjit mbi familjen në R. e Serbisë, kur regjistrimi në regjistra publik bëhet në emër vetëm të njërit bashkëshortë, konsiderohet që regjistrimi është kryer në emër të të dy bashkëshortëve. Fitimi i të drejtave të cilat janë regjistruar në regjistra publik mund lehtë të vërtetojë nëse personi i cili ka bërë regjistrimin si titullar i të drejtave,është në martesë apo jo. Megjithatë, duke pasur parasysh se nuk kemi regjistrim të bashkësisë jashtëmartesore, lehtë mund të vijë deri të bishtërimi i të drejtave të partnerit jashtëmartesorë i cili nuk është regjistruar si pronar i patundshmërive, e cila është fituar gjatë kohëzgjatjes së bashkësisë jashtëmartesore.

Konkluzionet përfundimtare

Përmes analizës juridiko-krahasuese të dispozitave ligjore të Republikës së Serbisë dhe të Maqedonisë, jemi përpjekur që të konstatojmë se në çfarë prizmi në aspektin e efekteve juridike , martesa dhe bashkësia jashtëmartesore janë të barabarata, dhe deri në çfarë mase bashkëshortëve jashtëmartesor u njihen të drejtat e tyre. Mirëpo deri te konstatimi që kemi ardhur dhe në të cilin gjenden realisht bashkëshortët jashtëmartesorë në praktikë, është që në mes tyre nuk ekziston as barazia juridike e as ajo faktike.Sipas Kushtetutës dhe Ligjit mbi familjen në R.e Serbisë, martesa dhe bashkësia jashtëmartesore janë të barabarta plotësisht. Edhe pse, partnerët jashtëmartesorë në praktikë shumë të drejta të tyre nuk mund ti realizojnë. Kjo është si pasojë e faktit që në shumë ligje, nocioni i bashkësisë jashtëmartesore dhe i partnerëve jashtëmartesorë nuk është paraqitur si term. Kjo çon deri tek ajo, që në praktikë organet kompetente ti injorojnë të drejtat e tyre të cilat ndryshe me ato ligje u janë garantuar bashkëshortëve martesorë. Ashtu siç është theksuar edhe gjatë punimit, është e domosdoshme të bëhen ndryshime në ligjet e lartë përmendura. Vetëm në këtë mënyrë ligjet do ishin në përputhshmëri me Kushtetutën dhe njëkohësisht do arrihet siguria ligjore. Sa i përketë të drejtave të cilat u janë mohuar, thuajse të njëjta lëshime janë bërë edhe nga ana e ligjëvënësit në R. e Maqedonisë.Ligjet përkatëse në R.e Maqedonisë me mohimin e këtyre të drejtave nuk bëjnë shkelje të Kushtetutës, megjithatë shkelin të drejtat themelore të bashkëshortëve jashtëmartesorë në mënyrë të pajustifikuar. E domosdoshme është barazimi i

[305] http://www.paragraf.rs/zastupnik/17079.htm. infor.të (22.01.2016).
[306] ,, Gazeta zyrtare e R.së Maqedonisë" nr. 98 nga 01.08.2012

martesës dhe bashkësisë jashtëmartesore edhe ligjërisht edhe faktikisht në R.e Maqedonisë. Para së gjithash është e nevojshme që të futet bashkësia jashtëmartesore si kategori e veçantë juridike në të drejtën familjare dhe në mënyrë precize të definohet kuptimi dhe kushtet për themelimin dhe vlefshmërinë e saj.Në shoqëritë tona ekziston qëndrimi negativ ndaj bashkësisë jashtëmartesore e cila është si pasojë e kuptimit patriarkal dhe zakonor, të cilat ende janë mjaftë të shprehura dhe ndikojnë në rrethin tonë. Megjithatë nuk mund të vëm në dukje kritika serioze në këtë institucion të së drejtës familjare. Ky raport shoqërorë nuk është aspak kundër parimeve themelore morale në të cilën bazohen shoqëritë tona. Nuk janë të kundërta as motivet e bashkëshortëve jashtëmartesorë që të krijojnë këtë bashkësi, as marrëdhëniet të cilat lindin me formimin e saj, por as mënyra e themelimit të bashkësisë jashtëmartesore.[307] Sepse thelbi i martesës dhe bashkësisë jashtëmartesore është i njëjtë.

Edhe pse, jo vetëm ligjëvënësitë dhe organet kompetenete nuk kanë raportë të njëjtë ndaj martesës dhe bashkësisë jashtëmartesore, por edhe vetë autorët konsiderojnë se vetë partnerët në mënyra të ndryshme veprojnë. Që do të thot se, para se ata të lidhin martesë, një çift e mendon mirë kryesisht për të parandaluar që mos merrë vendim të nxitua, sepse hyrja në bashkësi martesore pa qëllime serioze mund të dërgojë deri tek ndarja. Poashtu edhe organi kompetent vërteton plotësimin e kushteve, me ç'rast mbron interesat individuale dhe shoqërore. Tek bashkësia jashtëmartesore nuk kërkohet asnjë formë për lindjen apo shuarjen e saj. Kjo dërgon deri tek ajo, që çiftet pa menduar mire krijojnë bashkësi të tillë, e cila që nga fillimi i saj ka shansa të dobëta për të mbijetuar. Nga ana tjetër, partnerët jashtëmartesorë duhet të mendojnë për të ardhmen rrethë ndarjes eventuale, që ti ruajnë llogaritë e tyre për blerjen e sendeve, dhe provat tjera që provojnë ekzistimin e bashkësisë së tyre jashtëmartesore. E gjithë kjo mund jetë shkak i përçarjes në mes veti.Kushtetuta e R. së Maqedonisë, rregullimin e bashkësisë jashtëmartesore e lë në dorë të ligjeve, edhe pse kjo, asesi nuk nënkupton që çdo ligj mund ti jep kuptim ndryshe asaj. Sepse cënohet siguria juridike, parimi i ndalimit të diskriminimit, parimi i barabartësisë dhe barazisë nëse Ligji mbi trashëgimin e njeh bashkësinë jashtëmartesore kurse Ligji për sigurim shëndetësorë dhe invalidor apo Ligji mbi mbrojtjen sociale, e injorojnë bashkësinë jashtëmartesore.

„ Letra nuk do të thotë asgjë"është thënia e famshme, të cilën partnerët jashtëmartesorë e mendojnë, dhe e shpjegojnë në thelb arsyejen, se pse ato nuk janë të përcaktuar për martesë. Megjithëse, në shoqëritë tona patriarkale, birokratike, letra nënkupton çdo gjë. Ajo nuk është provë e ndonjë dashurie, gjithashtu nuk është asnjë garancion që bashkëjetesa do të mbijetojë, por ofron disa siguri dhe poashtu nuk ngulfatë lirinë dhe individualitetin e partnerëve martesorë, sepse „ Të gjithë jemi robër të ligjit, që të mund të jemi të lirë"

Literatura

1. Gordana Kovaček Stanić „ Porodično pravo" Pravni fakultet u Novom Sadu, 2014.
2. Zoran Ponjavić„ Porodično pravo" Pravni fakultet u Kragujevcu, 2007.
3. Marija Draškić„ Porodično pravo" Institut otvoreno društvo, 1998.
4. Olga Cvejić Jančić „Porodično pravo – bračno pravo" Pravni fakultet u Novom Sadu, 2001.

[307]S. Svorcan, Nasledna prava bračnog i vanbračnog partnera, Pravni fakultet u Kragujevcu, 1999, str. 167.

5. Slobodan Panov ,, Porodično pravo ” Pravni fakultet u Beogradu, 2010.
6. Slobodan Svorcan ,,Nasledna prava bračnog i vanbračnog partnera” Pravni fakultet u Kragujevcu, 1999.
7. Hamdi Podvorica ,, E drejta trashëgimore” Prishtinë, 2006.

ASPEKTET GJINORE TË PRONËSISË SË PYJEVE DHE KULLOTAVE NË SHQIPËRI

LINDA GJERMANI[308]

UDC: 347.214.2:305 (496:23)

Abstract

In Albania pastures and forests occupy 69% of the land making agriculture and forestry the main economic drives in rural areas. In comparison to urban and agriculture land the registration of forests and pastures as private properties is lagging behind. Most of the forests and pastures still remain property of the state at different levels, thus risking poor management and degradation. A positive effect has been reached through the associations of the forests and pasture users. While the modern legislation in Albania does not discriminate women against men with regards to property inheritance, the customary law (Kanuni) allows land to be inherited and possessed only by men. As such, Kanuni remains especially in mountain areas, a real impediment to women enjoying in full their property rights. The National Federal Association of Forests and Pasture Users has contributed throughout the country to facilitate women's registration of property titles. However, there is more room for strengthening gender equality through the implementation of the Cross-sectorial strategy for property rights and further improvements of the relevant legal framework in line with the EU standards.

Fjalët e rëndësishme/Key words: të drejtat e pronësisë/property rights, çështjet gjinore/gender, kullota/pastures, pyje/forests.

Hyrje

Megjithëse së fundi në Shqipëri është arritur përparim i dukshëm në privatizim dhe krijimin e tregut të tokës ka ende dobësi në hartmin e një politike të ndërthurur dhe koherente për tokën dhe strukturat e nevojshme për manaxhimin e burimeve natyrore. Studimi synon rë analizojë aspektet gjinore të pronësisë së pyjeve dhe kullotave në Shqipëri duke rekomanduar mbështetjen që duhet për përmirësime në fushën e të drejtave mbi tokën.

Veçanërisht shqyrtohen reformat pronësore të tokës mbas vitit 1991, duke u përqendruar tek pyjet dhe kullotat, si dhe tek përfshirja gjinore dhe mbrojtja e të drejtave pronësore të grave. Artikulli do të prezantojë të drejtat pronësore si dhe përpjekjet për t'i garantuar ato krahas manaxhimit efektiv të burimeve natyrore dhe mjedisit. Njëkohësisht, do të nxirren në pah aspekte ligjore dhe proçeduriale qe disavantazhojnë gratë përsa u përket të drejtave të

[308] Doktorante pranë Institutit të Studimeve Evropiane, Universiteti i Tiranës, Shqipëri.
indagjermani@gmail.com

pronësisë, veçanërisht për pyjet dhe kullotat. Artikulli sugjeron gjithashtu edhe ndërhyrje konkrete të mundshme për të garantuar të drejtat e barabarta të grave në këtë fushë dhe përmirësimin e punës së organeve përkatëse shtetërore, të cilat të cilat duhet të jenë garantuese të zbatimit të këtyre të drejtave në praktikë.

1. Informacion i shkurtër mbi gjendjen aktuale të pronësisw së tokave dhe kullotave në Shqipëri

Sipërfaqja e Shqipërisë llogaritet si 28,750 km², nga të cilat toka e punueshme bujqësore zë rreth 9%, ndërsa pyjet dhe kullotat zënë rreth 69%. Shqipëria ka një territor kryesisht malor me pyje të shumta një pjesëe të cilave përbën fondin pyjor kombëtar. Nga 1,498,957 milion ha pyje: 294,957 ha ose 19.68% përbëhen nga pyje të larta, 405,016 ha ose 27.02% nga pyje të krasitura, 41,724 ha ose 16.13% nga shkurre dhe 557,260 ha ose 37.17%[309] janë pyje te ulta. Tokat bujqësore dhe pyjet janë dy komponentë të rëndësishëm të manaxhimit të tokës dhe përgjithësisht për ekonominë në zonat rurale.

Reformat e viteve 90 jane shoqëruar me emigrim të brendshëm masiv si dhe emigracion jashtë vendit, sidomos të meshkujve. Emigracioni dhe roli tradicional i grave ne zonat rurale dhe ato malore bëjnë që bujqësia dhe ekonomia pyjore te kenë një domethënie të veçantë për gratë.

Ndonëse duke filluar nga vitet 90, shumica e tokës arë dhe ndërtesave u janë shperndarë individëve dhe familjeve, shumica e pyjeve dhe kullotave ka mbetur në pronësi të shtetit dhe për shkak të dobësive të vërejtura në manaxhimin dhe zbatimin e legjislacionit, janë shfaqur edhe degradim dhe dëmtime të ndryshme. Gjithashtu, ndërkohë që regjistrimi i tokave bujqësore dhe pronave në zonat urbane është pak a shumë në përfundim, pyjet dhe kullotat janë lënë jashtë këtij proçesi. Aktualisht pronësia mbi pyjet i takon në masën 52% shtetit, 44% komunave dhe 4% privatëve. Për të përmirësuar manaxhimin si dhe për të forcuar të drejtat pronësore mbi pyjet, janë krijuar shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave.

Në Shqipëri, është vërejtur mungesa e një politike koherente dhe strategjije përkatëse për tokën. Ndonëse privatizimi i shpejtë i pronave dhe krijimi i tregut të tokave ishte i nevojshëm, ekzistenca e shumë institucioneve që merren me këto çështje ka sjellë fragmentarizim dhe mbivendosje kompetencash. Shumë nga këto probleme janë ndërmarrë për t'u adresuar nga Strategjia Ndërsektoriale për reformën në fushën e të drejtave të pronësisë, për vitet 2012-2020. Veçanërisht për pyjet dhe kullotat, strategjia synon të zgjidhë regjistrimin e tyre në ZRPPL (Zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme), konsolidimin e pronësisë shtetërore me anë të inventarizimit dhe zhdukjes së mbivendosjeve, kalimin e pronësisë tek njësitë vendore, dhe zhvillimin e të drejtave pronësore me përparësi në zonat turistike, për shkak të potencialit të tyre ekonomik.

[309] Lako, T., Lako, T., Analize e pyejve private dhe komunale në Shqipëri dhe roli i saj në proçesin e hartimit të Strategjise kombëtare të pyjeve, 2008.Faqja 6.

Nga ana ligjore, mbeten ende për t'u sqaruar plotësisht rolet e ministrive të linjës, komunave, shoqatave të përdoruesve të pyjeve dhe kullotave dhe policisë pyjore, në përputhje me parimin e decentralizimit të manaxhimit te këtyre pronave. Strategjia parashikon edhe dhënien e të drejtave koncesionare për shfrytëzim, mirëmbajtje dhe rehabilitim dhe pasqyron direktivat e BE në këtë fushë.

Ndërkohë që gratë janë shpesh përdorueset kryesore të tokës për banim dhe bujqësi, për shkak të traditës, atyre shpesh u janë mohuar të drejtat pronësore mbi të dhe burime të tjera natyrore. Ndonëse ligjet aktuale janë të paanshme nga pikëpamja gjinore, ndikimi u kanunit praktikisht u mohon të drejtat trashëgimore grave në shumë zona të vendit, sidomos ato malore, por jo vetëm. Në përgjigjje të kësaj situate, Federata kombëtare e pyjeve dhe kullotave ka krijuar një njësi të posaçme për gratë dhe të rinjtë me përfaqësuese femra nga të gjitha qarqet.

2. Ecuria ligjore mbi pronësinë e pyjeve dhe kullotave në Shqipëri

Ligji i parë mbi pyjet në Shqipëri është miratur në vitin 1923 dhe dallonte pyjet dhe kullotat private, komunale (në nivel fshati) dhe shtetërore. Të gjitha u shtetëzuan plotësisht në vitin 1945. Në dëm të sipërfaqeve pyjore, gjatë viteve 60 u hapën shumë toka të reja me një sipërfaqe prej rreth 250 000 ha. Me rikthimin e pronësisë private në vitet 1990 u kthyen rreth 4% e pyjeve tek pronarët privatë të mëparshëm. Që nga viti 2005 dhe me amendimet e mëtejshme, komunat morën të drejta administrative e më pas pronësore mbi pyjet dhe kullotat në territorin e tyre.

Pyjet dhe kullotat në afërsi të fshatrave kanë pësuar dëmtime si pasojë e mbishfrytëzimit dhe kjo ka qenë akoma më e theksuar aty ku pronësia ka qenë e paqartë. Aktualisht, Ministria e brendshme nepërmjet agjensisë përkatëse ka përpiluar inventarin e pronave që mund t'ju transferohen njësive vendore, të cilat në vijim mund t'ua kalojnëfshatrave dhe shoqatave të përdoruesve. Në realitet, vetem pak komuna kanë regjistruar pronat e tyre si pasojë e problemeve me hartat shoqëruese dhe kostot e lidhura me tatimin për kalimin e pronësisë. Kjo e fundit është zgjidhur vetëm para dy viteve me një vendim të qeverisë që çliron njësitë vendore nga pagesa e këtij tatimi.

Shoqatat e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në nivel komune dhe Federata kombëtare e përdoruesve të regjistruara si persona ligjorë, kanë ndikuar për një manaxhim më të mirë të këtyre pasurive si dhe për të mbrojtur të drejtat pronësore të lidhura me ekonominë pyjore. Pyjet e manaxhuara nga komunat janë përdorur me më pak efektivitet se sa ato private ndërsa ato nën juridiksionin e qeverisë qendrore janë tej-shfrytëzuar dhe pjesërisht shkatërruar. Në veri kufijtë tradicionalë (të vjetër) janë të njohur por pronat nuk janë regjistruar, ndërsa në jug, veçanërisht në zonën bregdetare, kufijtë janë të paqartë, edhe pse pyjet e kullotat përdoren nga komunitetet. Strategjija ndërsektoriale për të drejtat pronësore për 2012-2017 parashikon 3,723 ha pyje të caktuara si pronë për kompensim nga Agjensia për kthimin dhe kompensimin e pronave. Mbi 71 000 ha pyje do duhet të transferohen nga qeveria në fondin e kompensimit fizik.

Ndërkohë që Strategjia parashikon edhe hapa konkrete për te përmirësuar dhe konsoliduar manaxhimin e pyejeve dhe kullotave, çështja e pronësisë mbetet një nga më të rëndësishmet, pasi ajo sjell me vete të drejta të rëndësishme, përtej atyre të përdorimit, pasi pronësia mund të hipotekohet si garanci ose kolateral, ndërsa të drejtat e përdorimit janë mjaft më të kufizuara në këtë aspekt.

3. Barazia gjinore dhe të drejtat e pronësisë

Ndonëse janë përdorueset parësore të tokës, grave u mohoet shpesh e drejta e pronësisë mbi të, kryesisht për shkak të mbizotërimit të zakoneve të vjetra. Pronësia mbi tokën sjell me vete përfitime ekonomike të drejtpërdrejta jo vetëm nëpërmhjet prodhimit bujqësor por edhe si të ardhura nga dhënia me qera, ose marrjen e huave për konsum apo investim në prodhim. Pa patur pronësi individuale ose të përbashkët të karakterit formal mbi tokën ose burimet e tjera natyrore, gratë nuk mund të gëzojnë përfitimet e mësipërme. Pronësia zakonisht forcon rolin e gruas ne vendimarrjen dhe ekonominë shtëpiake.

Pabarazia gjinore në pronësinë e tokës është një dukuri e njohur në botë e shfaqur kryesisht në mungesën e të drejtave të pronësisë ose në dhënien e të drejtave dytësore, qe do të thotë të atyre nëpërmjet lidhjes me meshkujt e familjes. Kjo bën që shumë gra të humbasin pronësinë në rast ndarjeje, vdekjes së bashkëshortit ose emigrimit. Të dhënat gjithashtu dëshmojnë se sipërfaqja e tokave të zotëruara nga gratë është përgjithësisht më e vogël se ajo e burrave dhe me cilësi më të ulët. Shífrat krahasuese nga regjistrimet e fermave bujqësore në nivel botëror tregojnë se më pak se 20% e zotëruesve të tokave janë gra.

Në Shqipëri të dhënat tregojnë se tradita e vjetër përcakton ende në një shkallë të lartë rolet gjinore në pronësinë e tokave dhe burimeve të tjera natyrore. Në shumicën e rasteve prona regjistrohet në emër të kryetarit të familjes dhe ndërsa për truallet urbane ligjërisht kërkohet regjistrim për të dy, për tokat bujqësore është vetë ligji që parashikon regjistrim dhe titull pronësie vetëm në emër të kryefamiljarit. Në shumicën dërrmuese të rasteve kur gratë i bashkohen familjeve të tyre të origjinës ato humbasin kështu të drejtën për tokën e fituar gjate viteve të martesës. Përveç forcës së traditës, në shumë raste një shkak më shumë për këtë situatë bëhet edhe mungesa e mjeteve financiare për të filluar proçedurat ligjore për fitimin e të drejtës mbi pasurinë. Në moshat e reja mungon ndërgjegjësimi i grave për të drejtat e tyre dhe institucionet ku mund të drejtohen. Megjithatë, vetëm 30% e grave janë të ndërgjegjësuara për përfitimet që rrjedhin nga regjistrimi i përbashkët i pasurive, dhe kjo përqindje është akoma më e ulët në zonat fshatare. Përjashtim nuk bëjnë as mjaft gra me nivel të lartë arsimor të zonave qytetare.

Shqipëria ka përqindjen më të lartë të tokës private të punuar nga njësitë familjare, krahasuar me vendet e tjera të Evropës lindore dhe jugore. Ndërkohë që shumë meshkuj kanë emigruar për punë jashtë vendit, mbingarkesa me punë e grave është rritur si pasojë, edhe pse pjesëmarrja e tyre në forcën e punës në sektorët formal është vetëm 56%. Në bujqësi, diferenca e pagesës midis burrave dhe grave është 50%, duke qenë më e theksuar se në sektorët e tjerë (25%).

4. Korniza ligjore

Legjislacioni shqiptar është përgjithësisht në përputhje me normat ndërkombëtare të përfshirjes së burrave dhe grave në pronësi, pa vendosur forma diskriminimi.

Kodi civil që daton nga viti 1991 përcakton të drejtat për të gëzuar pronësi. Në të njtën kohë, kodi përcakton tokën bujqësore si tokë të "familjes" e cila nuk duhet të ndahet midis anëtarëve, me përjshatim të rasteve të rralla dhe specifike. Në këtë kuadër neni 224 thekson se në çështjet e pronësisë ferma përfaqsohet nga kryetari i familjes, i cili në shumicën e rasteve është burrë dhe është i vetmi që regjistrohet në kartelën përkatëse të dokumentave të pronësisë në ZRPP. Gruaja trashëgon njëlloj si fëmijët dhe në mungesë të tyre 50% të tokës bashkë me trashëgimtarë të tjerë. Në bazë të kodit civil motrat dhe vëllezërit trashëgojnë në mënyrë të barabartë. Për të mbrojtur të drejtat e antarëve të tjerë të familjës dhe sidomos të gruas, ligji 8337, i 30.04.1998 "Mbi kalimin e pronësisë së tokave bujqesore, moçaleve, pyjeve dhe kullotave", kërkon prokurë nga çdo antar i familjes për të mundësuar transaksione me pronën, ndërsa për trojet urbane kërkohet që çdo antar në pronësi që fuguron në kartelë të nënshkruajë të gjitha dokumentet e transaksionit. Nga ana institucionale këto regulla mbikqyren dhe zbatohen nga noterët dhe ZRPP. Çuditërisht, ligji 7829, i 01.06.1994, për shërbimin e noterisë, ndërkohë që kërkon përfshirjen e bashkëshortes/ bashkëshortit në të gjitha dokumentat për shitjen, nuk e kërkon këte gjë për blerjen, duke e lënë kështu gruan jashtë regjistrimit në kartelën e pronësisë. Për rrjedhojë, në rastin e shitjeve të mëpasshme, vdekjes ose divorcit, gruas i duhet të hapë gjyq për të rivendosur të drejtat e saj të pronësisë sipas kodit civil dhe atij të familjes.

Ligji nr. 9970, 2008, "Mbi barazinë gjinore" dhe ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" rregullojnë aspekte të përgjithshme të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi si dhe përcaktojnë rolin e mekanizmave të ndryshme për garantimin e këtyre të drejtave. Këto ligje nuk shprehen veçanërisht për të drejtat pronësore të grave, por ligji për barazinë ligjore ka siguruar formimin e Këshillit Kombëtar për barazinë gjinore, me qëllim sigurimin e barazisë gjinore në të gjitha politikat dhe programet e qeverisë.

Si ç'është theksuar edhe më lart, të drejtat pronësore zakonore janë në mospërputhje me të drejtat që jep ligji i sotëm. Kanuni, me variacione sipas krahinave të ndryshme (i Lekë Dukagjinit për veriun e Shqipërisë, i Skënderbeut për Shqipërinë e mesme dhe ai i Idris Sulit për krahinat malore jugore) përmban nene të posaçme për përdorimin e tokës private dhe publike, por të gjithë diskriminojnë në kurriz të gruas. Konkretisht, sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit, gruaja nuk ka të drejta ndaj pasurisë së paluajtshme dhe këto pasuri nuk mund t'u transferohen grave, pasi mund të ndahen vetëm mes trashëgimtarëve meshkuj. Sipas Kanunit, gruaja mund vetëm të marrë dhurata nga familja e saj të dhëna për martesën. Gjithashtu, fshatrat kanë patur tradicionalisht të drejtën për të përdorur si fshat ose të ndarë në fise pyjet dhe kullotat afër vendbanimit të tyre, bazuar në marrveshjen me këshillin e pleqve të fshatit.

Nën të drejtën zakonore, kur djali largohet nga shtëpia, nuk humbet të drejtën e pronësisë mbi tokën, ndërsa kur martohet vajza dhe lë shtëpinë e saj të lindjes, ajo humbet të drejtën edhe të përdorimit të tokës së familjes. Kjo praktikë vazhdon në shumë zona edhe sot, ku

trashëgimtarë të tokës bëhen kryesisht djemtë, dhe vajzat detyrohen të heqin dorë nga e drejta e tyre e trashëgimisë.

5. Sfondi i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrjen ekonomike.

Me fillimin e viteve 1990 pronat e zotëruara më parë nga shteti ose/dhe kooperativat bujqësore u regjistruan kryesisht në emër të burrave, duke krijuar kështu një varësi ekonomike të grave ndaj burrave. Gjithashtu, shifrat e nivelit të punësimit të grave nuk pasqyrojnë realitetin përsa i përket anagzhimit të tyre konkret në punë, pasi nuk përfshijnë rolin riprodhues dhe shoqëror që ato luajnë në familje dhe vijimësinë e saj.

Niveli i ulët i zotërimit të pronësisë (vetëm 8% e grave zotërojnë prona në mënyrë ligjore/formale) dhe mungesa e poltikave të favorshme për nxitjen e sipërmarrjes private të grave, kanë rezultuar në një numër të pakët grash që drejtojnë sipërmarrje të vogla, të mesme ose të mëdha. Kështu në vitin 2005, vetëm 17 % e ndërmarrjeve bujqësore drejtoheshin nga gratë, me një ngritje të vogël prej vetëm 1% në vitin 2010 ndërkohë që sipas INSTAT "Femra dhe Meshkuj në Shqipëri 2013" në vitin 2012 58,5% e femrave punonin në në bujqësi, ndërkohë që meshkuj punonin vetëm 38,8%[310]. Sipas statistikave të prodhuara nga INSTAT, 18% e drejtuesve të ndërmarrjeve private janë gra. Ndonëse rreth 70 % e grave që jetojnë në zonat fshatare punojnë në bujqësi, vetëm 6% e fermave zotërohen ose drejtohen prej tyre. Shifrat e papunësisë në këto zona nuk janë të llogaritura zyrtarisht, pasi të rriturit në moshë pune që jetojnë në këto zona konsiderohen si të vetëpunësuar në ekonominë e tyre familjare, duke humbur kështu të drejtën për ndihmë ekonomike papunësie.

Në të njëjtën kohë, gratë e zonave fshatare kanë më pak mundësi për t'u bërë pjesë e organizimeve sociale si shoqatat, kooperativat apo grupet e ndryshme të interesit, gjë që sjell nivel të ulët pjesëmarrjeje dhe ndikimi në vendimmarrjen ekonomike dhe politike. Ndërkohë që me zgjedhjet vendore të vitit 2015 janë arritur përparime të ndjeshme në pëerfaqsimin gati në kuotën 50 % të grave në këshillat bashkiake ngelet mjaft për të bërë përsa i përket fushës ekonomike. Këtu do të syhohet në koordinimin e ndërhyrjeve që sjellin fuqizimin ekonomik të grave duke rritur aksesin e tyre në asetet financiare dhe pronësinë, si dhe nxitjen e sipërmarrjes ekonomike në zonat fshatare për të fuqizuar pavarësinë ekonomike të grave. Po kështu, strategjia parashikon edhe përmirësimin dhe forcimin e zbatimit të legjislacionit për regjistrimin e pasurive, veçanërisht në lidhje me martesën dhe divorcin.

Përvoja ka treguar se veprimtaritë me përfitime dhe rezultate konkrete janë ato që nxisin gratë të marrin një rol më aktiv dhe të kërkojnë zbatimin e të drejtave të tyre. Disa nga reflektimet më të mira për këtë janë bërë në raportin e Bankës Botërore: "Çështjet gjinore dhe praktikat më të mira nga projekti i administrimit të tokës: Një raport sintetik". Një nga përfundimet e arritura është që legjislacioni modern që siguron barazinë gjinore në çështjet e pronësisë, zbatohet në mënyrë joefektive në prani të të drejtës zakonore që nuk njeh barazinë në pronësi mes burrave dhe grave. Në këto kushte kërkohen ndërhyrje më të strukturuara se sa thjesht miratimi i një legjislacioni të përparuar por që mbetet gjërësisht i pazbatuar.

[310] Botimi i vitit 2015 nuk jep të dhëna në këtë drejtim.

Ndërhyrje të tilla mund të përgatiten duke mbledhur dhe analizuar paraprakisht informacionin e duhur për gjendjen socialekonomike dhe kulturore nga pikëpamja gjinore dhe që përfshin legjislacionin në fuqi dhe të drejtën zakonore mbi pronësinë, politikat dhe institucionet e ngarkuara me administrimin e tokës dhe pronave në përgjithësi, si dhe transaksionet e zhvilluara në treg.

Më poshtë po rendisim disa nga veprimtaritë e mundshme me aspekte gjinore në fushën e politikave dhe administrimit të tokës:

- Reforma e politikave ligjore: këtu mund të përfshihen projekt-ligje të cilat përfshijnë proçedura të caktuara për përfshirjen e grave dhe për të mbrojtur pozitën e të drejtat e tyre në tapitë dhe dokumentet e pronësisë, garantimin e zbatimit të kodeve të martesës dhe të trashëgimisë familjare të cilat nuk diskriminojnë në kurriz të gruas, nxitjen e barazisë gjinore në shpërndarjen e tokave shtetërore sipas legjislacionit dhe rregullave në fuqi, si dhe ligje që sigurojnë një përfaqsim të ndjeshëm të grave në organet e ngarkuara me administrimin e tokave në të gjitha nivelet.

- Ndërgjegjësimi i shoqërisë: bashkëpunimi me partnerët vendorë për të zhvilluar një program të gjerë ndërgjegjësimi mbi të drejtat e grave dhe aksesin në shërbimet e regjistrimit të tokës, mënyrat e regjistrimit të tyre dhe përfitimet nga përfshirja e grave në titujt /tapitë e pronave, pjesëmarrjen aktive të grave në takimet me komunitetin si dhe në takime të posaçme organizuar enkas për to, zhvillimin e vëzhgimeve të rregullta për klientët duke mbledhur të dhëna të ndara sipas gjinive.

- Zgjidhje mosmarrëveshjesh: caktimi i personelit të veçantë në institucionin e regjistrimit të pasurive/tokës së trajnuar dhe specializuar për çështjet e barazisë gjinore i cili/cila të veprojë si pikë ndërlidhëse për barazinë gjinore, mbështetja e programeve të ndihmës ligjore për gratë si dhe sigurimi i ndihmës ligjore të nevojshme për burrat dhe gratë në nivel vendor.

- Zhvillimi institucional: Përfshirja e barazisë gjinore si një objektiv i posaçëm në politikën organizative të ZRPP, krijimi i një njësie të barazisë gjinore brenda kësaj administrate.

- Shërbime të veçanta për gratë gjatë veprimtarive të regjistrimit dhe shpërndarjes së tapive të tokave dhe pronave; angazhimi i një avokati/eje për gratë, që mund të ofrojë këshilla individuale, të punojë me gratë rast pas rasti gjatë shqyrtimit të pronës së tyre si dhe të kërkojë risi që mund të përdoren për të mundësuar pjesëmarrjen më aktive të grave në proçesin e regjistrimit dhe dhënies së tapive për pronat.

- Afishimi i të dhënave për pronat para dhënies së tapive: organizimi i sesioneve informuese për gratë lidhur me dokumentimin e pronësisë si dhe i linjave telefonike për shpjegim dhe konsultim, mbështetja e kërkesave për apelim nga gratë, duke

siguruar ndihmë këshilluese ligjore për to, si dhe përdorimi i mjeteve të informimit publik për të rritur nivelin e informacionit në këtë drejtim.

- Tapitë e pronave dhe dhënia e tyre: të sigurohet që tapitë t'u jepen njëkohësisht pronarëve meshkuj dhe femra, verifikimi i saktësisë së tapive dhe përfshirjes në to të emrave të të gjithë pronarëve të ligjshëm qoftë burra, qoftë gra, si dhe garantimi i zbatimit rigoroz të rregullave nga ZRPP lidhur me përfshirjen në transaksionet pronësore të të gjithë pronarëve të ligjshëm.

Disa projektë të zbatuara në Shqipëri në fushën e pronësisë dhe manaxhimit të tokës dhe pyjeve kanë punuar në këto drejtime, por shpërndarja gjeografike nuk ka mbuluar të gjithë vendin, duke arritur vetëm rezultate të pjesshme. Ndërkohë, komponentët e tyre që kanë punuar me administratën qendrore dhe vendore kanë ndikuar përtej zonës së zbatimit të drejtpërdrejtë. Veçanërisht, në fushën e ndërgjegjësimit dhe rritjes së kapaciteteve të përfituesve, mbetet ende shumë për t'u bërë. Ka ende nevojë për të bërë specifikimet e duhura ligjore për sa u përket mënyrës së regjistrimit të të drejtave të pronësisë dhe përdorimit për të gjithë pjesëmarrësit në pronësi, burra dhe gra.

Në përgjithësi, i gjithë proçesi i regjistrimit të pronësisë ka nevojë për një fokus gjinor më të fuqishëm. Ndërkohë, për tokën bujqësore mundësitë për të forcuar pozitat e grave janë më të pakta përsa kohë mbetet në fuqi Kodi civil i tanishëm dhe rrjedhojat/fryma e tij në ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Çështja është diskutuar gjatë 20 viteve të fundit por duket qe ka munguar vullneti politik për të ndryshuar gjërat dhe për të korigjuar gjendjen e disfavorshme për gratë. Mbetet ende për të specifickuar se si do të identifikohen dhe sanksionohen të drejtat e pronësisë dhe të përdorimit për pyjet dhe kullotat dhe se si do të pasqyrohen ato në dokumentet e regjistrimit të pronave në ZRPP dhe në komuna. Psh. Ligji për noterinë dhe ai për regjistrimin duhet të kërkojnë që të dy bashkëshortët të përfshihen në të gjitha dokumentet ligjore, kontratat, në të gjitha transaksionet dhe kartelën e ZRPP, si një praktike standarde. Gjithashtu një rishikim më i guximshëm i legjislacionit për tokën bujqësore duhet të sigurojë që toka të regjistrohet në emër të të dy bashkëshortëve dhe jo vetëm në emër të kryetarit të familjes, si ç'është deri tani. Një ndryshim i tillë duhet të behet si në Kodin civil, po ashtu edhe në ligjin për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, gjë që nuk është detyrimisht e lehtë, por e domosdoshme në rast se duam të sigurojmë barazinë gjinore.

Në tërësi, ndryshimi i traditës dhe zakoneve ekzistuese, të disfavorshme për gratë kërkon një kombinim të ndërhyrjeve në kornizën ligjore me ndërgjegjësimin e mëtejshëm dhe avokacinë si dhe rezultate të prekshme të projekteve që dëshmojnë ndikimin pozitiv të kontributit të grave në statusin ekonomik të familjeve dhe të komuniteteve.

6. Përfundime dhe rekomandime

Shqipëria ka arritur përparim të ndjeshëm gjatë dy dekadave të fundit në privatizimin e pronave dhe krijimin e tregut të tokave. Shumica dërrmuese e pronave në zonat qytetare dhe fshatare janë privatizuar dhe mund të tregtohen lirisht. Megjithatë, ka patur mangësi në

zhvillimin e një politike të gjërë dhe të plotë për tokat si dhe strukturën e manaxhimit të burimeve natyrore. Lidhur më ngushtë me të drejtat e pronësisë, manaxhimin e pyjeve dhe kullotave dhe përfshirjen e barazisë gjinore në to mund të punohet më tej në këto fusha:

1. Pyjet dhe kullotat:

Mbështetje me rritje aftësish dhe fonde për:

- ✓ Përgatitjen e planeve manaxhuese për 410,000 ha kullota dhe pyje
- ✓ Përfundim i inventarit kombëtar
- ✓ Ndërtimi i arkivit elektronik për pronat e paluajtshme që u janë kaluar në pronësi njësive vendore sidomos mbas kryerjes së reformës administrative territoriale të vitit 2015.
- ✓ Përfundimi i regjistrimit të pronave të zotëruara ose administruara nga njësitë vendore dhe administrata qendrore. Rritja e kordinimit midis institucioneve gjatë proçesit të transferimit të pyjeve dhe kullotave pronë shtetërore duke unifikuar aktet nënligjore dhe hartuar plane veprimi të përbashkëta.
- ✓ Hartimi i një ligji tëri dhe aktet përkatëse nën-ligjore për pyjet dhe kullotat, në përputhje me legjislacionin e BE në këtë fushë.

2. Barazia gjinore:

- ✓ Përmirësimi i kornizës ligjore për çështjet e barazisë gjinore

Kjo përfshin psh., adresimin e mospërputhjes mes kushtit për të dhënë gruaja miratim për shitjen e pronës me mungesën e këtij kushti për mblerjen e pronës. Gjithashtu, do të duhej edhe korigjimi ligjor për regjistrimin e tokës bujqësore në emër të të dy bashkëshortëve, pa përjashtuar gruan si'ç parashikon legjislacioni i tanishëm

Bibliografi

- INSTAT, Femrat dhe Meshkujt në Shqipëri 2013, 2014, 2015
- INSTAT, Rezultatet paraprake të censusit të ndermarrjeve bujqësore, 2012
- Studim mbi zotërimin e tokës dhe çështjet gjinore në Shqipëri, Orgut, 2012,
- Qeveria shqiptare: Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe reduktimin e fhumës mbi bazë gjinore dhe dhunës në familje. 2011-2015
- Jazaj, Sonila, Studim paraprak i Këshillit të Evropës për rrezikun e korrupsionit nësistemin shqiptar të regjistrimit tëpasurive të paluajtshme, 2010.
- Kelm, Kathrine, Studim mbi sigurinë e tapive të regjistruara në Shqipëri, Banka Botërore, Projekti për administrimin dhe manaxhimin e tokave, 2009.
- Kola, H., Nevojat dhe të drejtat e komuniteteve lokale për prodhimet dhe shërbimet pyjore dhe manaxhimi iqendrueshëm i pyjeve në Shqipëri, 2007.
- Lako, T., Analize e pyjeve private dhe komunale në Shqipëri dhe roli i saj në proçesin e hartimit të Strategjise kombëtare të pyjeve, 2008.
- Raport nga Seminari kombëtar "Përmirësimi i kornizës ligjore për manaxhimin e qndrueshëm të pyjeve komunalë dhe kullotave në Shqipëri", 2008.
- Schmitz, Catharina, Raport për forcimin e fokusit të fuqizimit ekonomik tëgrave në programe të përzgjedhura nga portofoli i programit për Shqipërinë, 2010.

- Sida: Studim për pronësinë e tokave dhe barazinë gjinore, në Shqipëri.Orgut Consulting AB, Kelm, Kathrine, 2012.
- Sida: Barazia gjinore për zhvillimin: resultate dhe mësime të nxjerra, 2011.
- Sida: Pronat e burimeve natyrore: Një dokument prezantues, 2007.
- SNV, Mësime të nxjerra nga nismat locale për të luftuar prerjen e paligjshme të pyjeve dhe korrupsionin në manaxhimin e pyjeve, 2011.
- SNV-Sida: Forcimi i pylltarisë së qendrushme nëShqipëri, Një proçes pjesëmarrës identifikimi në nivel fshati dhe përdoruesi, 2011.
- Banka Botërore, Çështjet gjinore dhe praktikat më të të projekteve të administrimit të tokave: Raport sintetik, 2005.
- Banka Botërore, Vlersimi i ndikimit gjinor të projektit të admisnitrimit të tokave në Ballkanin perëndimor në nivel vendi: Shqipëria, Bosnje –Hercegovina, Mali i zi, qershor 2011.
- Baka Boltërore dhe IFAD, Paketë udhëzimesh for integrimin e çështjeve gjinore në projektet për politikat dhe administrimin e tokave, 2009.
- Banka Botërore,Informim i shkurtër, Qeverisja në mbrojtjen e të drejatve për pasuritë e paluajtshme në Shqipëri, Një sfidë në vazhdim, 2011.
- Kanuni i Lekë Dukagjinit. Shtëpia botuese Gjonlekaj, 1989.